



Centre for Legal
Empowerment

www.cle.al



Mbështetur nga:

FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

ANALIZË E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR PËR ROLIN E PARALIGJORIT DHE VLERËSIMI I EKZISTENCËS SË KUSHTEVE PËR PËRFSHIRJEN E KËTIJ PROFESIONI NË LISTËN KOMBËTARE TË PROFESIONEVE

AUTORET:

Av. Iris ALIAJ

Av. Erinda MELI

FALËNDERIME

Një falënderim i veçantë u drejtohet organizatave jofitimprurëse dhe paralogjorëve, të cilët mundësuan të sillnin eksperiencën shqiptare për profesionin e paralogjorit dhe që iu përgjigjën pyetësorit në komponentin sasior dhe cilësor: Znj. Romina Sefa, Qendra për Advokim Social, Znj. Ferdiola Tare, Qendra T'REJA, Ervis Çota, Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome, Znj. Erida Skëndaj dhe Znj. Ardita Kolmarku, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Znj. Rajmonda Bozo, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, Dorina Ndreka, avokate pranë Klinikës së Ligjit pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Griselda Dama, juriste pranë Klinikës së Ligjit Shkodër, Znj. Samanda Dulja, Z. Fatjon Kaca, dhe Z. Gentian Sejrani.

Falënderojmë Z. Ergys Qirici, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Ministria e Drejtësisë dhe stafi i tij për informacionin që na kanë vënë në dispozicion në kuadër të këtij studimi.

Falënderojmë ekspertët ndërkombëtarë të kontaktuar për efekt të këtij studimi, të cilët kanë ndihmuar në analizën e shteteve si Maqedoni, Gjeorgji dhe Ukrainë: Znj. Aneta Trajkovska, avokate në Maqedoni, Znj. Veronica Teleuca, avokate në Moldavi, Znj. Daniella Misail-Nichitin, avokate, La strada, Moldavi, Z. Darko Pavlovsky, ekspert i të drejtave të njeriut në Maqedoni, Znj. Nino Khaindrava eksperte e të drejtave të njeriut dhe juriste nga Gjeorgjia në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Znj. Olga Dubinska, eksperte e të drejtave të njeriut dhe ish-juriste nga Ukraina në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura nga ekspertja ndërkombëtare, Znj. Nadejda Hriptievschi kanë ndihmuar në përmirësimin e studimit.

Një falënderim i përzemërt i drejtohet Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, i cili dha ndihmesë jo vetëm për financimin e këtij studimi, por edhe si një partner, për realizimin dhe përmirësimin e studimit.

Shpresojmë që gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e këtij studimi të jenë të dobishme për të gjithë aktorët e angazhuar në rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe ky studim fillestar të shërbejë si një fillesë për institucionalizimin dhe formalizimin e këtij profesioni.

Mohim përgjegjësie

Zhvillimi i këtij studimi u mbështet nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Ky dokument është përgatitur me qëllim studimin e mundësisë së përfshirjes së profesionit të paraligjorit në Listën Kombëtare të Profesioneve.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e autoreve dhe të kontribuesve dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

ANALIZË E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR PËR ROLIN E PARALIGJORIT DHE VLERËSIMI I EKZISTENCËS SË KUSHTEVE PËR PËRFSHIRJEN E KËTIJ PROFESIONI NË LISTËN KOMBËTARE TË PROFESIONEVE	1
FALËNDERIME	2
PËRMBAJTJA E LËNDËS	3
SHKURTIME	6
Hyrje dhe Metodologjia.....	9
Përmbledhje ekzekutive	11
PJESA I	13
ANALIZA E LEGJISLACIONIT, RREGULLIMI LIGJOR DHE PRAKTIKA E PROFESIONIT TË PARALIGJORIT, DETYRAT FUNKSIONALE, PUNËSIMI, TRAJNIMET, FINANCIMET, NË MAQEDONINË E VERIUT, MOLDAVI, UKRAINË, GJEORGJI, SIERRA LEONE, AFRIKË E JUGUT, FILIPINE	13
A. MAQEDONI E VERIUT.....	13
1. Kuadri ligjor	13
2. Paraligjori në Maqedoninë e Veriut	15
(a) Programet paraligjore në fokus të organizatave maqedonase dhe OSF	16
(b) Paraligjori në ditët e sotme dhe impakti i tij në komunitetin rom.....	17
B. MOLDAVI	22
1. Sistemi i ndihmës juridike në Moldavi.....	22
2. Çfarë është një paraligjor?.....	23
3. Detyrat e një paraligjori?.....	25
4. Fazat kryesore të zhvillimit të rrjetit të paraligjorëve	26
5. Mësimet kryesore nga institucionalizimi i profesionit të paraligjorit në Moldavi	30

C.	UKRAINË	32
1.	Kuadri ligjor i sistemit të ndihmës juridike	32
2.	Praktika e sistemit të ndihmës juridike.....	33
3.	Paraligjorët në Ukrainë.....	36
1.	Kuadri ligjor i sistemit të ndihmës juridike	44
2.	Praktika e sistemit të ndihmës juridike në Gjeorgji	45
E.	SIERRA LEONE	47
1.	Kuadri ligjor i ndihmës juridike.....	47
2.	Roli i paraligjorit në sistemin e ndihmës juridike sipas ligjit të 2012 dhe praktika në zbatim të ligjit	49
3.	Paraligjorët me bazë komunitare si pjesë e programeve paraligjore të ojf-ve. vështrim i përgjithshëm.....	51
4.	Eksperienca e organizatës Timap me paraligjorët.....	53
F.	AFRIKA E JUGUT.....	64
1.	Sistemi i ndihmës juridike	64
2.	Fillesat e paraligjorëve në Afrikën e Jugut	65
3.	Paraligjori në Afrikën e Jugut në ditët e sotme.....	67
4.	Përmbajtja/modulet e kurseve dhe trajnimeve të paraligjorëve në Afrikën e Jugut	68
5.	Shembuj të punës me paraligjorët të bazuar në komunitet.....	70
G.	FILIPINE.....	71
1.	Sistemi i ndihmës juridike	71
2.	Paraligjori në Filipine.....	76
PJESA II.....		82
PARALIGJORI NË SHQIPËRI (EKSPERIENCA E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE DHE PARALIGJORËVE)		82
A.	Metodologjia.....	82
B.	Përmbledhje e gjetjeve nga pyetësorët	82
1.	Koncepti i paraligjorit	84
2.	Funksionet e paraligjorit.....	85
3.	Përzgjedhja e paraligjorëve për kryerjen e shërbimeve/detyrave	87
4.	Parashikimi dhe njohja në legjislacion.....	88
5.	Specifikat lidhur me institucionalizimin e paraligjorit	89
6.	Roli dhe detyrat e paraligjorit në rast të institucionalizimit të tij	90
7.	Roli i paraligjorit si ofrues i ndihmës juridike parësore.....	91
8.	Punësimi i paraligjorit si pjesë e ndihmës juridike, pranë qendrave të shërbimit të ndihmës	

juridike parësore, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe nga klinikat ligjore të themeluara pranë institucioneve të arsimit të lartë	92
9. Punësimi i paralogjorëve në zyra avokatie.....	93
10. Punësimi i paralogjorit në institucione shtetërore	94
11. Përfshirja e paralogjorëve në komunitet si punonjës të OJF-ve, fushat e angazhimit dhe llojet e komuniteteve	95
12. Financimi i paralogjorëve	96
13. Kriteret për të ushtruar funksionin e paralogjorit.....	97
14. Trajnimet fillestare dhe të vazhdueshme të paralogjorëve si dhe përmbajtja e kurrikulave.....	98
Pjesa III.....	102
VLERËSIMI I EKZISTENCËS SË KUSHTEVE PËR PËRFSHIRJEN E PARALIGJORIT NË LISTËN KOMBËTARE TË PROFESIONEVE	102
A. Përmbajtja e LKP duke analizuar listën e profesioneve që kanë ngjashmëri me paralogjorin ..	102
B. Analiza e LKP krahasuar me analizën e shteteve objekt studimi dhe eksperiencën shqiptare.....	118
C. Analiza e legjislacionit shqiptar lidhur me aksesin në drejtësi	123
D. Raporte monitoruese për sistemin aktual të ndihmës juridike si dhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike.....	129
E. Konstatime dhe sugjerime për institucionalizimin e profesionit të paralogjorit.....	131
INSTITUCIONALIZIMI I PARALIGJORIT NË SHQIPËRI	137
A. Rregullimi i paralogjorit në Shqipëri dhe komunitetet me të cilat mund të punojë në praktikë	137
B. Kompetencat e paralogjorëve	141
C. Mënyra e punësimit të paralogjorëve.....	142
D. Financimi i paralogjorëve	145
E. Trajnimet fillestare e të vazhdueshme	147
KONKLUZIONE DHE SUGJERIME.....	150
ANEKS 1.....	151
ANEKS NR. 2.....	154
ANEKS NR. 3.....	156
ANEKS NR. 4.....	157
BIBLIOGRAFIA	158
LIGJE 158	
RAPORTE	159
FAQE INTERNETI.....	160

SHKURTIME

LKP	Lista e re Kombëtare e Profesioneve
VKM nr. 514/2017	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të Profesioneve (LKP)”, i rishikuar
Bachelor	Programet e ciklit të parë të studimeve
Master	Programet e ciklit të dytë të studimeve
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
OSF	Fondacionet/i Shoqëria e Hapur
OJF	Organizata Jofitimprurëse
KSHNJ	Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike në Shqipëri
MD	Ministria e Drejtësisë
KM	Këshilli i Ministrave
DNJF	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në Shqipëri
QSHNJP	Qendra të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore
Ligji nr.111/2017	Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
Ligji nr.10039/2008	Ligji nr.10039, datë 22.02.2008 “Për ndihmën juridike”, i shfuqizuar
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
KL	Klinikat e Ligjit
GJK	Gjykata Kushtetuese
KEDNJ	Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Strasburg
CRD	Civil Rights Defenders

UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
QKV	Qendra javore të Këshillimit Virtual në Maqedoni
ESE	Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave në Maqedoni
KHAM	Shoqata Humanitare dhe Bamirëse e Romëve në Maqedoni
CDRIM	Qendra për Zhvillim dhe Iniciativë Demokratike në Maqedoni
HERA	Shoqata e Edukimit Shëndetësor dhe Kërkimit në Maqedoni
QLK	Qendra Ligjore me bazë komunitare në Ukrainë
NJNJ	Njësia e Ndhmës Juridike në Gjeorgji
ZNJ	Zyrat e Ndhmës Juridike në Gjeorgji
Bordi	Bordi i Ndhmës Juridike në Sierra Leone
NJAJ	Ndihma Juridike në Afrikën e Jugut
ZKK	Zyrat e Këshillimit të Komunitetit në Afrikën e Jugut
SHKPBK	Shoqata Kombëtare e Paraligjorëve të bazuar në Komunitet në Afrikën e Jugut
AKZHZZK	Aleanca Kombëtare për Zhvillimin e Zyrave të Këshillimit të Komunitetit në Afrikën e Jugut
SAQA	Autoriteti i Kualifikimeve të Afrikës së Jugut
WLC	Qendra Ligjore e Grave në Afrikën e Jugut
ZAP	Zyra e Avokatit Publik në Filipine
DHAIF	Dhoma e Avokatisë e Integruar në Filipine
GLA	Grupet e Ligjit Alternativ në Filipine
CLED	Programi i Edukimit Klinik Ligjor i Shkollës së Drejtësisë Ateneo në Filipine
IBP	Avokat i Detyrueshëm i krijuar nga Gjykata e Lartë e Filipineve
LAP	Lidhja e Avokatëve Protestantë në Filipine

LAVINI	Lëvizja e Avokatëve për Vëllazëri, Integritet dhe Nacionalizëm, Inc në Filipine
OP	Organizatë popullore në Filipine
NJQV	Njësi/zyrë e caktuar e qeverisjes vendore në Filipine
DAR	Departamenti i Reformës Agrare në Filipine
PTP	Programi i Trajnimit Paraligjor në Filipine
UGANET	Rrjeti Uganda për Ligjin, Etikën dhe HIV/AIDS
LGBTQIA	Lezbike, Gej, Biseksuale, Transgjinore, Queer, Interseks, A seksual

Hyrje dhe Metodologjia

Ky studim ka për qëllim të bëjë një analizë të legjislacionit shqiptar, më konkretisht të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve”, i ndryshuar, për të evidentuar nëse paralogjori parashikohet si profesion në këtë VKM apo jo, dhe nëse profesione të ngjashme krijojnë mbivendosje me të.

Një nga synimet e studimit është dhe realizimi i një analize të detajuar i rolit të paralogjorit në ofrimin e shërbimeve ligjore, detyrat funksionale, praktikën, kuadrin ligjor në Shqipëri dhe në vendet e tjera objekt studimi ku ky profesion është i institucionalizuar, ose ekziston në praktikë, si: Maqedoni e Veriut, Moldavi, Ukrainë, Gjeorgji, Sierra Leone, Afrikë e Jugut, Filipine.

Nëpërmjet këtij studimi do të vlerësohet ekzistenca e kushteve për përfshirjen e paralogjorit në Listën Kombëtare të Profesioneve, për të analizuar nëse ka mundësi që detyrat funksionale të paralogjorit të parashikohen në një profesion më vete dhe nëse mund të ketë mbivendosje me profesionet e tjera.

Ky studim synon t’i japë sugjerime institucioneve kompetente me qëllim parashikimin ose jo të një profesioni të posaçëm në Shqipëri të emërtuar paralogjor, domosdoshmërinë e tij si dhe rregullimin e posaçëm lidhur me detyrat funksionale, punësimin, shkollimin, trajnimet, financimin etj.

Për të arritur qëllimin e mësipërm, një analizë e detajuar është realizuar për legjislacionet dhe praktikatat përkatëse të shteteve të Evropës, Afrikës dhe Azisë, si Maqedonia e Veriut, Moldavia, Ukraina, Gjeorgjia, Sierra Leone, Afrika e Jugut dhe Filipine, eksperiencat e të cilëve i ka shërbyer eksperteve për të sugjeruar parashikimin apo jo të profesionit të paralogjorit në legjislacionin shqiptar, ose nëse është rasti, parashikimin e një profesioni të posaçëm, i cili për nga detyrat funksionale është i ngjashëm me paralogjorin.

Më konkretisht, analiza e realizuar përmban edhe një tablo lidhur me mënyrën sesi është i rregulluar paralogjori, shkollimi i tij, detyrat konkrete, paralogjorët në komunitete, trajnimet e vazhdueshme, mënyra e financimit (institucione qendrore/lokale), komunitetet me të cilat paralogjorët punojnë në vendet objekt studimi, me qëllim që të sugjerohet mënyra e rregullimit të këtij profesioni dhe nëse është rasti institucionalizimi i tij në Shqipëri. Në këtë kuadër, janë marrë në konsideratë edhe raporte të hartuara nga organizata ndërkombëtare dhe kombëtare të vendeve objekt studimi.

Gjithashtu, janë realizuar intervista me avokatë të ndryshëm, që ushtrojnë profesionin në disa vende të Evropës dhe që janë përfshirë kryesisht edhe në procesin e dhënies së ndihmës juridike si dhe juristë të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Për realizimin e këtij studimi janë intervistuar edhe organizata jofitimprurëse në Shqipëri, që kanë zbatuar projekte në të cilat janë përfshirë paralogjorë, por edhe 3 paralogjorë, të cilët kanë ushtruar këtë profesion në vendin tonë.

Në mënyrë të posaçme është analizuar VKM nr. 514/2017, që parashikon Listën Kombëtare të Profesioneve duke u fokusuar në profesione të ngjashme me paraligjorin si, asistent ligjorë, avokatë, nëpunës ligjorë dhe socialë, detyrat e këtyre profesionistëve, funksionet që mund të kryejnë etj. Me qëllim që analiza e legjislacionit të jetë e plotë dhe më e thelluar është zgjeruar fokusi i këtij studimi duke u analizuar edhe legjislacioni shqiptar, që garanton aksesin në drejtësi të qytetarëve.

Me qëllim që sugjerimet e këtij studimi të jenë të mbështetura në të dhëna cilësore dhe sasore janë marrë në konsideratë studime lidhur me nevojat e sistemit të ndihmës juridike në Shqipëri dhe nëse është rasti, i parashikimit të një profesioni të ri, që do të mund të përmirësojë mangësitë e këtij sistemi. Të dhëna të përditësuara janë vënë në dispozicion nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë lidhur me funksionimin e skemës së re të ndihmës juridike falas.

Në kuadër të realizimit të këtij studimi, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë kontraktoi një eksperte ndërkombëtare, znj. Nadejda Hriptievschi, e cila ofroi ekspertizën e saj lidhur me hartimin e një përmbledhje të shkurtër të përvojës së Moldavisë në institucionalizimin e profesionit të paraligjorit si dhe diskutime lidhur me studimin përfundimtar të hartuar nga ekspertet kombëtare.

Eksperienca shqiptare e krahasuar edhe me analizën që do t'i bëhet vendeve të lartpërmendura si dhe ekspertiza e ekspertes ndërkombëtare mundësuan dhënien e sugjerimeve konkrete për objektin e këtij studimi.

Përmbledhje ekzekutive

Studimi për paraligjorin në Shqipëri synon të analizojë VKM nr. 514/2017 për Listën Kombëtare të Profesioneve dhe legjislacionin që garanton mbrojtje për aksesin në drejtësi. Për të arritur qëllimin e këtij studimi janë marrë në analizë legjislacionet dhe ushtrimi në praktikë i profesionit të paraligjorit në shtetet si Maqedonia, Ukraina, Gjeorgjia, Moldavia, Filipine, Sierra Leone dhe Afrika e Jugut. Gjithashtu, është paraqitur edhe një tablo e detajuar lidhur me situatën në praktikë të paraligjorit në Shqipëri sjellë nëpërmjet eksperiencës së disa organizatave dhe paraligjorëve, të cilët kanë ushtruar detyrat dhe funksionet e paraligjorit.

Nga analiza e realizuar ka rezultuar se, në legjislacionin shqiptar dhe në listën e profesioneve nuk ka asnjë profesion, apo shembuj punësimi që emërtohen me termin paraligjorë. Gjithashtu, në LKP ka profesione të ngjashme, por që ndryshojnë nga një sërë elementesh me paraligjorin si punësimi, detyrat, etj.

Nga eksperiencia e shteteve objekt studimi, por edhe nga praktika e paraligjorit në Shqipëri është evidentuar rëndësia e këtij profesioni në qasjen në drejtësi të qytetarëve vulnerabël dhe atyre në zonat më të largëta. Paraligjori fuqizon komunitetet dhe i edukon ata për të drejtat e tyre dhe për të vënë në lëvizje institucionet përgjegjëse. Ky profesionist i sjell qytetarët pranë ofruesve të ndihmës juridike dhe pranë institucioneve shtetërore. Ai ka rëndësi pasi shërben si një urë lidhëse midis qytetarit dhe shërbimeve që ofrohen nga aktorë të ndryshëm, por dhe duke e sjellë rastin më afër institucioneve shtetërore, OJF-ve, klinikave të ligjit.

Referuar studimeve mbi aksesin në drejtësi është evidentuar se, nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas dhe qasje në drejtësi janë të mëdha. Përpos ndryshimeve ligjore dhe arritjeve për të garantuar aksesin nëpërmjet ndihmës juridike, në qytete të ndryshme ende ka nevojë për shërbime të ndihmës juridike falas apo shërbime të tjera që do të ndikojnë te qasja në drejtësi e qytetarëve.

Duke qenë se në të gjitha shërbimet ligjore falas është qytetari, i cili shkon pranë zyrave shtetërore, mungon një profesionist që të ndërlihd qytetarët, nevojat e tyre dhe t'i adresojë ato pranë institucioneve përgjegjëse, apo shërbimeve të nevojshme ligjore ose sociale. Në këtë kuadër nga studimi ka rezultuar se, profesionisti i vetëm që e mundëson këtë është paraligjori. Ai përmirëson qasjen në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet shërbimeve ligjore që ofron.

Përsa më sipër, me anë të këtij studimi rekomandohet që në listën e profesioneve të parashikohet edhe një grup njësi i ri profesioni i posaçëm që do të emërtohet “paraligjor”, i cili mund të përfshihet në fushën ligjore ose sociale, me veprimtari të lidhur ngushtësisht me komunitetin. Ky profesion sugjerojmë të parashikohet në LKP si pjesë e grupit të vogël të profesioneve me nr. kod profesioni 341 “Specialistë ligjor, të punës sociale dhe të fesë”, pas grupit-njësi profesioni me nr. kod profesioni 3412 “Asistentë, specialistë të punës sociale”, ose në mënyrë alternative, mund të parashikohet si shembull punësimi profesioni.

Në këtë studim është paraqitur edhe mënyra sesi mund të institucionalizohet profesioni i paraligjorit në Shqipëri, duke dhënë sugjerime lidhur me kompetencat, rolin, funksionet, mënyrën e punësimit, trajnimet, financimin e tyre. Gjithashtu, janë evidentuar edhe komunitetet me të cilat mund të punojë paraligjori.

Me konkretisht, është rekomanduar se, paraligjori duhet të përfshihet në ofrimin e ndihmës ligjore parësore duke vazhduar të kryejë një pjesë të të njëjtave funksione që ka pasur deri tani. Ai sugjerohet të ofrojë informacione dhe këshillim ligjor, vendosje të marrëdhënieve të drejtpërdrejta e të ngushta me komunitetin, edukimi ligjor i komunitetit. Ai sugjerohet të ketë kompetenca për të referuar rastin pranë ofruesve të ndihmës juridike parësore, dytësore dhe institucioneve përgjegjëse, kur është nevoja për ndihmë më të specializuar shoqërimin përpara institucioneve shtetërore, lehtësimi i komunikimit të anëtarëve të zonës ku jeton me institucionet shtetërore dhe, për raste të veçanta përfaqësimi përpara këtyre institucioneve. Gjithashtu, një rol që sugjerohet t'i njihet paraligjorit është edhe ofrimi i asistencës për ofruesit e ndihmës juridike parësore dhe dytësore me qëllim lehtësimin e punës së tyre.

Paraligjorët mund të ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e ndihmës juridike parësore, OJF dhe klinikat e ligjit. Ata mund të punësohen në qendrat e ndihmës juridike parësore, klinikat e ligjit, zyra avokatie, institucione shtetërore, OJF të autorizuar si ofrues të ndihmës juridike parësore dhe OJF që punojnë me komunitete të ndryshme, por që nuk janë pjesë e skemës së ndihmës juridike.

Financimi i paraligjorëve mund të kryhet nëpërmjet alokimit të fondeve nga pushteti qendror edhe lokal si dhe nga donatorë të ndryshëm.

Programet e trajnimit të paraligjorëve konsiderojmë se, duhet të jenë fillestare e të vazhdueshme të ofruara dhe të certifikuara nga institucione të akredituara. Trajnimi fillestar sugjerojmë që të mund të ofrohet dhe të realizohet nga sistemi i ndihmës juridike falas. Trajnim i vazhdueshëm sugjerojmë që të ofrohet nga OJF, donatorë të ndryshëm, por edhe institucione shtetërore apo vetë universitete publike e private.

PJESA I

ANALIZA E LEGJISLACIONIT, RREGULLIMI LIGJOR DHE PRAKTIKA E PROFESIONIT TË PARALIGJORIT, DETYRAT FUNKSIONALE, PUNËSIMI, TRAJNIMET, FINANCIMET, NË MAQEDONINË E VERIUT, MOLDAVI, UKRAINË, GJEORGJI, SIERRA LEONE, AFRIKË E JUGUT, FILIPINE

Në këtë pjesë të studimit do të analizojmë shtete, të cilat e kanë të parashikuar profesionin e paraligjorin në sistemin e tyre të brendshëm si dhe shtete, të cilat nëpërmjet organizatave të ndryshme kanë zbatuar projekte pilot me fokus paraligjorin. Një analizë e thelluar është bërë për të gjithë shtetet objekt studimi lidhur me legjislacionin e sistemit të ndihmës juridike, rregullimin ligjor dhe praktikën e profesionit të paraligjorin, rëndësinë e tij, punësimin, rolin dhe detyrat funksionale, trajnimet etj.

A. MAQEDONI E VERIUT

1. Kuadri ligjor

Ligji për ndihmën juridike i Maqedonisë¹ rregullon të drejtën për ndihmë juridike falas, ofruesit e ndihmës juridike falas, procedurën, përfituesit, kushtet, mënyrën, financimin, mbikëqyrjen, organet kompetente për marrjen e vendimeve, organizimin e ditëve të këshillave ligjore falas, ndihmën juridike falas në çështjet ndërkufitare (neni 1 i ligjit).

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i aksesit të barabartë të qytetarëve dhe personave të tjerë të parashikuar me ligj, tek institucionet e sistemit me qëllim realizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike efektive në përputhje me parimin e aksesit të barabartë në drejtësi. Procedura për përfitimin e ndihmës juridike falas është një procedurë urgjente (neni 2 i ligjit).

Për ofrimin e ndihmës juridike ligji parashikon si institucione kompetente Ministrinë e Drejtësisë, avokatët dhe shoqatat e autorizuara të qytetarëve (neni 4).

Neni 6 i ligjit parashikon ofrimin e ndihmës juridike falas në formën e ndihmës juridike paraprake dhe ndihmës juridike në të gjitha procedurat gjyqësore dhe administrative.

Ndihma juridike paraprake përfshin: 1) këshillim fillestar ligjor për të drejtën e ushtrimit të ndihmës juridike falas; 2) informacion i përgjithshëm ligjor; 3) plotësimin e kërkesës për ndihmë juridike falas.

Ligji për ndihmën juridike falas në Maqedoninë e Veriut nuk parashikon termat ndihmë juridike parësore dhe dytësore, por bën një ndarje ndërmjet këtyre formave në një mënyrë pak më të përgjithshme, duke konsideruar përfaqësimin dhe përgatitjen e pretendimeve me shkrim në

¹ Ligj 07-5503/1 “Për ndihmën juridike falas”, Fletore zyrtare e Republikës së Maqedonisë No.161/09

procedurat administrative dhe gjyqësore në një kategori të veçantë ndihme juridike. Kjo formë e ndihmës juridike ofrohet nga avokatë.

Ofrimi i ndihmës juridike në një procedurë përpara një institucioni konsiston në përfaqësimin në gjykatë dhe organet administrative, si dhe përgatitjen e pretendimeve me shkrim në këto procedura.

Neni 12 i ligjit parashikon një rang të gjerë përfituesish të ndihmës juridike duke filluar prej shtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendbanim të përhershëm të tillë si: 1) përfituesit e ndihmës sociale; 2) përfituesit e pensionit të invaliditetit, të cilët duhet të plotësojnë disa kushte; 3) përfitues të pensionit mujor minimal, të cilët duhet të plotësojnë disa kushte; 4) familjet ose një prind i vetëm me një ose më shumë fëmijë të mitur, të cilët kanë detyrimin për ushqim. Gjithashtu, ndihma juridike falas u ofrohet edhe personave të mëposhtëm: 1) një personi, të cilit i jepet azil, një personi të dëbuar brenda territorit të shtetit dhe një personi të dëbuar që banon në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut; 2) shtetasit të huaj, i cili në përputhje me traktatet ndërkombëtare, pavarësisht nëse banon apo jo në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ushtron të drejta që janë në kompetencë të një autoriteti shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, personit pa shtetësi që banon në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut; 3) qytetarit të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian në kushte dhe mënyra të parashikuara me këtë ligj.

Në bazë të nenit 16 të ligjit, ndihma juridike paraprake ofrohet nga zyrtarë të autorizuar në njësitë rajonale të ministrisë dhe shoqatat e autorizuara të regjistruara në regjistrin e shoqatave të qytetarëve për ndihmën juridike paraprake. Nenet 17 deri në 19 parashikojnë kushtet që duhet të përmbushin shoqatat e autorizuara të qytetarëve dhe njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë për të ofruar ndihmë juridike paraprake, ndër të cilat pasjen në stafin e tyre të paktën të një avokati të licencuar nga Dhoma e Avokatisë. Ministri i Drejtësisë merr vendim nëse duhet të ofrohet ndihma ligjore. Në bazë të nenit 27 Ministria e Drejtësisë mban një regjistër të avokatëve dhe të shoqatave të qytetarëve, që ofrojnë ndihmë juridike paraprake.

Pavarësisht këtyre rregullimeve ligjore, qytetarët maqedonas nuk janë shumë të informuar në lidhje me shoqatat e autorizuara të qytetarëve dhe njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë. Numri i personave që u drejtohen këtyre institucioneve është shumë i ulët. Në kuadër të reformës përpara i përket ndihmës juridike falas, me mbështetjen e projektit të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Mbështetja në reformat për ndihmën juridike”, është rekomanduar rritja e informacionit të qytetarëve për këto institucione dhe rritja e aksesit të tyre tek to.²

² <https://www.coe.int/en/web/cdcj/support-to-legal-aid-reforms-in-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia>

2. Paraligjori në Maqedoninë e Veriut

Referuar analizës së mësipërme të legjislacionit të ndihmës juridike, rezulton se, Maqedonia e Veriut³ nuk e ka të parashikuar paraligjorin si profesion të posaçëm, pjesë të mekanizmit të ndihmës juridike dhe as në ligje të tjera. Në kuadër të këtij studimi ne kemi kontaktuar një sërë përfaqësuesish të organizatave jofitimprurëse, avokatë e juristë të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët na kanë informuar se koncepti i paraligjorit nuk është i parashikuar në legjislacion dhe nuk njihet si profesion i posaçëm. Ky ishte një fakt që e konstatuam edhe gjatë punës kërkimore.

Gjithsesi, u vijua puna kërkimore me qëllim marrjen e të dhënave nga burime të tjera për ekzistencën apo jo të paraligjorit apo për profesione të ngjashme me të. Rezultoi se paraligjori në Maqedoninë e Veriut është parashikuar vetëm në projekte të ndërmarra nga organizata të ndryshme, edhe me ndihmën e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Maqedoninë, Bashkimi Evropian dhe që kanë pasur në fokusin e tyre të drejtat e komunitetit rom si dhe projekte të tjera me paraligjorë. Komuniteti rom në Maqedoninë e Veriut ka gjetur një fokus të veçantë në projektet e organizatave të ndryshme, pasi romët përballen me disa pengesa sociale dhe ekonomike përfshirë varfërinë, përjashtimin social, pa shtetësinë dhe diskriminimin me të tjerët. Problematika të tjera që has komuniteti rom shtrihen në arsim, punësim, shëndetësi, strehim dhe në çështje që lidhen me jetëgjatësinë.

Një nga këto projekte ka qenë: “Nga Veprimi në të Drejtat e Barabarta për Romët”, nëpërmjet të cilit është synuar rritja e pjesëmarrjes së komunitetit rom në vendime që ndikojnë në jetën e tyre, si dhe fuqizimi i anëtarëve të komunitetit për të ushtruar të drejtat e tyre. Një pjesë integrale e projektit, ka qenë krijimi i qendrave javore të këshillimit virtual (QKV) në Skype. Këto qendra ndërthurin ekspertizën e jashtme nga studiot e avokatisë (këshilltarë ligjorë/avokatë) dhe bashkëveprojnë me individë romë që kanë përjetuar diskriminim dhe shkelje të tjera të të drejtave të tyre.

Ndërmjetësuesit e trajnuar të projektit kanë ndërmarrë vizita mujore në terren në gjashtë komuna: Tetovë, Kërçovë, Dibër, Shtip, Vinicë dhe Berovë, me anë të të cilave ata dokumentojnë raste diskriminimi dhe ankese ndaj individëve romë. Pas kësaj, zgjidhen raste specifike të shkeljeve të mundshme të të drejtave të tyre dhe u ofrohet individëve mundësia për të marrë pjesë në QKV. Qëllimi i QKV-ve është t’u japë individëve këshilla juridike, përgjigje dhe të informojë për masat e duhura që mund të ndërmerren lidhur me diskriminimin/ankesat që ata kanë përjetuar.

Rastet në QKV kanë qenë të larmishme dhe kanë shërbyer për të dhënë informacione të reja mbi situatën politike dhe sociale të romëve në Maqedoninë e Veriut. Raste të tilla të trajtuara kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet mbi tokën, pa shtetësinë, mos zbatimi i ligjit dhe ngacmimet në vendin e punës. Këto raste kanë treguar se romët vazhdojnë të diskriminohen dhe t’u shkelen të drejtat e

³ Informacioni është marrë nga kërkimi në faqe të ndryshme interneti, të cilat parashtronin rezultatet e projekteve të financuara nga OSF për paraligjorin në Maqedoninë e Veriut

tyre në mënyrë të vazhdueshme. Për rrjedhojë, ka lindur nevoja për të advokuar me qëllim ndikimin në politikat kombëtare për përmirësimin e të drejtave të tyre. Më konkretisht, këshillat ligjore jepen nga këshilltarë që përpiqen të adresojnë këto çështje, duke raportuar pranë organeve dhe komisioneve përkatëse për të drejtat e njeriut. Gjithashtu, duke qenë se individët romë shpesh hasin vështirësi kur bashkëveprojnë me organet shtetërore për shkak të procedurave komplekse shtetërore, QKV-të me anë të këshillave të tyre i informojnë ata për hapat e nevojshme që mund të ndërmerren për kompensim ose apelim të vendimeve/veprimeve shtetërore që prekin romët.

Për më tepër, QKV-të shërbejnë si një filtër për rastet që kanë mundësi të raportohen pranë Komisionit kundër diskriminimit dhe zyrës së Avokatit të Popullit. Në këtë kuadër ligji lejon shoqatat, fondacionet dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile, që kanë një interes të ligjshëm për të mbrojtur interesat e një grupi të caktuar, të paraqesin një padi në qoftë se ata provojnë se i pandehuri ka diskriminuar një numër personash.

(a) Programet paraligjore në fokus të organizatave maqedonase dhe OSF

Fillesat e programeve paraligjore në Maqedoninë e Veriut

Në Maqedoninë e Veriut pavarësisht aftësive të larmishme të OJF-ve për të edukuar dhe fuqizuar romët rreth të drejtave të tyre shëndetësore, shpesh OJF-të janë përballur me kufizime të shumta, të tilla si njohuritë e kufizuara për ligjet që garantojnë të drejtat shëndetësore, të drejtat e njeriut, mungesa e aftësive/kapaciteteve për të komunikuar në mënyrë efektive dhe advokuar për çështjet e të drejtave shëndetësore të romëve përpara autoriteteve përkatëse. Gjithashtu, viktimat hezitojnë të paraqesin ankime kundër autoriteteve të kujdesit shëndetësor. Nga ana tjetër, ka shumë pak përgjegjshmëri për shkeljet e të drejtave të romëve në mjediset e kujdesit shëndetësor. Duke pasur parasysh problematikat e mësipërme, studime të ndryshme kanë treguar se, rritja e disponueshmërisë së shërbimeve juridike si dhe edukimi i romëve, ndikojnë në rritjen e aftësisë së romëve për të ngritur pretendime dhe ndjekur procedura të caktuara ligjore.

Prandaj, për rritjen e kapaciteteve të OJF-ve në mbrojtjen e të drejtave shëndetësore të romëve dhe për të ndikuar në ndryshimin sistematik janë ngritur disa programe paraligjore të bazuara në komunitet.

Më konkretisht, në fund të vitit 2010, Fondacionet Shoqëria e Hapur (OSF) caktuan disa grante pilot për disa OJF maqedonase për t'u mundësuar atyre angazhimin në advokim ligjor për të drejtat shëndetësore të romëve.

Organizata Roma SOS, me qendër në Prilep, Maqedoni, përdori grantin e saj për krijimin e një qendre ligjore për ofrimin e informacioneve lidhur me shëndetin dhe të drejtat e romëve si dhe advokimin për të drejtat e romëve para autoriteteve shëndetësore në nivele të ndryshme.

Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave (ESE), me qendër në Shkup, Maqedoni, filloi të punonte me OJF me në qendër romët si, Shoqata Humanitare dhe Bamirëse e Romëve (KHAM), Qendra e Burimeve Rome (sot Nisma për Zhvillim dhe Përfshirje e Komuniteteve) dhe Qendra për Zhvillim dhe Iniciativë Demokratike (CDRIM), për të trajnuar paraligjorët. Qëllimi i këtij projekti paraligjor pilot nëpërmjet punës së paraligjorëve ishte fuqizimi i romëve, advokimi për shërbime më të mira shëndetësore, ofrimi i shërbimeve, për komunitetet rome në disa komuna të Maqedonisë së Veriut.

Rezultatet paraprake të projektit tregonin se ofrimi i një numri të madh shërbimesh juridike mund të rriste në mënyrë të konsiderueshme aftësinë e romëve për të ngritur pretendime ligjore. Për shembull, OJF-ja maqedonase Projekti i Mundësive të Shëndetit Shkup, me zbatimin e një projekti advokimi ligjor në vitin 2011, raportoi se brenda disa muajve si rezultat i ofrimit të shërbimeve juridike, numri i çështjeve për të drejtat shëndetësore u rrit gati trefish, nga një mesatare prej 15 në muaj në një mesatare prej 40 në muaj.

Edhe në 2014, si rezultat i zbatimit të projekteve të mbështetura nga OSF, rezultoi se OJF-të që punonin me komunitetin rom rritën kapacitetet e tyre, në edukimin ligjor dhe fuqizimin e komuniteteve rome për të drejtat shëndetësore. Në përgjithësi, OJF-të përfituese kanë adoptuar një shumëllojshmëri të qasjeve ndaj ligjit, fuqizimin në komunitetet rome për t'i inkurajuar ata të pretendojnë të drejtat e shëndetit të tyre. Këto strategji variojnë nga fushatat informuese derë më derë, edukimin ligjor, krijimin e ndërmjetësuesve të shëndetit rom dhe të programeve paraligjore. Disa nga këto nisma tashmë kanë treguar se janë efektive për të ndikuar tek komunitetet rome.

(b) Paraligjori në ditët e sotme dhe impakti i tij në komunitetin rom

Në Maqedoninë e Veriut, sikurse u përmend edhe më sipër, paraligjorët po luftojnë diskriminimin ndaj romëve nga sistemi mjekësor dhe mbrojnë të drejtat shëndetësore të tyre. Shembuj të rasteve konkrete nga praktika janë si vijon⁴: (a) një grua kryen një vizitë mjekësore tek një mjek gjinekolog, por i kërkohet të paguajë për këtë shërbim pavarësisht se një shërbim i tillë me ligj ofrohet falas; (b) një fëmijë i vogël dhe prindërit e tij nuk informohen asnjëherë për vaksinimin e fruthit, shytave dhe rubeolës; (c) një burrë që ka nevojë mjekësore për dializë nuk i ofrohet shërbimi në spital, pasi ka kërkuar rimbursimin e transportit për të shkuar në spital, e cila i është refuzuar edhe pse parashikohet me ligj një e drejtë e tillë. Këto janë vetëm disa nga shumë shkelje të të drejtave shëndetësore me të cilat përballen romët në Maqedoni.

Gjithashtu, në një raport të OSF “Sjellja e Drejtësisë në Shëndet”⁵ rezultoi se, komuniteti i varfër i romëve në Maqedoninë e Veriut ende përballen me pengesa të mëdha për akses në shërbime

⁴ <https://www.opensocietyfoundations.org/voices/roma-justice-sometimes-best-medicine>

⁵ https://www.opensocietyfoundations.org/publications/bringing-justice-health#publications_download

shëndetësore dhe ligjore dhe përjeton “mosrespektim, abuzim dhe mungesë komunikimi” në mjediset e kujdesit shëndetësor, edhe pse kujdesi shëndetësor që prej vitit 2009 i ofrohet të gjithë qytetarëve në të gjithë Maqedoninë e Veriut. Pavarësisht situatës së mësipërme, sikurse paraqitet edhe më poshtë, puna e paraligjorëve romë ka ndikuar në shëndetin e romëve në komunitetet e tyre.

Sot, punën me paraligjorët në Maqedoni për fuqizimin e komuniteteve rome, zbatimin e të drejtave shëndetësore të tyre, advokimit bazuar në çështje ligjore të identifikuarra përmes ofrimit të shërbimeve juridike, vazhdojnë e bëjnë 4 organizatat e sipërpërmendura, tre prej të cilave janë organizata lokale rome (CDRIM, KHAM Delcevo, Nisma për Zhvillim dhe Përfshirje e Komuniteteve). Secila prej organizatave rome ka dy paraligjorë të rekrutuar nga komunitetet rome. Njohja e paraligjorëve të çështjeve lokale dhe besimi që ata kanë brenda komuniteteve të tyre, mundësojnë krijimin e marrëdhënieve më të forta me komunitetin/klientët. Shoqata ESE (e katërta), është një organizatë kombëtare, e cila promovon të drejtat e grave, të drejtat e njeriut, drejtësinë sociale, me përvojë në advokim dhe kërkim. Gjithashtu, ESE ofron trajnime, mbikëqyr menaxhimin e çështjeve dhe ndërhyr në raste veçanërisht të vështira.

Paraligjorët shkojnë derë më derë, ata dëgjojnë komunitetin, japin këshilla, dhe në disa raste ndërhyjnë duke shoqëruar qytetarët tek autoritetet lokale ose klinikat, negociojnë zgjidhje për mosmarrëveshjet, paraqesin ankesa, ose kërkojnë mjete ligjore për të vënë në vend shkeljen. Gjithashtu, ndihmojnë shumë romë të pajisen me dokumente të identifikimit personal, pa të cilat ata nuk mund të përfitojnë sigurim shëndetësor për të subvencionuar kujdesin shëndetësor.

Paraligjorët kanë kontribuar edhe në ndryshime sistematike në Maqedoninë e Veriut. Për shembull, shumë ofrues të kujdesit shëndetësor kanë përdorur forma të ndryshme të paligjshme për pacientët romë për shërbime si kontrollat gjinekologjike dhe certifikatat e vaksinimit. Në raste të tjerë kanë fshehur dokumentat e identitetit të pacientëve romë nëse ata nuk kishin mundësi të paguanin faturat në spital. Këto situata janë përmirësuar shumë si rezultat i ndërhyrjeve të vazhdueshme nga paraligjorët.

Gjithashtu, paraligjorët kanë ndihmuar qytetarët romë të mbrojnë vetë të drejtat e tyre. Duke zhvilluar tryeza të rrumbullakëta në komunitetet lokale, paraligjorët kanë edukuar romët për të drejtat e shëndetit dhe kanë shqyrtuar problemet lokale. Në Crnik, një fshat në pjesën lindore të Maqedonisë së Veriut, fshatarët kanë advokuar me sukses për ngritjen e një qendre lokale vaksinimi, e cila në fakt do të hapet së shpejti, dhe ata janë në proces të aplikimit për statusin e “zonës shëndetësore rurale”, e cila do t’i ofrojë fshatit qasje në një ambulancë.

Këto katër organizata me anë të programeve të tyre paraligjore po sjellin drejtësi për shëndetin e romëve në Maqedoninë e Veriut.

Disponueshmëria e përmirësuar e shërbimeve juridike dhe rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat, kanë filluar të parandalojnë shkeljet e të drejtave të njeriut. Kështu, OJF-të raportojnë se ndihma

dhe ndërmjetësimi paraligjor, aty ku është e mundur, kanë zvogëluar abuzimet që bëhen haptazi ndaj komunitetit rom nga ana e profesionistëve shëndetësorë. Më parë, romët ishin të shqetësuar nëse paraqisnin ankesa përpara autoriteteve kompetente dhe nuk kishin besim tek sistemi i drejtësisë. Por që nga fillimi i projektit, numri i ankesave ligjore dhe administrative të sjella nga ose në emër të romëve është rritur ndjeshëm. Për më tepër, është konstatuar se pretendimet e paraqitura nga romët janë rritur, duke filluar që nga kërkesat për ndihmë lidhur me plotësimin e formularëve deri tek kërkesat konkrete të të drejtave të pacientëve. Gjithashtu, është vënë re një rritje e aksesit në kujdes shëndetësor jo vetëm për romët, por edhe për jo romët, pasi në seancat e këshillimit ligjor kanë marrë pjesë si pjesëtarë të komunitetit rom dhe jo romë, që hasnin të njëjtat problematika lidhur me aksesin në kujdesin shëndetësor.

Fuqizimi ligjor i romëve ka qenë një pjesë kryesore e strategjisë së OSF për të përdorur advokimin ligjor si mënyrë për të avancuar të drejtat e shëndetit të romëve në Maqedoninë e Veriut. Një rritje e numrit të ankesave nga romët, mund të shërbejë si një tregues i rritjes së fuqizimit ligjor të komunitetit rom. Në fakt, anëtarët e komunitetit rom filluan të bëhen të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe filluan t'i pretendojnë ato të drejta në mjediset e kujdesit shëndetësor.

Kapaciteti i OJF-ve me në qendër romët për t'u përfshirë në çështje gjyqësore, i cili ishte shumë i kufizuar në fillim të iniciativës, është përmirësuar. Fillimisht, vetëm një pjesë e vogël e OJF-ve kishin si ekspertizë dhe objektiv të veprimtarisë së tyre pretendimin e shkeljeve të të drejtave të romëve në gjykata. Tani, çdo OJF e angazhuar në ofrimin e shërbimeve ligjore trajton qindra raste të lidhura me të drejtat e romëve në vit. Jo të gjitha çështjet kanë të bëjnë me shëndetin ose rezultojnë në procese gjyqësore, por rritja e numrit të këtyre çështjeve tregon një ndryshim themelor të qëndrimit të romëve ndaj problemeve të tyre. Për shembull, një projekt me fokus shëndetin, konstatoi një rritje të trefishtë të ankesave në muajt e pare, pasi shërbimet e tij ligjore u bënë të disponueshme. Gjithashtu, Shoqata e Edukimit Shëndetësor dhe Kërkimit (HERA) regjistroi një rritje nga vetëm 4 ankesa individuale lidhur me tarifën e paligjshme të ngarkuara nga gjinekologët në 2015, në 24 ankesa të tilla në vitin 2016. OJF-ja Roma SOS dokumentoi 340 ankesa ligjore ndërmjet 2012 dhe 2015, nga të cilat 4 u zgjodhën për çështje gjyqësore strategjike dhe më pas u fituan në emër të klientëve romë, duke sjellë pasoja ligjore dhe politike në të gjithë vendin. Aktualisht, paraligjorët romë trajtojnë rreth 400 raste në vit. Kjo rritje e rasteve tregon se ka pasur një ndikim edhe në rritjen e njohurive të romëve për të drejtat e pacientëve të caktuar, që nuk ekzistonin në fillim të iniciativës.

Krahas projekteve të mësipërme, një projekt tjetër i paraligjorëve është kryesuar nga HERA, në partneritet me OJF-të rome, Ambrela dhe Iniciativën për Zhvillim dhe Përfshirje të Komuniteteve. Ky projekt filloi në vitin 2014, dhe ka në fokus mbështetjen e të drejtave të shëndetit riprodhues të grave rome. Aktiviste gra rome, të trajnuara për të punuar si paraligjore, vendosin kontakte me gratë rome lokale për të rritur ndërgjegjësimin e tyre lidhur me të drejtat e shëndetit riprodhues, duke mbledhur prova dhe dokumente dhe kur është e nevojshme, bëjnë shoqërimin e grave rome në institucionet lokale të kujdesit shëndetësor për të ndërmjetësuar konfliktet.

Paraligjorët gjithashtu mobilizojnë gratë rome për të kryer monitorimin e shërbimeve në shëndetësi në komunitet, duke përdorur rezultate periodike të komunitetit. HERA përdor këto rezultate për të ushtruar presion tek autoritetet shëndetësore me qëllim ofrimin e shërbimeve shëndetësore që mungojnë. Rezultatet strategjike përfshijnë krijimin e një grupi pune komunitare për shëndetin riprodhues dhe gjinekologjik dhe zhvillimin e një plani veprimi advokimi, i cili synon Komitetin Kombëtar për Nënë e Sigurt, Ministrinë e Shëndetësisë, Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, si dhe shoqatat e mjekëve të përgjithshëm dhe gjinekologë, me qëllim promovimin e ndryshimeve sistematike.

Pjesëmarrësit në këto nisma paraligjore dëshmojnë shumë për suksesin e tyre. Për shembull, vlerësimi i vazhdueshëm nga ESE tregon se mbi 70% e anëtarëve të komunitetit rom janë të kënaqur me punën e paraligjorëve. Nga ana tjetër, kjo nuk do të thotë që romët nuk përballen më me shkelje të shëndetit dhe të drejtave të tyre. Sipas një studimi të fundit të kryer nga ESE, në dhjetë lokalitete maqedonase me popullsi të konsiderueshme rome, 34.6% e romëve ende raportojnë për “trajtim të padrejtë” nga specialistë mjekësorë, përkundrejt vetëm 5.3% të jo romëve. Për më tepër, 9.8% e romëve raportojnë se janë fyer nga mjekët, përkundrejt 1.6% të jo romëve. Deri në 2.3% të grave rome që vizitojnë gjinekologët shprehen se janë goditur të paktën një herë; ndërkohë që numri i rasteve për gratë jo rome është 0%. Megjithatë, duke qenë se komunitetet rome më të vetëdijshme kanë filluar të kërkojnë respektimin e të drejtave të tyre shëndetësore dhe të bëjnë thirrje për përgjegjshmëri, kjo ka pasjellë ndryshimin e dinamikës në sistemin shëndetësor, ku romët nuk perceptohen më si persona të pafuqishëm dhe të pavetëdijshëm. Dialogu i vazhdueshëm me profesionistët e shëndetit, gjithashtu ka rezultuar në ndërgjegjësim më të madh midis mjekëve dhe infermierëve për nevojat dhe problemet me të cilat përballen pacientët romë.

Si një mënyrë për të krijuar sinergji, OJF-të kanë filluar të bashkojnë qasjet ligjore të fuqizimit me strategjitë e përgjegjësisë sociale. Si rezultat, romët kanë filluar të kërkojnë të kenë një qasje më të madhe në sistemin shëndetësor dhe njëkohësisht tani janë duke kërkuar që t’u dëgjohet zëri edhe në zhvillimin e politikave lokale për të përmirësuar treguesit e shëndetit rom. Paraligjorët romë nga organizata KHAM gjithashtu kanë filluar të shprehin interes edhe për ngritjen e kapaciteteve në vende të tjera, të tilla si Rumania, ku organizatat lokale rome kanë shprehur interes për këtë iniciativë. Një shkëmbim i tillë ndërkombëtar eskperiencash ndërmjet kolegëve shihet si një nxitje për vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë jo vetëm të paraligjorit, por edhe të fuqizimit ligjor të romëve më gjerësisht.

Për më tepër, angazhimi me autoritetet lokale ka ndihmuar në trajtimin e barrierave strukturore që më parë dukeshin të pakapërcyeshme. Për shembull, në fillim të iniciativës, një shumicë e madhe e vendbanimeve rome konsideroheshin si vendbanime të përjashtuara nga planifikimi urban dhe nuk përfitonin nga investimet ose shërbimet publike. Habitat for Humanity, një OJF ndërkombëtare me degë në Maqedoni, kryesoi një projekt për të legalizuar vendbanimet rome dhe të siguronte grante për të mbuluar tarifat administrative të regjistrimit, bazuar në ligjin e vitit 2011 për legalizimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme. Disa OJF me qendër romët,

Qendra Kombëtare e Romëve në Kumanovë dhe Romët SOS në Prilep, të trajnuar më parë nga OSF, kanë marrë pjesë në këtë iniciativë duke ofruar këshillime juridike dhe mbështetje të llojeve të ndryshme.

Si rezultat, rreth 50% e vendbanimeve romë në tërë Maqedoninë e Veriut janë legalizuar dhe, pas advokimit të OJF-ve, janë përfshirë në planifikimin urban. Fakti që nuk u raportuan prishje të shtëpive të romëve dhe autoritetet lokale nuk ndërmorën veprime të menjëhershme, mund t'i atribuohet rritjes së ndërjegjësimit të romëve për të drejtat e tyre dhe aftësisë së OJF-ve për t'i mbështetur në ngritjen e pretendimeve për të drejtat e tyre. Legalizimi do të thotë që banorët e vendbanimeve të dikurshme të paligjshme romë, tani mund të presin dhe të kërkojnë ofrimin e shërbimeve publike, përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në, qendrat e reja shëndetësore.

Në përfundim, përse u sqarua më sipër një përmbledhje e rezultateve të projekteve me paraligjorët dhe roli i tyre në forcimin e të drejtave të komunitetit rom, paraqitet si më poshtë:

Një vlerësim i iniciativave të advokimit ligjor në Maqedoninë e Veriut tregon se, vetëm pas disa vitesh pune nga ana e OJF-ve (nga 2012 deri në 2015), ka pasur përparim në tejkalimin e hendekut midis ligjit dhe praktikës, për qasjen e romëve në kujdesin shëndetësor.

Kapaciteti i OJF-ve me në qendër romët për të vazhduar këtë punë është rritur ndjeshëm. Komunitetet romë janë më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre shëndetësore dhe kanë më pak frikë të ankohen kur ndodhin shkelje të të drejtave të tyre. Rritja e numrit të ankesave ligjore dhe administrative të sjella nga ose në emër të romëve ka rezultuar në zvogëlimin e shkeljeve të të drejtave të tyre në mjediset e kujdesit shëndetësor dhe ka frenuar disa abuzime të zakonshme që ndodhnin më parë. Rritja e besimit të romëve gjithashtu ka ndihmuar në arritjen e bashkëpunimit me autoritetet lokale sa i përket trajtimit të problemeve sistematike, të tilla si mungesa e dokumentacionit personal dhe strehimit të paautorizuar. Edhe pse përgjegjshmëria në kujdesin shëndetësor është ende më shumë një përjashtim sesa një normë, proceset gjyqësore strategjike dhe advokimi i të drejtave të njeriut, të shoqëruar me fushatat mediatike, kanë çuar në disa ndryshime konkrete sa i përket reduktimit të pengesave strukturore në qasjen në kujdesin shëndetësor.

Duke pasur parasysh sa më sipër, në përgjithësi, strategjitë e fuqizimit të komunitetit, advokimi për të drejtat e njeriut, i medias dhe proceset gjyqësore strategjike, vazhdojnë të jenë qasje, të vlefshme dhe efektive në një shoqëri ku romët dhe grupet e tjera të marginalizuara përballen me përjashtime dhe pengesa në ushtrimin e të drejtës së tyre për shëndet.

B. MOLDAVI

Kjo pjesë e studimit është përgatitur nga ekspertja ndërkombëtare, Znj. Nadejda Hriptievschi dhe u përshtat nga ekspertet kombëtare.

1. Sistemi i ndihmës juridike në Moldavi

Më datë 1 korrik 2008 hyri në fuqi ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, i cili krijoi sistemin aktual të ndihmës juridike.⁶ Ligji reformoi sistemin në tre nivele: 1) rishikoi qëllimin dhe kriteret e pranueshmërisë për ndihmë juridike, 2) krijoi një organ të ri drejtues për të mbikëqyrur sistemin e ndihmës juridike dhe 3) parashikoi një sistem të përzier të dhënies së ndihmës juridike.

Ndihma juridike ofrohet në çështje penale dhe jo-penale. Sistemi aktual ofron dy kategori të ndihmës juridike: ndihmë juridike parësore, e cila konsiston në ofrimin e këshillave për çdo çështje përveç ndihmës për hartimin e dokumenteve procedurale për gjykatat, e cila ofrohet nga paraligjorët dhe organizatat jofitimprurëse dhe ndihmë juridike të kualifikuar nëpërmjet ofrimit të këshillave dhe përfaqësimit në gjykatë, e cila ofrohet nga avokatë të kualifikuar dhe organizata jofitimprurëse. Në rast ndalimi të një personi, ndihma juridike ofrohet menjëherë pas arrestimit. Kjo ndihmë përcaktohet si ndihmë juridike urgjente, e cila përfshin dhënien e këshillave dhe përfaqësim gjatë 72 orëve të para të paraburgimit dhe njihet ndryshe si këshillim i stacionit policor.

Ndihma juridike parësore duhet t'i ofrohet çdo personi për çdo çështje, pa u kufizuar në një fushë të caktuar juridike. Çdo person mund të përfitojë ndihmë juridike parësore pa qenë e nevojshme të vërtetojë gjendjen e tij financiare. Ndihma juridike parësore duhet të sigurohet menjëherë pas paraqitjes së kërkesës, ose brenda 3 ditëve nga paraqitja e kërkesës përpara paraligjorit apo OJF-së.⁷ Nëse çështja e klientit është e ndërlikuar dhe paraligjori ose OJF-ja nuk e di përgjigjen, përfituesi duhet të këshillohet të kontaktojë një avokat, ose të informohet të paraqitet më vonë në ato raste kur ofruesi i ndihmës juridike parësore mund të kthejë përgjigje maksimumi brenda 3 ditëve. Paraligjori/OJF-ja që ofron ndihmë juridike parësore duhet t'i shpjegojë përfituesit mundësinë për të kërkuar ndihmë juridike të kualifikuar. Avokatët në mënyrë të paracaktuar mund të ofrojnë ndihmë juridike parësore, por shërbimet e tyre nuk paguhen nga shteti. Vetëm ndihma juridike e kualifikuar ofrohet nga avokatët me financimin e shtetit.

Sistemi i ndihmës juridike menaxhohet nga Këshilli Kombëtar i Ndihmës Juridike. Ai ka një strukturë administrative qendrore, të udhëhequr nga Drejtori Ekzekutiv, dhe katër zyra territoriale në të gjithë vendin. Moldavia ka një model të përzier ofruesish të ndihmës juridike: paraligjorë të cilët ofrojnë ndihmë juridike parësore, mbrojtës publikë dhe avokatë privatë të cilët ofrojnë ndihmë

⁶ Ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, nr. 198 datë 26 Korrik 2007 (hyrë në fuqi më 1 Korrik 2008 dhe dispozitat në lidhje me ndihmën juridike civile hyrë në fuqi më 1 Janar 2012).

⁷ Neni 18 i Ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

juridike të kualifikuar, dhe organizata jofitimprurëse që ofrojnë kryesisht ndihmë juridike parësore. Arsyeja e zgjedhjes së një modeli të përzier ishte kryesisht rritja e cilësisë dhe aksesit në sistemin e ndihmës juridike, si dhe ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike me kosto efektive. Konkurrenca midis llojeve të ndryshme të ofruesve besohet se do të kontribuojë pozitivisht në koston dhe cilësinë e ndihmës juridike. Krahas kësaj, besohet se mbrojtësit publikë dhe paraligjorët, të financuar me burime publike, do të sigurojnë një filtër të besueshëm në sistemin e ndihmës juridike duke pasur parasysh se tarifat e avokatëve privatë janë të larta, ose ata shpesh refuzojnë ofrimin e ndihmës juridike, ose nuk janë në gjendje të ofrojnë ndihmë juridike për një arsye të caktuar.

2. Çfarë është një paraligjor?

Ligji i vitit 2007 mbi ndihmën juridike të shtetit garantoj për herë të parë një përcaktim ligjor të konceptit “paraligjor”. Ligji parashikon se një paraligjor është: *“një person që respektohet nga komuniteti lokal, me arsim juridik jo të përfunduar ose arsim të lartë të përfunduar, që nuk ushtron profesionin e avokatit të kualifikuar dhe pas një trajnimit të posaçëm, është i kualifikuar për të ofruar ndihmë juridike parësore për anëtarët e komunitetit, nga buxheti i alokuar për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, sipas një rregulloreje për statusin dhe kualifikimet e paraligjorëve”*.⁸

Paraligjorët janë pjesë përbërëse e sistemit të ndihmës juridike shtetërore, që ofrojnë ndihmë juridike parësore për çdo person, pavarësisht nga niveli i të ardhurave të tij/saj. Ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti përfshin dispozitat bazë për paraligjorët, ndërsa rregullime më të hollësishme të profesionit të tyre parashikohen në legjislacionin dytësor. Ligji parashikon se ndihma juridike parësore mund të ofrohet nga paraligjorët, ose organizatat jofitimprurëse të specializuara. Këshilli Kombëtar i Ndihmës Juridike koordinon procesin e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe kontrollon cilësinë e këtyre shërbimeve.⁹ Ligji parashikon se paraligjorët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të një rregulloreje të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ndihmës Juridike. Këshilli Kombëtar i Ndihmës Juridike është përgjegjës për trajnimin e paraligjorëve, që realizohet me fonde të buxhetit të shtetit dhe burime të tjera që nuk janë të ndaluara me ligj, të alokuara me këtë qëllim. Shpërblimi i paraligjorëve sigurohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera që nuk janë të ndaluara me ligj, në bazë të një kontrate bashkëpunimi të nënshkruar me zyrën territoriale të Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike, brenda zonës ku paraligjori ofron shërbimet e tij/saj. Administrata publike lokale mund të vendosë në dispozicion të paraligjorëve hapësirën e zyrave dhe mjete të tjera të nevojshme teknike dhe materiale për veprimtarinë e tyre.¹⁰

⁸ Neni 2 i Ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

⁹ Neni 15 i Ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

¹⁰ Neni 16 i Ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

Rregullorja për aktivitetin e paraligjorëve ¹¹ detajon statusin e paraligjorëve. Në të parashikohet se me ofrimin e ndihmës juridike parësore, paraligjorët ushtrojnë një veprimtari me interes publik, duke kontribuar në këtë mënyrë në zbatimin e detyrimit të shtetit për të siguruar qasje në shërbime juridike për çdo person, pavarësisht nga statusi i tij/saj financiar. Në këtë kontekst, shteti siguron kushte pune për paraligjorët në mënyrë që të ofrojnë ndihmë juridike parësore. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, paraligjorët janë të pavarur nga çdo ndikim nga autoritetet publike. Çdo ndërhyrje në veprimtarinë profesionale të paraligjorëve, që nuk parashikohet me ligj është e ndaluar.

Paraligjorët nuk janë punonjës me orar të plotë të Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike. Ata kontraktohen nga Këshilli Kombëtar i Ndhmës Juridike në bazë të kontratave të ofrimit të shërbimeve, për një minimum prej 15 orësh në javë, që duhet të ndahen në mënyrë të barabartë për të paktën tre ditë pune.

Hartuesit e ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti parashikuan paraligjorët si persona që do të punonin në komunitetet lokale. Ky vizion udhëhoqi pilotimin fillestar të paraligjorëve si pjesë të një projekti të zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Moldavinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë së Moldavisë në vitet 2010-2012, që testoi dhe punësoi një rrjet prej 32 paraligjorësh me bazë komunitare në zonat rurale.¹² Profili i një paraligjori sikurse u testua dhe konfirmua nga projekti, paraqitet si më poshtë:

- Paraligjori do të punojë me komunitetin në vendbanimin e tij ose në një komunitet të afërt;
- Të dhëna që provojnë aftësi lidhësi ose potencial për t'u bërë udhëheqës në komunitet;
- Ndjeshmëri ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- Aftësi të të menduarit kritik;
- Qëndrim pro-aktiv;
- Edukimi - arsim i lartë juridik jo i përfunduar ose arsim i lartë i përfunduar. Njohuritë ligjore të paraligjorit janë përparësi, por nuk janë kriter. Në rrethana të jashtëzakonshme, kandidatët me arsim të lartë jo të përfunduar mund të pranohen.

Brezi i parë i paraligjorëve (2010 - 2012) testoi një model paraligjorësh që ishin punonjës socialë, duke pasur parasysh një sërë ngjashmëri mes dy profesionistëve sa i përket roleve dhe aktiviteteve të tyre në një komunitet, dhe një model paraligjorësh me njohuri të tjera. Të dy modelet rezultuan të ishin të vlefshme. Me kalimin e viteve, përvoja ka treguar se cilësia më e rëndësishme që një paraligjor duhet të ketë është përkushtimi i tij/saj për fuqizimin ligjor të qytetarëve dhe

¹¹ Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike nr. 27, datë 29 Tetor 2014 për miratimin e Rregullores për veprimtarinë e paraligjorëve (e cila zëvendësoi rregulloren 2011), e cila gjendet në adresën http://www.legis.md/cautare/getResults?doc_id=86347&lang=ro.

¹² Projekti pilot "Përmirësimi i qeverisjes së mirë në Moldavi përmes rritjes së pjesëmarrjes publike", i zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Moldavinë me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze në Dhjetor 2009 - 31 Janar 2012. Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë për pilotimin e një rrjeti me të paktën 20 paraligjorë me bazë komunitare të nënshkruar më 9 prill 2010 (<http://www.justice.gov.md/libview.php?l=ro&idc=4&id=160>).

aftësinë që duhet të ketë për të punuar me anëtarët e komunitetit. Prandaj, motivimi i personit për të punuar me dhe për komunitetin duhet të jetë një kriter kryesor i përzgjedhjes së paraligjorëve.

Paraligjorët zgjidhen nga një komision i përbërë nga koordinatori dhe një punonjës i zyrës territoriale të Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike dhe një përfaqësues i autoritetit publik lokal. Rregullorja për veprimtarinë e paraligjorëve parashikon rregulla përzgjedhje në mënyrë të detajuar, përfshirë sistemin e pikëve të intervistës. Ndërkohë që gjatë fazës së përzgjedhjes fillestare të paraligjorëve u respektuan në mënyrë rigoroze rregullat e përcaktuara, me kalimin e viteve në praktikë standardet e seleksionimit janë ulur dhe aktualisht mbetet një sfidë për ruajtjen e cilësisë dhe përkushtimit të rrjetit të paraligjorëve.¹³

Pas përzgjedhjes, paraligjorët duhet të kalojnë një trajnim fillestar dhe vetëm pas kësaj ata mund të ofrojnë shërbime paraligjore. Sipas rregullores për kurrikulën e trajnimit fillestar të paraligjorëve, ky trajnim konsiston në të paktën 30 orë trajnimi, të shpërndara brenda 20 seanceve trajnimi gjatë 5 ditëve. Çdo seancë trajnimi duhet të zgjasë minimumi 1,5 orë. Rekomandohen gjithashtu aktivitete jashtë kurrikulës.¹⁴ Trajnimi fillestar i paraligjorëve u krye në fazat fillestare të rrjetit të paraligjorëve, me mbështetjen e OSF Moldavi (2010 - 2014). Këshilli Kombëtar i Ndhmës Juridike nuk ka arritur ende të sigurojë një trajnim të vetin gjithëpërfshirës fillestar për paraligjorët. Kjo mbetet një sfidë aktuale për Këshillin.¹⁵ Gjithashtu, paraligjorëve u kërkohet të kryejnë trajnime të vazhdueshme, të paktën 40 orë në vit.

3. Detyrat e një paraligjori?

Rregullorja për aktivitetin e paraligjorëve¹⁶ parashikon në mënyrë të zgjeruar të njëjtat funksione të paraligjorëve, duke kualifikuar paraligjorët vetëm si ofrues të ndihmës juridike parësore, me funksionet e mëposhtme:

- a) Dhënia e informacionit dhe ofrimi i konsultimeve në bazë të kërkesës së banorëve të komunitetit;
- b) Ndërmjetësimi, në bazë të një kërkesë, për zgjidhjen e konflikteve midis anëtarëve të komunitetit;

¹³ Udhërrëfytyesi për forcimin e profesionit të paraligjorëve brenda sistemit kombëtar të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Oleg Efrim, Vlad Roșca, Natalia Roșca [et al.] përgatitur brenda Kornizës së Përbashkët për projektin e fuqizimit ligjor në Moldavi, zbatuar nga Programi i Drejtësisë i Fondacionit Soros-Moldavi, me mbështetjen e Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur, 2017, i cili gjendet në adresën <http://soros.md/publication/foaie-de-parcurs-profesia-parajurist>.

¹⁴ Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike nr. 11 i 20 qershorit 2014 për miratimin e Kurrikulës për trajnimin fillestar të paraligjorëve, i cili gjendet në adresën https://cnaigs.md/uploads/asset/file/ro/379/Hotarirea_nr._11_din_20.06.14_aprobarea_curriculumului_de_instruire_initiale_a_PJ_anexa.pdf.

¹⁵ Udhëzuesi për forcimin e profesionit të paraligjorëve brenda sistemit kombëtar të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, 2017.

¹⁶ Faqe 26 e rregullores.

- c) Organizimi i seminareve dhe leksioneve publike për tema të ndryshme që lidhen me kompetencën e tyre profesionale;
- d) Dhënia e informacioneve për anëtarët e komunitetit për të parandaluar problemet me natyrë juridike ose konflikte;
- e) Marrja pjesë, brenda kufijve të parashikuar me ligj, në proceset e vendimmarrjes lokale;
- f) Referimi i çështjeve, kur ndihma juridike është e nevojshme për avokatët ose, kur është e përshtatshme, tek Zyrat Territoriale të Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike;
- g) Kompetenca të tjera të parashikuara me ligj në fushën e ndihmës juridike.

Rregullorja për veprimtarinë e paraligjorëve parashikon rregulla të hollësishme se si, paraligjorët duhet të ofrojnë ndihmë juridike parësore, të kryejnë aktivitete ndërgjegjësuese dhe me interes publik për komunitetin.

Gjithashtu, rregullorja përfshin rregulla mbi konfliktin e interesit, referimin e përfituesve tek ofruesit, dokumentimin e veprimtarisë së tyre dhe detyrimet e tyre për raportim. Rregullorja përfshin një sërë detyrimesh, në veçanti detyrimin e paraligjorëve për të mos kryer veprime që mund të dëmtojnë interesat e përfituesit, të mos ushtrojnë veprimtari të paligjshme edhe nëse kërkohet nga përfituesi, dhe të mos ushtrojnë funksione ose të japin këshilla përtej kompetencave të tyre. Rregullorja dhe politikat e Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike parashikojnë shumë qartë se paraligjorët nuk janë avokatë të kualifikuar dhe nuk duhet të kryejnë asnjë funksion në rast se nuk janë plotësisht kompetent. Për më tepër, rregullorja parashikon një mekanizëm të sigurimit të cilësisë së shërbimeve paraligjore përmes monitorimit periodik nga stafi i Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike. Rregullorja përfshin edhe rregulla mbi bashkëpunimin e paraligjorëve me zyrat territoriale të Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike, veçanërisht mbrojtësit publikë/avokatët e ndihmës juridike dhe konsulentët ligjorë, si dhe palë të tjera jashtë sistemit të ndihmës juridike.

Pritshmëritë për paraligjorët janë që të ofrojnë shërbime për të gjithë anëtarët e komunitetit, të pasur dhe të varfër, si dhe për njerëzit jashtë komunitetit duke qenë se vendbanimi nuk është një kriter. Megjithatë, përvoja ka treguar se një pjesë e konsiderueshme e përfituesve të ofrimit të ndihmës juridike nga paraligjorët janë njerëz të varfër, të cilët zakonisht vijnë nga familje që përfitojnë nga programe sociale shtetërore.

4. Fazat kryesore të zhvillimit të rrjetit të paraligjorëve

Sikurse u përmend edhe më sipër, rrjeti i paraligjorëve u krijua bazuar në rezultatet dhe rekomandimet e një projekti pilot dyvjeçar të zbatuar nga OSF Moldavi, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë së Moldavisë në vitet 2010-2012, me qëllim promovimin e një sistemi të larmishëm të ndihmës juridike, që përfshiu mbështetje për pilotimin e 32 paraligjorëve me bazë

komunitare.¹⁷ Një dokument vlerësimi i rezultateve të projektit pilot arriti në përfundimin se paraligjorët ishin të rëndësishëm në Moldavi për tre qëllime kryesore: edukimin e komuniteteve për të drejtat e tyre dhe mjetet për të kërkuar të drejtat e tyre; ofrimi i këshillave bazë juridike; dhe lehtësimin e përfshirjes së anëtarëve të komunitetit në proceset e vendimmarrjes dhe aktivitetet me interes të komunitetit. Rezultatet e projektit pilot treguan se puna e paraligjorëve përfshin fusha të ndryshme të jetës shoqërore të Moldavisë dhe ata mund të kontribuojnë në: rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat dhe besimin në sistemin ligjor, të banorëve ruralë dhe grupeve vulnerabël shoqërore; reduktimin e ankesave ligjore që vijnë nga mungesa e të kuptuarit të ligjit dhe proceseve ligjore; në qeverisjen e mirë dhe, në një afat më të gjatë në uljen e varfërisë në komunitetet rurale si rezultat i angazhimit aktiv të komuniteteve në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të tyre. Në të njëjtën kohë, autorët arritën në përfundimin se afati kohor prej dy vitesh ishte i pamjaftueshëm për analizën e politikave dhe rekomandimet e përgjithshme të politikave në lidhje me shërbimet paraligjore në Moldavi. Ata rekomanduan vazhdimin e mbështetjes për rrjetin e pilotuar paraligjor, si dhe shtimin e mëtejshëm gradual të rrjetit të paraligjorëve me bazë komunitare. Aspektet kryesore që kishin nevojë për analizë të mëtejshme përfshinin identifikimin e përkatësisë institucionale më të përshtatshme për paraligjorët; identifikimin e institucionit të trajnimit dhe skemën e akreditimit për paraligjorët; zhvillimi i rregullave për prokurimin e shërbimeve paraligjore nga autoritetet shtetërore dhe vlerësimet e buxhetit për shërbimet paraligjore me financim nga buxheti kombëtar.¹⁸

Krahas ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, ngritja dhe zhvillimi i rrjetit të paraligjorëve u lehtësua edhe me anë të përfshirjes së tij në dokumente të rëndësishme politikash të miratuara në 2011-2012, përkatësisht Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë 2011 - 2016,¹⁹ Plani i Veprimit të Qeverisë 2011-2014²⁰ dhe Plani Kombëtar i Veprimit për të Drejtat e Njeriut 2011-2014.²¹ Bazuar në Strategjinë e Reformës në Sektorin e Drejtësisë, që nga viti 2013, Këshilli Kombëtar i Ndihmës Juridike arriti të përfshinte paraligjorët në sistemin e ndihmës juridike, duke shtuar çdo vit (me një përjashtim) 10 pozicione të tjera për paraligjorët. Fondacioni Soros Moldavi vazhdoi të mbështeste zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike në vend, me një fokus të veçantë tek paraligjorët.

¹⁷ Projekti pilot “Përmirësimi i qeverisjes së mirë në Moldavi përmes rritjes së pjesëmarrjes publike”, i implementuar nga Fondacioni Soros-Moldavi (SFM) me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze në Dhjetor 2009 - 31 Janar 2012. Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë për pilotimin e një rrjeti me të paktën 20 paraligjorë me bazë komunitare të nënshkruar më 9 prill 2010 (<http://www.justice.gov.md/libview.php?l=ro&idc=4&id=160>).

¹⁸ Shih për detaje dokumentin “Themelimi i paraligjorit me bazë në komunitet në Moldavi - përfundime dhe rekomandime kryesore të bazuara në një projekt pilot dyvjeçar”, Nadejda Hriptievschi, shkurt 2012, i cili gjendet në http://parajurist.md/assets/site/files/Establishment_of_community-based_paralegals_in_Moldova.pdf.

¹⁹ Miratuar nga Parlamenti, Ligj nr. 231 datë 25 Nëntor 2011.

²⁰ Miratuar nga Qeveria, Vendim nr. 179 datë 23 Mars 2011

²¹ Miratuar nga Parlamenti, Vendim nr. 90 datë 12 Maj 2011.

Në kuadër të një projekti të zbatuar nga OSF Moldavi midis 2012 - 2014, në partneritet me Këshillin Kombëtar të Ndihmës Juridike, një ekip ekspertësh vendas dhe stafi i Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike hartuan një seri dokumentesh rregullatore si pjesë të legjislationit dytësor, në lidhje me veprimtarinë e paraligjorëve, i miratuar më vonë nga Këshilli Kombëtar i Ndihmës Juridike. Këto dokumente përbëjnë bazën kryesore të kornizës rregullatore të paraligjorëve dhe janë ende në fuqi. Dokumentet kryesore që rregullojnë veprimtarinë e paraligjorëve përfshijnë si më poshtë:

- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike nr. 4, datë 15 shkurt 2013 mbi shpërblimin e veprimtarisë së paraligjorëve;²²
- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike nr. 11, datë 20 qershor 2014 për miratimin e kurrikulës për trajnimin fillestar të paraligjorëve;²³
- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike nr. 12, datë 20 qershor 2014 për miratimin e kurrikulës për trajnimin e vazhdueshëm të paraligjorëve;²⁴
- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike nr. 13, datë 20 qershor 2014 për miratimin e mekanizmit referues të paraligjorëve për përfituesit;²⁵
- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike nr. 16, datë 15 korrik 2014 në lidhje me miratimin e Kodit të Etikës së Paraligjorëve;²⁶
- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike nr. 27, datë 29 Tetor 2014 për miratimin e rregullores për veprimtarinë e paraligjorëve e cila zëvendësoi një rregullore të mëparshme të miratuar në 2011.²⁷

Gjithashtu, me mbështetjen e OSF Moldavi, një ekip ekspertësh hartuan një udhëzues ligjor bazik për qytetarin mbi aspektet kryesore të ligjit, duke paraqitur në një gjuhë të thjeshtuar dispozitat ligjore dhe zgjidhjet e mundshme për problemet hipotetike. Udhëzuesi gjendet në internet dhe për herë të fundit është azhornuar në 2017.²⁸ Për udhëzimin e paraligjorëve u hartua një udhëzues metodologjik, i cili gjendet në internet.²⁹ Këto janë burime të rëndësishme për punën e paraligjorëve, si dhe për komunitetin në përgjithësi.

²² Në dispozicion në https://cnaigs.md/uploads/asset/file/ro/148/Hotararea_nr.4_din_15.02.2013.pdf.

²³ Në dispozicion në https://cnaigs.md/uploads/asset/file/ro/379/Hotarirea_nr.11_din_20.06.14_aprobarea_curriculumului_de_instruire_initiale_a_PJ_anexa.pdf.

²⁴ Në dispozicion në https://cnaigs.md/uploads/asset/file/ro/378/Hotarirea_nr.12_din_20.06.14_aprobarea_curriculumului_de_instruire_continua_a_PJ_anexa.pdf.

²⁵ Në dispozicion në https://cnaigs.md/uploads/asset/file/ro/377/Hotarirea_nr.13_din_20.06.14_aprobarea_mecanismului_de_directionar_e_de_catre_PJ_a_beneficiarilor_anexa.pdf.

²⁶ Në dispozicion në <https://cnaigs.md/ro/acte-normative?page=2>.

²⁷ Në dispozicion në http://www.legis.md/cautare/getResults?doc_id=86347&lang=ro.

²⁸ Në dispozicion në http://parajurist.md/assets/site/files/Indrumar_juridic_elementar_actualizat_2017.pdf.

²⁹ Në dispozicion në http://parajurist.md/assets/site/files/Ghid_metodologic_pentru_para-juristi_actualizat_2017.pdf.

Në 2017, OSF Moldavi kërkoi kryerjen e një vlerësimi të kuadrit ligjor për veprimtarinë e paralogjorit, e cila rezultoi në përgatitjen e një udhëzuesi për forcimin e profesionit të paralogjorit brenda sistemit kombëtar të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.³⁰ Autorët identifikuan një seri boshllëqesh të kuadrit rregullator. Këto përfshinin në veçanti mungesën e qartësisë lidhur me formën e organizimit dhe statusin e paralogjorëve, mungesën e një mekanizmi efektiv për trajnime fillestare dhe të vazhdueshme për të siguruar shërbime cilësore, mungesën e një mekanizmi transparent për përcaktimin e shpërblimit të paralogjorëve, ekzistencën e një mekanizmi të gabuar për shërbimet e ofruara nga paralogjorët dhe një sistem seleksionimi, i cili nuk siguronte punësimin mbi bazën e meritokracisë. Autorët shqyrtuan mundësi të ndryshme për institucionalizimin e profesionit të paralogjorëve dhe arritën në përfundimin se opsioni më i mirë ishte që paralogjorët të kontrakttoheshin si profesionistë nga zyrat territoriale të Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike. Megjithatë, me qëllim që Këshilli Kombëtar i Ndihmës Juridike të përmirësonte kuadrin ligjor rregullator dhe kontraktimin e paralogjorëve, ishte e domosdoshme që paralogjorët të njiheshin si punë/ profesion.³¹ Gjithashtu, autorët e Udhërrëfyesit rekomanduan aktivitete që synonin forcimin dhe efektivitetin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të paralogjorëve, sigurimin e zgjedhjes së paralogjorëve bazuar në merita dhe kritere lidërsipi, krijimin e një mekanizmi transparent dhe të qëndrueshëm për shpërblimin e paralogjorëve, forcimin e statusit dhe rolit të paralogjorëve përmes shoqatës së tyre profesionale dhe sigurimin e një mekanizmi efektiv në mënyrë të tillë që paralogjorët të mbanin përgjegjësi për punën që kryenin.³²

Në maj 2017, 42 paralogjorë krijuan një organizatë jofitimprurëse, Shoqatën Kombëtare të Paralogjorëve. Qëllimi i shoqatës është të kontribuojë në fuqizimin ligjor të individëve përmes rrjetit të paralogjorëve të bazuar në komunitet. Shoqata gjithashtu synon të konsolidojë njohuritë ligjore të paralogjorëve dhe të ofrojë mundësi për zhvillim profesional, të përmirësojë nivelet e fuqizimit ligjor të komuniteteve të ofruara nga anëtarët e shoqatës, si dhe nivelin e të kuptuarit të rolit të paralogjorëve nga autoritetet publike lokale dhe të përmirësojë bashkëpunimin me autoritetet kombëtare dhe partnerët e jashtëm. Shoqata ka një platformë në internet, www.parajurist.md, përmes të cilës paralogjorët i përgjigjen pyetjeve lidhur me çështje të thjeshta juridike që mund të kërkohen nga kushdo në internet.


Në Shkurt 2018, profesioni “paralogjor” u përfshi në klasifikuesin e profesioneve të Republikës së Moldavisë (Corma 006 -14), i miratuar nga Ministria e Punës, Mbrojtjes Sociale dhe Familjes nr. 22 datë 3 Mars 2014. Ky është një hap i rëndësishëm në institucionalizimin e profesionit të paralogjorit në Moldavi. Institucionalizimi i paralogjorit duhet të lejojë Këshillin Kombëtar të Ndihmës Juridike të përmirësojë metodat e kontraktimit të paralogjorëve.

³⁰ Udhëzuesi për forcimin e profesionit të paralogjorëve brenda sistemit kombëtar të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, 2017, në dispozicion në <http://soros.md/publication/foaie-de-parcurs-profesia-parajurist>.

³¹ Deri në vitin 2018 paralogjorët nuk njiheshin si një profesion në legjisllacionin e Moldavisë.

³² Udhëzuesi për forcimin e profesionit të paralogjorëve brenda sistemit kombëtar të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, 2017, i cili gjendet në <http://soros.md/publication/foaie-de-parcurs-profesia-parajurist>.

Në vitin 2019, janë parashikuar 62 pozicione paraligjori në skemën e Këshillit Kombëtar të Ndhmës Juridike, nga të cilët 58 paraligjorë ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë efektive, të financuar nga buxheti i ndihmës juridike të shtetit.³³ Një paraligjor punon në një komunitet/fshat/ qytet dhe disa prej tyre ofrojnë shërbime për më shumë se një komunitet. Në mënyrë sasiore, numri i paraligjorëve të financuar përmes buxhetit të shtetit dhe përfituesve që kanë marrë ndihmë juridike parësore nga paraligjorët është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



5. Mësimet kryesore nga institucionalizimi i profesionit të paraligjorit në Moldavi

- Institucionalizimi kërkon kohë. Projektet pilot që lejojnë testimin e modeleve të ndryshme paraligjore, si dhe hartimi i rregullave të bazuara në eksperiencë konkrete janë shumë të domosdoshme për identifikimin e zgjidhjeve më të përshtatshme lidhur me nevojat e një komuniteti të caktuar në një shtet;
- Nëse është e mundur, institucionalizimi nuk duhet të jetë përparësi derisa të krijohet më shumë përvojë dhe të krijohet një grup i caktuar paraligjorësh, që do të shërbente si forcë shtytëse për institucionalizimin e mëtejshëm. Puna e paraligjorit për nga natyra e saj është e destinuar kryesisht për qytetarët, dhe vetëm në periudhë afatgjatë autoritetet publike mund të vlerësojnë plotësisht përfitimet nga veprimtaria e paraligjorëve. Paraligjorët fuqizojnë qytetarët që të jenë më aktivë në kërkimin e të drejtave të tyre, gjë që jo gjithmonë vlerësohet nga autoritetet publike. Përqendrimi që në krye të herës në institucionalizimin e paraligjorit do të anashkalonte aspekte të rëndësishme që lidhen me aktivitetin pro-aktiv dhe fokusin e paraligjorëve me qendër tek komunitetet;
- Financimi i paraligjorëve është një element i rëndësishëm që duhet të merret parasysh gjatë hartimit/krijimit të një skeme/rrjeti paraligjor. Nëse autoritetet publike nuk janë plotësisht

³³ Shih për hollësi statistikat për ndihmën juridike parësore (në Rumanisht) në <https://statparajurist.cnajgs.md/>.

të angazhuara për të krijuar një rrjet paraligjor të mbështetur plotësisht nga buxheti i shtetit, atëherë rekomandohet që të identifikohen zgjidhje krijuese për të bërë të qëndrueshme çdo iniciativë. Këto mund të përfshijnë punësim me kohë të pjesshme, punësimin e një paraligjori me disa komunitete, përfshirjen e anëtarëve të komunitetit në pension etj.;

- Efektiviteti i punës së paraligjorit varet në masën më të madhe nga përkushtimi dhe profili personal i tij. Një paraligjor mund të përfitojë një shpërblim të mirë, program trajnimi dhe mbështetje, por nëse nuk ka një shpirt aktivizmi qytetar dhe përkushtim për rolin e tij/saj, puna e tij do të ketë ndikim shumë të vogël në komunitet dhe shoqëri. Prandaj, motivimi i personit për të punuar me dhe për komunitetin duhet të jetë një kriter kryesor për zgjedhës për paraligjorët;
- Trajnimi i paraligjorëve është një element thelbësor për ruajtjen e cilësisë së shërbimeve paraligjore. Por, trajnimi i mirë është i kushtueshëm. Prandaj, janë të domosdoshme që të gjenden mënyra të tjera interaktive me qëllim që paraligjorët të kryejnë trajnime të mjaftueshme për të ushtruar funksionet e tyre dhe për të qenë të përditësuar me informacione të reja dhe me ndryshimet që pëson legjislacioni. Këto mund të përfshijnë seanca trajnimi në internet, platforma interaktive në internet, manuale paraligjore të përditësuara në mënyrë periodike, partneritete me avokatë për seanca trajnimi periodik etj.
- Pavarësisht nga modeli i zgjedhur për rrjetin e paraligjorëve, në çdo rast duhet të krijohet mundësia që paraligjorët të marrin këshilla nga avokatët/specialistët ligjorë. Megjithëse edhe praktika e Moldavisë ka rezultuar se ka vend për përmirësime lidhur me profesionin e paraligjorit, një praktikë e mirë që vjen nga ky shtet është përfshirja e paraligjorëve në sistemin kombëtar të ndihmës juridike dhe mundësia që u jepet paraligjorëve për të kontaktuar në çdo moment mbrojtësit publikë ose specialistët ligjorë nga zyrat territoriale të Këshillit Kombëtar të Ndihmës Juridike. Kontaktet e drejtpërdrejta ose një ekip rezervë ligjor i parashikuar posaçërisht për paraligjorët, përfshirë edhe për çështje gjyqësore eventuale strategjike, do të përmirësonte ndjeshëm veprimtarinë e paraligjorëve dhe impaktin e tyre.

C. UKRAINË

1. Kuadri ligjor i sistemit të ndihmës juridike

Në bazë të ligjit të Ukrainës N 3460-VI, “Ligji për ndihmën juridike falas”, i ndryshuar,³⁴ datë 2 qershor 2011, ndihma juridike falas garantohet nga shteti dhe financohet plotësisht ose pjesërisht nga buxheti i shtetit, buxhetet e organeve të qeverisjes lokale dhe burime të tjera.³⁵

Në bazë të nenit 3 të ligjit, e drejta për ndihmë juridike falas parësore i garantohet në bazë të Kushtetutës çdo qytetari ukrainas, të huaj, dhe personi pa shtetësi, duke përfshirë refugjatë ose një person që ka nevojë për mbrojtje. Ndihma juridike parësore falas është një lloj garancie shtetërore e parashikuar për të informuar një person për të drejtat dhe liritë e tij/saj, procedurën për t’i ushtruar ato, rikthimin e të drejtave në rast të shkeljes dhe për procedurën e ankimit kundër vendimeve, veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale, zyrtarëve dhe punonjësve të tyre.³⁶ Më konkretisht, në bazë të nenit 7 të ligjit, ndihma juridike parësore përfshin shërbimet juridike të tilla si: 1) informacion ligjor; 2) konsultime dhe shpjegime në lidhje me probleme juridike; 3) përgatitje të ankimeve, pretendimeve dhe dokumenteve të tjera ligjore (me përjashtim të dokumenteve procedurale gjyqësore); 4) asistencë për të siguruar qasje në ndihmën juridike dytësore dhe 5) ndërmjetësim.

Autoritetet që ofrojnë ndihmë juridike parësore janë: 1) autoritetet ekzekutive; 2) autoritetet lokale; 3) individë dhe subjekte juridike private; dhe 4) institucione të specializuara.³⁷

Neni 11 i ligjit parashikon se punonjësit e këtyre institucioneve duhet të jenë të kualifikuar me qëllim që të ofrojnë një shërbim efektiv, që konsiston në një interpretim specifik dhe të qartë të dispozitave ligjore dhe dhënien e këshillave për të drejtat dhe liritë e personave dhe qytetarëve, si dhe detyrat e tyre. Nëse gjatë takimit me personin konstatohet se është i domosdoshëm ofrimi i shërbimit juridik dytësor, punonjësi i shpjegon qytetarit procedurën për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike dytësore.

Neni 12 i ligjit parashikon në mënyrë të posaçme ofrimin e shërbimit juridik parësor nga institucionet e specializuara dhe entitete të tjera. Më konkretisht, ligji parashikon se, autoritetet e vetëqeverisjes lokale, duke marrë parasysh nevojat e caktuara të komunitetit në një zonë të caktuar administrative dhe territoriale, mund të krijojnë në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj, institucione të specializuara për të ofruar ndihmë juridike parësore falas. Institucionet e specializuara që krijohen në bazë të ligjit kanë statusin e një personi juridik jofitimprurës të tilla si organizatat jofitimprurëse. Një model i tillë institucionesh është ngritur me krijimin e një sërë

³⁴ Ligj nr. N 3460-VI, datë 2 qershor 2011 “Ligji i Ukrainës mbi ndihmën juridike falas”

³⁵ Neni 1 i Ligjit nr. N 3460-VI, datë 2 qershor 2011 “Ligji i Ukrainës mbi ndihmën juridike falas”

³⁶ Në bazë të nenit 8 të ligjit parashikohet: “Në përputhje me Kushtetutën e Ukrainës (254k / 96-VR) dhe këtë ligj, e drejta për ndihmë juridike parësore falas duhet t’u ofrohet të gjithë personave nën juridiksionin e Ukrainës”

³⁷ Neni 9 i Ligjit nr. N 3460-VI, datë 2 qershor 2011 “Ligji i Ukrainës mbi ndihmën juridike falas”

qendrash ligjore me bazë komunitare të financuara nga Fondacioni i Rilindjes Ndërkombëtare, për të cilat informacion jepet edhe më poshtë. Gjithashtu, sipas ligjit autoritetet e vetëqeverisjes lokale mund të lidhin kontrata me “subjekte juridike private”, në përputhje me statutin e tyre, që parashikon ofrimin e ndihmës juridike parësore, si dhe me “avokatë” dhe “specialistë të tjerë”, të cilët mund të jenë edhe paraligjorë, për të ofruar ndihmë juridike parësore në territorin e njësisë përkatëse administrative dhe territoriale. Nga ana tjetër, pavarësisht se institucionet e specializuara krijohen nga autoritetet e vetëqeverisjes lokale, autoritetet qendrore janë ato që përcaktojnë kompetencat e këtyre institucioneve.

Sikurse u paraqit edhe më sipër, ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore ofrohet edhe nga autoritetet e qeverisjes qendrore, të ashtuquajturat “agjenci ekzekutive”. Këto “agjenci ekzekutive” janë në të vërtetë punonjës të Ministrisë së Drejtësisë, të cilët ofrojnë këshilla juridike parësore, krahas funksioneve të tjera të punës. Urdhri i Ministrisë së Drejtësisë së Ukrainës, datë 21.09.2011 “Për miratimin e urdhrin të funksionimit të Zyrës Shtetërore të Ndihmës Juridike Falas” rregullon funksionimin e 730 “qendrave të këshillimit publik”. Këto qendra janë të hapura për konsulta personale për disa orë, një ose dy herë në javë. Gjithashtu, ofrohen edhe shërbime telefonike “hotline”.³⁸

Brenda sistemit të Ministrisë së Drejtësisë është krijuar Qendra Koordinuese për Sigurimin e Ndihmës Ligjore, e cila është një institucion qeveritar. Objekti i veprimtarisë së saj është zbatimi i përgjegjësisë të Ministrisë së Drejtësisë në fushën e ndihmës juridike falas dhe më konkretisht, për të zhvilluar dhe zbatuar një sistem efektiv të ndihmës juridike falas parësore dhe dytësore në Ukrainë. Gjithashtu, ky institucion merret me koordinimin dhe monitorimin e qendrave për ofrimin e ndihmës juridike falas.

Përsa i përket ndihmës juridike dytësore, në bazë të ligjit kjo është një lloj garancie shtetërore e parashikuar për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë individët. Ndihma juridike dytësore përfshin shërbimet juridike të mëposhtme: 1) mbrojtje ligjore nga ndjekja penale; 2) përfaqësimi i interesave të individëve që kanë të drejtën të përfitojnë ndihmë juridike dytësore falas në gjykata, agjenci të tjera shtetërore, autoritete të vetëqeverisjes lokale, individë të tjerë; 3) përgatitja e dokumenteve procedurale.

2. Praktika e sistemit të ndihmës juridike

Përpos ofruesve të ndihmës juridike të mësipërm të parashikuar në ligj, në praktikë aksesin tek ndihma juridike falas qoftë parësore dhe dytësore, garantohet kryesisht nga sektori joqeveritar, e cila ofrohet nga avokatë, të licencuar nga Shoqata e Avokatëve Kombëtare dhe të regjistruar në regjistrin kombëtar të avokatëve, zyra avokatie mbi një bazë *pro bono*, zyra pritjesh ligjore me avokatë nga organizatat publike; si dhe një sërë këshilltarësh publikë, që nuk kanë përfunduar

³⁸https://www.undp.org/content/dam/ukraine/docs/seichasen_4708604_eng-international_study-legal_aid_systems.pdf, faqe 30-31

arsim të lartë në drejtësi, por që përpiqen të ndihmojnë njerëzit që jetojnë në lagjet/komunitetet e tyre etj.³⁹ Gjithashtu, Qendra Koordinuese për Sigurimin e Ndhmës Juridike është përfshirë në ngritjen e një rrjeti paraligjorësh, dhe inkurajimin e bashkëpunimit me ofruesit e ndihmës juridike joqeveritare.⁴⁰

Edhe organizata të ndryshme si Fondacioni Shoqëria e Hapur dhe Fondacioni i Rilindjes Ndërkombëtare ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore, duke mundësuar përfaqësim ligjor falas për të pandehurit, me qëllim qasjen e tyre në një avokat publik përpara marrjes në pyetje nga policia dhe njoftimin e avokatëve publikë për çdo rast paraburgimi.⁴¹

Sa i përket kulturës *pro bono* kjo nuk është e përhapur gjerësisht në Ukrainë, por Fondacioni i Ndhmës Juridike Falas të Ukrainës ka bërë përpjekje për të promovuar këtë praktikë. Një platformë on-line *pro bono* është e aksesueshme për qytetarët. Gjithashtu, shumë zyra avokatie, dhoma avokatie dhe OJF të ndryshme ofrojnë punë dhe programe *pro bono*.

Lidhur me financimin e sistemit të ndihmës juridike, financimi nga buxheti kombëtar është rritur gjatë viteve. Megjithatë, 20% e nevojave të sistemit të ndihmës juridike mbulohen përmes mbështetjes financiare nga donatorët ndërkombëtarë, si shtete të tjera apo dhe OJF.⁴²

Disa ofrues të ndihmës juridike falas paraqiten si më poshtë:

(a) Klinikat e ligjit

Fondacioni Shoqëria e Hapur dhe Fondacioni i Rilindjes Ndërkombëtare mbështesin klinikat e ligjit, si dhe një sërë projektesh të ndihmës juridike për të promovuar qasje të barabartë në drejtësi për qytetarët ukrainas, forcimin e shtetit të së drejtës, dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Klinikat e ligjit janë pjesë e universiteteve në Ukrainë. Ato zakonisht ofrojnë ndihmë juridike në formën ekonsultave ligjore për individët, si pjesë e përgatitjes praktike të profesionistëve të ardhshëm ligjorë. Klinikat ligjore, ku studentët e drejtësisë ofrojnë shërbime juridike falas për qytetarët, kanë për qëllim edukimin e tyre për çështje ligjore dhe ofrimin e shërbimeve juridike për ata që kanë nevojë, por që nuk kanë mundësi financiare.⁴³

(b) Zyrat e mbrojtësve publikë

³⁹<https://www.undp.org/content/dam/ukraine/docs/DG/12.%20UNDP-IRF%20manual-%20centres%20legal%20consultations%20eng.pdf>

⁴⁰<https://spp.ceu.edu/sites/spp.ceu.hu/files/attachment/basicpage/2536/legalempowermentleadershipparticipants handbook2017.pdf>

⁴¹ <https://pinchukfund.org/en/projects/13/>

⁴²<https://www.coe.int/en/web/national-implementation/interviews/andriy-vyshnevsky-2016-ukrainian-legal-aid-system>

⁴³ <https://pinchukfund.org/en/projects/13/>

Në një studim të Fondacionit Shoqëria e Hapur të vitit 2012 “Përmirësimi i Drejtësisë në Paraburgim: Roli i avokatëve dhe paraligjorëve”⁴⁴, evidentohet roli i zyrave të avokatëve/mbrojtësve publikë në Ukrainë, të cilat janë krijuar nga Fondacioni Ndërkombëtar i Rilindjes për të pilotuar modele të reja të ndihmës juridike në çështjet penale. Këta avokatë mbrojtës publikë ofrojnë këshilla juridike dhe ndihmë për të dyshuarit që ndalohen nga policia. Çdo zyrë funksionon me një skemë të avokatit në detyrë, e cila siguron që një avokat të jetë gjithmonë në detyrë dhe të jetë i disponueshëm për të ofruar ndihmë për një të dyshuar brenda një kohe të shkurtër. Avokatët publikë përfaqësojnë klientë në seancat gjyqësore ku vlerësohet masa e paraburgimit.

(c) Qendrat e ndihmës juridike

Që nga 1 korriku 2015, Ministria e Drejtësisë së Ukrainës ka ngritur 100 qendra të ndihmës juridike falas, të mbikëqyrura nga Qendra Koordinuese për Sigurimin e Ndihmës Juridike. Qëllimi i këtyre qendrave është kryesisht ofrimi i ndihmës juridike dytësore falas për qytetarët vulnerabël në proceset civile dhe administrative, si dhe për personat e dyshuar dhe të akuzuar dhe viktimat në procedurat penale.⁴⁵ Këto qendra gjithashtu ofrojnë këshilla juridike edhe për personat vulnerabël që kanë nevojë për to. Në 2016 numri i këtyre qendrave u rrit duke arritur shifrën 125. Rreth 5000 avokatë privatë bashkëpunojnë me këto qendra në bazë të kontratave civile.⁴⁶

(d) Qendrat ligjore me bazë komunitare⁴⁷

Në Ukrainë, qeveria ka punuar me organizata lokale të shoqërisë civile, shkolla drejtësie dhe Fondacionin Ndërkombëtar të Rilindjes për të zhvilluar një sistem të shërbimeve juridike mbarëkombëtare për ata që kanë nevojë.⁴⁸ Ky partneritet në rritje, i cili ka përfshirë edhe vullnetarë nga komunitetet lokale, ka hapur një sërë qendrash ligjore komunitare në të gjithë vendin, duke ndihmuar qytetarët të kenë akses tek sistemi gjyqësor ose institucionet shtetërore. Ky partneritet mbështetet në punën e avokatëve, paraligjorëve lokalë dhe vullnetarëve të trajnuar të komunitetit. Këto qendra ofrojnë ndihmë juridike parësore në formën e informacioneve, ndihmës së rëndësishme juridike për komunitetet, këshillave ligjore, dhe, kur është e përshtatshme, ofrojnë mbështetje për proceset gjyqësore dhe përfaqësimin strategjik. Për shkak të mbështetjes së fortë të komunitetit në ngritjen e këtyre qendrave, qeveritë lokale dhe komunat kanë filluar të financojnë

⁴⁴<https://www.justiceinitiative.org/uploads/ce76d68b-747d-4743-a594-4cd18d1759cb/improving-pretrial-justice-20120416.pdf>

⁴⁵ <https://www.lw.com/admin/Upload/Documents/Global%20Pro%20Bono%20Survey/pro-bono-in-ukraine.pdf>

⁴⁶<https://www.coe.int/en/web/national-implementation/interviews/andriy-vyshnevsky-2016-ukrainian-legal-aid-system>

⁴⁷<https://www.opensocietyfoundations.org/uploads/575ab024-f0c1-4114-9a71-fc3b420593bd/community-legal-ukraine-20160920.pdf>

⁴⁸<https://www.justiceinitiative.org/uploads/1ad25cfb-f315-45cb-9d0a-fe0c5d3e1af2/fact-sheet-justice-implementation-partnerships-20130319.pdf>

më shumë kostot e qendrave, ndërkohë që këto qendra vazhdojnë të kenë mbështetje edhe nga rrjeti i këtyre qendrave me bazë komunitare (shih më poshtë për informacione të mëtejshme).

Më konkretisht, në Ukrainë më shumë se 30 qendra ligjore me bazë komunitare (QLK) të drejtuara nga organizata joqeveritare ofrojnë informacion ligjor falas dhe këshillim (ndihmë juridike parësore), me fonde nga bashkitë lokale dhe donatorët.

Organizimi i qendrave ligjore me bazë komunitare dhe stafi i tyre

Qendrat ligjore me bazë komunitare janë të pavarura dhe funksionojnë si një entitet i veçantë ose si një nënndarje e një OJF-je lokale. Në vitin 2015 në vijim të iniciativës së Ministrisë së Drejtësisë, të gjitha QLK-të dhe qendrat e ndihmës juridike dytësore të financuara nga qeveria, i përkasin një rrjeti të nivelit kombëtar, të koordinuar nga Fondacioni i Rilindjes Ndërkombëtare, pjesë e Fondacionit të Shoqërisë së Hapur, detyra e të cilit është të koordinojë çështjet dhe probleme të tjera në të gjithë sistemin.

Stafi i këtyre qendrave janë individë të punësuar nga komuniteti që administrohen nga OJF-të lokale. Stafi përfshin menaxherin e projektit, një ose disa avokatë, si dhe personel tjetër administrativ. Disa qendra kanë paraligjorë lokalë në komunitetet e fshatit, trajnojnë vullnetarë dhe/ose kontaktojnë firma ligjore *pro bono*.

Shërbimet Ligjore

Disa QLK ofrojnë këshilla të specializuara ligjore, që synojnë grupe të marginalizuara siç janë komunitetet rome, përdoruesit e drogës, personat HIV-AIDS, ose personat që kanë nevojë për kujdes paliativ, të burgosur etj. QLK gjithashtu orientojnë klientët në qendrat e ndihmës juridike dytësore falas, ku atyre mund t'u mundësohet pasja e një avokati falas.

Krahas këshillave juridike, shumë qendra ofrojnë ndërmjetësim dhe zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve, të ofruara kryesisht në tre fusha: ndërmjetësim në shkolla për një mjedis më të sigurt, ndërmjetësim në gjykata për të ulur kohëzgjatjen dhe koston e procedurave, dhe ndërmjetësim në komunitete për të lehtësuar problematikat sociale. QLK përdorin shërbimin online “Hapësira Ligjore” për të komunikuar dhe për t'u përgjigjur pyetjeve të klientëve. Tashmë është në dispozicion edhe një aplikacion telefoni, që u ofron klientëve qasje të drejtpërdrejtë tek një avokat.

Qendrat gjithashtu kanë projekte të rrjetit, që lidhin dy ose më shumë QLK. Këto projekte janë të përqendruara në çështje të ndryshme sistematike ligjore për të gjetur së bashku zgjidhje të çështjeve që kanë të bëjnë me parandalimin e dhunës në familje, diskriminimin dhe pronën.

3. Paraligjorët në Ukrainë

(a) Një vështrim i përgjithshëm mbi paraligjorët në Ukrainë dhe praktika e OJF-ve të ndryshme me paraligjorë

Në Ukrainë për paraligjorin përdoret termi “konsulentë ligjorë në komunitet”/“këshilltarë publikë”. Ata janë persona, që kanë arsim të specializuar dhe ofrojnë ndihmë juridike bazike parësore për njerëzit që jetojnë në zona rurale dhe zona të largëta të populluara. Në dallim nga vende të tjera ku konsulentë të tillë mund të jenë subjekt i certifikimit nga shteti, në Ukrainë specialistë të tillë nuk njihen zyrtarisht me ligj.

Paraligjorët punojnë në komunitet në zonat rurale, me grupe të marginalizuara si gratë e dhunuara, komuniteti rom etj. Popullsia rurale ashtu sikurse pjesa tjetër e popullsisë përballet me probleme të ndryshme ligjore. Zakonisht çështje të tilla kanë të bëjnë me njohjen e trashëgimisë së të afërmeve ose miqve që kanë ndërruar jetë, përfitim të ndihmave sociale ose pensioneve, privatizimin e parcelave të tokës, marrjen e dokumenteve të titullit të pronësisë mbi shtëpitë dhe tokat, njohjen e pagesave për fëmijët etj. Në rast të veprimeve ose mosveprimeve, një person mund të privohet nga mundësia për të gëzuar ose mbrojtur një të drejtë të caktuar. Prandaj, paraligjorët në komunitete janë shumë të kërkuar në zonat rurale duke ofruar kryesisht ndihmë juridike parësore në formën e konsultimeve dhe këshillave juridike.⁴⁹

Rolin e paraligjorit e luajnë OJF si, Namati dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur.⁵⁰ Në projekte të ndryshme është përfshirë puna e paraligjorëve me fokus të veçantë grupet e marginalizuara duke ndikuar në rritjen e aksesit të komunitetit në sistemin e drejtësisë. Për shembull, ata janë përfshirë në një projekt për të ndihmuar romët pa shtetësi, që jetonin në bashkësi të izoluar, për t’u pajisur me dokumente identifikimi. Me ndihmën e avokatëve vendas, si dhe paraligjorëve romë të bazuar në komunitet, u arrit që disa individë romë të pajiseshin me dokumente identifikimi personal duke u mundësuar shkollimin dhe kryerjen e veprimtarive të tjera jetësore.⁵¹ OJF-të kanë ndihmuar edhe në ngritjen e qendrave të konsulencës paraligjore, për shembull në 2011 organizata publike “Komiteti i Zgjedhjeve të Ukrainës”, me mbështetje financiare nga Fondacioni i Rilindjes Ndërkombëtare, krijoi pesë qendra të tilla.

(b) Si lindi nevoja për të rritur aksesin për ndihmë juridike falas në Ukrainë dhe të ashtuquajturit “këshilltarë publikë”

Ashtu sikurse u paraqit edhe në legjislacionin më sipër, sistemi i ndihmës juridike falas, një strukturë relativisht autonome nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë, vepron në të gjithë Ukrainën nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike parësore (konsultime) dhe ndihmës juridike dytësore (mbrojtje ligjore, përfaqësim përpara gjykatës, përgatitje të dokumenteve procedurale etj.) përmes një sërë qendrash dhe zyrash të ofrimit të kësaj ndihme.

Pavarësisht situatës së mësipërme, në Ukrainë ekziston nevoja për të zgjeruar aksesin në ndihmë ligjore falas. Kërkesa për të përfutur shërbime ligjore falas është e madhe, ndërkohë që ka shumë

⁴⁹<https://www.undp.org/content/dam/ukraine/docs/DG/12.%20UNDP-IRF%20manual-%20centres%20legal%20consultations%20eng.pdf>

⁵⁰ <https://www.justiceinitiative.org/voices/access-justice-advances-ukraine>
<https://www.youtube.com/watch?v=InLjcZcCJsc>

⁵¹ <https://osgf.ge/en/where-an-open-society-scholarship-can-take-you/>

qytete/fshatra të vogla, të cilat nuk janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku. Nga ana tjetër, ka shumë individë në nevojë që nuk plotësojnë gjithmonë kriteret për të përfituar ndihmë ligjore falas. Gjithashtu, niveli i ndërgjegjësimit ligjor në Ukrainë është shumë i ulët. Qytetarët nuk i besojnë institucioneve shtetërore dhe për rrjedhojë nuk aplikojnë për të përfituar ndihmë juridike.

Duke pasur parasysh situatën e mësipërme, dhe problematikat e shfaqura në zbatimin e sistemit të ndihmës juridike falas në Ukrainë, ka lindur nevoja për të përmirësuar aksesin në këtë sistem. Nisur nga kjo, sikurse u paraqit edhe më sipër, duke filluar nga viti 2017 në Ukrainë është zbatuar një projekt nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, që synon të krijojë një rrjet të të ashtuquajturve këshilltarë publikë ose këshilltarë juridikë publikë. Iniciativa për të krijuar një rrjet këshilltarësh publikë dhe trajnimi i tyre po zbatohet në Ukrainë nga Fondacioni i Rilindjes Ndërkombëtare, në bashkëpunim me Qendrën e Koordinimit të Ndhmës Juridike, Rrjetin e Zhvillimit Ligjor dhe Fondacionin e Ndhmës Ligjore të Ukrainës. Shpesh këta këshilltarë quhen gjerësisht në mënyrë jozyrtare paraligjorë. Ky projekt është i lidhur ngushtë me sistemin e ndihmës juridike falas, dhe ka për qëllim zgjerimin e aksesit në sistemin e ndihmës juridike falas. Gjithashtu, projekti është i lidhur me reformën e decentralizimit, qëllimi i së cilës është fuqizimi i komuniteteve lokale, që të bëhen më pak të varura nga shteti, veçanërisht nga organet qendrore. Ky projekt pilot nuk vepron brenda një kuadri rregullator shtetëror dhe po zbatohet vetëm në disa rajone të Ukrainës.

Në kuadër të këtij projekti, u vendos që të trajnohen njerëz nga komunitetet për të ofruar disa lloje të shërbimeve të ndihmës juridike, duke rritur gjithashtu ndërgjegjësimin tek individët për sistemin shtetëror të ndihmës juridike falas, dhe shërbimet e tjera shtetërore, si dhe lehtësimin e aksesit tek ndihma juridike duke ndikuar në fuqizimin e komuniteteve.

Kështu, këta paraligjorë komunitarë veprojnë në komunitete të vogla. Ata punojnë *pro bono*, dhe e vetmja gjë që përfitojnë është trajnimi paraprak. Si rregull, ata nuk kanë arsim ligjor. Profesionet e personave që veprojnë si paraligjorë janë të ndryshme, por mjafton që ata të jenë aktivë në komunitet, të jenë të njohur dhe të besuar në komunitetin e tyre (ose të paktën të jenë të gatshëm të kryejnë këtë rol në komunitet dhe njëkohësisht të kenë edhe një potencial të caktuar për të fituar besim tek komuniteti). Gjithashtu, duhet të njohin mirë problemet e komunitetit, sistemin e shërbimeve shtetërore, dhe të njohin personalisht personat që ofrojnë shërbimet shtetërore në rajonin e tyre. Ata veprojnë si një lidhje midis komunitetit dhe shtetit.

Disa prej tyre janë aktivistë të shoqërisë civile, shpesh të rinj, anëtarë të OJF-ve të specializuara (për shembull, ato që mbështesin disa kategori vulnerabël siç janë veteranët), nëpunës civilë që punojnë në agjencitë shtetërore lokale, ose organet lokale të vetëqeverisjes/organe ekzekutive, punonjës të kujdesit shoqëror, punonjës socialë, vullnetarë, bibliotekarë, mësues të shkollave të drejtësisë si dhe studentë të drejtësisë që studiojnë në qytete, por që kohë pas kohe kthehen në komunitetet e tyre për të dhënë këshilla juridike.⁵²

⁵²<https://legaid.gov.ua/ua/holovna/178-hruden-2017/2159-persh-hromadski-radnyky-v-ukraini-proishly-navchannia>

(i) Këshilltarët e komunitetit/këshilltarët publikë

Kush janë këshilltarët e komunitetit/këshilltarët publikë

Këshilltarë të komunitetit janë njerëz që nuk kanë një edukim ligjor, por mund të ofrojnë ndihmë juridike themelore/bazike në komunitetet e vogla për çështjet më të zakonshme. Këshilltarët publikë informojnë komunitetin që ligji është një pjesë integrale e jetës dhe me ndihmën e tij mund të zgjidhen si problemet familjare ashtu edhe problemet e qytetarëve në përgjithësi. Detyra e këshilltarëve është që të ndihmojnë qytetarët që të kuptojnë terminologjinë juridike.⁵³

Këshilltarët e komunitetit janë anëtarë të zakonshëm të komunitetit që kanë disa njohuri për mekanizmat ligjorë shtetërorë. Këshilltarët publikë nuk janë avokatë dhe nuk kanë një diplomë në drejtësi, por ata kanë disa nga cilësitë e mëposhtme: njohuri themelore të ligjit dhe sistemit ligjor; janë anëtarë të komunitetit ose pjesë e organizatave me bazë komunitare; kanë aftësi dhe njohuri themelore/bazike për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ndërmjetësim, negociim, etj.); janë në gjendje të përcjellin ide dhe informacion në komunitet duke përdorur metoda interaktive; mund të kenë një marrëdhënie pune me autoritetet lokale dhe ofruesit e shërbimeve; kanë aftësi për të organizuar një komunitet për të rritur kapacitetin e komuniteteve me qëllim rritjen e aftësisë së komuniteteve për të zgjidhur problemet komunitare sistematike në të ardhmen.⁵⁴

Rëndësia e veprimtarisë së këshilltarëve të komunitetit është se ata janë të parët që identifikojnë çështje ligjore që shqetësojnë banorët e komunitetit. Sa më shumë këshillime të komunitetit ata kryejnë, aq më shumë komuniteti dhe problemet e tij do të dëgjohen. Në veçanti, në këtë mënyrë i vihet në ndihmë Ministrisë së Drejtësisë për të përcaktuar ato fusha të së drejtës së komunitetit për të cilat shteti është më pak i vetëdijshëm, dhe për rrjedhojë të formulojë një politikë shtetërore në fushën e aksesit në drejtësi, duke marrë parasysh nevojat përkatëse të komunitetit.

Si mund të bëhesh këshilltar publik?

Këshilltarë publikë mund të jenë: përfaqësuesit e çdo profesioni, nëse ata kanë mundësinë për të mësuar dhe dëshirën për të realizuar veten në komunitet; studentët e drejtësisë që studiojnë në qendrat rajonale, por herë pas here kthehen në komunitetet e tyre për këshilla; punonjësit socialë dhe vullnetarët; cilido qytetar i Ukrainës, i cili dëshiron të bëjë ndryshime pozitive në shoqëri, është në gjendje të aftësohet vetë dhe të aftësojë të tjerët, si dhe të komunikojë me qytetarët e komuniteteve të tij me një cilësi të lartë; përfaqësuesit e autoriteteve të vetëqeverisjes lokale, ose autoriteteve ekzekutive; përfaqësuesit e organizatave të shërbimeve.

⁵³https://www.irf.ua/novyny/komanda_yaka_zminit_spriynyattya_prava_v_kievi_obgovorili_institut_gromadskikh_radnykiv/

⁵⁴<http://www.vin.gov.ua/news/ostanni-novyny/17583-na-vinnychchyni-aktyvno-rozvyvaietsia-institut-hromadskykh-radnykiv>

Motivimet kryesore të kandidatëve janë ofrimi i ndihmës për njerëzit kur kanë nevojë për të, të zgjidhin problemet e komuniteteve të tyre dhe të zhvillohen vetë.

Detyrat e këshilltarëve publikë

Këshilltarët publikë kryejnë një sërë detyrash si: 1) ofrimi i ndihmës për problemet themelore/bazike, që kanë të bëjnë me pyetjet më të shpeshta ligjore; 2) fuqizimi ligjor i qytetarëve; 3) orientimi i qytetarëve për të marrë përsipër përgjegjësi dhe zgjidhur probleme në përputhje me ligjin; 4) shërbejnë si një urë lidhëse ndërmjet qeverisjes lokale, komunitetit, administratës publike; 5) promovimi i përparësive të zhvillimit të komunitetit; 6) ndërveprimi i drejtpërdrejtë me publikun; 7) ofrimi i këshillave juridike “fillestare” për qytetarët, që nuk janë në gjendje të kërkojnë ndihmë juridike nga avokatë profesionistë; 8) referimi i çështjes tek ofruesit e ndihmës juridike falas në rastet kur nuk mund të ndihmojnë vetë në ofrimin e ndihmës juridike etj.

Lidhur me ofrimin e këshillave juridike, ndihma konkrete që ofrojnë paraligjorët konsiston në, të kuptuarit e çështjeve ligjore duke orientuar individin në institucionin përkatës për zgjidhjen e problemit, këshillim lidhur me hapat që duhet të ndërmerren në një çështje të caktuar si dhe njohuri për funksionimin e sistemit të drejtësisë. Ata ndihmojnë në identifikimin e një problemi ligjor, për të informuar personin për mjetet juridike në dispozicion të tyre dhe për të lehtësuar përdorimin e këtyre mjeteve.

Gjithashtu, ata edukojnë komunitetin për të drejtat e tyre, për mjetet ligjore me anë të cilave mund të mbrojnë të drejtat e tyre duke ndikuar në fuqizimin e tyre ligjor.

Ka raste kur paraligjorët ndërmarrin edhe projekte apo nisma sociale, për shembull, mbledhjen e një grupi pune për të zhvilluar dhe mbrojtur një plan për përmirësimin e cilësisë së rrugëve ose mundësive për punësim. Ata përfshijnë në nismat e tyre sociale njerëz të tjerë, siç mund të jenë fëmijët e shkollave.

Gjithashtu, pritet që, duke vepruar si një lidhje midis komunitetit dhe shtetit, ata të informojnë agjencitë shtetërore për problemet e përgjithshme dhe nevojat ligjore të komunitetit. Prandaj, këshilltarët e komunitetit mund të iniciojnë dhe zbatojnë ndryshime pozitive në qytetet dhe fshatrat e tyre dhe të marrin mbështetje nga shteti dhe komuniteti.

Këshilltarët publikë nuk zgjidhin çështje të ndërlikuara juridike; nuk përfaqësojnë klientët në gjykata; nuk janë avokatë profesionistë; nuk kanë arsim në drejtësi.

Puna e këshilltarëve publikë është pa pagesë. Pavarësisht kësaj, cilësia e punës së tyre është e rëndësishme për kryerjen me efektivitet të detyrave të tyre. Për paraligjorët është e rëndësishme që gjatë veprimtarisë së tyre të fitojnë autoritet dhe popullaritet në komunitetin e tyre, të promovojnë ndryshime pozitive në të, duke qenë se këta persona kanë njohuritë e duhura dhe shërbejnë si një burim informacioni.

Shembuj nga praktika e këshilltarëve publikë në Ukrainë

Deri më sot, në Ukrainë janë duke punuar 66 këshilltarë publikë nga tre grupe të ndryshme, dhe në vitin 2019 ishin parashikuar të zhvillohen një sërë grupesh të reja trajnimesh për aftësimin e këtyre këshilltarëve duke rritur numrin e tyre deri në 150.

Në 15 korrik 2019 këshilltarët e komunitetit në Ukrainë prezantuan iniciativat e tyre të ndërmarra gjatë një diskutimi të hapur “Trendet në komunitet: eksperiencia e këshilltarëve publikë/të komunitetit”.⁵⁵ Iniciativat sociale të këshilltarëve të komunitetit në Ukrainë adresojnë temat më të rëndësishme të komuniteteve lokale. Disa këshilltarë publikë kanë iniciuar projektin “Përfshirja e të rinjve në vendimmarrje” dhe kanë organizuar një hapësirë për edukim qytetar dhe rekreacion në shkollë. Si rezultat i këtij projekti, janë përmirësuar njohuritë e studentëve për njohuri në financë, mbrojtjen e të drejtave të studentëve dhe tema të tjera të rëndësishme. Gjithashtu, një këshilltar tjetër publik ka zbatuar një fushatë informative dhe edukative me titull “Rastet e bashkëpronarëve”, gjatë zbatimit të së cilës u informuan bashkëpronarët e ndërtesave të apartamenteve në lidhje me dispozitat procedurale për menaxhimin e pronësisë së përbashkët. Ka pasur edhe raste ku këshilltarët publikë janë përfshirë në zbatimin e ligjit në tre komunitete të ndryshme. Më konkretisht, kjo nismë u zbatua për të trajnuar një aktivist në çdo qytet, i cili do të merrte rolin e këshilltarit publik dhe do të ndihmonte në zgjidhjen e çështjeve më të ngutshme të qytetarëve në këto komunitete.

Në një komunitet tjetër, u zbatua nisma “Animatorët e komunitetit”, e cila synonte të gjente qytetarë aktivë në fshatrat e rrethit, t’i mësonte ata si të përdorin mjetet e ndikimit në qeveri dhe ndërveprimin me komunitetin dhe për të frymëzuar krijimin e bashkëpunimit pozitiv dhe fuqizimin e komuniteteve të tyre. Si rezultat, u krijua bashkëpunimi midis aktivistëve të 5 fshatrave duke rritur edhe kompetencat e banorëve lokalë. Një këshilltar tjetër publik ishte marrë me çështje të sigurisë së komunitetit, duke përfshirë kushtet e rrugës, mundësitë e punësimit dhe mjedisin.

(ii) Trajnimi i paralogjorëve/këshilltarëve publikë

Paralogjorët zgjidhen bazuar në një konkurs të hapur dhe i nënshtrohen trajnimit fillestar. Që prej vitit 2017 janë ofruar një sërë trajnimesh për aftësimin e tyre. Trajnimet janë organizuar nga Qendra e Koordinimit të Ndihmës Juridike Falas, financuar nga Fondacioni i Rilindjes Ndërkombëtare.

Më konkretisht, në maj 2017 filloi trajnimi i trajnerëve, që do të përfshiheshin më vonë në trajnimin e këshilltarëve publikë/paralogjorëve të ardhshëm. Trajnerët e paralogjorëve ishin përfaqësues të organizatave të ndryshme të përfshira në ofrimin e shërbimeve ndaj klientit, duke përfshirë ndihmën juridike, dhe kishin eksperiencë në praktika trajnimi. Midis tyre ishin ekspertë të sistemit të ndihmës juridike.

⁵⁵ https://www.irf.ua/novyny/vidkrita_diskusija_trendi_v_gromadakh_dosvid_gromadskikh_radnikiv/

Një nga qëllimet e trajnimit ishte prezantimi i trajnerëve të ardhshëm me kurrikulën e plotë, si dhe diskutimi i metodologjisë së punës së tyre me paraligjorët e ardhshëm. Më konkretisht, gjatë trajnimit 4-ditor trajnerët e ardhshëm u informuan se çfarë janë paraligjorët, u informuan për të zhvilluar këtë komunitet të ri për Ukrainën, si dhe për të sqaruar disa aspekte të bashkëpunimit me ta; u diskutua metodologjia për të zhvilluar aftësi praktike për punë të mëtejshme të përshtatshme me paraligjorët të ardhshëm, metodat që duhet të përdoren për trajnimin e paraligjorëve, si dhe u vendos edhe në lidhje me përmbajtjen e tre moduleve trajnimi.⁵⁶

Në 4 tetor 2017, filloi për herë të parë trajnimi i këshilltarëve publikë/paraligjorëve.⁵⁷ Gjatë trajnimit, pati përfaqësues trajnerë nga Programi për Iniciativën në të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësi të Fondacionit të Rilindjes Ndërkombëtare, Qendra e Koordinimit të Ndhmës Juridike dhe Rrjeti i Zhvillimit Ligjor.

Fillimisht u zhvillua moduli i parë i kursit të trajnimit për kandidatët që kishin shprehur dëshirën për t'u bërë këshilltarë publikë, dhe e kishin kaluar me sukses konkursin për pranimin e këshilltarëve publikë. Trajnimi ishte 4-ditor. Pjesëmarrësit e modulit të parë të trajnimit ishin 29 përfaqësues aktivë të komuniteteve territoriale nga rajone të ndryshme të Ukrainës.

Moduli i parë i trajnimit ishte “Të drejtat e njeriut”. Në veçanti, në këtë modul u trajtuan të kuptuarit e të drejtave të njeriut, garancitë ligjore për zbatimin dhe mbrojtjen e tyre. Gjithashtu, u trajtuan problemet e popullsisë në nevojë dhe parandalimi i diskriminimit, të drejtat e minoriteteve, çështjet bazike ligjore në fushat e familjes, tokës, punës, fushën sociale, trashëgimisë dhe të drejtave të konsumatorit.

Gjatë trajnimit u theksua rëndësia e zhvillimit të një rrjeti të këshilltarëve të komunitetit në Ukrainë, pasi përfshirja e tyre në zgjidhjen e problemeve ligjore dhe problemeve të tjera të individëve konsiderohet si një nga mënyrat efektive për të rritur kapacitetin e banorëve të komuniteteve ukrainase.

Moduli i dytë i trajnimit “Jeta në komunitet” u fokusua në jetën e komunitetit: 1) format e vetorganizimit të komunitetit dhe instrumentet e ndikimit dhe kontrollit tek autoritetet; 2) të kuptuarit e detyrave dhe funksioneve të nevojshme të praktikave restauruese, përfitimet dhe rreziqet e përdorimit të praktikave restauruese në vendimmarrjen e komuniteteve dhe zgjidhjen e problemeve; zgjidhja e konflikteve, proceset e lehtësimit dhe ndërmjetësimit; 3) bazat e legjislacionit për të parandaluar dhunën në familje, sistemin e shërbimeve shtetërore dhe OJF-të e autorizuara për të parandaluar dhunën; komunikimi me individët që i nënshtrohen dhunës në familje, orientimi i viktimave që kërkojnë ndihmë tek institucioni i duhur; ofrimi i këshillave themelore juridike ose i informacionit të nevojshëm; 4) të kuptuarit e çështjeve të sigurisë së komunitetit si pjesëmarrje dhe përgjegjësi e ndarë midis policisë, qeverive lokale dhe banorëve; të

⁵⁶<https://legalaid.gov.ua/ua/component/content/article/146-news/novyny/traven-2017/2029-v-ukraini-hotuiut-treneriv-merezhi-paraiurystiv-pershyi-navchalnyi-treninh-proishov-na-chernihivshchyni>

⁵⁷<https://legalaid.gov.ua/ua/holovna/2113-v-ukraini-vpershe-rozpochato-navchannia-hromadskykh-radnykiv>

kuptuarit e formave dhe rezultateve të bashkëpunimit ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara në fushën e sigurisë në komunitet, sjelljes proaktive në raste urgjente.

Në dhjetor 2017, përfundoi moduli i fundit, i treti i kursit pilot të trajnimit për këshilltarët publikë “Ndryshimet e sistemit dhe bashkëpunimi”. Trajnimi 4-ditor u mbajt në rajonin e Kievit nga 9 dhjetor deri më 12 dhjetor 2017.⁵⁸ Pjesëmarrës të trajnimit ishin përfaqësues aktivë të komuniteteve territoriale nga rajone të ndryshme të Ukrainës, të cilët kaluan me sukses modulet e trajnimit të parë dhe të dytë.

Gjatë këtij trajnimi, pjesëmarrësit u trajnuan në lidhje me rrjetet rajonale të shërbimeve sociale dhe sistemin shtetëror të ofrimit të ndihmës juridike falas; partnerët joqeveritarë të tij; sigurinë e informacionit dhe rrjetëzimit; njohuri për konceptet themelore dhe procesin e advokimit për paraligjorët; parimet e komunikimit në komunitet, mundësitë e përdorimit të medieve sociale, llojet e komunikimit, identifikimi i problemeve të advokimit në komunitet, përgatitja e çështjeve praktike në komunitet për të ilustruar rëndësinë e problemeve dhe pamundësinë e zgjidhjes së tyre me mënyra ekzistuese ligjore; analiza e strukturës së komunitetit për përfshirjen e mëtejshme të përfaqësuesve të saj në fushatën e advokimit; aftësi të vetë-prezantimit dhe kundër-argumentimit; mbledhja e fondeve, buxhetimi, paraqitja e propozimeve të granteve.

Gjithashtu, këshilltarët e komunitetit/pjesëmarrësit diskutuan arritjet dhe sukseset e tyre në komunitet, shqyrtuan çështje që lidhen me aftësitë praktike të dialogut me komunitetin, kundërveprimin ndaj dhunës në familje dhe sigurisë së komunitetit. U diskutuan edhe një sërë temash aktuale në lidhje me aktivitetet e mëtejshme të këshilltarëve të komunitetit në fushën e rritjes së kapaciteteve ligjore të komuniteteve. Në veçanti, këshilltarët publikë diskutuan aspektet e bashkëpunimit të paraligjorëve me avokatët dhe anëtarët e tjerë të sistemit të drejtësisë.

⁵⁸<https://legalaid.gov.ua/ua/holovna/178-hruden-2017/2159-pershi-hromadski-radnyky-v-ukraini-proishly-navchannia>

D. GJEORGJIA

1. Kuadri ligjor i sistemit të ndihmës juridike

Ligji i Gjeorgjisë për ndihmën juridike⁵⁹ i ndryshuar, ka për qëllim të krijojë një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm të ndihmës juridike me fokus ndaj nevojave të shoqërisë për garantimin e të drejtës kushtetuese të mbrojtjes.

Shërbimi i ndihmës juridike përfshin ndihmën juridike parësore nëpërmjet ofrimit të këshillave dhe konsultimeve juridike dhe dytësore nëpërmjet ndihmës juridike në formën e hartimit të dokumenteve ligjore dhe përfaqësim gjyqësor nga avokatë të kualifikuar mbrojtës. Ndihma juridike dytësore sigurohet vetëm në procedurat penale, civile dhe administrative për një person të akuzuar, dënuar ose liruar, nëse ekzistojnë kushtet e përcaktuara me ligj. Subjektet e ndihmës juridike janë shtetasit e Gjeorgjisë, personat pa shtetësi dhe shtetasit e huaj. Shërbimi i ndihmës juridike falas u ofrohet atyre që kanë të drejtë për mbrojtje të detyrueshme dhe gjithashtu grupeve të marginalizuara.⁶⁰

Ligji⁶¹ rregullon funksionimin e një organi të pavarur, Autoriteti Ligjor i së Drejtës Publike ose shkurt Njësia e Ndihmës Juridike (NJNJ), e cila administron sistemin e ndihmës juridike dhe përbëhet nga zyra qendrore, zyrat e ndihmës juridike (ZNJ) dhe qendrat e këshillimit. NJNJ ka formën e personit juridik të së drejtës publike nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë. Ministria ushtron mbikëqyrjen e përgjithshme të funksionimit të SHNJ, miraton statutin e saj dhe emëron drejtorin dhe anëtarët e bordit monitorues. Gjithashtu, Ministria vendos për krijimin e ofruesve të ndihmës juridike të drejtuar nga shteti, zyrat e ndihmës juridike (ZNJ) dhe qendrat e këshillimit, bazuar në propozimin e drejtorit të NJNJ.

NJNJ funksionon përmes një rrjeti të zyrave të ndihmës juridike dhe qendrash këshillimi, duke përdorur burime të jashtme të ofruesve të ndihmës juridike, të zgjedhur me një procedurë oferte, si dhe avokatë të regjistruar në regjistrin e avokatëve publikë.

Qendrat e këshillimit veprojnë në zona të largëta ku nuk ka zyra të ndihmës juridike. Ato nuk ofrojnë ndihmë juridike drejtpërdrejtë dhe puna e tyre është e kufizuar vetëm në dhënien e këshillave juridike, kohëzgjatja e të cilave nuk mund të kalojë 1 orë. Qendra e këshillimit gjithashtu transferon çështjet për trajtim të mëtejshëm tek avokatët që janë të regjistruar në listën e avokatëve publikë.

⁵⁹ <https://matsne.gov.ge/en/document/download/21604/11/en/pdf>

⁶⁰ https://www.undp.org/content/dam/georgia/docs/publications/DG/UNDP_GE_DG_Early%20Access%20to%20Legal%20Aid%20Eng.pdf

⁶¹ <https://rm.coe.int/georgia-barriers-remedies-and-good-practices/168075fd52>

ZNJ shtrihen në të gjithë rajonet e Gjeorgjisë. Në ato zona të largëta ku nuk ka zyra të tilla, atëherë janë qendrat e këshillimit që sigurojnë përfshirjen e një avokati publik në një procedurë ligjore.

Ndihma juridike ofrohet përmes mbrojtësve publikë, siç janë avokatët dhe këshilltarët ligjorë, një ofruer i ndihmës juridike ose një avokat i regjistruar në regjistrin e avokatëve publikë.

Njësia e Ndhmës Juridike ofron shërbimet e mëposhtme: hartim i dokumenteve ligjore të tilla si aplikime, pretendime, ankesa, deklarata mbrojtje, mocione dhe dokumente të tjerë; ofrim i mbrojtjes ligjore për një të akuzuar, të dënuar ose person të pafajshëm në procedurë penale, mbrojtjen e viktimave në procedurat penale me shpenzimet e shtetit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale të Gjeorgjisë; përfaqësim në gjykatë për çështje administrative dhe civile; dhe përfaqësim përpara një organi administrativ.

NJNJ ofron shërbimet e saj pa pagesë në çështjet penale, civile, tregtare, të drejtën e punës dhe të drejtën administrative.

Ndihma juridike falas ofrohet nga NJNJ vetëm për personat me paftësi paguese në Gjeorgji. Drejtori i NJNJ mund të vendosë për ofrimin e shërbimeve edhe në favor të një personi me aftësi paguese, i cili për shkak të kushteve të vështira socio-ekonomike, nuk mund të përballojë shërbimet e avokatit.⁶²

Sikurse u paraqit edhe më sipër, ligji parashikon ofrimin e ndihmës juridike në një territor të caktuar edhe nga ofruerit privatë, të cilët mund të jenë persona juridikë, si organizata jofitimprurëse ose avokatë privatë. Kjo quhet ndihmë juridike me kontratë. Paraqitja e ofertave është e hapur për të gjitha firmat e avokatëve dhe avokatët në Gjeorgji. Regjistri i avokatëve publikë hartohet dhe mirëmbahet nga Njësia e Ndhmës Juridike. Përveç kësaj, ligji u mundëson zyrtarëve të ndihmës juridike dhe qendrave të këshillimit të kenë një listë të avokatëve të regjistruar, të cilët mund të përdoren për të ofruar shërbim.

2. Praktika e sistemit të ndihmës juridike në Gjeorgji

Që nga nëntori 2017, në të gjithë Gjeorgjinë veprojnë 13 zyra të ndihmës juridike dhe 9 qendra këshillimi. Ndihma juridike parësore në Gjeorgji mund të ofrohet nga qendrat shtetërore të këshillimit dhe këshilltarët juridikë që punojnë në zyrat e ndihmës juridike, si dhe personat juridikë të së drejtës private dhe avokatë individualë, të kontraktuar nga NJNJ.

Ndryshimet në legjislacionin gjeorgjian 2017-2018 kanë zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme kompetencat e NJNJ, duke rritur aksesin e publikut në ndihmë juridike dhe duke zgjeruar fushën e shërbimeve të ofruara për çështje që kanë të bëjnë me punën, mosmarrëveshjet e pasurive të paluajtshme dhe dhunën me bazë gjinore dhe familjare.

⁶²Po aty

Ndihma juridike parësore e ofruar nga këshilltarët ligjorë të ZNJ konsiston në dhënien e këshillave verbale dhe këshillimeve. Megjithatë, këta këshilltarë hartojnë edhe dokumente ligjore. Të gjithë këshilltarët kanë arsim në drejtësi. Ndihma juridike e ofruar nga këshilltarët nëpërmjet këshillimeve ligjore nuk duhet të zgjasë më shumë se një orë. Konsultimet jepen në takime ballë për ballë aty për aty, ose me takim paraprak, gjatë orarit të punës së ZNJ. Gjithashtu, këshilla dhe konsulta juridike falas jepen edhe përmes telefonit nëpërmjet qendrave të thirrjeve telefonike.⁶³ Qendra e thirrjeve telefonike u krijua si përgjigje e kërkesës së shtuar për shërbime juridike nga qytetarët, e cila punëson katër këshilltarë të kualifikuar që punojnë si operatorë telefonik, të trajnuar posaçërisht për këtë pozicion pune.

Gjithashtu, këshilltarët dhe avokatët e ndihmës juridike organizojnë fushata edukimi ligjor për fëmijët e shkollave dhe banorët e komunitetit. Ata gjithashtu përfaqësojnë interesat e komunitetit përpara autoriteteve shtetërore, organizojnë takime me autoritetet lokale dhe institucionet e tjera shtetërore për të diskutuar problemet sistematike me të cilat përballen komunitetet të tilla si regjistrimi civil ose titulli i pronësisë mbi tokën. Këshilltarët dhe avokatët bëjnë një përpjekje të përbashkët për të marrë pjesë në ngjarjet e komunitetit dhe të pranohen si nga banorët, ashtu edhe nga autoritetet lokale. Në disa rajone, për shembull, ata marrin pjesë në aktivitetet e këshillave lokale. Më tej, avokatët dhe konsulentët organizojnë seanca të lëvizshme për të ofruar konsulta me ato komunitete, që janë të vështirë për t'u arritur për shkak të distancave të largëta me qytetet kryesore.

Pavarësisht rrjetit të gjerë të shërbimeve të ofruara nga shteti, ka kërkesa të shumta për shërbime shtesë të ndihmës juridike, kërkesë e cila plotësohet përmes programeve të ndihmës juridike të siguruara nga OJF-të. Për shembull, organizata GYLA ofron këshillime juridike si personalisht, ashtu edhe përmes internetit dhe lidhjeve telefonike, si dhe ofron përfaqësime në procedurat penale, civile dhe administrative. Një sërë OJF-sh të tjera dhe klinika shkollash juridike ofrojnë shërbime juridike falas.⁶⁴ Në Gjeorgji ndihma juridike pavarësisht se garantohet nga shteti, financohet kryesisht nga fonde të siguruara nga donatorë ndërkombëtarë.

Në Gjeorgji “zyrat shtetërore të këshillimit juridik” kanë të punësuar avokatë si dhe paraligjorë, dhe në këtë mënyrë zyra të tilla ofrojnë si asistencë juridike parësore ashtu edhe dytësore.⁶⁵

⁶³<http://georgiatoday.ge/news/10975/Free-Legal-Aid-Now-Available-by-Phone-for-Georgian-Citizens?fbclid=IwAR1-i6isY3XwByqhfl0oMWQQqOH38Rx08H0rLVGZw5NQceexk5DzQhphkec>
<https://www.osce.org/odihr/36297?download=true>

64

⁶⁵https://www.undp.org/content/dam/ukraine/docs/seichasen_4708604_eng-international_study-legal_aid_systems.pdf

E. SIERRA LEONE

1. Kuadri ligjor i ndihmës juridike

Ligji i ndihmës juridike i vitit 2012 të Sierra Leone⁶⁶, parashikon një model të përzier të ofrimit të ndihmës juridike, nëpërmjet ofrimit të këshillave juridike, shërbimeve të ndërmjetësimit deri në përfaqësimin në gjykatë, shërbime të ofruara nga partneriteti publik/privat i qeverisë, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Ky ligj njohu për herë të parë ligjërishit dhe formalisht si pjesë të kornizës së ndihmës juridike edhe paraligjorët, të cilët deri në 2012 kishin vepruar mbi baza joformale.

Në bazë të ligjit ndihma juridike u sigurohet personave të varfër, nëse e kërkon interesi i drejtësisë. Ligji parashikon një përkufizim të gjerë të ndihmës juridike, i cili konsiderohet si ofrimi i këshillave dhe ndihmës juridike, ose përfaqësim për personat e varfër. Ndërsa, këshilla dhe ndihma juridike konsiston në: ofrim i informacionit si në çështjet penale dhe civile rreth ligjit dhe proceseve ligjore përkatëse; ndihmë në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve; këshillime për çështje ligjore; ndihmë në hartimin e dokumenteve të caktuara; referim i çështjeve ligjore tek avokatët; dhe kryerja e punëve të tjera, që nuk përbëjnë përfaqësim ligjor.

Në bazë të ligjit ofruesit e ndihmës juridike janë të shumtë të tillë si, një praktikues ligjor, organizatë e shoqërisë civile, organizatë jofitimprurëse, klinikë universitare ligjore, ose paraligjor i akredituar për të ofruar ndihmë juridike. Sipas ligjit një praktikues i ndihmës juridike është një praktikues ligjor i punësuar nga Bordi i Ndihmës Juridike (Bordi), një praktikues ligjor me praktikë në fushën private i akredituar nga Bordi, një praktikues ligjor i punësuar nga një shoqëri civile e akredituar, një organizatë jofitimprurëse, ose klinikë ligjore universitare për të ofruar ndihmë juridike.

Në bazë të ligjit një “paraligjor i akredituar” mund të jetë një person i punësuar nga Bordi, një autoritet shtetëror, një organizatë e akredituar e shoqërisë civile, ose një organizatë jofitimprurëse. Paraligjori duhet të ketë përfunduar një kurs trajnimi në fushën përkatëse të studimit në Institutin e Trajnimit Gjyqësor dhe Ligjor, ose në një institucion arsimor të miratuar nga Bordi.

Në bazë të nenit 9 të ligjit parashikohet ngritja e Bordit të Ndihmës Juridike, e cila është një strukturë mbikëqyrëse me funksione të ndryshme, në formën e një organizate jofitimprurëse dhe që funksionon në mënyrë të pavarur nga çdo agjenci qeveritare. Më konkretisht, kompetencat e Bordit të Ndihmës Juridike, ndër të tjera, janë: 1) ofrimi i ndihmës juridike; 2) akreditimi i personave, ose organeve që ofrojnë ndihmë juridike; 3) përcaktimi i llojeve të personave dhe çështjeve për të cilat mund të jepet ndihma juridike; 4) përcaktimi i rrethanave në të cilat do të paguhet kontributet për ndihmë juridike nga persona të ndihmuar ligjërishit dhe si do të qarkullojnë

⁶⁶ <https://sierralii.org/sl/legislation/act/2012/6>

kontributet; 5) lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me praktikues ligjorë, shoqërinë civile dhe organizatat joqeveritare, klinikat universitare ligjore, ose departamentet e ligjit, etj.

Lidhur me kompetencën e Bordit për ofrimin e ndihmës juridike, shërbimet themelore të Bordit kanë qenë ofrimi i informacioneve ligjore dhe edukimi ligjor për qytetarët, ofrimi i këshillave ligjore, këshillim ndërfaqësor dhe përfaqësimi ligjor për të burgosurit e qendrave rehabilituese të Sierra Leone. Bordi ka ndërhyrë në çështje të ndryshme si: çështjet familjare, mbështetja ndaj fëmijëve, veprat penale për të mitur, borxhet, çështjet e tokës, çështjet penale, dhuna në familje, përdhunimi, ndotja e mjedisit, mosmarrëveshjet me bazë tregtare dhe problemet e komunitetit.⁶⁷

Me qëllim që të ofrohet ndihmë ligjore, Bordi ka kompetenca të gjera për të akredituar praktikuesit ligjorë, organizatat e shoqërisë civile, klinikat ligjore universitare, paraligjorët dhe organizatat joqeveritare, të cilat ofrojnë informacione juridike, këshilla, ndihmë, shërbime të ndërmjetësimit dhe përfaqësim në gjykatë.

Sipas ligjit, Bordi duhet të ketë në përbërjen e tij nga një përfaqësues nga shoqëria civile dhe organizatat jofitimprurëse që kanë përvojë, njohuri dhe ekspertizë për çështje që lidhen me ndihmën juridike. Aktualisht, dy përfaqësues të shoqërisë civile janë pjesë të Bordit.

Të gjitha institucionet që janë të pavarura nga Bordi i Ndihmës Juridike, pavarësisht nëse ofrojnë përfaqësim ligjor, këshilla ose ndihmë dhe që mund të punojnë me paraligjorë, mund të ofrojnë ndihmë juridike, por vetëm nëse kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me Bordin e Ndihmës Juridike. Nëse personat e varfër kanë nevojë për përfaqësim ligjor në gjykatë, si në çështjet civile dhe ato penale, kjo formë e ndihmës juridike duhet së pari të miratohet nga Bordi. Këshillimi dhe ndihma juridike, të cilën mund ta ofrojnë paraligjorët dhe që e përfitojnë vetëm personat e varfër, nuk ka nevojë të miratohet nga Bordi për çdo rast.⁶⁸

Ligji parashikon se, nëse ofruesi i ndihmës juridike, kur ofron ndihmë juridike dhe këshilla, nuk financohet nga Bordi i Ndihmës Juridike, atëherë ky ofrues mund të vendosë kriteret e veta për të përcaktuar ofrimin e ndihmës juridike.

Përfaqësimi ligjor në çështjet penale duhet të sigurohet që nga momenti i arrestimit derisa të merret një vendim në lidhje me një ankim të mundshëm. Policia dhe zyrtarët e burgut kanë detyrimin të njoftojnë Bordin e Ndihmës Juridike për një arrestim ose burgim të një personi, i cili nuk është i përfaqësuar dhe që konstatohet se është i varfër, ndërkohë që edhe gjyqtarët dhe magjistratët mund të informojnë Bordin për të njëjtën gjë. Në ligj nuk ka një kriter të ngjashëm si në rastin e përfaqësimit, lidhur me kohëzgjatjen e ofrimit të ndihmës dhe këshillave juridike.⁶⁹

⁶⁷http://www.internationallegalaidgroup.org/images/miscdocs/LEGAL_AID_BOARD_COUNTRY_REPORT_2016_Final.pdf

⁶⁸<https://acjr.org.za/resource-centre/formalising-the-role-of-paralegals-in-africa-a-review-of-legislative-and-policy-developments/view>, fq. 20

⁶⁹ Po aty, fq. 20-21

Përfaqësimi ligjor në gjykatë mund të ofrohet vetëm për personat e varfër (niveli maksimal i të ardhurave përcaktohet nga Bordi i Ndhmës Ligjore), si në çështjet civile apo penale, dhe duhet të miratohet nga Bordi i Ndhmës Juridike. Ndërsa, ndihma dhe këshillat ligjore, përfshirë shërbimet paraligjore, mund t'u ofrohen të njëjtëve persona të varfër nëse financohen nga Bordi, ose për një grup më të gjerë individësh nëse këto shërbime nuk financohen nga Bordi.⁷⁰

Ligji i ndihmës juridike, gjithashtu, parashikon mekanizmat e mbikëqyrjes së ofrimit të ndihmës juridike. Së pari, të gjithë ofruesit e ndihmës juridike duhet të mbajnë të dhëna të çështjeve individuale në të cilat ndërhyjnë dhe duhet të raportojnë pranë Bordit të Ndhmës Juridike. Praktikuesit ligjorë që ofrojnë përfaqësim ligjor mund të jenë subjekt i një mase disiplinore nëse sjellja e tyre është joprofessionale. Gjithashtu, nëse një ofrues i ndihmës juridike e tillë si një organizatë që ofron ndihmë juridike, përfshirë shërbimet paraligjore, nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij/saj në bazë të një marrëveshje bashkëpunimi të lidhur me Bordin e Ndhmës Juridike, marrëveshja mund të anulohet. Mos akreditimi, ose ofrimi i ndihmës juridike pa marrëveshje bashkëpunimi përbën një vepër penale, për të cilat si individët ashtu edhe organizatat mund të jenë përgjegjës.

Bordi financohet nga një buxhet i veçantë i alokuar nga Parlamenti, të ardhurat e krijuara nga Bordi gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, si dhe nga grante, dhurime, trashëgimi, ose çdo lloj kontributi tjetër të bërë në favor të Bordit (neni 15 i ligjit).

Ligji i ndihmës juridike në Sierra Leone është duke u zbatuar ngadalë. Bordi i Ndhmës Juridike u krijua vetëm në mes të vitit 2014, por mungesa e vazhdueshme e financimit ka kufizuar aftësinë e tij për të funksionuar. Bordi është ende në proces të punësimit të stafit të tij dhe ende nuk është plotësisht funksional.

2. Roli i paraligjorit në sistemin e ndihmës juridike sipas ligjit të 2012 dhe praktika në zbatim të ligjit

Sikurse u përmend edhe më sipër, ligji parashikon si një element themelor të sistemit rolin e paraligjorit. Në nenin 14 të ligjit parashikohet se Bordi i Ndhmës Juridike cakton të paktën një paraligjor në çdo komunë për të ofruar këshilla, ndihmë juridike dhe edukim ligjor për shefin dhe banorët e komunës, por jo përfaqësim ligjor në gjykata, si dhe, kur vlerësohet e përshtatshme për të ndihmuar që çështje të caktuara të shqyrtohen në sistemin formal të drejtësisë.

Duke parashikuar në mënyrë të shprehur se paraligjorët do të ushtrojnë profesionin në secilin prej 149 komunave të Sierra Leone, ligji siguron një metodë fleksibël dhe me kosto efektive për ofrimin e shërbimeve ligjore në zona të mëdha të popullatës në një shtet që nuk ka mjaftueshëm avokatë të kualifikuar, veçanërisht jashtë kryeqytetit Freetown.⁷¹

⁷⁰ Po aty, fq. 21

⁷¹ <https://www.justiceinitiative.org/voices/new-legal-aid-law-sierra-leone-embraces-role-paralegals>

Sipas një studimi të organizatës Namati, të paktën deri në Mars 2019, Bordi i Ndhmës Juridike ende nuk e ka përbushur këtë mandat. Deri më sot, ka ngritur një zyrë që është e hapur për publikun, por që përdor një model të bazuar në avokatë për ofrimin e ndihmës juridike në çështjet penale.⁷² Megjithatë, që nga viti 2016, Bordi ka filluar të mbështesë disa paraligjorë që ndihmojnë të paraburgosurit, por nuk ka certifikuar ose financuar paraligjorë, që u shërbejnë komuniteteve në një gamë më të gjerë çështjesh ligjore. Sipas sekretarit ekzekutiv të Bordit, qeveria po planifikon të vendosë paraligjorët në stacionet e policisë. Këto paraligjorë mund të mbështeten në financimin e qeverisë në të ardhmen.⁷³

Por, në bazë të informacioneve të tjera për punën e Bordit të Ndhmës Juridike rezulton se, me ndihmën e organizatave, Bordi ka rekrutuar një sërë paraligjorësh dhe ka hapur një sërë zyrash në të gjithë territorin e Sierra Leone. Bordi ofron këshillim dhe përfaqësim ligjor për të varfërit dhe grupet e marginalizuara në shoqëri. Bordi ofron zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve. Paraligjorët e Bordit të Ndhmës Juridike bëjnë një punë të rëndësishme në rritjen e qasjes në drejtësi, veçanërisht në komunitetet e largëta.⁷⁴

Gjithashtu, Bordi ka kompetencë të vlerësojë cilësinë e përfaqësimit të ndihmës juridike dhe të vendosë masa disiplinore për paraligjorët, që nuk arrijnë të ofrojnë përfaqësimin e duhur ligjor (neni 30 i ligjit paragrafi 1). Kriteret specifike për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve paraligjore nuk janë specifikuar në ligjin e ndihmës juridike. Megjithatë, një “Udhëzues për Ndhmën Juridike”, që do të adresojë standarde të tilla është në përpunim e sipër.⁷⁵

Ligji përcakton se për akreditimin e paraligjorëve nga Bordi, ata duhet të përfundojnë kurset përkatëse në Institutin e Drejtësisë dhe Trajnimit Gjyqësor, ose në një institucion tjetër të miratuar nga Bordi (neni 30 i ligjit paragrafi 2).

Që nga viti 2017, Bordi nuk ka finalizuar ende një skemë zyrtare të certifikimit për paraligjorët. Përbajtja e programit të trajnimit për paraligjorët nuk është miratuar ende për shkak se palët e ndryshme të interesuara nuk kanë rënë dakord. Bordi është duke punuar me sistemin gjyqësor për të filluar kursin e certifikimit në studime paraligjore në Institutin e Drejtësisë dhe Trajnimit Gjyqësor.⁷⁶

Pavarësisht zbatimit të vonuar të ligjit, paraligjorët e komunitetit po ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve juridike në pjesë të ndryshme të vendit. Për shembull, paraligjorët po përmirësojnë ofrimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor duke ndihmuar komunitetet të bëjnë përgjegjëse

⁷² <https://namati.org/wp-content/uploads/2019/03/Sierra-Leone-Community-Paralegal-Research-Brief-Final.pdf>
fq.6

⁷³ Po aty, fq. 8

⁷⁴ http://internationallegalaidgroup.org/images/miscdocs/South_Africa_2017_PowerPoints/compressed_PP_Introducing_Legal_Aid_in_Sierra_Leon.pdf

⁷⁵ <https://namati.org/wp-content/uploads/2019/03/Sierra-Leone-Community-Paralegal-Research-Brief-Final.pdf>
fq. 7

⁷⁶ <https://thecalabashnewspaper.com/sierra-leone-news-legal-aid-board-staff-benefit-from-undp-funded-capacity-building-training/>

qeverinë për mungesë infermierësh. Ata janë duke ndihmuar gratë që kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin, duke mbështetur gratë në burg, ose duke ofruar ndihmë me shërbimet e paraburgimit. Paraligjorët po ndihmojnë komunitetet për t'i bërë përgjegjëse kompanitë e investimeve për dëmtimin e mjedisit dhe për veprimtari të tjera, po ndihmojnë në negocimin e marrëveshjeve të tokës me pale të treta dhe dhënien e informacionit dhe këshillave juridike përmes një linje telefonike publike pa pagesë.⁷⁷

3. Paraligjorët me bazë komunitare si pjesë e programeve paralegjore të ojf-ve. vështrim i përgjithshëm

Pas luftës civile, qeveria e Sierra Leone, organizata ndërkombëtare dhe organizata të shoqërisë civile filluan të ndërmerrnin si nismë paraligjorët me bazë komunitare si një mënyrë për të çuar përpara drejtësinë. Më konkretisht, në 2003 Fondacioni Shoqëria e Hapur ndërmorri një projekt pilot Nisma për drejtësi, për të ofruar shërbime juridike bazike në zonat rurale të Sierra Leone. Frymëzimi për projektin erdhi nga Afrika e Jugut, ku paraligjorët me bazë komunitare luajnë një rol integral në sistemin kombëtar të aksesit në drejtësi. Për shkak të mungesës së avokatëve në vend dhe strukturës juridike dualiste të Sierra Leone, Nisma për drejtësi filloi të investojë në ngritjen e një rrjeti paraligjorësh me bazë komunitare veçanërisht në pjesët rurale të vendit.

Në këtë kuadër në 2004, për të zbatuar nismën u krijua një organizatë joqeveritare lokale, Timap për Drejtësi, në kuadër të projektit Nisma për drejtësi. Një sërë paraligjorësh u trajnuan për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve bazike ligjore me të cilat përballen anëtarët e komunitetit dhe në të njëjtën kohë duke synuar forcimin e komuniteteve të tyre.⁷⁸ Paraligjorët e Timap, të mbikëqyrur nga avokatë praktikantë, adresonin dhe vazhdojnë të adresojnë problemet e ndryshme ligjore të komunitetit duke u bazuar në njohuritë e tyre mbi ligjin dhe familjaritetin që ata kanë me zakonet vendase.

Duke u bazuar në punën e Timap për Drejtësi, në 2009 qeveria e Sierra Leone, dhe një sërë donatorësh, përfshirë Bankën Botërore, GIZ, dhe Fondacionin Shoqëria e Hapur nëpërmjet projektit Nisma për drejtësi, dhe organizatash jofitimprurëse zhvilluan bashkërisht një qasje kombëtare ndaj programeve paralegjore. Kjo qasje është e përqendruar në rritjen e aksesit në ndihmë juridike dhe përfshin një “linjë të përparme të paraligjorëve të komunitetit dhe një grup të vogël avokatësh mbështetës”. Në bazë të kësaj iniciative, ekziston një rrjet prej gjashtë organizatash paralegjore: Qendra Ligjore për Aksesin në Drejtësi, Komisioni për Drejtësi dhe Paqe, AdvocAid, BRAC, Agjencia e Zhvillimit dhe Ndihmës së Sierra Leone Kisha Metodiste, dhe

⁷⁷ <https://namati.org/wp-content/uploads/2019/03/Sierra-Leone-Community-Paralegal-Research-Brief-Final.pdf>
fq. 9

⁷⁸ https://www.justiceinitiative.org/uploads/6001868b-f85d-4883-8da7-bdf2ebc93a4c/OSJI-Paralegal-Manual-US-11-05-2014.pdf?fbclid=IWAR1G4INPAQU31BkQj2-uG7w_fyMvea2emKclKRJJC9nRWZIV5pm2Gxr37KE

Timap për Drejtësi. Këto organizata punojnë me paraligjorë me bazë komunitare. Në këtë pjesë të studimit fokusi vendoset tek puna e këtyre organizatave nëpërmjet paraligjorëve.⁷⁹

Ky rrjet koordinohet nga Organizata Namati, e krijuar në 2011, që punon me fuqizimin ligjor të popullsisë në 8 vende të ndryshme dhe që siguron mbikëqyrje dhe trajnim për organizatat paraligjore.

Krahas këtij rrjeti, organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare janë duke ofruar shërbime paraligjore me bazë komunitare. Për shembull, Qendra për Përgjegjshmëri dhe Shtetin e së Drejtës ka një program monitorues të komunitetit, ku vullnetarë të trajnuar monitorojnë gjykatat lokale në çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe çështjet e drejtësisë në komunitet dhe raportojnë në Qendër. Gjithashtu, World Hope International ka një program paraligjor, që është i përqendruar në trafikimin e qenieve njerëzore dhe u siguron mbështetje individëve dhe komuniteteve dhe lehtëson angazhimin me policinë.⁸⁰

AdvocAid është një organizatë, e cila ofron ndihmë juridike falas. Organizata ka një staf paraligjorësh dhe këshilltarësh në të gjithë vendin, që u ofrojnë vajzave dhe grave ndihmë juridike dhe përfaqësim në stacione policore dhe gjykatë me qëllim që të drejtat e tyre themelore të respektohen dhe të njihen nga sistemi i drejtësisë. Paraligjorët e AdvocAid jetojnë brenda komuniteteve ku shërbejnë, janë të njohur e të respektuar në komunitet dhe kanë krijuar marrëdhënie të forta pune me stacionet e policisë, qendrat rehabilituese dhe gjykatat në zonën e tyre të banimit.⁸¹

Paraligjorët me bazë komunitare punojnë për fuqizimin ligjor, ata ndihmojnë njerëzit të kuptojnë dhe përdorin ligjin. Ata janë të trajnuar në ligj dhe politikë dhe në aftësi të tilla si ndërmjetësim, organizim kolektiv dhe advokim. Disa janë paraligjorë me njohuri të përgjithshme dhe merren me çfarëdo çështje që ndikon te drejtësia për anëtarët e komunitetit. Të tjerët specializohen në çështje si përkrhja e të mbijetuarve të dhunës seksuale, mbrojtja e të drejtave të tokës në komunitet, ose adresimi i dështimeve në ofrimin e shërbimeve publike.

Paraligjorët me bazë komunitare edhe pse quhen të tillë, nuk shërbejnë si ndihmës avokatë. Ata formojnë një vijë të përparme dinamike, krijuese që mund të përfshijë institucione zyrtare dhe tradicionale.⁸² Paraligjorët përbëjnë një urë lidhëse ndërmjet ligjit formal, institucioneve qeveritare dhe mekanizmave të drejtësisë zakonore, për shkak të familjaritetit që paraligjorët kanë me komunitetet lokale, sistemet informale në vend dhe dinamikën e pushtetit lokal. Paraligjorët ndihmojnë individët dhe anëtarët e komunitetit të gjejnë zgjidhje praktike për padrejtësitë shpesh në nivelin e komunitetit ose administratës, duke përdorur edukimin, ndërmjetësimin, organizimin në komunitet dhe advokimin. Paraligjorët të përkrhur dhe të mbikëqyrur nga avokatë, nëse është

⁷⁹ <https://namati.org/wp-content/uploads/2012/09/Final-Timap-Manual-June-2012.pdf>

⁸⁰ https://namati.org/wp-content/uploads/2016/01/sierra_leone_robb-jackson.pdf, fq. 23

⁸¹ <https://advocaidsl.org/access-to-justice/>

⁸² <https://namati.org/wp-content/uploads/2019/03/Sierra-Leone-Community-Paralegal-Research-Brief-Final.pdf>

e nevojshme, mund të trajtojnë çështje më komplekse. Sistemi i paralogjorëve kolektivisht ofron një model krijues dhe fleksibël për të vendosur drejtësi, madje edhe në zonat më të largëta të zonave rurale.⁸³

Që nga viti 2012, paralogjorët operojnë në afërsisht 36% të komunave të vendit dhe disa pjesë të kryeqytetit. Ata punojnë kryesisht për OJF të ndryshme, përfshirë Timap për Drejtësi, Qendrën Ligjore për Aksesin në Drejtësi dhe Komisionin për Drejtësi dhe Paqe.

Paralogjorët e komunitetit janë të pavarur për shkak të pavarësisë së Bordit të Ndhmës Juridike, i cili është përgjegjës për koordinimin, rregullimin dhe financimin e paralogjorëve.

Trajnimi i paralogjorëve kryhet kryesisht nga një sërë organizatash të shoqërisë civile. OJF të tilla si, Timap për Drejtësi ofrojnë kurse trajnimi shumë-javore dhe programe të tjera për rritjen e kapaciteteve për paralogjorët. Në partneritet me Namati, Timap për Drejtësi ka përgatitur një manual paralogjor, i cili vepron si gur themeli për të gjitha trajnimet që mund të ndërmerren për paralogjorët, nga OJF të ndryshme. Universiteti i Makenit në Sierra Leone, gjithashtu, ka një program trajnimi për paralogjorët, i cili bashkëpunon me organizatat partnere për të ofruar trajnime afatshkurtra për paralogjorët.

4. Eksperienca e organizatës Timap me paralogjorët

Paralogjorët e Timap adresojnë shkeljet e të drejtave brenda komunitetit. Timap përpiqet të zgjidhë problemet ligjore të komunitetit duke treguar se drejtësia është e mundur, si dhe duke ndihmuar fuqizimin e komunitetit me të cilin punon me qëllim që në të ardhmen vetë individi të trajtojë çështje ligjore në komunitetin e tij.

Paralogjorët përdorin një sërë mjetesh për zgjidhjen e çështjeve duke përfshirë ofrimin e informacionit, ndërmjetësimin, advokimin, duke ndihmuar klientët të kenë qasje tek autoritetet, edukimin e komunitetit, organizimin e veprimeve kolektive, organizime në komunitet dhe ndihmë në procese gjyqësore.

Praktikisht paralogjorët ofrojnë ndihmë për të gjitha çështjet ligjore, përfshirë ato që kanë të bëjnë me jetesën e fëmijëve, kujdestarinë e fëmijëve, problemet martesore, dhunën me bazë gjinore, mosmarrëveshjet mbi tokën, drejtësinë penale, ankesat në lidhje me zhvillimin e jetesës ose sektorin privat (punësimi, bujqësia, minierat, zhvillimi i tregut), konfliktet midis individëve dhe

⁸³Sipas një artikulli të kërkuar nga ana jonë në faqen e internetit <http://www.accesstojustice.africa/countries/sierra-leone/>, rezulton se gjatë një periudhe trevjeçare, ndërmjet 2010 dhe 2013, grupet paralogjore të përfshira në projektin paralogjor “shkallë lart” (të zbatuar nga organizatat Timap, Brac, Advocaid, AJLC dhe JSC) trajtuan mbi 19,000 çështje nga të cilat u zgjidhën më pak se 84% e tyre. Gjithashtu, janë ngritur mbi 1500 klinika të lëvizshme, të cilat edukojnë komunitetin.

autoriteteve shtetërore (korrupsioni, shpërdorimi i detyrës dhe vështirësitë në ofrimin e shërbimeve shtetërore publike dhe infrastrukturë si shëndetësia, arsimi, rrugët, uji).

Puna e paraligjorëve të Timap bazohet në njohjen e mirë të ligjit zyrtar dhe qeverisë dhe njohjen e komunitetit dhe përdorimit të mjeteve të orientuara nga/drejt komuniteti/t. Paraligjorët gjithashtu punojnë me drejtorët e Timap dhe avokatë të tjerë, që janë të përfshirë në procese gjyqësore strategjike dhe advokim të nivelit të lartë dhe njëkohësisht trajnojnë, mbikëqyrin dhe mbështesin paraligjorët në punën e tyre. Për këtë arsye, Timap dhe paraligjorët e tij kanë një qasje sintetike ndaj kuadrit ligjor dualist të Sierra Leone, duke u angazhuar dhe kërkuar përmirësimin e institucioneve formale dhe zakonore.

Misioni i Timap është “ofrimi i zgjidhjeve konkrete dhe praktike për problemet ligjore të njerëzve”, duke u përqendruar te njerëzit që nuk kanë, ose e kanë të kufizuar qasjen në drejtësi.

(a) Mjetet dhe strategjitë e paraligjorëve për zgjidhjen e problemeve ligjore. Detyrat e paraligjorëve

Për shkak se paraligjorët Timap duhet të jenë të përgatitur të ndihmojnë klientët dhe komunitetet për çdo lloj problemi që sillen në vëmendjen e tyre, ata duhet të jenë të aftë të përdorin metoda të ndryshme të adresimit të padrejtësive. Gjithashtu, paraligjorët duhet të zgjedhin mjetet dhe strategjitë më të përshtatshme për një çështje të caktuar.

Mjetet dhe strategjitë më të zakonshme që përdorin paraligjorët e Timap përfshijnë: ofrimi i informacionit për të drejtat dhe procedurat, qasje tek autoritetet, ndërmjetësimi, advokimi, edukimi i komunitetit, organizimi i veprimit kolektiv dhe procedurat gjyqësore, në bashkëpunim me avokatët.

Dhënia e informacionit: Paraligjorët Timap u sigurojnë klientëve informacione për të drejtat e tyre, si dhe procedurat të cilat një klient mund të ndjekë për të mbrojtur të drejtat e tij përpara institucioneve dhe autoriteteve. Për shembull, një paraligjor ofron informacione për një grua lidhur me të drejtat e saj në bazë të ligjit të dhunës në familje. Një paraligjor ofron gjithashtu informacion kur i përshkruan një klienti procedurat me të cilat mund të ndeshet nëse është duke konsideruar të fillojë një proces gjyqësor, të raportojë një krim në polici, ose në rastin e komunikimit të një fletëthirrje nga gjykata lokale.

Aksesi tek autoritetet: Disa klientë jo vetëm kanë nevojë për informacion lidhur me institucionet dhe autoritetet, por mund të kenë nevojë për ndihmë edhe lidhur me mënyrën sesi të bashkëveprojnë me to. Paraligjorët e Timap shpesh ndihmojnë klientët sesi të veprojnë me policinë, ministritë apo dhe autoritete të tjera. Një paraligjor mund të shoqërojë një klient në komisarjat për të siguruar që oficerët e policisë do të shqyrtojnë ankimin e klientit, dhe mund të vazhdojë të advokojë për klientin ndërkohë që hetimi dhe procedurat vazhdojnë. Një paraligjor mund të orientojë një person kur merret në pyetje për procedurën përkatëse.

Ndërmjetësimi: Paraligjorët luajnë një rol të rëndësishëm gjatë ndërmjetësimit. Shumë çështje zgjidhen për shkak të ndërhyrjes së paraligjorit, i cili i dërgon një letër palës tjetër për zgjidhjen e çështjes me anë të ndërmjetësimit. Në manualin 2012 të përgatitur nga Timap jepen këshilla sesi një paraligjor duhet të sillt gjatë ndërmjetësimit, kur mund të përdoret ndërmjetësimi, çfarë metodash duhet të përdoren gjatë ndërmjetësimit etj.

Advokimi dhe edukimi i komunitetit: gjatë advokimit paraligjorët mund të dërgojnë letra në institucionet përkatëse me qëllim që këto të fundit të ndërmarrin veprime; të përdorin median me qëllim tërheqjen e vëmendjes në probleme sociale të caktuara, shpesh edhe për probleme që kërkojnë vëmendje kombëtare; takime në komunitete për të identifikuar problemet dhe nevojat e komunitetit. Një shembull i tillë ka qenë puna e paraligjorëve për të organizuar mbledhje në komunitet si pjesë e fushatës së fuqizimit të edukimit, pasi shpesh reformat e kryera në fushën e edukimit fillestar nuk njihen nga komuniteti.

Organizimi i veprimeve kolektive: Veprimi kolektiv nënkupton organizimin e anëtarëve të komunitetit për të punuar së bashku për adresimin e një problemi. Një paraligjor dhe komuniteti mund të vendosin që zgjidhja më efektive për zgjidhjen e një problemi është thirrja e anëtarëve të komunitetit për të vepruar së bashku dhe vetë, dhe jo lobimi i qeverisë për të ofruar një shërbim të caktuar.

Shembuj të këtyre veprimeve kolektive: Fshatarët në një komunë të Sierra Leone u ankuan tek paraligjorët e Timap se ndaj tyre nuk ofroheshin më shërbime bazike për shkak të gjendjes së rrugës që lidhte fshatin e tyre me rrugën kryesore. Edhe pse Timap kishte advokuar që qeveria të ndërtonte rrugët, nga ana e qeverisë nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim. Në këto kushte, paraligjorët organizuan banorët e fshatit që të kryenin mirëmbajtje vullnetare e kolektive të rrugës.

Pas një epidemie kolere në një qytet në pjesën veriore të Sierra Leone, paraligjorët e Timap kryen një vlerësim të plotë të problemit, duke studiuar kushtet e nivelit të tokës dhe duke kërkuar mendimin e ekspertëve. Kjo bëri të mundur mbajtjen e një takimi të komunitetit, në të cilin pati kontribute edhe nga një zyrtar qeverie të specializuar në shëndetësi dhe kanalizime. Në takim u ra dakord për një plan veprimi në vijim të së cilit komuniteti punoi vullnetarisht për të përmirësuar sistemin e ujit dhe kanalizimeve. Paraligjorët vazhdojnë të ndjekin çështjen për të siguruar që plani të realizohet në mënyrë efektive dhe të kërkojnë këshilla teknike shtesë kur është e nevojshme.

Roli i paraligjorit gjatë një procedure gjyqësore: Nëse është rasti paraligjorët e Timap mund të vlerësojnë se çështja duhet të zgjidhet në rrugë gjyqësore. Ky vendim merret pas diskutimeve që mbahen midis paraligjorit, paraligjorit drejtues dhe drejtorëve. Për shembull, në rastin e një çështje më komplekse, si refuzimi i palës së paditur për të ndërmjetësuar, ose mosrespektimi i një marrëveshje nga një pale, paraligjorët duhet të punojnë me një paraligjor drejtues dhe së bashku të vendosin nëse është rasti për t'iu drejtuar drejtorëve për fillimin e një procesi gjyqësor të mundshëm. Gjatë procesit gjyqësor paraligjorët nuk mbrojnë klientin, por ndihmojnë avokatët duke ndikuar në përshpejtimin e procedurave gjyqësore dhe reduktimin e ngarkesës së punës së avokatëve. Paraligjorët mund të marrin edhe rolin e ndërlidhësit midis klientit dhe avokatit.

Paraligjori mund të kontaktojë oficerët e gjykatës në përgatitjen dhe marrjen e dokumenteve si dhe konfirmimin e datave të shtyrjes së procesit gjyqësor. Paraligjori luan një rol të rëndësishëm deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes dhe madje edhe pas kësaj mund të vazhdojë të ofrojë shërbime vazhduese si dhe shërbime këshillimore.

Paraligjorët kryejnë këto detyra: përgatitje të dosjes; gjetja e fakteve (marrja në pyetje e dëshmitarëve, vajtja në vendngjarje); kërkime ligjore; këshillim/edukim i klientëve rreth procedurave gjyqësore; kontaktimi i dëshmitarëve; depozitime në gjykatë; të kujtojë avokatët për datat e gjyqeve; të negociojë caktimin e datave të gjyqeve; të marrë pjesë në gjyqe dhe të monitorojë çështjet për të qenë në dijeni për çështjen në të gjitha fazat procedurale të saj (për shembull të shpjegojë çfarë ka ndodhur me çështjen, kur largohet një avokat të punojë me avokatin e ri, të prezantojë klientin me avokatin e ri etj.).

Roli që ka paraligjori në mbrojtjen e çështjeve penale: Paraligjorët e caktuar posaçërisht për të punuar në çështjet penale vizitojnë burgjet lokale dhe stacionet policore dhe bisedojnë me të dyshuarit dhe të burgosurit. Ata ofrojnë edukim ligjor dhe identifikojnë çështjet që kërkojnë përfaqësim ligjor.

Paraligjori merr informacion nga policia, oficerët e burgut, ose të dhëna të tjera lidhur me veprën penale për të cilën është arrestuar i akuzuari si dhe statusin e përgjithshëm të çështjes. Paraligjori gjithashtu interviston dhe merr deklaratë nga i akuzuari për të përgatitur dosjen e çështjes. Paraligjori në raste të caktuara informon policinë për detyrimet e tyre ligjore duke orientuar edhe lidhur me veprimet që duhet të kryhen nga ana e tyre, si tërheqja e akuzës, lirimi me kusht, dërgimi i çështjes në gjykatë. Në rastet e lirimit me kusht, paraligjori mund të kontaktojë edhe anëtarët e familjes ose të afërmit e të dyshuarit duke dhënë informacione lidhur me procedurat apo kushtet e lirimit me kusht. Nëse çështja shkon për gjykim në gjykatë, paraligjori përgatit dosjen e çështjes dhe e referon tek avokati përgjegjës për çështje penale në zonën në fjalë, ose ndonjë zyrtar tjetër. Gjatë procesit gjyqësor, paraligjori ndihmon avokatin.

Roli i paraligjorit pas përfundimit të procesit gjyqësor: Së pari, paraligjori ndihmon në riintegrimin e klientëve që janë liruar nga burgu, janë të pafajshëm sipas vendimit të gjykatës, ose kanë vuajtur dënimin për vepra penale të komuniteteve. Paraligjori vlerëson nëse komuniteti është i gatshëm të pranojë apo jo individin dhe në çfarë kushtesh. Së dyti, paraligjori mund të monitorojë zbatimin e urdhrave gjyqësorë, detyrë që mund të realizohet në bashkëpunim me zyrtarë të gjykatës dhe punonjës të tjerë. Nëse shfaqet një problem gjatë monitorimit, paraligjori duhet të informojë menjëherë avokatin, i cili mund të vendosë për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale si paraqitja e një kërkesë tjetër në gjykatë. Së treti, paraligjori mund të këshillojë periodikisht klientë të caktuar, për shembull ata që kanë kryer veprën penale të përdhunimit ose vepra të tjera seksuale.

(b) Çështjet dhe organet në të cilat përfshihen paraligjorët

Paraligjori dhe gjykatat lokale: Gjykatat lokale janë kompetente për të trajtuar çështje të së drejtës zakonore. Paraligjorët këshillojnë dhe përgatisin çështje, të cilat janë në kompetencë të gjykatës

lokale, por nuk mund të bëjnë përfaqësime përpara këtyre gjykatave. Paraligjorët në disa raste mund të këshillojnë dhe t'u bëjnë sugjerime nëpunësve të gjykatës, veçanërisht kryetarit dhe sekretarit duke inkurajuar gjykatat të respektojnë procedurat.⁸⁴

Paraligjori dhe policia: Puna e zakonshme e paraligjorëve në polici është dhënia e informacionit ligjor dhe këshillave bazike ligjore për njerëzit, të cilët veprojnë në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, paraligjori bën referimin në polici të çështjeve penale të një natyre serioze, duke ndihmuar klientët të sigurojnë lirin me kusht, ose të vendosin kontakte me të afërmit e tyre, si dhe për të monitoruar policinë që të drejtat e të dyshuarve të respektohen.⁸⁵

Puna e paraligjorëve me shefat e komunës: Në Sierra Leone shpesh shefat e komunës marrin rolin e një gjykate dhe zgjidhin mosmarrëveshje të ndryshme, por në shumë raste korruptohen duke përfituar padrejtësisht pagesën e një pale gjyqfituese kundër palës tjetër. Paraligjorët shpesh kanë ndërhyrë për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Paraligjorët dhe problemet në komunitet: Në raste kur ka probleme në komunitet, paraligjorët bëjnë vizita në vend, takime me komunitetin apo dhe marrin informacione.⁸⁶

Paraligjorët dhe mbrojtja e fëmijëve, kryesisht në punësimin e fëmijëve në shkolla. Një problem i tillë ka qenë punësimi i fëmijëve në miniera duke lënë shkollën, shpesh edhe në dijeni të prindërve. Paraligjorët kanë mbajtur një takim në komunitet, ku është folur për problemet dhe rreziqet në shfrytëzimin e fëmijëve duke i punësuar në miniera dhe rëndësinë e ndjekjes së shkollës nga ana

⁸⁴<https://namati.org/wp-content/uploads/2014/10/Daniel-A-STORY-FROM-THE-FIELD-final.pdf>. Në një rast korupsioni që përfshinte nëpunës të gjykatës, të cilët kishin marrë rryshfete, paraligjorët kërcënuan se do të fillonin procedura gjyqësore kundër nëpunësve të gjykatës për korupsion dhe shfrytëzim. Pas ndërhyrjes së Timap për Drejtësi, këta nëpunës kthyen të gjitha paratë që kishin përfituar padrejtësisht nga individët. Në një rast tjetër, ku procesi gjyqësor monitorohej nga paraligjori, kryetari i seancës bëri një seri gabimesh. Pavarësisht tërheqjes së vëmendjes nga paraligjori, gjyqtari refuzoi të konsideronte këshilla të tilla, duke marrë një vendim kundër klientit të paraligjorit. Paraligjori ndihmoi klientin të përgatiste një kërkesë për rishikim të vendimit tek nëpunësi i së drejtës zakonore, kërkesë, e cila u pranua në favor të klientit.

⁸⁵ Në një rast, punonjësit e gjykatës lokale u kallëzuan në polici si të dyshuar për kryerjen e veprave penale gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Policia kërkoi ndaj të dyshuarve pagesën e një shume lekësh si garanci, edhe pse në legjislacion nuk kishte një parashikim të tillë për pagesë. Pavarësisht kësaj, punonjësit paguan dhe u liruan me kusht. Pas lirimit të tyre, punonjësit e gjykatës u ankuan tek paraligjorët. Paraligjorët u ankuan në polici, por nga ana e tyre u mohua të kishin marrë para. Pas ndërhyrjes së paraligjorëve, policia u detyrua të ngjiste letra në vende të ndryshme rreth stacionit të policisë me shënimin “lirimi me kusht është falas”. Në rastet e përdhunimit, paraligjori adreson çdo problem të menjëhershëm në lidhje me sigurinë apo shëndetin e klientit. Paraligjori shpjegon të drejtat dhe mundësitë që ka klienti, përfshirë të drejtën për të paraqitur kallëzim penal. Gjithashtu, paraligjorët e Timap shoqërojnë viktimat e përdhunimit në komisariate për të bërë ankesa dhe “për të advokuar” për klientin gjatë gjithë procesit të ndjekjes penale.

⁸⁶ Për shembull, një rast i tillë ka qenë kur një organizatë nuk zbatoi një projekt në komunitet. Pas ndërhyrjes së paraligjorëve duke kërcënuar se çështja do të bëhej problem korupsioni dhe do të ndiqej gjyqësisht, organizata në fjalë u detyrua të vazhdonte zbatimin e projektit. Paraligjorët janë përfshirë edhe në mosmarrëveshje në shkolla, për shembull në lidhje me pagesën e tarifave shtesë shkollore, ose pagesave të paparashikuara në ligj. Në këto raste, çështjet janë zgjidhur me anë të takimeve në komunitet.

e tyre. Fokusi kryesor i zgjidhjes së problemit ishte që komuniteti të respektonte aktet nënligjore, që ndalonin fëmijët të largoheshin nga shkolla për punësim në miniera. Paraligjorët udhëzuan pleqtë e komunitetit në zbatimin e këtij akti nënligjor.

Paraligjorët dhe puna e tyre në burgje: Paraligjorët në Sierra Leone ofrojnë edukim të përgjithshëm ligjor për të paraburgosurit e vendosur në burgje. Paraligjorët gjithashtu mund të ofrojnë këshilla juridike dhe ndihmë për të akuzuarit e vetëpërfaqësuar në gjykatë për t'i informuar lidhur me procedurat dhe për t'i përgatitur për procesin gjyqësor ndaj tyre.⁸⁷

(c) Organizimi i paraligjorëve - Mënyra e organizimit të Timap për Drejtësi⁸⁸

Timap për Drejtësi përfshin më shumë se 70 anëtarë stafi të paguar, shumica e të cilëve janë paraligjorë. 430-450 persona të tjerë nuk paguhen, ose kompensohen në mënyrë modeste si praktikantë, vullnetarë, persona kontakti, anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të Komunitetit, ndërmjetës të komunitetit dhe anëtarë të Bordit të Drejtoreve.

Timap për Drejtësi ka një program të quajtur “Ndërmjetësimi në komunitet”. Sipas këtij programi, komunitetet zgjedhin ndërmjetësues vullnetarë, të cilët më pas trajnohen dhe udhëzohen nga paraligjorët e Timap. Timap aktualisht ka shtatë paraligjorë drejtues, secili i shërben një grupi të caktuar komunash. Paraligjorët drejtues janë pika referimi për paraligjorët dhe ndihmojnë ose këshillojnë ata për rastet që paraligjorët trajtojnë. Më konkretisht, organizimi i paraligjorëve në Timap paraqitet si më poshtë:

Bordi i Drejtorëve: Bordi i Drejtorëve drejton stafin udhëheqës të Timap si dhe stafin tjetër duke përcaktuar drejtimin e programit. Bordi zakonisht angazhon drejtorët dhe ka pak ndërveprim me paraligjorët.

Drejtorët avokatë: Timap aktualisht drejtohet nga dy avokatë. Ata ofrojnë trajnime dhe mbikëqyrje për paraligjorët; paraligjorët më pas raportojnë tek drejtorët.

Drejtuesi i ndërmjetësimit: Drejtuesi i ndërmjetësimit koordinon Programin e Ndërmjetësimit në Komunitet. Ai mbikëqyr dhe këshillon 300 ndërmjetësues të komunitetit në 97 fshatra në katër komuna.

Paraligjorët drejtues: janë pika referimi për paraligjorët dhe ndihmojnë ose këshillojnë paraligjorët për çështje. Çdo paraligjor është vendosur pranë një paraligjori drejtues. Timap ka aktualisht shtatë paraligjorë drejtues, secili duke punuar me një grup të caktuar komunash. Paraligjorët drejtues kryejnë edhe detyra administrative dhe veprojnë si një urë bashkëpunimi ndërmjet paraligjorëve dhe drejtorëve.

⁸⁷<https://acjr.org.za/resource-centre/formalising-the-role-of-paralegals-in-africa-a-review-of-legislative-and-policy-developments/view>

⁸⁸<https://namati.org/wp-content/uploads/2012/09/Final-Timap-Manual-June-2012.pdf>

Paraligjorët: janë vija e parë e punës së Timap dhe ofrojnë ndërmjetësim, advokim dhe shërbime të tjera në 19 zyra në të gjithë Sierra Leone.

Punonjësi për medien: drejton aktivitetet e Timap në terren. Paraligjorët mund të ndihmojnë punonjësin e medieve për prezantimet e programeve të caktuara në radio, mbledhjen e historive të rëndësishme për punën e Timap dhe publicitete të tjera.

Punonjësit e zyrave (nëpunës) që punojnë pranë avokatëve: këta persona nëpunës ndihmojnë avokatët për kërkime dhe çështje të caktuara që lidhen me procedurat gjyqësore. Paraligjorët herë pas here mund të punojnë me nëpunësit nëse një prej çështjeve të tyre i është referuar avokatëve për fillimin e procedurave gjyqësore.

Asistent zyre: kryen detyra në zyrën e Freetown dhe mund të ndihmojë paraligjorët me punë të ndryshme.

Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të Komunitetit janë ndërlidhës të komunitetit Timap, të cilët ofrojnë mbikëqyrje dhe asistencë këshillimore për paraligjorët. Ata shërbejnë si një urë lidhëse midis komunitetit dhe Timap dhe si një pikë mbështetje kur ekziston një konflikt midis drejtuesve dhe Timap.

Ndërmjetësit e komunitetit: Ndërmjetësit e komunitetit janë të trajnuar, udhëzohen dhe mbështeten nga paraligjorët. Ata zgjidhin mosmarrëveshje të vogla në komunitetet e tyre dhe gjithashtu referojnë çështje tek paraligjorët dhe institucionet e tjera.

Personat e kontaktit: Personat e kontaktit banojnë në fshatrat ku Timap kryen klinika të lëvizshme. Ata ndihmojnë paraligjorët për të njoftuar komunitetet në lidhje me ditët e klinikave dhe paralajmërojnë paraligjorët për çështjet që kanë në komunitetet e tyre.

Praktikantët: Timap herë pas here pret stazhierë nga Sierra Leone dhe të huaj. Shumë prej tyre punojnë përkrah paraligjorëve.

Sistemi i klinikës së lëvizshme: Ky sistem ndihmon që Timap të arrijë dhe t'i shërbejë shtetasve të Sierra Leone, të cilët nuk janë në gjendje të vizitojnë zyrat e Timap për shkak të kostove financiare, ose distancave të largëta. Klinikat e lëvizshme janë të rëndësishme jo vetëm për ofrimin e ndihmës juridike në komunitete të largëta, por edhe për shtrirjen e shërbimeve tek ata persona që shpesh janë të përjashtuar në proceset kryesore të vendimmarrjes administrative të komunave.

Sipas këtij sistemi paraligjorët vizitojnë një grup fshatrash pranë çdo zyre çdo të premte. Një person kontakti në secilin fshat caktohet për të punuar me paraligjorët. Personi i kontaktit vepron vullnetarisht si ndërlidhës midis paraligjorëve të Timap dhe komuniteteve. Ai informon njerëzit për lëvizjen e paraligjorëve si dhe referon tek paraligjorët ata klientë, që kanë raste veçanërisht të rëndësishme.

Një klinikë tipike e lëvizshme fillon me një takim të shkurtër me komunitetin gjatë të cilit trajtohen çështje ligjore të ndryshme që prekin komunitetin si, dhuna në familje, shtatzënia në

adoleshencë, ose procedurat e arrestimit nga policia. Pas takimit të hapur me komunitetin, paralogjorët trajtojnë raste individuale të klientëve. Puna në këto klinika është njësoj si puna normale në zyrë: pranimi i çështjeve të klientëve dhe asistenca për zgjidhjen e tyre. Disa raste trajtohen direkt në vend në klinikë. Ato raste që nuk mund të trajtohen dot menjëherë për shkak të kohës, ose kompleksitetit, shtyhen për trajtim në ditën tjetër të klinikës, ose klientit i kërkohet të raportojë në zyrën e paralogjorit.

Përgjegjësitë e personit të kontaktit përfshijnë:

- Sigurimi dhe përgatitja e një vendi për të mbajtur seanca të klinikës së lëvizshme. Klinikat e lëvizshme kërkojnë një vend publik për të adresuar komunitetin ose një vend më privat për t'u marrë me çështje të veçanta.
- Informimi i anëtarëve të komunitetit në lidhje me lëvizjet e paralogjorëve. Për sa kohë që paralogjorët respektojnë oraret e klinikës së lëvizshme, informimi është një procedurë e thjeshtë. Por nëse paralogjorët humbasin një ditë të caktuar, ose kryejnë një vizitë jashtë afatit të zakonshëm, personi i kontaktit mund të ndihmojë në shpërndarjen e këtij informacioni.
- Dhënia e ndihmës për paralogjorët për të dërguar letra palëve të përfshira në çështje.
- Dhënia e ndihmës për paralogjorët për të organizuar takime në komunitet.

Personat e kontaktit nuk angazhohen në punë thelbësore që adresojnë çështje ligjore. Për shembull, ata nuk ndërmjetësojnë mosmarrëveshje, ose të bëjnë përpjekje për të zgjidhur çështjet/problemet e raportuara përpara tyre.

Në rast se një çështje ose problem ligjor i raportohet drejtpërdrejtë një personi kontakti, ky i fundit mund të kryejë një nga veprimet si vijon: të informojë palët për datën e ardhshme të klinikës së lëvizshme në atë zonë dhe t'u kërkojë atyre që të takojnë një paralogjor në të njëjtën ditë; t'i kërkojë palëve të shkojnë në zyrën e paralogjorit në qytetin kryesor të komunës; në rastet e urgjencës, personi i kontaktit mund të shkojë në zyrën e paralogjorit (së bashku me palët nëse është e mundur) dhe të informojë paralogjorin.

Fondi i urgjencës

Timap ka krijuar një fond urgjence për t'u përdorur në ato raste ku individët nuk kanë mundësi financiare. Qëllimi i fondit të emergjencës është të ofrojë mbështetje financiare për klientët që kanë vuajtur një shkelje të rëndë të të drejtave të tyre dhe nuk kanë mundësi financiare për të adresuar shkeljen, dhe për rrjedhojë mos t'u mohohet qasja në drejtësi. Nevoja më së shpeshti lind në ato situata që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë, siç janë rastet e dhunës në familje dhe sulmet seksuale. Për shembull, nëse një klient është një i mbijetuar i dhunës në familje, por nuk ka burime financiare për të marrë raport mjekësor, që e kërkon policia si provë për hetimet, paratë nga Fondi mund të mbulojnë transportin e klientit, tarifën e mjekut dhe kostot mjekësore.

(d) Trajnimi i paralogjorëve

Manuali 2012 Timap për Drejtësi

Në 2012 Timap për Drejtësi, ashtu sikurse u përmend edhe më sipër, përgatiti një manual për paraligjorët për ta pasur parasysh në punën e tyre të përditshme dhe për të shërbyer si gur orientimi për të gjithë paraligjorët në Sierra Leone.

Me anë të këtij manuali paraligjorët marrin informacione rreth strukturave qeveritare të Sierra Leone. Njohja me mënyrën e funksionimit të qeverisë është e rëndësishme për shkak të mënyrave të shumta me të cilat paraligjorët hyjnë në kontakt me institucionet qeveritare. Gjithashtu, informacione jepen për sistemin gjyqësor formal dhe zakonor, pushtetin legjislativ, parimin e ndarjes së pushteteve, si dhe një përshkrim të ministrive me të cilat paraligjorët punojmë më shpesh. Sugjerime jepen edhe se si paraligjorët mund të zgjidhin probleme të caktuara që përfshijnë organe qeveritare të posaçme; mënyra sesi duhet të trajtohet një çështje me organe të caktuara, mënyra sesi duhen aksesuar këto organe.

Manuali jep informacione lidhur me ligjet dhe politikën minerare, këshilla sesi paraligjori duhet të trajtojë çështjet e punës së fëmijëve në kompanitë e minierave, etj., hapat që mund të ndjekë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme ligjore.

Në lidhje me politikat e arsimit, informacione jepen për mënyrën se si paraligjorët duhet të adresojnë punën e fëmijëve në shkolla, për shembull, shfrytëzimi i tyre në fermat e mësuesve apo dhe nga njerëz të tjerë në komunitet, informacion në lidhje me legjislacionin sa i përket ndalimit të ndëshkimit trupor dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dhunës, abuzimit, si të zgjidhen problemet e arsimit nëpërmjet investigimeve, takimeve në komunitet, monitorimeve etj.

Në lidhje me çështjet në fushën e mirëqenies sociale, paraligjorët duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Njësinë e Ndihmës Familjare së Policisë në zonat e tyre operative. Ata duhet t'i referojnë çështjet në polici si dhe të shoqërojnë fëmijën në komisariat dhe të sigurojnë që çështja e tij/saj të trajtohet në mënyrën e duhur.

Në lidhje me politikën e kujdesit shëndetësor, manuali udhëzon që seancat e klinikës së lëvizshme dhe takimet në komunitet të jenë një mundësi për ndjekjen e çështjeve shëndetësore. Paraligjorët mund të rrisin pritshmëritë e komuniteteve për sektorin e shëndetësisë duke dhënë informacione për shërbimet që njësitë shëndetësore ofrojnë duke shpjeguar kufizimet që kanë ofruesit e këtyre shërbimeve. Manuali jep udhëzime se si paraligjori duhet të identifikojë në mënyrë aktive problemet e shëndetit në nivel komuniteti nëpërmjet vizitave në qendrat shëndetësore gjatë klinikave të lëvizshme; udhëzon lidhur me komunikimin me njerëzit/përdoruesit e shërbimit; organizimin e takimeve në komunitet, etj.

Në manual bëhet një përmbledhje e ligjit në Sierra Leone, çfarë quhet ligj, çfarë është drejtësia; llojet e ligjeve; e drejta penale si veprat seksuale; e drejta e kundërvajtjeve penale; e drejta familjare (çështjet e dhunës në familje për të cilat paraligjori duhet të tregojë kujdes); hapat që duhet të ndërmerren paraligjorinë në këto raste; manuali jep informacion se çfarë hapash duhet të ndërmerren në zyrën e paraligjorit, në stacionin e policisë, në gjykatë, në qendrën shëndetësore/spital, hapat e

përgjithshme kur çështja është ende në procedurë e sipër; juridiksioni për të mitur; e drejta e pasurive; e drejta kontraktore; e drejta e trashëgimisë; procedura penale (mënyra sesi paraligjori duhet të punojë kur ka të bëjë me një çështje që përfshin policinë, procedurat përpara gjykatës si hetimi paraprak ose gjykimi i shkurtuar etj.); e drejta e pronës; ligji rregullues për rregullimin e aktiviteteve; e drejta administrative; të drejtat e njeriut; e drejta zakonore; burimet formale të ligjit etj.

Manuali përmban dhe shembuj të formularëve që duhet të përgatisë një paraligjor, një draft marrëveshje ndërmjetësimi, një formë për mbledhjet në komunitet, raportimet e ndryshme që duhet të bëjnë paraligjorët dhe strukturat e tjera lidhur me to, monitorimi etj.

Trajnimet nga OJF si Timap për Drejtësi, Namati

Sikurse u paraqit edhe më sipër, paraligjorët e akredituar të Sierra Leone duhet të jenë të punësuar nga një organizatë e akredituar dhe duhet të kenë përfunduar trajnimin e detyrueshëm. Çdo paraligjor duhet gjithashtu të akreditohet në Bordin e Ndhimës Ligjore. Mos akreditimi ose ofrimi i ndihmës juridike pa marrëveshje bashkëpunimi përbën një vepër penale, për të cilën si individët ashtu edhe organizatat mund të konsiderohen përgjegjës.

Në Sierra Leone, paraligjorët e Timap për Drejtësi marrin trajnim të vazhdueshëm nëpërmjet drejtorëve avokatë. Drejtorët kalojnë më shumë se gjysmën e çdo muaji në zyrat e ndryshme të Timap duke vlerësuar mënyrën sesi paraligjorët kanë trajtuar çështje si dhe duke aftësuar paraligjorët në punën e tyre të drejtpërdrejtë me klientë dhe duke ofruar trajnime në fushat përkatëse të ligjit ose punën e qeverisë. Çdo zyrë vizitohet çdo muaj nga të paktën një drejtor, i cili zakonisht qëndron dy ose tre ditë.⁸⁹

Një qëllim kryesor i vizitave në vend është që të zhvillohen njohuritë dhe aftësitë profesionale të stafit paraligjor. Drejtori mund ta bëjë këtë në mënyrë joformale, duke zgjedhur një çështje dhe pastaj të monitorojë ecurinë e saj së bashku me paraligjorin dhe të bëjë pyetje se si është trajtuar secila fazë. Paraligjorët gjithashtu mund të marrin pjesë në leksione që mbahen nga praktikues me eksperiencë dhe të mbahen të azhornuar përsa i përket praktikës ligjore përmes materialeve të shpërndara me shkrim.

Gjatë vizitave të tyre në zyrat në terren, drejtorët e Timap rishikojnë dosjet e çështjeve, mbikëqyrin paraligjorët duke kryer punën e tyre dhe diskutojnë çështje komplekse me të cilat përballen paraligjorët dhe mënyrën sesi këto çështje janë trajtuar prej paraligjorëve.

Në mënyrë tipike, gjatë udhëtimeve të tyre në terren drejtorët Timap vlerësojnë ndër të tjera elementët e mëposhtëm të një çështje: organizimi i dosjeve të çështjeve, përdorimi korrekt i formateve të formularëve administrative, përshtatshmëria e strategjive të ndërmarra me çështjet, cilësia e bashkëveprimit me klientët, shpeshësia dhe efektiviteti i ndërveprimeve me institucionet,

⁸⁹ <http://www.accesstojustice.africa/countries/sierra-leone/>

respektimi i konfidencialitetit të klientit, trajtimi me përgjegjshmëri i parave, angazhimi me problemet e komunitetit.⁹⁰

Gjithashtu, organizata paraligjore si Timap trajnojnë paraligjorët e tyre me anë të trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme teorike, për lëndët e ligjit themelor, mjetet dhe teknikat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe informacionit të vendosur në dispozicion me anë të manualeve informative në fusha të ndryshme.

Më konkretisht, trajnimi fillestar i paraligjorëve zakonisht zhvillohet gjatë dy javëve.⁹¹ Në bazë të fushave ligjore të identifikuara gjatë vlerësimit të nevojave të programit dhe informacionit të përfituar nga vizitat studimore, trajnimet shpesh përqendrohen në tre fusha:

- Ligji substancial (e drejta kushtetuese, kundërvajtjet penale, e drejta penale dhe e drejta e familjes)
- Mënyra e funksionimit të qeverisë dhe struktura e gjykatave të Sierra Leone
- Aftësi paraligjore (ndërmjetësim, intervistim, marrja e deklaratave, advokimi, edukimi komunitar, trajtimi i viktimave të dhunës në familje dhe procedurat administrative).

Megjithatë, shpesh trajnimi i paraligjorëve që kryhet kryesisht nga avokatë konsiderohet si i mjaftueshëm për paraligjorët që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrën e duhur. Kur paraligjorët përballen me raste që janë jashtë kompetencës së tyre, ata i referojnë ato tek avokati mbikëqyrës. Në të ardhmen, trajnimi paraligjor mendohet të përmirësohet dhe zyrtarizohet më tej. Për shembull, Instituti i Drejtësisë dhe Trajnimit Gjyqësor i parashikuar në ligj parashikon të ofrojë trajnime paraligjore. Gjithashtu, planifikohet që edhe institute dhe kolegje të tjera të ofrojnë kurse të akredituara paraligjore. Kurse trajnimi intensiv katër-javore për paraligjorët e rinj janë kryer në Shkollën e Trajnimit të Policisë Hastings me mbështetjen e projektit të Fondacionit Shoqëria e Hapur, Nisma për Drejtësi dhe GTZ.

⁹⁰ Po aty, faqe 108

⁹¹ https://www.justiceinitiative.org/uploads/6001868b-f85d-4883-8da7-bdf2ebc93a4c/OSJI-Paralegal-Manual-US-11-05-2014.pdf?fbclid=IWAR1G4INPAQU31BkQj2-uG7w_fyMvea2emKclKRJJC9nRWZIV5pm2Gxr37KE, faqe

F. AFRIKA E JUGUT

1. Sistemi i ndihmës juridike

Kushtetuta e Afrikës së Jugut parashikon të drejtën për të pasur ndihmë juridike, të financuar nga shteti dhe për t'u informuar menjëherë për këtë të drejtë.⁹²

Në Dhjetor 2014, Afrika e Jugut miratoi ligjin e ri të ndihmës juridike nr. 39. Sipas këtij ligji, Ndihma Juridike në Afrikën e Jugut (NJAJ) është një institucion i pavarur, i financuar nga shteti, përgjegjës për të ofruar ndihmë juridike. Më konkretisht, ky ligj autorizon NJAJ për të punësuar praktikues ligjorë, avokatë, kandidatë për avokatë dhe paraligjorë.⁹³ Ligji e detyron NJAJ-në të ofrojë ndihmë juridike, përfshirë përfaqësim ligjor në çështjet penale, këshillim ligjor, informacion dhe edukim. Disa nga këto shërbime do të vazhdojnë të ofrohen nga paraligjorët. Përfshirja e paraligjorëve të bazuar në komunitet si ofrues të pavarur të ndihmës juridike, jashtë kornizës NJAJ, edhe pse është advokuar ndër vite, nuk u arrit të përfshihej as në këtë ligj të ndryshuar.

Në një raport të vitit 2014⁹⁴ të Komitetit të Portofolit për Drejtësi dhe Shërbime Rehabilituese (Komiteti) për ligjin e ndihmës juridike, Komiteti konstatoi se NJAJ kryesisht po ndihmonte individët në çështjet penale, dhe se kërkohehin fonde shtesë të shtetit për të ofruar ndihmë juridike në çështjet civile. Komiteti pranoi që paraligjorët dhe qendrat e këshillimit të komunitetit luajnë një rol të madh në fushën e ligjit për interes publik duke ofruar shërbime juridike, kryesisht në çështjet civile, për komunitetet e varfra dhe rurale dhe se sektori duhej të njihej dhe rregullohej, si një plotësues i NJAJ. Një nga rekomandimet e këtij studimi ishte pasja e një legjislacioni të posaçëm, i cili duhet të rregullonte profesionin e paraligjorëve si dhe të përfshinte në legjislacion paraligjorët e bazuar në komunitet.

Prandaj, paraligjorët e komunitetit të Afrikës së Jugut janë në pritje të hartimit të projektligjeve të reja, duke shpresuar në krijimin e një organi rregullator ligjor për paraligjorët, dhe përcaktimin e normave dhe standardeve për qasje në profesion, trajnim, akreditim ose regjistrim, përcaktimin e roleve dhe funksioneve të këtij profesioni, si dhe mekanizmat e përgjegjësishë dhe mbikëqyrjes.

Afrika e Jugut ka parashikuar një larmi të gjerë mekanizmash të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike civile. Këto mekanizma paraqiten më poshtë:

- (i) këshillime private pa pagesë (*pro bono*);
- (ii) këshillime ligjore me pagesë nga shteti;
- (iii) praktikues ligjor (avokat) i financuar nga shteti, por që punon në firma ligjore rurale;
- (iv) klinikat ligjore të financuara nga shteti;

⁹² Kushtetuta e Republikës së Afrikës së Jugut, 35(2)(b)

⁹³ Legal Aid Act (39 of 2014), 4(1)(a)

⁹⁴ National Assembly, "Report of the Portfolio Committee on Justice and Correctional Services on the Legal Aid Bill" [B8-2014], dated 10 September 2014", faqe 5-7

- (v) qendrat e drejtësisë të financuara nga shteti (zyrat e ndihmës juridike me një ndalesë);
- (vi) zyra ligjore private të specializuara;
- (vii) klinika ligjore të pavarura të universiteteve;
- (viii) zyra të këshillimit paraligjor/zyrat e këshillimit të komunitetit;
- (ix) skemat e sigurimeve ligjore.

Sikurse u paraqit më sipër në mënyrë listuese, sistemi i ndihmës juridike falas në Afrikën e Jugut ofrohet nga shteti, organizatat jo fitimprurëse, avokatët, zyrat e avokatisë, paraligjorët dhe klinikat e ligjit⁹⁵. Institucione të ndryshme mund të ofrojnë ndihmë juridike, përfshirë ndihmën juridike të financuar nga shteti. Këto institucione mund të përfshijnë zyra mbrojtëse, programe gjyqësore (ku shteti paguan praktikuesit ligjorë që punojnë në firmë private me qëllim ofrimin e shërbimeve juridike), qendra ligjore, institucione të pavarura të ndihmës juridike, universitete dhe klinika ligjore (këto dy të fundit financohen nga shteti ose nga donatorë privatë), shërbime *pro bono* të ofruara në mënyrë të pavarur nga avokatë privatë, dhe OJF. Institucionet e sipërpërmendura në ofrimin e ndihmës juridike ndihmohen nga ofrues të ndryshëm të ndihmës juridike, të tillë si, avokatë, asistentë ligjorë, paraligjorë, të sapodiplomuar në drejtësi, ose studentë të drejtësisë⁹⁶.

Në ligj janë përcaktuar edhe kriteret e përfituesve të ndihmës ligjore të financuar nga shteti, ku paraligjorët shqyrtojnë rastet e kualifikimit të qytetarëve që përfitojnë ndihmë juridike. Paraligjorët, ofrues të ndihmës juridike shpesh janë qasja e parë për njerëzit që kërkojnë ndihmë juridike në çështjet civile ose penale, dhe që ofrojnë këshilla të përgjithshme ligjore për çështjet e paraqitura për ndihmë juridike. Paraligjorët zakonisht kanë ndjekur trajnim zyrtar për paraligjorë të ofruar nga disa universitete dhe institute. Ky trajnim zyrtar paraligjor nuk ofrohet në veçanti vetëm për paraligjorët me bazë komunitare, por edhe për paraligjorët, të cilët punojnë në firma ligjore private për mbrojtjen e të drejtave të korporatave. Aktualisht, NJAJ ka mbi 2000 personel juridik, i cili përfshin avokatët kryesorë, kandidatët për avokatë dhe paraligjorët.

2. Fillesat e paraligjorëve në Afrikën e Jugut

Në Afrikën e Jugut, krahas NJAJ, paraligjorët e komunitetit dhe Zyrat e Këshillimit të Komunitetit (ZKK) kanë qenë pjesë e peizazhit socio-politik që nga vitet '30, dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në luftën kundër aparteidit. Sot, ato mbesin institucionet e vetme që ofrojnë informacion juridik dhe këshilla për komunitetet e varfra dhe të marginalizuara, sidomos komunitetet rurale. Paraligjorët e komunitetit sot ndërhyjnë kryesisht në çështjet civile, por ka

⁹⁵ <https://www.lssa.org.za/upload/files/Costs%20conference/Dave%20Holness%20Paralegals%20%20graduate%20community%20service%20for%20access%20to%20justice.%20Submission%20made.pdf>

⁹⁶ <https://acjr.org.za/resource-centre/formalising-the-role-of-paralegals-in-africa-a-review-of-legislative-and-policy-developments>

hapësira ligjore që ata të ndërhyjnë gjithnjë e më shumë edhe në çështje penale, puna e të cilëve do të ndikojë në kohëzgjatjen e procedurave në këto procese.

Paraligjorët me bazë komunitare në Afrikën e Jugut kanë ndërmarrë shumë iniciativa për t'u vetë-rregulluar. Në vitin 1996, u krijua Shoqata/Instituti Kombëtar/e e/i Paraligjorëve të bazuar në Komunitet (SHKPBK) me qëllim organizimin e këtij sektori, njohjen zyrtare të tij, lehtësimin e iniciativave të advokimit, sigurimin e shërbimeve cilësore si dhe zhvillimin e trajnimeve dhe praktikave të standardizuara.⁹⁷ Me kalimin e viteve, SHKPBK u nda dhe organizatat e shoqërisë civile që ishin aktive në ofrimin e shërbimeve ligjore nëpërmjet punës së paraligjorëve vendosën të krijojnë një aleancë të re për rregullimin e ZKK dhe paraligjorëve.⁹⁸ Në vitin 2005 prej tyre u krijua Aleanca Kombëtare për Zhvillimin e Zyrate të Këshillimit të Komunitetit (AKZHZKK), në një kohë kur sektori mbeti jashtëzakonisht i fragmentuar, njohja zyrtare e profesionit të paraligjorit ishte ende e vështirë dhe njëkohësisht bëheshin përpjekje për advokim. Përpjekjet për t'i sjellë të gjitha ZKK-të nën një aleancë ishin sfiduese, pasi organizatat dhe rajone të ndryshme kishin interesa të ndryshme. Por, AKZHZKK u bë aleanca kryesore e paraligjorëve në koordinimin dhe mbikëqyrjen e punës së të gjitha ZKK-ve. Megjithatë, AKZHZKK nuk përfaqëson të gjitha ZKK-të dhe organizatat që ofrojnë shërbime paraligjore.

Përpjekjet për zyrtarizimin e rolit të paraligjorëve përmes legjislacionit, përfshirë këtu edhe kërkesën e përsëritur të vetë komunitetit paraligjor duke pasur edhe mbështetjen e qeverisë, kanë filluar që prej viteve 1990, por këto përpjekje kanë qenë shumë të ngadalta në materializimin e kësaj iniciative. Objektivi i parë i komunitetit paraligjor ishte hartimi i legjislacionit të veçantë për ata që përkëtojnë formalizimit të profesionit të paraligjorit. Disa anëtarë të komunitetit të paraligjorëve studiuuan Ligjin e Praktikës Ligjore dhe e konsideruan atë si një rrugë të favorshme për të institucionalizuar profesionin e tyre krahas të gjithë praktikuesve të tjerë ligjorë. Më konkretisht, Ligji i Praktikës Ligjore rregullon aksesin në profesionet ligjore dhe ofrimin e ndihmës juridike në Afrikën e Jugut. Fokusi i këtij ligji nuk ishte ofrimi i ndihmës juridike. Draftet origjinale parashikuan profesionin e paraligjorit, por drafti i vitit 2010 nuk e përfshiu më referencën e paraligjorit. Kjo erdhi edhe si rezultat i vendimeve strategjike të vetë komunitetit të paraligjorëve, pasi disa vendosën të advokojnë me Departamentin e Drejtësisë dhe Zhvillimin Kushtetues për zhvillimin e një kornize të veçantë rregullatore për paraligjorët. Përfundimisht, Ligji i Praktikës Ligjore u miratua në Shtator 2014 (Ligji nr. 28 i 2014) duke mos njohur zyrtarisht paraligjorët dhe duke mos përcaktuar një kornizë rregullatore për paraligjorët.

Në bazë të ligjit Këshilli i Praktikës Ligjore, një organ i cili kryesisht ka kompetencë për të rregulluar profesionet ligjore, detyrohet që, brenda dy vjetësh, të shqyrtonte dhe t'i rekomandonte ministrit përkatës njohjen ligjore të paraligjorëve, duke marrë parasysh praktikën më të mira ndërkombëtare, interesin e publikut dhe interesat e profesionit ligjor, me qëllim kryerjen e

⁹⁷ S Benjamin, *Joining Forces For The Poor: Alliance-building for social justice in South Africa and the story of the National Alliance for the Development of Community Advice Offices*, September 2012, faqe. 11.

⁹⁸ S Benjamin, *Joining Forces For The Poor: Alliance-building for social justice in South Africa and the story of the National Alliance for the Development of Community Advice Offices*, September 2012, faqe 16.

ndërhyrjeve legislative dhe ndërhyrjeve të tjera për të përmirësuar qasjen në profesionin ligjor të paraligjorit dhe në përgjithësi qasjen në drejtësi.

Pavarësisht përpjekjeve të paraligjorëve, sikurse u paraqit edhe më sipër, paraligjorët nuk njihen në legjislacion si profesion i posaçëm.

3. Paraligjori në Afrikën e Jugut në ditët e sotme

Instituti/Shoqata Kombëtare e Paraligjorit e koncepton paraligjorin si një person, i cili në bazë të arsimit, trajnimeve ose përvojës së punës, kualifikohet të kryejë punë juridike sa i përket fushës së mirëqenies sociale ose punë të ngjashme me to, të cilat kërkojnë njohuri bazike të ligjit.

Edhe pse reformat kushtetuese pas aparteidit, garantuan një sërë të drejtash dhe përfitimesh për të gjithë afrikano-jugorët, përfshirë të drejtën për ndihmë juridike, qasja në shumë prej këtyre shërbimeve mbetet një sfidë për ata individë që jetojnë në zona të largëta dhe për ata që nuk mund të përballojnë shpenzimet financiare të një përfaqësimi ligjor. Paraligjorët, të cilët punojnë me komunitetet, plotësojnë këtë boshllëk duke siguruar zgjidhje të mosmarrëveshjeve dhe mbështetje juridike, të cilat me anë të punës së paraligjorëve bëhen të arritshme si nga ana gjeografike ashtu edhe nga ana financiare. Paraligjorët informojnë komunitetin e tyre për çështje sociale dhe sfida të përditshme me të cilat përballen klientët e tyre, pjesë të komuniteteve. Pavarësisht kësaj, roli i paraligjorëve, sikurse u përmend edhe më sipër, mbetet kryesisht i paformalizuar dhe i nënvlerësuar.

Paraligjori në Afrikën e Jugut mund të punojë:

- në zyra ligjore që ofrojnë shërbime për komunitetin të drejtuar nga organizata të komunitetit ose OJF
- si person i punësuar nga institucione shtetërore ose nga organizata joqeveritare
- si person që jep këshillime në fushën e marrëdhënieve të punës ose për sindikata
- si person i punësuar nga një praktikues ligjor ose firmë ligjore
- i vetëpunësuar si praktikant paraligjor ose konsulent ligjor
- i punësuar në një bankë, shoqëri sigurimesh ose ndërmarrje
- mundësi punësimi në shërbimet e policisë pas orientimit të dhënë nga Ministri i Policisë, me qëllim ofrimin e ndihmës për komisariatet e policisë në të gjithë vendin.

Kompetencat e paraligjorëve:

- Ndihmon individët në çështje administrative siç është plotësimi i dokumentacionit zyrtar.
- Ndihmon individët të kuptojnë konceptet bazike juridike.
- Ofrimi i këshillave bazike juridike.
- Këshillimi dhe edukimi i komuniteteve për të drejtat e tyre të njeriut.
- Referimi i çështjeve tek një praktikues ligjor.

4. Përmbajtja/modulet e kurseve dhe trajnimeve të paraligjorëve në Afrikën e Jugut

Në Afrikën e Jugut me qëllim që të bëhesh paraligjor duhen ndjekur disa kurse që ofrohen nga fakultetet e drejtësisë të universiteteve shtetërore, ose nga fakultete kryesisht private, të cilat përgatisin paraligjorët.

Për shembull, disa nga modulet dhe kurrikulat që trajtohen nga disa universite/shkolla janë si vijon:⁹⁹

Shkolla e Ligjit të Afrikës së Jugut:

Procesi gjyqësor civil dhe mbledhja e borxheve. Kursi përqendrohet në procedurat ligjore për rikuperimin e borxheve, duke përfshirë hartimin e fletëthirrjeve, kërkesëpadive dhe gjithë dokumenteve të tjera të procesit gjyqësor, deri në vendimmarrje dhe urdhrat e ekzekutimit. Gjithashtu, ky kurs ka parashikuar edhe njohuri lidhur me fazën paraprake të procesit gjyqësor, si përgatitja e dokumenteve, përpara dhe gjatë procesit gjyqësor, si dhe përdorimin e precedentëve në proces gjyqësor. Rregullat në lidhje me procedurën që ndiqet nga gjykatat më të ulta deri në Gjykatën e Lartë studiohen që nga fillimi i procesit deri në ekzekutimin e vendimit. Pjesë e këtyre moduleve janë ligji i mbrojtjes së konsumatorit dhe ligji i mbledhjes së borxheve.

Shkrimi ligjor. Një nga kurrikulat është edhe shkrimi ligjor i ideuar si një kurs i shkurtër, intensiv dhe gjithëpërfshirës, i parashikuar për të fuqizuar studentët me njohuritë e duhura lidhur me hartimin e dokumenteve të duhura ligjore, përfshirë letra, parashtrime, dhe dokumente për mbledhjen e borxheve, me qëllim aftësimin e studentëve në procesin e të menduarit dhe draftimit ligjor.

E drejta familjare dhe divorci. Ky kurs parashikon të drejtat që kanë bashkëshortët gjatë martesës deri në zgjidhjen e saj. Gjithashtu, parashikohet informacion në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës, pasurinë bashkëshortore, kontratat paramartesore etj. Pjesë e modulit janë edhe pasojat që vijnë nga zgjidhja e martesës lidhur me fëmijët si, e drejta e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, e drejta e takimit, kujdestaria. Pjesë të këtij moduli janë edhe dispozitat e ligjit të kujdesit për fëmijët, si dhe ndryshimet e fundit për rastet e bashkëjetesave, apo formave të tjera të jetesës së përbashkët.

Praktika për proceset familjare. Ky modul u siguron studentëve, të cilët kanë përfunduar kursin e mësipërm mbi familjen dhe divorcin, të përfitojnë njohuri më të thelluara sa i përket të drejtës familjare, duke përfshirë ligje të ndryshme që rregullojnë marrëdhënien familjare si, ligji për

⁹⁹ Materiali është marrë në faqen zyrtare të një prej shkollave që ofrojnë kurse për paraligjorë. Shkolla të ndryshme kanë kurrikula të ndryshme. Materiale janë gjetur edhe për programet e paraligjorëve në universitete shtetërore dhe private.

detyrimin ushqimor, dhunën në familje, të drejtën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore dhe kujdestarisë së fëmijëve.

E drejta e punës. Ky kurs parashikon të drejtat dhe detyrimet ndërmjet punëdhënësit-punëmarrësit, si dhe aspekte të tjera që lidhen me këtë marrëdhënie.

Pasuritë e paluajtshme. Ky kurs i shkurtër është shumë i vlefshëm për administrimin e pasurive.

Një program për paraligjorët në një **universitet privat të Afrikës së Jugut**, përfshin lëndët e mëposhtme: menaxhimi i zyrës së ndihmës juridike për praktikant ligjore; ligji penal dhe procedura penale; procesi i mbledhjes së borxhit; proceset gjyqësore civile; hyrje në ligjin e Afrikës së Jugut si dhe disa lëndë me zgjedhje, si menaxhimi i pasurive; ligji i pronës; kontabiliteti financiar etj.

Në rastet e ndjekjes së kurseve të trajnimit të paraligjorëve të ofruara nga universitetet private, paraligjorët e regjistruar për ndjekjen e tyre, nuk e kanë të detyrueshme blerjen e librave shkollorë në mënyrë që të përfundojnë kursin. Megjithatë, pas përfundimit të kursit, universiteti rekomandon blerjen e manualeve të posaçme për paraligjorët, si një mjet me vlerë për punën praktike. Materialet e kursit sigurohen edhe në formate elektronike në të cilët studentët kanë akses.¹⁰⁰

Një program tjetër paraligjori, i cili ofrohet në **Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Johannesburg** përfshin në vitin e parë, modulet si vijon: hyrje në ligjin e Afrikës së Jugut dhe ligjin mbi familjen 1; ligji penal dhe ligji i procedurës penale e provave 1; e drejta civile 1; ligji i biznesit dhe aftësitë e komunikimit, ndërsa në modulet e vitit të dytë përfshihen sërish disa lëndë të njëjta, por me njohuri më të thelluara si: ligji mbi familjen 2; ligji penal dhe ligji i procedurës penale dhe provave 2; e drejta civile 2; ligji i biznesit 2; dhe ligji i punës. Në këtë universitet, kursi/trajnimi bëhet në gjuhën angleze. Gjatë këtyre kurseve trajnuese studentët ndjekin modulet e mësipërme. Periudha minimale e studimit për marrjen e diplomës është dy vjet, por kjo periudhë mund të reduktohet në një vit, në varësi të numrit të moduleve me të cilat një student është kredituar në bazë të studimeve të mëparshme. Periudha maksimale e studimit për marrjen e diplomës është katër vjet. Kursi i trajnimit përfshin 8 module dhe prezantohet gjatë 2 viteve. Gjatë vazhdimit të këtij kursi, studentët janë të detyruar të ndjekin katër workshop të detyrueshme. Studentët vlerësohen dy herë në secilin modul me anë të detyrave. Studentët duhet të kenë së paku një mesatare prej 40% të pikëve për të dy detyrat në secilin modul, me qëllim që të futen në provimin e parashikuar për modulet përkatëse. Gjithashtu, gjatë ndjekjes së këtij kursi trajnimi, studentët marrin edhe kredite si dhe pajisen me diplomë për ushtrimin e profesionit të paraligjorit. Pas përfundimit të këtij kursi trajnues dhe marrjes së diplomës, paraligjorët mund të punojnë si: vlerësues në gjykatat penale (Departamenti i Drejtësisë paguan për shërbimin e ofruar, dhe paraligjori mund të punojë në Gjykatën më të afërt lokale të Magjistraturës), ndërmjetës (paraligjori mund të kontaktojë Institutin Kombëtar të Paraligjorëve), këshilltar i mirëmbajtjes, mbledhës i borxheve, ose edhe këshilltar ligjor.

¹⁰⁰ <https://www.labourguide.co.za/workshop/1364-paralegal-manual/file>

Në përfundim të kurseve të mësipërme, me qëllim që të bëhesh paralogor e të ushtrosh këtë profesion, duhet të marrësh një diplomë ose certifikatë të akredituar paralogore. Studentët kur regjistrohen për të ndjekur kurse për paralogorët duhet të kenë parasysh se ofruesit e trajnimeve duhet të jenë të regjistruar dhe të certifikuar në SAQA (Autoriteti i Kualifikimeve të Afrikës së Jugut).

5. Shembuj të punës me paralogorët të bazuar në komunitet

Në Afrikën e Jugut, edhe pse prostitucioni është i paligjshëm, rastet që adresohen në gjykatë janë shumë të rralla. Megjithatë, shumë punonjës të seksit arrestohen, ngacmohen dhe frikësohen. Shpesh mënyra e tyre e vetme për të shpëtuar është pagimi i ryshfeteve ndaj policëve. Prandaj, Qendra Ligjore e Grave (WLC) në Cape Town filloi të punësojë punëtorë seksi si asistente paralogore për t'u dhënë ndihmë juridike kolegëve të tyre.

Në Afrikën e Jugut, paralogorët që kërkojnë dëmshpërblim për përfitimet e mbajtura nga shteti përfshijnë një sërë autoritetesh komunale, krahinore dhe kombëtare. Referuar këtij problemi, një organizatë paralogore e Afrikës së Jugut, Ligji i Komunitetit dhe Qendra e Zhvillimit Rural, fituan (përafërsisht 370,000 dollarë amerikanë) në favor të klientëve të tyre gjatë një viti, shumica e të cilëve ishin përfitues të fitimeve të mbajtura nga shteti.

G. FILIPINE

1. Sistemi i ndihmës juridike

Sistemi ligjor në Filipine është unik sepse kombinon të drejtën civile, ligjin e zakonshëm, ligjin mysliman dhe ligjin indigjen. Gjithashtu, Gjykata e Lartë e Filipineve është unike sepse ka kompetenca për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave kushtetuese, procedurat gjyqësore, praktikën e ligjit dhe ndihmën juridike.

Ndihma juridike në Filipine është parashikuar në Kushtetutë. Më konkretisht, në nenin III, § 11 të Kushtetutës është parashikuar garantimi i të drejtës për ndihmë juridike dhe asistencë, nëpërmjet një qasje të re në gjykata dhe organe kuazi-gjyqësore. Gjithashtu, në Kushtetutë parashikohet që ndihma e duhur juridike nuk do t'i mohohet asnjë personi për shkak të varfërisë. Sipas nenit VIII § 5 të Kushtetutës, sistemi gjyqësor është i detyruar të nxjerrë rregulla për ndihmën juridike për personat e pa privilegjuar.

Autoritetet shtetërore të përfshira në ofrimin e ndihmës juridike janë, si vijon: Zyra e Avokatit Publik (ZAP), avokatët e caktuar nga gjykata, dhe agjencitë e zgjedhura qeveritare. Gjithashtu, ka edhe shumë organizata joqeveritare, të cilat ofrojnë ndihmë juridike për grupet vulnerabël. Disa shkolla drejtësie gjithashtu kanë programe të arsimit juridik klinik, të cilat lejojnë studentët e drejtësisë të praktikojnë ligjin.

Megjithatë, për t'iu dhënë mundësi palëve të zgjidhin konfliktet pa pasur nevojë të shkojnë në gjykatë, qeveria ka krijuar një mekanizëm për zgjidhjen ose ndërmjetësimin e mosmarrëveshjeve alternative në nivelin e fshatit.

Gjithashtu, për shkak të varfërisë dhe shkeljeve të shpeshta të të drejtave të njeriut, shteti filipinas ka parashikuar mundësi të shumta që avokatët të përfshihen në punë *pro bono*.

Sistemi i ndihmës shtetërore juridike

Sikurse u përmend edhe më sipër, sistemi i ndihmës shtetërore juridike përbëhet nga Zyra e Avokatit Publik, avokatë të caktuar nga gjykata si këshilltar *ex-officio*, dhe shërbime të ndihmës juridike që ofrohen nga disa agjenci qeveritare.

Zyra e Avokatit Publik

Zyra e Avokatit Publik është një agjenci shtetërore, që punon pranë Departamentit të Drejtësisë, funksioni kryesor i së cilës është ofrimi i ndihmës juridike falas për personat e varfër, në të gjitha çështjet civile, penale, të punës, administrative, dhe çështje të tjera kuazi-gjyqësore, në formën e përfaqësimit ligjor, asistencës dhe këshillimit.

Lidhur me kompetencat e këshillimit të ZAP, shërbimet e saj përfshijnë këshillim, përgatitje të dokumenteve ligjore, administrim i betimeve për pohime dhe deklarime, dhe ndërmjetësim i kërkesave dhe mosmarrëveshjeve. ZAP gjithashtu cakton avokatë në komisarariat për të ndihmuar personat që janë nën hetim dhe kryen vizita në burg për të intervistuar të burgosurit lidhur me problemet e tyre ligjore.

Për të përfituar shërbimet e ZAP, një person duhet të jetë pa të ardhura ose të ketë të ardhura të pamjaftueshme për të pasur një avokat privat. Shumica e zyrave të ZAP janë të vendosura në qendrat e qeverisjes vendore ose në ndërtesat e gjykatave.

Avokatët e ZAP nuk ofrojnë shërbime juridike lidhur me: 1) palët të cilat nuk arrijnë të kalojnë testin e pamjaftueshmërisë së të ardhurave (*indigent test*); 2) palët që tashmë përfaqësohen nga këshilltarë/avokatë privatë; 3) qiradhënësit e ndërtesave të banimit në rastet e nxjerrjes jashtë shtëpisë nga ana e qiramarrësit; 4) rastet e konfliktit të interesit; 5) ndjekjen e çështjeve penale, dhe 6) raste të reformës agrare, të cilat trajtohen nga Departamenti i Reformës Agrare.

Avokatët e caktuar nga gjykata

Kur një i akuzuar në një çështje penale në një proces gjyqësor përpara gjykatës nuk ka avokat, kryetari i trupit gjykues është i detyruar ta pyes nëse dëshiron të ketë avokat, dhe nëse, i akuzuari nuk mund ta gjejë vetë një avokat, duhet të caktojë një avokat për të. Në mungesë të një avokati të ZAP, gjyqtari mund të caktojë çdo avokat të pranishëm në sallën e gjyqit, për ndjekjen e çështjes së të akuzuarit. Avokati i caktuar nga gjykata është i detyruar të ofrojë ndihmë juridike falas për të akuzuarin. Avokati, nga ana tjetër, mund të kërkojë një pagesë të caktuar si kompensim nga shteti.

Agjencitë shtetërore që ushtrojnë ndihmë juridike

Disa agjenci shtetërore kanë zyra të ndihmës juridike me qëllim që individët e përfshirë në programet e tyre të përfitojnë ndihmë juridike. Për shembull, Departamenti i Reformës Agrare ka një njësi të veçantë që ndihmon fermerët në rastet e reformës së tokës. Agjencia e Punësimit të Jashtëm në Filipine ofron ndihmë juridike për punëtorët e Filipines që punojnë jashtë shtetit. Në të njëjtën mënyrë, Komisioni për të Drejtat e Njeriut në bazë të kushtetutës ka kompetencë të ofrojë ndihmë juridike për të akuzuarit, të drejtat e të cilëve janë shkelur ose kanë nevojë për mbrojtje.

Shërbime të ndihmës juridike nga organizata joqeveritare

Organizatat joqeveritare kanë shumë rëndësi përsa i përket shtrirjes së shërbimeve juridike falas për filipinasit kundër të cilëve është ngritur një akuzë penale. Organizata të tilla përfshijnë Avokatin e Integruar të Filipineve, Grupet Ligjore Alternative dhe grupet e tjera ligjore.

Dhoma e Avokatisë e Integruar e Filipineve (DHAIF)

Ka rreth 45,000 avokatë në Filipine, dhe organizata e tyre kryesore është DHAIF. Të gjithë avokatët praktikantë në bazë të ligjit duhet të jenë anëtarë të DHAIF.

Grupet ligjore alternative

Grupet ligjore alternative (GLA) janë organizata ligjore private të krijuara për mbrojtjen dhe fuqizimin e grupeve dhe komuniteteve të varfra dhe të marginalizuara si: të varfërit në zonat urbane, punëtorët, gratë, të burgosurit, peshkatarët, fshatarët, njerëzit e varfër, fëmijët dhe viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Këto organizata adresojnë kryesisht çështje publike, për shembull, çështje që prekin në përgjithësi komunitete ose grupe të mëdha individësh, të tilla si mjedisi, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore. GLA ofrojnë shërbime juridike falas dhe kërkojnë të mundësojnë qasje më të madhe në drejtësi për këto grupe. Ata bashkëpunojnë ngushtë me komunitete individësh dhe OJF të tjera dhe përdorin një qasje gjithëpërfshirëse në adresimin e çështjeve.

Programet e GLA zakonisht synojnë promovimin e ndjekjes së interesit publik, respektimin e të drejtave të njeriut dhe drejtësinë sociale. Puna e organizatave pjesëmarrëse në GLA përfshin çështjet gjyqësore, përpjekje për reformat në politikat shtetërore, iniciativat arsimore për të informuar grupet e marginalizuara për të drejtat dhe shqetësimet e tyre ligjore, dhe një përpjekje për të krijuar grupe të paraligjorëve në komunitete dhe organizata që mund të ofrojnë ndihmë juridike nga brenda. Grupet anëtare të koalicionit të GLA shpesh mbajnë marrëdhënie me shkollat e drejtësisë për të realizuar këto objektiva.

Në Filipine ka mbi 20 grupe ligjore alternative. Shumica përbëhen nga avokatë dhe paraligjorë të rinj. Ata ofrojnë ndihmë juridike falas dhe mbështeten financiarisht nga agjenci financimi dhe aktivitete të tyre për krijimin e të ardhurave.

Një shembull i një grupi ligjor alternativ është Qendra e të Drejtave të Njeriut Ateneo, një OJF me bazë shkollore, e cila synon: 1) të formojë mbrojtës të të drejtave të njeriut; 2) ta bëjë drejtësinë të arritshme për viktimat e varfra, të cilave u shkelen të drejtat e njeriut; 3) të monitorojë respektimin e të drejtave të njeriut nga ana e autoriteteve shtetërore; dhe 4) të edukojë publikun për ligjin dhe të drejtat e njeriut.

Për të arritur objektivat e saj, Qendra ka një program internshipi ku studentët e drejtësisë/avokatët caktohen për të punuar me OJF-të e të drejtave të njeriut për gjashtë muaj deri në një vit. Gjithashtu, Qendra ka një drejtor arsimore, e cila zhvillon seminare mbi të drejtat e njeriut për të përgatitur stafin e autoriteteve shtetërore dhe OJF-të, si dhe një drejtor kërkimor, e cila angazhohet në advokimin e politikave. Drejtoria gjyqësore e Qendrës trajton raste që përfshijnë shkelje të të drejtave të njeriut, veçanërisht raste që çenojnë fëmijët dhe punëtorët migrantë. Gjatë punës së saj, Qendra mbështetet shumë tek vullnetarët studentë të Shkollës së Drejtësisë Ateneo.

OJF të tjera me programe të ndihmës juridike

Në Filipine ka shumë OJF të tjera, që ofrojnë ndihmë juridike falas për personat e varfër. Disa prej tyre janë organizata me bazë kishtarë, ndërsa të tjera kanë zyra të ngritura nga persona privatë, si

për shembull, politikanë dhe/ose bashkësi që ofrojnë ndihmë juridike për çështje specifike. Për shembull, Grupi i Ndhmës Juridike është i njohur në vend për ofrimin e ndihmës juridike për të burgosurit politikë dhe të dënuarit me vdekje.

Programet e ndihmës juridike në shkollat e drejtësisë

Më 1986, Gjykata e Lartë e Filipineve miratoi Rregulloren 138-A të Praktikës së Studentit të Drejtësisë. Ky akt parashikon që një student i vitit të katërt të drejtësisë, i cili është regjistruar në programin e shkollës së drejtësisë të klinikës ligjore, të miratuar nga Gjykata e Lartë, mund të përfaqësojë klientë të pranuar nga klinika ligjore, përpara çdo trupi gjyqësor, autoriteti ose punonjësi, lidhur me çdo çështje civile, penale ose administrative, pa pagesë.

Paraqitja e një studenti përpara një trupe gjyqësore ose çdo organi tjetër, duhet të jetë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të një avokati të akredituar nga shkolla e drejtësisë. Kjo do të thotë që avokati mbikëqyrës duhet të jetë i pranishëm gjatë seancës dëgjimore, veçanërisht kur studentit paraqitet përpara gjykatës së shkallës së parë, dhe të gjitha dokumentet ligjore duhet të nënshkruhen nga avokati mbikëqyrës në emër të klinikës ligjore. Arsyet e “pranisë fizike” të një avokati janë: 1) për të shmangur një mbrojtje ligjore jocilësore për shkak të paafësisë ose mungesës së përvojës së studentëve të drejtësisë; 2) të zbatojë parimin se asnjë person nuk mund të ushtrojë një profesion pa kualifikimet e nevojshme, sikurse është një licencë e kërkuar në bazë të ligjit.

Megjithatë, në gjykatat e shkallës së parë, ku çështjet dhe procedura janë relativisht të thjeshta, një student i drejtësisë mund të paraqitet për të mbrojtur një çështje vetëm pa mbikëqyrjen e një avokati.

Rregullat që mbrojnë komunikimet e privileguara ndërmjet avokatit dhe klientit zbatohen edhe për komunikime të ngjashme, që përfshijnë studentin e drejtësisë. Për më tepër, studentit i drejtësisë duhet të respektojë standardet e sjelljes profesionale, që rregullojnë profesionin e avokatëve. Nëse një avokat nuk mbikëqyr në mënyrën e duhur një student, kjo mund të përbëjë shkak për veprim disiplinor.

Bazuar në Rregulloren e Praktikës së Studentit të Drejtësisë, rreth shtatë shkolla të drejtësisë kanë krijuar programe të edukimit ligjor klinik, të miratuar nga Gjykata e Lartë. Përmes këtyre programeve, shkollat e drejtësisë ofrojnë ndihmë juridike falas. Megjithatë, ka shumë shkolla të tjera të drejtësisë që nuk kanë programe të edukimit ligjor klinik, por ende ofrojnë ndihmë juridike falas përmes zyrave të tyre të ndihmës juridike.

Edukimi Ligjor Klinik i Shkollës së Drejtësisë Ateneo

Programi i Edukimit Ligjor Klinik i Shkollës së Drejtësisë Ateneo (CLED) përbëhet nga mësimdhënia në klasë dhe praktika juridike. Studentët e CLED regjistrohen për një lëndë me zgjedhje (Edukimi Ligjor Klinik I dhe III) dhe ndjekin seanca në klasë për të kryer praktikën juridike. Në të njëjtën kohë, ata caktohen në ekipe për të trajtuar çështje aktuale ligjore nën

mbikëqyrjen e profesorëve të ligjit dhe avokatëve. Puna juridike kryhet në koordinim me Qendrën e të Drejtave të Njeriut Ateneo, që zbaton programin e ndihmës juridike të shkollës së drejtësisë.

Programi CLED i shkollës Ateneo ka këto objektiva: 1) ofrimi i ndihmës juridike cilësore për organizatat bazë dhe individë të varfër, që nuk janë në gjendje të marrin shërbime juridike; 2) trajnimi dhe praktika e studentëve të drejtësisë për legjislacionin, nën mbikëqyrjen e avokatëve kompetentë; dhe 3) nxitja midis studentëve e konceptit të shërbimit, ndërgjegjësimit shoqëror dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në trajtimin e çështjeve, programi synon të prezantojë studentët e drejtësisë me një koncept të ndihmës juridike në të cilën klienti është i përfshirë në mënyrë aktive në vendimmarrje dhe në një përpjekje për të fuqizuar klientin.

Zgjidhja/ndërmjetësimi alternativ i mosmarrëveshjeve

Për të shmangur proceset gjyqësore të gjata dhe të kushtueshme, shteti ka ngritur një sistem të njohur si Drejtësia Barangay (*Katarungang Pambarangay Barangay Justice*). Barangay është i njëvlefshëm me një fshat dhe është njësi më e vogël politike në shtet.

Sistemi i drejtësisë Barangay është një sistem i zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të familjes dhe banorëve në nivelin e fshatit. Objektivat e tij janë: 1) promovimi i administrimit të shpejtë të drejtësisë dhe zbatimi i parimit kushtetues i ruajtjes së kulturës filipinase dhe forcimit të familjes si një institucion themelor shoqëror; 2) rritja e cilësisë së drejtësisë.

Sipas sistemit, të gjitha ato raste që përfshijnë palë, të cilat banojnë në të njëjtin qytet/bashki dhe kanë të bëjnë me një konflikt të njëjtë duhet, së pari, të paraqiten përpara një këshilli pajtimi konfliktesh për zgjidhje miqësore, dhe vetëm, në rastin kur një zgjidhje e tillë nuk arrihet, sikurse vërtetohet nga këshilli i pajtimit, palët mund të paraqesin një çështje për zgjidhje përpara gjykatave të zakonshme. Një çështje e paraqitur për zgjidhje përpara një gjykate, pa kaluar një proces të tillë, mund të rrëzohet nga gjykata.

Megjithatë, sistemi i drejtësisë Barangay nuk ka kompetencë për të zgjidhur çështjet e mëposhtme: 1) një nga palët është shtetërore; 2) një nga palët është autoritet shtetëror publik dhe mosmarrëveshja ka të bëjë me kryerjen e veprimtarisë së tij; 3) raste që përfshijnë prona të paluajtshme që ndodhen në qytete/komuna të ndryshme; 4) çdo kërkesë kundër një personi juridik; 5) mosmarrëveshje që përfshijnë palë që banojnë në qytete/komuna të ndryshme; 6) vepra penale me një dënim maksimal që tejkalon një vit burgim ose me gjobë më të madhe se një shumë e caktuar; 7) vepra penale kur nuk ka palë të paditur private (për shembull, rastet e bixhozit ose prostitucionit); 8) mosmarrëveshje, të cilat kërkojnë marrjen e një veprimi urgjent ligjor për të parandaluar padrejtësinë; 9) mosmarrëveshje që përfshijnë ligjin e reformës agrare; 10) mosmarrëveshjet e punës etj.

Skemat pro bono, avokatët ofrojnë shërbime të ndihmës juridike në baza vullnetare, pa pagesë nga shteti dhe nga personi që kërkon ndihmë. Në Filipine, avokatët kanë një detyrim profesional të

punojnë me një numër rastesh të papaguara në vit. Edhe praktikantëve që duan të bëhen avokatë u kërkohet të punojnë me një numër të tillë rastesh gjatë trajnimit të tyre.

Skemat Paraligjore, shërbimet e ndihmës juridike ofrohen nga paraligjorët, të cilët jo domosdoshmërisht kanë një kualifikim ligjor. Paraligjorët kryejnë disa nga funksionet e avokatëve, në faza të ndryshme të procesit të drejtësisë penale, por jo tërësinë e shërbimeve që kryejnë avokatët, ose punojnë me avokatë, ose punojnë për avokatët duke i ndihmuar, ose referojnë tek avokatët ato çështje që ndiqen vetëm nga një avokat. Natyra e saktë e punës së paraligjorëve ndryshon nga juridiksioni në juridiksion.

Avokatët në Filipine nuk mund të praktikojnë ligjin pa qenë anëtarë të dhomës së avokatëve. Avokatët përgjithësisht ndjekin çështje që kanë të bëjnë me të drejtën civile, të drejtën tregtare, të drejtën e punës, të drejtën e tokës, ligjin e taksave, ligjin penal, të drejtën politike dhe të drejtën ndërkombëtare.

Sipas ligjit të Filipines, paraligjorët nuk njihen si profesionistë ligjorë. Ata luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në adresimin e çështjeve të menjëhershme juridike dhe mosmarrëveshjeve, që përfshijnë të drejtat e anëtarëve të komunitetit. Paraligjorët me bazë në komunitet njohin ligjet dhe përcjellin informacionin anëtarëve të komunitetit në nevojë. Paraligjorët gjithashtu mund të ofrojnë edukim ligjor, të ndihmojnë anëtarët e komunitetit për t'u qasur tek institucionet shtetërore, të ofrojnë shërbime të tjera ligjore, dhe të mobilizojnë mbështetjen e komunitetit rreth çështjeve lokale. Gjithashtu, paraligjorët mund të paraqiten në disa gjykata komunale në emër të klientëve, nëse nuk ka avokatë të disponueshëm, si dhe përpara organeve kuazi-shtetërore.

2. Paraligjori në Filipine

Në këtë pjesë të studimit do të parashtrohet një informacion më i zgjeruar në lidhje me fillesat dhe mënyrën sesi funksion paraligjori në Filipine.

Puna e paraligjorëve në ditët e sotme në Filipine nuk është një fenomen i ri. Fillesat e punës së paraligjorëve në dhënien e ndihmës juridike për të varfërit, datojnë që nga fillimi i viteve 1930, kur trazirat agrare dhe punëtore u shfaqën në përgjigje të përkeqësimit të kushteve sociale dhe ekonomike. Përvoja filloi si një traditë ligjvënijeje për të varfërit dhe grupet e tjera të marginalizuara, e cila vazhdoi në dekadat pasuese, kur gjeneratat e reja të organizatave të punëtorëve dhe fshatarëve u ngritën, në përgjigje të kërkesave ende të paplotësuara, për kushte më të mira pune dhe njohjen e të drejtave të pronësisë.

Në vitin 1974, gjatë zbatimit të ligjit ushtarak, një grup i vogël avokatësh dhe jo-avokatësh, vlerësuan një strategji për punën e paraligjorëve, të cilët u panë si persona që mund të trajtonin çështje të të drejtave të njeriut. Të gjitha problematikat politiko-sociale në vend shërbyen si një terren trajnimi për gjeneratat e ardhshme të avokatëve, dhe për krijimin e institucioneve të tyre.

Kjo eksperiencë u bë pikë referimi e rëndësishme për aktivizmin ligjor alternativ dhe për përpjekjet lidhur me krijimin e paraligjorëve. Ligjet alternative dhe qasja e aktivizmit paraligjor fituan kështu një rëndësi të re sociale.

Gjatë kësaj periudhe, organizata të tjera të ngjashme, si Lidhja e Avokatëve Protestantë (LAP) dhe Lëvizja e Avokatëve për Vëllazëri, Integritet dhe Nacionalizëm, Inc (LAVINI) gjithashtu ndoqën modelin e shërbimeve ligjore falas për adresimin e abuzimeve të të drejtave të njeriut.

Paraligjorët në ditët e sotme: Përkufizimi, Puna, Mjetet dhe Trajnimi

(a) Përkufizimi

Në Filipine, termi paraligjor i referohet kryesisht dikujt që ka disa njohuri mbi ligjin dhe punën e qeverisë, ka ndjekur disa trajnime në këto fusha, dhe praktikon aftësitë e tij/saj paraligjore në emër të një organizate qeveritare ose joqeveritare. Ka një dallim të qartë midis një paraligjori dhe një *abogadillo* (“avokat i vogël”). Termi *abogadillo* i referohet çdo personi i cili ofron konsulencë juridike dhe shërbime me pagesë. Kjo formë konsulence konsiderohet si e paligjshme nga aktivistët e ligjit alternativ, për shkak të mungesës së përgjegjshmërisë ndaj një autoriteti më të lartë. Gjithashtu, konsiderohet si e paligjshme edhe nga Dhoma e Avokatisë dhe Gjykata e Lartë.

Grupet e ndihmës juridike kanë trajnuar paraligjorët në lidhje me konceptet themelore të ligjit, procedurën ligjore dhe aftësitë e nevojshme për të kryer punë rutine dhe për të kryer punë të tjera, duke filluar nga intervistimi i dëshmitarëve, ruajtja e provave fizike, plotësimi i formateve standarde etj.

Paraligjorët përzgjidhen, midis studentëve të drejtësisë dhe shkencave shoqërore me rezultate të larta, që pranojnë të punojnë me komunitete të varfra gjatë periudhës së shkollës; nga përfaqësuesit e komuniteteve, të cilët rekomandohen nga organizatat civile që punojnë me ta; si dhe nga anëtarët e sindikatave të rekomanduara nga vetë sindikatat e tyre.

Trajnimi i paraligjorëve ka pasur shumë anë pozitive, ndër të cilat krijimi i mundësive për juristët që të kenë më shumë kohë për të ofruar këshillime dhe kryer negociata e advokim. Paraligjorët kanë edukuar komunitetet në të cilat jetojnë me njohuri rreth funksionimit të ligjit dhe mënyrës së përdorimit të ligjit për të mbrojtur të drejtat e tyre. Disa studentë të drejtësisë për shkak të motivimit të fituar nga përvoja e tyre si paraligjorë, kërkojnë t’i bashkohen grupeve të ndihmës juridike pas marrjes së licencës së avokatit.

(b) Çështjet në të cilat përfshihen paraligjorët

Paraligjorët në Filipine përfshihen sot në: 1) edukim për të drejtat e njeriut, të drejtat e dispozitat kushtetuese si dhe të drejtat dhe procedurat ligjore; 2) hulumtim/hetim/ dokumentacion ligjor; 3) ndërmjetësim në zgjidhjen e konflikteve ose të mosmarrëveshjeve; 4) përfaqësim në gjykata të caktuara kuasi-gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; 5) zbatim i ligjit si *bantay gubat* (roje pyjore) dhe *bantay dagat* (roje komunale të ujit); 6) advokim i politikave rreth rregulloreve vendase dhe ligjeve, politikave dhe programeve kombëtare; dhe 7) organizim dhe mobilizim i

njerëzve për të adresuar në mënyrë më efektive shqetësimet e tyre të drejtësisë duke hartuar kërkesa të bazuara në të drejtat e tyre ligjore.

(c) Përgjegjësia e paraligjorëve

Paraligjorët njihen në Filipine, si paraligjorë me bazë në komunitet, duke i parë si pjesë, ose që i shërbejnë, njësisë bazë të shoqërisë, në vendin e punës, lagje, famulli, shkollë apo një mjedis tjetër themelor social-institucional. Megjithatë, në praktikë, kjo përkatësi rezulton të ketë kuptime të ndryshme në lidhje me marrëdhëniet e paraligjorëve me shtetin.

Për shembull, paraligjorët që janë anëtar të një organizate popullore (OP), kanë përgjegjësi ndaj asaj organizate. Për paraligjorët e tjerë, ku puna e të cilëve vjen nga lidhja që ata kanë, dhe njohja që u bëhet atyre nga një njësi/zyrë e caktuar e qeverisjes vendore (NJQV), përgjegjësia e tyre është kryesisht për qeverinë lokale. Gjithashtu, ka paraligjorë të cilët i shërbejnë një grupi ose kategorie të veçantë të njerëzve dhe që quhen paraligjorë me bazë komunitare në OJF. Ka edhe nga ata paraligjorë të vendosur në një institucion qeveritar, siç është Departamenti i Reformës Agrare (DAR), i cili filloi programin e tij paraligjor në vitet 1990 me qëllim nxitjen e zbatimit të reformës agrare.

Në të gjitha këto raste, një karakteristikë përcaktuese, është se paraligjori në mënyrë të qartë përpiqet t'i shërbejë një grupi ose kategorie të caktuar individësh, të cilëve edhe pse u njihen një sërë të drejtash dhe/ose të drejtat e njeriut, në praktikë këto të drejta nuk u respektohen në mënyrë efektive. Paraligjori në Filipine ka qenë lëvizja e gjerë për ndryshime shoqërore, e cila, edhe pse ka disa dallime të rëndësishme brenda vetë sistemit ligjor filipinas, pasqyron një konsensus themelor për problemet kryesore që rrethojnë shoqërinë filipinase.

(d) Njohja dhe trajnimi

Paraligjorët me bazë në komunitet tani njihen nga disa institucione kuasi-gjyqësore, për shembull, Bordi i Rregullimit të DAR, që merret me mosmarrëveshje të lidhura me reformën agrare, dhe Komisioni Kombëtar i Marrëdhënieve të Punës, që trajton mosmarrëveshjet midis punëdhënësve dhe punonjësve. Por këta paraligjorë ende nuk njihen zyrtarisht nga sistemi gjyqësor.

Paraligjori me bazë në komunitet sot është formuar edhe si rrjedhojë e reformave të udhëhequra nga shteti dhe nismat e individëve. Për shembull, kur kushtetuta parashikonte të drejtën e njerëzve për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, kjo passolli propozime të ndryshme legjislative në një sërë fushash ligjore. Legjislacioni i ri mjedisor bëri që Gjykata e Lartë të krijojë gjykata të reja mjedisore me juridiksion parësor dhe të përmirësojë rregullat e kompensimit në çështjet mjedisore. Të gjitha ndryshimet legjislative krijojnë një nevojë të ngutshme për fushata ndërgjegjësimi lidhur me këto ndryshime, si në aspektin e përmbajtjes ligjore, ashtu edhe të procedurave të kompensimit. Gjithashtu, ddryshimet e legjislacionit sjellin nevojën për trajnime të mëtejshme të paraligjorëve.

Trajnimet dhe aftësimi i paraligjorëve shihen si elementë të rëndësishëm edhe nga organizatat alternative ligjore. Programet paraligjore kryesisht janë të orientuar drejt specializimeve rreth

fushave dhe ligjeve të ndryshme. Grupe të tilla si FLAG dhe PLL kanë krijuar metodologji trajnimi dhe mjete praktike paraligjore, të cilat kanë rezultuar të jenë të qëndrueshme edhe në një periudhë afatgjatë, duke vendosur madje standarde që u miratuan më vonë nga programet paraligjore.

Puna e paraligjorëve të parë shërbeu për krijimin e moduleve mbi të drejtat e njeriut, analizën e situatës së të drejtave të njeriut dhe krijimin e praktikës për aftësitë paraligjore. Si rezultat, trajnimi standard paraligjor sot përfshin: 1) analizën e situatës në të cilën pjesëmarrësit e gjejnë veten në të drejtat e njeriut dhe në aspektin sociopolitik; 2) hyrje në filozofinë e advokimit ligjor, ose hyrje në fuqizimin ligjor si mënyrë e përdorimit të ligjit për të fuqizuar individët, për të reformuar ligjet, për të mbrojtur të drejtat dhe për të bërë përgjegjës shtetin ose korporatat; dhe 3) udhëzime lidhur me parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe parimet ligjore.

(e) Llojet e paraligjorëve

Lloji A: Paraligjor i një organizate themelore. Ky paraligjor është anëtar i një organizate themelore, zakonisht është punëtor i një fabrike, ose agrar në cilësinë e pronarit të tokës, i cili caktohet nga organizata si paraligjor. Organizatat themelore janë shoqata të organizuara nga vetë të varfërit, si punëtorë, fshatarë ose peshkatarë, anëtarët dhe udhëheqësit e të cilëve vijnë nga këta sektorë. Paraligjorët e organizatës zakonisht mbështeten nga një grup individësh për mbrojtjen e të drejtave ose një OJF e përbërë nga profesionistë, që ofrojnë shërbime për të varfërit.

Lloji B: Drejtues-Organizator Paraligjor. Ky paraligjor është anëtar i një organizate popullore (OP), ose i një rrjeti me një shtrirje rajonale, për shembull, një komunitet i varfër që shtrihet në fshatra dhe komuna të shumta, ose i një rrjeti të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, që mbulon disa provinca.

Lloji C: Paraligjorë, student i drejtësisë. Këta paraligjorë janë studentë vullnetarë që edukojnë nga ana ligjore komunitetin, monitorojnë zgjedhjet dhe japin këshilla dhe ndihmë juridike.

Lloji D: Paraligjorë me bazë në zyrë/i punësuar në një zyrë. Këta mund të jenë anëtarët e stafit të OJF-ve, që dokumentojnë çështje, japin informacion ligjor dhe ndihmojnë avokatët.

Lloji E: Paraligjorë i bashkësisë kryesore. Këta janë anëtarët e komunitetit, të cilët trajnohen nga OJF-të, ose vetë zyrtarët lokalë që janë trajnuar nga OJF-të, që kryejnë funksione paraligjore në dobi të anëtarëve të komunitetit.

Organizimi i komunitetit

Organizimi i komunitetit shihet gjithashtu si një faktor vendimtar, që lehtëson programet paraligjore. Një OJF ligjore, që është organizatë anëtare e GLA, duhet që në partneritet me organizata të tjera të specializohet dhe të kryejë punë organizative në komunitet. Qëllimi i një organizimi të tillë komunitar është arritja e një sinergjie dhe plotësimi i punës, për shembull, një organizatë, kryen organizimin komunitar ndërsa organizata tjetër kryen punë juridike për komunitetin apo dhe aftësimin e paraligjorëve. Megjithatë, në praktikë, mund të lindin probleme

lidhur me organizimin komunitar për çfarëdo arsye, pasi puna organizuese e komunitetit nuk është e qëndrueshme.

Skepticizmi mbi aftësitë e paraligjorëve: Nga një këndvështrim tjetër, lëvizja paraligjore është penguar nga perceptimi se ndihma juridike duhet të jepet nga avokatë, duke sjellë dyshime tek vetë paraligjorët lidhur me aftësinë e tyre për të studiuar dhe praktikuar ligjin. Disa paraligjorë shprehen se ata nuk janë avokatë, por megjithatë duke qenë se funksionet e tyre i ushtrojnë në lidhje të ngushtë me ligjin, atyre u duhet të jenë të kujdesshëm, përndryshe mund të gjenden në një pozitë të vështirë.

Puna e paraligjorëve: Puna e një paraligjori sot në Filipine mund të kategorizohet në tre drejtime: 1) ndërgjegjësimi i të drejtave të njeriut; 2) zgjidhja e mosmarrëveshjeve private; dhe 3) rritja e përgjegjëshmërisë shtetërore dhe korporative.

(f) Financimi: Në Filipine mbetet problem financimi i punës së paraligjorëve. Më konkretisht, paraligjorët dhe sidomos ata që punojnë në OJF hasin problematika me financimin, edhe pse kanë pasur mbështetje afatgjatë nga donatorë të ndryshëm. Gjithashtu, shumë burime tradicionale financimi për programet e formimit të paraligjorëve nuk shfaqin më interes për financimin e programeve të tilla.

(g) Trajnimi i Paraligjorëve

Ushtrimi i funksioneve të paraligjorit në mënyrë efektive dhe në cilësinë e duhur kërkon arsimim të duhur, ndjekje të trajnimeve të vazhdueshme dhe eksperiencë në ushtrimin e këtij profesioni. Paraligjorët janë përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve juridike, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të hulumtimit, parashtrimin e fakteve dhe çështjeve ligjore, drejtimin dhe koordinimin e veprimtarisë së zyrës juridike dhe mirëmbajtjen e dosjeve dhe dokumenteve. Përveç dhënies së ndihmës për avokatët, një paraligjor bën edhe punë administrative.

Për të qenë një paraligjor në Filipine, qytetari duhet të ketë të paktën një diplomë bachelor në artet apo shkencat liberale, ose një shkollim në ligj. Megjithatë, këto kurse universitare nuk mjaftojnë për të përgatitur një student që të përballlet me burokracitë shtetërore, prandaj, sikurse u përmend edhe më sipër, aftësimi dhe trajnimi i paraligjorëve është tepër i rëndësishëm. Në Filipine, universitetet, kryesisht ato private parashikojnë një program të trajnimit të paraligjorëve. Programi i Trajnimit Paraligjor (PTP) është një program trajnimi, i cili synon të krijojë themelet për zhvillimin dhe profesionalizimin e punës së paraligjorëve në vend. Programi i Trajnimit Paraligjor kryesisht në universitete është krijuar për t'u dhënë pjesëmarrësve njohuri themelore dhe praktike për konceptet ligjore bazike që kanë të bëjnë me qeverinë, sistemin gjyqësor, procedurën civile, penale dhe kuazi-gjyqësore, juridiksionin e njësisive të qeverisjes vendore, standardet etike të gjyqtarëve, avokatëve dhe nëpunësve civilë, dhe rregullat, rregulloret dhe procedurat e agjencive të ndryshme administrative.

Kurset që duhen ndjekur për t'u bërë paralogjorë janë të ndryshme dhe variojnë nga njëri universitet në tjetrin. Universitete të caktuara kërkojnë nga pjesëmarrësit që të kryejnë dhe përfundojnë njëzet e gjashtë (26) seanca tre-orëshe, që mbulon një periudhë kohëzgjatje prej tre muajsh.

PTP është hapi i parë për programet e specializuara të trajnimit për zhvillimin e profesionit të paralogjorit në Filipine. Programi i Trajnimit Paralogjor është një program zyrtar, me kohë të pjesshme, për aftësitë ligjore dhe teknike të studentëve, që janë apo që do të angazhohen në punë dhe shërbime paralogjore. Ky kurs kërkon t'i japë njohuri paralogjorit për bazat e ligjit material dhe të zhvillojë aftësitë e tij në procedurat praktike përpara gjykatave dhe agjencive administrative. Në përfundim të kursit, studentët marrin një certifikatë të përfundimit të programit të paralogjorëve.

Në Filipine, ekzistojnë mundësi të shumta punësimi të paralogjorëve, të tilla si paralogjor në zyrat e avokatëve, në sektorin privat dhe në zyrat qeveritare.

PJESA II

PARALIGJORI NË SHQIPËRI (EKSPERIENCA E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE DHE PARALIGJORËVE)

A. Metodologjia

Me qëllim që të thellonim analizën e legjislacionit shqiptar lidhur me mundësinë e përfshirjes së profesionit të paraligjorit në Listën Kombëtare të Profesioneve si dhe evidentimin e paraligjorit apo ndonjë profesioni të ngjashëm me të, studimi u fokusua edhe te eksperiencat e paraligjorit në Shqipëri. Për këtë qëllim u hartua një pyetësor dhe u realizuan intervista me paraligjorë për të marrë më shumë informacion rreth eksperiencës së tyre në Shqipëri.

Pyetësori përmban pyetje që lidhen me eksperiencën e organizatave dhe paraligjorëve me profesionin e paraligjorit, nevojën apo jo për institucionalizimin e këtij profesioni, sqarimin se çfarë do të konsiderohet paraligjor në kontekstin shqiptar të këtij profesioni, detyrat, roli i tij, punësimi, edukimi, trajnimet etj.

Organizatave të intervistuar janë: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, Klinika e Ligjit pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit, Organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome”, Qendra për Advokim Social, Klinika e Ligjit Shkodër, dhe Qendra T’REJA. Gjithashtu u intervistuan edhe tre paraligjorë konkretisht, Znj. Samanta Dulja, Z. Fation Kaca, dhe Z. Gentian Sejrani.

Të intervistuarit nëpërmjet projekteve të financuara nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë kanë eksperiencë në zbatimin e projekteve në të cilët kanë përfshirë paraligjorë, si dhe kanë ushtruar funksionet e një paraligjori.

Kjo pjesë e studimit është e rëndësishme për të kuptuar sesi është vetërregulluar ky profesion deri tani, cili është roli i një paraligjori në krahasim me profesionet e deritanishme, a është i domosdoshëm përfshirja e tij si një profesion i ri në Listën Kombëtare të Profesioneve etj.

Më poshtë do të analizojmë rezultatet e studimit nga intervistimi i 2 përfaqësuesve nga klinikat e ligjit Durrës dhe Shkodër, 5 organizatave jofitimprurëse dhe 3 paraligjorë.

B. Përmbledhje e gjetjeve nga pyetësorët

Ashtu sikurse u përmend më sipër, të intervistuarve iu shpërnda një pyetësor i detajuar, i cili është përfshirë në aneksin nr. 1 të këtij studimi. Pyetësori përmbante pyetje të ndryshme, konkretisht, në seksionin “Pyetje të përgjithshme për paraligjorin”, organizatat e intervistuar kanë sqaruar se, kanë në fokusin e shërbimeve të tyre ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për individët

në nevojë si familje/individë të varfër, minoritete rome dhe egjiptiane, apo dhe familje që kanë nevojë për shërbime sociale. Shërbimet ligjore të ofruara konsistojnë në këshillime, orientime, plotësim dokumentacioni, hartim i shkresave të ndryshme, shoqërim dhe përfaqësim përpara institucioneve, si dhe ankesa kryesisht pranë Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi etj. Gjithashtu, disa prej organizatave kanë ekspertizë në ndjekjen e rasteve të litigimit strategjik dhe *class action*, duke synuar krijimin e precedentit gjyqësor dhe ofrimin e zgjidhjeve të përshtatshme për raste të ngjashme.

Disa aktivitete të tjera pjesë e veprimtarisë së të intervistuarve lidhen me rritjen e kapaciteteve të studentëve nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme si dhe edukim ligjor të publikut apo aktivitete me natyrë sensibilizuese, lobuese dhe advokuese, që ndikojnë në rritjen e aksesit në shërbime për komunitetin rom dhe egjiptian.

Të gjithë të intervistuarit kanë përfshirë paraligjorin në projektet e zbatuara. *Shembull*: Klinika e Ligjit Durrës ka përfshirë paraligjorë të kontraktuar me kontratë shërbimi për disa periudha kohe. Sipas tyre, veprimtaria që ushtrohet nga studentët e vitit të tretë juridik, apo studentë të masterit, është e njëjtë me atë të paraligjorëve. Edhe Klinika e Ligjit Shkodër ka pasur studentë që kanë kryer rolin e paraligjorit si dhe paraligjorë komuniteti.

Një organizatë e intervistuar, na ka informuar se, që prej themelimit shërbimet paraligjore kanë qenë një nga aktivitetet e rëndësishme të programit të saj. Stafi paraligjor i përzgjedhur mund të jetë jurist ose jo jurist si, punonjës social, psikologë etj. Aktualisht, në këtë organizatë janë të punësuar me kohë të plotë 4 paraligjorë, tre prej të cilëve janë juristë dhe një është psikolog me trajnim ligjor. Detyrat e paraligjorit janë të përcaktuara në përshkrimin e punës.

Kjo organizatë ka vënë në dispozicion edhe statistika lidhur me numrin e çështjeve që paraligjorët e kësaj organizate kanë ndjekur gjatë vitit 2019 dhe totalin e çështjeve të ndjekura prej tyre gjatë 21 viteve shërbime (Aneksi nr. 2 bashkëngjitur studimit). Më konkretisht, rezulton se, gjatë vitit 2019 janë hapur 10436 raste, që janë trajtuar nga paraligjorët, prej të cilave janë mbyllur 6915 raste dhe janë ende aktive 3511 raste. Gjatë 21 viteve të funksionimit të organizatës janë hapur 15760 raste, që janë trajtuar nga paraligjorët, prej të cilave janë mbyllur 15585 raste dhe janë ende aktive 175 raste. Nga këto statistika rezulton se, gjatë vitit 2019 paraligjorët janë marrë kryesisht me raste të regjistrimit të lindjes së fëmijëve (457 raste), regjistrime të tjera civile (167 raste), divorce (243), çështje të së drejtës familjare (108 raste), mbështetje psikologjike (3 raste), strehim/mirëqenie (159 raste), si dhe çështje të tjera të ndryshme (199 raste). Target-grupi i punës së paraligjorëve janë kryesisht: fëmijët (457 raste), gratë kryefamiljare (277 raste), personat me paaftësi dhe invalidë (17 raste), të papunët (287 raste), të moshuarit pa të ardhura (45 raste), pensionistët (61 raste), si dhe familje të tjera të varfra (192 raste). Nga të dhënat e mësipërme evidentohet se, paraligjori ka një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e ndihmës juridike falas, duke trajtuar raste të shumta (10436 raste në vitin 2019).

Gjithashtu, kjo organizatë ka vënë në dispozicion informacion lidhur edhe me themelimin e një programi paraligjor nga një OJF, më konkretisht lidhur me konceptimin e programit paraligjor; buxhetimin e sigurimin e burimeve financiare; dhe skemën e metodologjisë së punës paraligjore (Aneksi nr. 3 bashkëngjitur studimit).

Paraligjorët e intervistuar në këtë pyetësor, ushtrojnë funksionin e paraligjorit në projekte të ndryshme të Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, më konkretisht projekti “Fuqizimi ligjor për komunitetin rom dhe egjiptian”, i fokusuar me çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale si strehimi në rastet e legalizimeve të banesave, punësimi, rastet e ndihmës ekonomike.

1. Koncepti i paraligjorit

Sipas të intervistuarve, paraligjori është një person, i cili ka njohuri të përgjithshme në fushën e drejtësisë, që ofron shërbime të ndihmës juridike parësore për çështje të thjeshta dhe standarde dhe orienton qytetarët lidhur me të drejtat e tyre edhe në rast të shkeljes së tyre. Ndryshe nga një asistent avokat, paraligjori ka kontakte të ngushta dhe të drejtpërdrejta me komunitetin dhe qytetarët, me qëllim që të kuptojë më tepër situatat dhe problemet e tyre. Paraligjori duhet të ketë aftësitë për të ndërmarrë vetë hapat e parë në një procedurë ligjore, si dhe të jetë në gjendje që të identifikojë rastet, përfshirë ato strategjike, të ofrojë asistencë për ndjekjen e procedurave të nevojshme, edhe para institucioneve, të asistojë lidhur me plotësimin e dokumentacionit, si dhe të ofrojë këshillim ligjor lidhur me legjislacionin në fuqi, me qëllim zgjidhjen e problemit.

Paraligjori konsiderohet profesionisti, që ndërmjetëson dhe ndërlihd marrëdhënien midis familjes/individit dhe avokatit për një problematikë me natyrë ligjore, mban kontakte të vazhdueshme me individët/familjet/komunitetin, si dhe mbledh informacion të nevojshëm dhe siguron dokumente që mund t’i shërbejnë avokatit në ndjekjen e çështjes.

Gjithashtu, paraligjori konsiderohet juristi, i cili asiston avokatin/këshilltarin ligjor. Paraligjori është një individ që punën e tij e ushtron në terren, orienton dhe përcjell problematikat e hasura të komunitetit pranë institucioneve përgjegjëse për të arritur zgjidhje ligjore të nevojshme. Paraligjori gjithashtu shihet si një urë lidhëse midis komunitetit dhe punës në zyrë.

Një paraligjor jo domosdoshmërisht duhet të jetë jurist apo të ketë formim apo arsim në drejtësi, por mund të jetë çdo person që ka aftësinë dhe dëshirën për të punuar me komunitetin, si dhe të jetë i motivuar për të rritur kapacitetet e tij nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për çështje ligjore dhe sociale.

Paraligjori është personi që bën organizimin komunitar në komunitetin e tij nëpërmjet njohurive ligjore. Sipas një paraligjori të intervistuar, mesazhi i paraligjorit duhet të jetë “Ne do ta zgjidhim problemin bashkë”.

Përfundim: Lidhur me paraligjorin, nga përgjigjet e mësipërme vëmë re koncepte të ndryshme, të cilat kanë të përbashkëtat dhe veçoritë e tyre. Të intervistuarit e konceptojnë paraligjorin si një

person që ofron ndihmë juridike, disa si ofrues të ndihmës juridike parësore e të tjerë si ndërmjetës ndërmjet qytetarit, komunitetit dhe avokatit apo juristit (i cili ka përfunduar studimet për drejtësi) dhe ofron ndihmë juridike kryesisht parësore në ndihmë të punës, që do të realizohet në vijimësi nga avokati. Paraligjori, gjithashtu shihet si një person që ndikon në fuqizimin e komuniteteve. Funksionet e një paraligjori shihen të lidhura ngushtësisht me detyrat e avokatit. Të intervistuarit e konsiderojnë një paraligjor si ndihmës avokat apo si personi që ndërlidh punën në komunitet dhe e sjell rastin te avokati, i cili është ai që do të jap zgjidhjen e duhur ligjore. Nga përgjigjet e dhëna vërejmë se paraligjori është një profesion i ngjashëm për nga funksionet me asistent avokatin me veçantinë e vetme se funksioni i tij ushtrohet pranë komunitetit dhe nevojave të tij.

2. Funksionet e paraligjorit

Organizatave, të cilat kanë pasur të punësuar paraligjorë në projekte të ndryshme i kanë mundësuar atyre role të ndryshme që lidhen me informimin e publikut për çështje të rëndësishme ligjore, kryesisht në rastin e kontratave konsumatore, ndihmës ekonomike, pensione, ndryshimit të akteve të gjendjes civile, si dhe raste të ngjashme. Gjithashtu, roli i tyre ka konsistuar edhe në identifikimin e rasteve që kanë pasur nevojë për ndihmë dytësore, si dhe të rasteve strategjike.

Paraligjorët kanë ofruar ndihmë ligjore parësore kryesisht familjeve të varfëra për problematika që lidhen me mbrojtjen e të drejtave social-ekonomike në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga institucionet publike. Një nga detyrat e paraligjorit ka konsistuar në organizimin e takimeve periodike me komunitetin për t'i informuar mbi rolin, funksionin, shërbimet që një paraligjor ofron. Gjithashtu, paraligjori ka identifikuar rastet në komunitet, afër vendbanimeve të familjeve të varfëra dhe ka dhënë informacion në lidhje me sistemin ligjor, legjislacionin, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, ka këshilluar familjet/individët për çështje administrative, ka mbledhur informacion të nevojshëm për trajtimin e rastit, ka hartuar dokumente të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën publike, si dhe ka shoqëruar dhe përfaqësuar familjet/individët përpara organeve administrative. Paraligjori ka pasur për detyrë të mbante kontakte të rregullta me komunitetin dhe të socializohej me të.

Roli i paraligjorit në projektet që një organizatë ka zbatuar ka qenë proaktiv pranë komunitetit, konkretisht duke shërbyer në ofrimin e ndihmës juridike për qytetarët, në funksion të edukimit ligjor, me fokus informimin për legjislacionin në fuqi si dhe ka asistuar për problematikat që qytetarët kanë hasur duke ndihmuar në mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm, draftimin e kërkesave, ankimeve lidhur me përfshirjen në skemën e ndihmës ekonomike dhe programet sociale të strehimit si dhe komunikimet me institucionet. Në rastet kur paraligjori ka hasur vështirësi me institucionet në referimin e problematikës pranë institucioneve përkatëse, ka konsultuar juristët e organizatës ose avokatët.

Për një organizatë tjetër, roli i paraligjorëve ka qenë i lidhur me identifikimin dhe adresimin e rasteve të familjeve rome dhe egjiptiane, të cilat kanë pasur mungesë akses në shëndetësi, arsim dhe strehim.

Një tjetër organizatë ka sqaruar se, shërbimet paralogjore kanë lindur si nevojë për t'iu përgjigjur kërkesave të shumta të individëve dhe grupeve të marginalizuara për t'u qasur në programet sociale të mbështetura nga shteti. Paralogjorët i ndihmojnë këto kategori të përdorin ligjin si mjet themelor për të përmirësuar situatën e tyre ekonomike dhe për t'i asistuar ata për t'u qasur në shërbimet sociale përkatëse. Këto kategori shpesh e kanë të pamundur të plotësojnë procedurat dhe kriteret e kërkuara administrative dhe nga ana tjetër e kanë të pamundur të marrin një avokat për arsye financiare, gjeografike apo dhe kulturore.

Praktika në një organizatë tjetër ka vërtetuar se paralogjor mund të jetë çdo person që ka përfunduar programet e ciklit të parë të studimeve (bachelor), programet e ciklit të dytë të studimeve (master) dhe që ka dëshirën të trajnohet për ofrimin e shërbimeve paralogjore.

Të intervistuarit kanë dhënë detaje të tjera në përgjigje të pyetjeve të pyetësorit, lidhur me detyrat, shërbimet apo funksionet e ushtruara nga paralogjorët. Për shembull, KL Durrës është përgjigjur se, paralogjorët e angazhuar pranë kësaj klinike kanë qenë dy kategori, studentë të programit të ciklit të dytë të studimeve (studentë master), si dhe të rinj pjesë e komuniteteve. Detyrat e tyre kanë qenë të përshtatura me shkollimin e tyre. Studentët e masterit në mënyrë periodike kanë zhvilluar takime me qytetarë pranë njësive administrative me qëllim prezantimin e veprimtarisë së KL, ofrimin e ndihmës ligjore parësore, si dhe identifikimin e rasteve, të cilat kishin nevojë për ndihmë dytësore. Gjithashtu, ata janë angazhuar edhe në hartimin e kërkesave dhe ankimeve pranë autoriteteve publike. Paralogjorët pjesë e komuniteteve, kanë pasur detyrë identifikimin e atyre rasteve, që kishin nevojë për ndihmë parësore dhe dytësore, referimin e tyre pranë KL, shoqërimin e qytetarëve pranë institucioneve publike, si dhe informimin e qytetarëve lidhur me ecurinë e rastit të tyre. Përzgjedhja e studentëve është bërë duke angazhuar studentët, të cilët kanë pasur rezultatet më të mira gjatë angazhimit të tyre disa muajor pranë KL.

Një tjetër organizatë në përgjigje të kësaj pyetje, ka listuar detyrat e paralogjorit, të cilat janë të përcaktuara në përshkrimin e punës edhe gjatë fazës së rekrutimit të tyre, si vijon:

- Interviston klientë, njihet me problemet e tyre, plotëson dokumentacionin dhe kërkesat e nevojshme për pranimin si klient;
- Ndihmon klientët për të mbledhur informacionin dhe dokumentet e nevojshme, për zgjidhjen e problemeve social-administrative, duke i udhëzuar dhe asistuar në rastet kur klientët nuk mundin t'i sigurojnë;
- Udhëzon klientët që kanë mundësi të hartojnë kërkesa dhe të përgatisin dokumente vetë;
- Harton kërkesa në emër të klientëve;
- Përfaqëson klientët për zgjidhjen e problemeve social-administrative dhe nëse është e nevojshme përfaqësimin e tyre në të gjitha nivelet e administratës shtetërore;
- Bashkëpunon me këshilltarin e programit (nga 4 paralogjorë ai që ka më shumë përvojë quhet këshilltar, i cili është përgjegjës për punën e tre paralogjorëve të tjerë për rastet që ndjekin si edhe për përzgjedhjen e rasteve që i përcillen avokatit);
- Shpjegon të drejtat ligjore për problemet sociale të grupeve të ndryshme në nevojë;

- Këshillon dhe aftëson grupe klientësh, si dhe individët pjesë e komuniteteve për t'u vetëpërfaqësuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- Merr pjesë në *street law* të organizuara nga organizata;
- Jep kontributin e nevojshëm në draftimin e historive të suksesit, për botim apo promovim;
- Përgatit raporte mujore progresive si edhe vjetore, si dhe plotëson dhe jep mendim për nevojën e mbulimit të shpenzimeve të klientit, ato noteriale, administrative apo tjetër.

Paraligjorët e intervistuar kanë sqaruar se, roli i tyre ka qenë organizimi komunitar dhe dhënia e informacioneve ligjore duke ofruar shërbime sociale në komunitetin ku jetojnë. Ata nuk kanë pasur një eksperiencë të mëparshme dhe fillimisht kanë trajtuar anën sociale të çështjeve, duke evidentuar edhe impaktin social të tyre. Më pas, me ndihmën edhe të avokatëve dhe të ndjekjes së trajnimeve të ndryshme, janë aftësuar më shumë edhe për trajtimin ligjor të çështjeve. Gjithashtu, një paraligjor tjetër ka theksuar edhe dallimet e këtij profesioni me aktivistin sipas të cilit ky i fundit nuk trajton probleme ligjore, ndërsa një paraligjor nuk përfshihet në organizimin e raporteve apo studimeve që janë me fokus ligjor, detyra këto të aktivistit.

Përfundim: *Sipas të intervistuarve rezulton se roli i paraligjorëve konsiston në ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe në edukimin ligjor apo ndërgjegjësimin e komuniteteve në nevojë për të drejtat e tyre. Detyrat e paraligjorëve janë shumë të ngjashme me ato të punonjësve me trajnim të posaçëm, të cilët janë të punësuar pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, me dallimin e vetëm që paraligjori ka një lidhje të ngushtë me komunitetin. Kjo lidhje e ngushtë është kryesisht me komunitetet vulnerabël për të cilët ofrojnë jo vetëm shërbime të ndihmës juridike parësore, por edhe informimin e tyre për të drejtat.*

3. Përzgjedhja e paraligjorëve për kryerjen e shërbimeve/detyrave

Paraligjorët janë përzgjedhur ndërmjet të rinjve aktivistë nga komuniteti, duke qenë shpesh edhe të angazhuar më herët në komunitet si anëtarë të besuar nga komuniteti, ose të angazhuar në organizata rinore. Këta persona kanë shprehur dëshirën për të kontribuar dhe ndihmuar familjet në nevojë dhe kanë pasur njohuri bazike për trajtimin e çështjeve ligjore. Një pjesë e të përzgjedhurve kanë formim juridik, por jo gjithmonë ka qenë e domosdoshme. Gjithashtu, ka edhe raste ku personat janë identifikuar në takime të ndryshme të organizuara nga vetë organizata, tek të cilët është vënë re potenciali dhe dëshira për të dhënë kontribut për arritjen e qëllimit të një nisme të caktuar.

Në rastin e një organizate tjetër, përzgjedhja e paraligjorëve është bërë me procedura rekrutimi si për të gjithë profesionet e tjera, sipas kërkesave përkatëse të përshkrimit të punës.

Përfundim: *Duke qenë se ky profesion i ushtruar nga disa paraligjorë nuk është i formalizuar, kryesisht përfshirja e tyre në projekte apo angazhimi si paraligjorë është krejtësisht rastësor, duke u përzgjedhur bazuar në rezultatet e mira në universitet, apo të rinj që kanë pasur dëshirë të*

advokojnë dhe janë përfshirë në organizatë dhe veprimtarinë e saj, ose të rinj që kanë pasur angazhime të mëparshme në komunitet.

4. Parashikimi dhe njohja në legjislacion

Të gjithë të intervistuarit janë dakordësuar lidhur me parashikimin dhe përfshirjen në Listën Kombëtare të Profesioneve të paraligjorit si një profesion i veçantë, ose dhënien e një statusi ligjor të këtij profesioni. Sipas tyre, paraligjori duhet të jetë profesion i veçantë, por i rregulluar me kujdes që të shmangen mbivendosjet me profesione të tjera, duke dhënë edhe argumentet përkatëse përse formalizimi i paraligjorit është i rëndësishëm. Ndër argumentet e dhëna kanë qenë si vijon:

Parashikimi dhe njohja e profesionit të paraligjorit në legjislacion është i rëndësishëm, sepse është një profesion që ekziston tashmë në praktikë dhe një punë që bëhet realisht, prandaj, do të formalizonte punën e bërë deri më tani nga paraligjorët.

Formalizimi i paraligjorit si profesion apo certifikimi i tyre si profesionistë të së drejtës do të mundësojë njohjen e tyre nga institucionet, subjektet private, OJF-të etj., duke ndryshuar qasjen e deritanishme kundrejt këtij profesioni të paformalizuar.

Gjithashtu, duke qenë se paraligjori është një profesion ende i panjohur për shumicën e shoqërisë shqiptare, njohja e tij do të mundësojë që komunitetet të kenë njohuri që të kërkojnë ndihmë tek paraligjori, e jo gjithmonë t'i drejtohen avokatit, apo institucioneve shtetërore apo atyre të drejtësisë.

Krijimi i një kuadri ligjor rregullator për paraligjorin do të ndikojë edhe në cilësinë e ofrimit të shërbimit nga këta profesionistë.

Një arsye tjetër është edhe qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e punës së paraligjorit përmes mbështetjes financiare nga shteti duke qenë se mbështetja e deritanishme e paraligjorëve është realizuar vetëm nga donatorët, e cila shpesh rrezikon dhe qëndrueshmërinë e këtij profesioni. Megjithatë, ka edhe organizata që konsiderojnë se, mbështetja e donatorëve në profesionin e paraligjorit duhet të vazhdojë pasi është vlerë e shtuar dhe kontribuon për të përmirësuar mekanizma të caktuara, që i vijnë në ndihmë të varfërve. Në çdo rast, edhe në këtë skemë mbetet i domosdoshëm edhe një lloj institucionalizimi i profilit të paraligjorit.

Të intervistuar të tjerë kanë evidentuar rolin e paraligjorit, detyrat dhe të mirat që do të sjellë parashikimi i një profesioni të tillë. Për shkak se paraligjori punon ngushtësisht me komunitetet, njohja e këtij profesioni do të ndihmonte komunitetin në adresimin, zgjidhjen e problematikave, krijimin e rasteve precedente, ndërjegjësimin e komunitetit, edukimin ligjor të tij, organizimin komunitar, parandalimin e abuzimeve ligjore ndaj një komuniteti të caktuar, motivimin e komunitetit për të rritur llogaridhënien ndaj pushtetit lokal dhe atij qendror. Parashikimi dhe njohja e profesionit të paraligjorit do të ndikonte gjithashtu në ndërmjetësimin

dhe ndërtimin e marrëdhënies dhe komunikimit efektiv midis komunitetit dhe institucioneve publike dhe komunitetit dhe avokatëve.

Gjithashtu, njohja e profesionit të paraligjorit është e domosdoshme, pasi detyrat/funksionet që ka, janë të ndryshme nga ato të profesioneve të tjera, prandaj duhet bërë dallimi i tij me aktivistin, asistentin, avokatin apo asistentin e avokatit. Më konkretisht, edhe pse disa paraligjorë njihen vetëm me emrin asistent avokat, në fakt paraligjorët nuk kanë të njëjtat funksione si një asistent avokat. Kjo pasi, si paraligjor mund të shërbejnë jo vetëm juristët, por edhe jo juristët, që në fakt e bëjnë këtë punë në mënyrë të pjesshme si pjesë të detyrave në struktura të ndryshme lokale, për shembull, punonjësit socialë, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, psikologët etj. Gjithashtu, paraligjori duke qenë se mbledh dokumentacion, harton kërkesa, ankesa, ndjek rastin në institucionin përkatës, dhe kur është rasti ngre edhe padi në gjykatë, mund të ngatërrohet me profesionin e juristit. Por, paraligjori ndryshe nga juristi është më afër me rastin dhe individin, ndërkohë që një jurist dhe avokati ndjekin procedurën ligjore, shpesh duke harruar pjesën njerëzore.

Gjithashtu, duke pasur parasysh rolin e paraligjorit, i cili lehtëson punën e institucioneve, KL-të, apo qendrat që ofrojnë ndihmë ligjore falas, njohja e këtij profesioni do të sillte edhe reduktim të kostove të proceseve gjyqësore dhe do të ndikonte edhe te mbingarkesa e tyre.

***Përfundim:** Sipas eksperiencës së të intervistuarve, në mënyrë të përmbledhur evidentohet se, parashikimi dhe njohja në legjislacion e profesionit të paraligjorit është e domosdoshme për të rritur cilësinë e ofrimit të shërbimit të tyre, qëndrueshmërinë e këtij profesioni, njohjen e tij nga aktorë të ndryshëm, evidentimin e funksioneve të tij nga profesione të tjera, reduktimin e kostove gjyqësore etj.*

5. Specifikat lidhur me institucionalizimin e paraligjorit

Lidhur me institucionalizimin e paraligjorit në kontekstin shqiptar, të intervistuarit na kanë sqaruar se, paraligjori duhet të jetë i parashikuar në mënyrë të përgjithshme dhe jo specifike, për t'i dhënë mundësinë edhe personave me arsim të ndryshëm universitar të fushave të shkencave shoqërore që pas kryerjes së një trajnimit përkatës të ushtrojnë profesionin e paraligjorit. Nëse paraligjori institucionalizohet në vendin tonë, duhet pasur parasysh që është një koncept i ri dhe si i tillë do të ketë vështirësi në kuptueshmërinë e tij.

Në rast të institucionalizimit të profesionit të paraligjorit, sipas të intervistuarve duhet që roli dhe detyrat e tij të jenë njësoj siç ka funksionuar deri tani duke parashikuar edhe ofrimin e shërbimeve në komunitetet e marginalizuara etj. Gjithashtu, duhet të përcaktohet mirë në ligj roli dhe përgjegjësitë që duhet të ketë paraligjori për të bërë diferencën me asistentin, aktivistin dhe profesionet e tjera të ngjashme me të, pasi paraligjori është një urë lidhëse ndërmjet komunitetit dhe punës së zyrës, ndryshe nga profesionet e tjera.

Përfundim: Të gjithë të intervistuarit janë dakordësuar lidhur me parashikimin e paraligjorit si një profesion i veçantë në listën kombëtare të profesioneve, ose dhënien e një statusi ligjor profesionit të paraligjorit, por duke mbajtur në konsideratë që ky profesion të ketë detyra të mirëpërcaktuara me qëllim që mos të ketë mbivendosje me profesione të tjera.

6. Roli dhe detyrat e paraligjorit në rast të institucionalizimit të tij

Organizatrat kanë sugjeruar që roli dhe detyrat e paraligjorit të konsistojë në fushën ligjore dhe atë sociale, konkretisht:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor i qytetarëve.
2. Ndërmarrja e nismave ndërgjegjësuese në komunitetet që punojnë duke ofruar informacione të domosdoshme për të orientuar dhe aftësuar qytetarët në nevojë, për adresimin e problemeve të tyre ligjore dhe sociale.
3. Komunikimi me qytetarët e interesuar dhe organizatat komunitare për të garantuar akses në shërbime ligjore dhe sociale.
4. Organizatori komunitar, i cili transferon njohuri ligjore tek komuniteti dhe që bashkë me to advokojnë për të zgjidhur problemet.
5. Lehtësimi i komunikimit të anëtarëve të zonës ku ai jeton, me institucionet.
6. Informimi për ndihmën juridike pa pagesë.
7. Identifikimi i problemeve ligjore që pengojnë aksesin.
8. Orientimi i duhur i qytetarëve për rrugët ligjore që duhet të ndjekin për zgjidhjen e problemit apo mosmarrëveshjes; ofrimi i asistencës së drejtpërdrejtë; shpjegimi me fjalë të thjeshta i procedurës administrative apo ligjore.
9. Mbledhja e dokumentacionit të nevojshëm për trajtimin e rastit konkret të paraqitur; intervistimi i personave të përfshirë; studimi i legjislacionit vendas dhe atij ndërkombëtar; hartimi i raportit/memos konkrete ku reflektohen pengesat dhe zgjidhjet optimale për trajtimin e ankesës së referuar; mirëmbajtja e dosjeve me të dhënat përkatëse.
10. Hartimi i shkresave për të mbrojtur çështje të ndryshme administrative lidhur me ofrimin e ndihmës ligjore parësore, në raste të thjeshta ligjore, apo për procedura standarde; hartimi i ankesave kundrejt institucioneve shtetërore dhe të pavarura.
11. Referimi i çështjes pranë institucioneve përgjegjëse për zgjidhjen e tyre; përfaqësimi i personit në nivele të ndryshme të administratës, për raste të veçanta; realizimi i ndërhyrjeve të ndryshme institucionale;
12. Identifikimi nëse një çështje duhet ndjekur edhe gjyqësisht, referimi i saj tek avokati; asistenca për avokatin në identifikimin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm; përpilimi i dokumenteve paraprakë për të asistuar avokatin; bashkëpunimi reciprok në grup me avokatin/këshilltarin ligjor.
13. Kur është nevoja për ndihmë më të specializuar, referimi i rasteve pranë zyrave të ndihmës ligjore pa pagesë, apo ofrimin e ndihmës juridike dytësore;

14. Në aspektin social paraligjori luan rolin e menaxhuesit optimal të stresit të qytetarit, përbalimin emocional dhe referimin e zgjidhjeve të duhura qytetarit me qëllim përbalimin e situatës së mëtejshme ligjore.
15. Ndërmjetësimi apo zgjidhja me pajtim e konflikteve dhe prirja për aftësi bashkëpunuese me autoritetet lokale apo organe shtetërore në interes të përfituesve vulnerabël.

Lidhur me rolin dhe funksionet e paraligjorit, të intervistuar të tjerë janë dakordësuar sikurse më sipër se, paraligjori duhet të përfshihet në ofrimin e ndihmës juridike parësore nëpërmjet ofrimit të informacionit dhe këshillimit ligjor si dhe duke mbajtur marrëdhënie të drejtëpërdrejta e të ngushtë me komunitetin. Ai kryen detyra që kërkojnë njohuri të ligjit dhe procedurave ligjore. Sa i përket përfaqësimit, paraligjori i cili nuk ka një edukim ligjor të certifikuar, duhet të jetë gjithmonë nën mbikëqyrjen e avokatit/juristit, duke kryer punë juridike të deleguara posaçërisht, për të cilat përgjegjës është avokati. Gjithashtu, paraligjorët që nuk kanë arsim juridik nuk mund të përfaqësojnë klientin në gjykatë, ata duhet të trajnohen që të ndihmojnë avokatin në fazën parapërgatitore të procesit gjyqësor.

Përfundim: Edhe nga sugjerimet e mësipërme vëmë re se, detyrat e paraligjorit janë të lidhura ngushtësisht me ofruesin e ndihmës juridike parësore, edukimin e qytetarëve për të drejtat e tyre, si dhe marrëdhëniet e drejtëpërdrejta me komunitetin.

7. Roli i paraligjorit si ofrues i ndihmës juridike parësore

Sikurse rezultoi edhe më sipër, të gjithë të intervistuarit janë dakordësuar dhe e shohin rolin e paraligjorit si ofrues të ndihmës juridike parësore, pasi gjithë eksperiencat aktuale disave prej tyre paraligjorët ka ngjashmëri me funksionet e ofruesve të ndihmës juridike parësore. Një nga organizatat e intervistuarat ka përcjellë në mënyrë skematike strukturën e saj, ku janë përfshirë edhe paraligjorët si ofrues të ndihmës juridike parësore (bashkëlidhur në aneksin nr. 4 të këtij studimi). Me këtë strukturë organizative, kjo organizatë ofron shërbime ligjore të drejtëpërdrejta për rreth 1500 individë, nga të cilët 1100-1200 raste janë mbështetur me shërbime paraligjore dhe rreth 300 raste përfaqësohen në gjykatë. Sipas kësaj organizate, ndihma parësore është themelore në rritjen e aksesit në drejtësi dhe është më pak e kushtueshme për organizatën krahasuar me avokatët.

Përfundim: Të intervistuarit janë dakordësuar sërish se, paraligjori mund të ofrojë ndihmë juridike parësore, por e veçanta e këtij profesioni është marrëdhënia e ngushtë dhe roli i tij si ndërmjetës ndërmjet komunitetit dhe avokatit, institucionit shtetëror etj. Gjithashtu, është evidentuar rëndësia e këtij profesionisti për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve.

8. Punësimi i paraligjorit si pjesë e ndihmës juridike, pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe nga klinikat ligjore të themeluara pranë institucioneve të arsimit të lartë

Lidhur me punësimin e paraligjorëve, të intervistuarit kanë pasur mendime të ndryshme. Një pjesë janë dakord që paraligjorët mund të angazhohen në të gjitha institucionet e mësipërme: pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pranë organizatave jofitimprurëse, si dhe pranë klinikave ligjore të themeluara pranë institucioneve të arsimit të lartë. Në rastin e punësimit të tyre në OJF, por jo vetëm, trajnimi i tyre duhet të ketë një fokus specifik, sipas fushës së veprimtarisë që ushtron secila organizatë, për shembull: dhuna në familje, diskriminimi, të drejtat e konsumatorit etj., pra të kryhet një profilizim/specializim i paraligjorëve. Në çdo rast, paraligjorët të punësohen sipas një përzgjedhje të drejtë dhe procesi transparent, dhe punësimi i tyre të jetë me kohë të plotë.

Ka pasur mendime ndryshe, ku është sugjeruar që, paraligjorët mund të punësohen vetëm pranë OJF-ve. Përfundimi i mundësisë së punësimit pranë klinikave të ligjit konsiston në faktin se, klinikat e ligjit kanë në fokus trajnimin e mëtejshëm apo ofrimin e njohurive të posaçme nëpërmjet parashikimit të klinikës së ligjit si modul arsimor të studentëve të fakulteteve të drejtësisë dhe paraligjorët nuk bëjnë pjesë në këtë kategori.

Edhe punësimi i paraligjorëve në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, nuk vlerësohet i përshtatshëm, sepse do të krijonte mbivendosje, për shkak se legjislacioni ka parashikuar një terminologji të posaçme për funksionarët e punësuar në to, “punonjës me trajnim të posaçëm”. Një arsye tjetër e dhënë është edhe fakti se këto qendra janë pranë institucioneve shtetërore/Ministritë së Drejtësisë. Por ka edhe mendim ndryshe, ku një nga paraligjorët, ka sqaruar se, paraligjorët mund të punësohen pranë institucioneve shtetërore, sidomos në zyrat që ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore, pasi në këtë mënyrë do të vendoset një lidhje e institucioneve shtetërore me komunitetin. Duke pasur një paraligjor brenda strukturës së tyre, do ta kenë edhe më të lehtë për të marrë informacionin nga komuniteti si dhe të kenë të dhëna edhe më të sakta të mbledhura nga komuniteti. Me vendosjen e paraligjorëve në këto struktura, roli i paraligjorit mund ta zbusë marrëdhënien midis institucionit dhe individit, apo dhe komunitetit që ka nevojë për ndihmë juridike.

Gjithashtu, në mbështetje të argumentit se, paraligjorët mund të punojnë në struktura shtetërore, një organizatë ka shprehur mendimin se, në zonat e largëta ku institucionet shtetërore e kanë të vështirë të qasen ndaj komuniteteve për shkak edhe të natyrës së shërbimit që ofrohet në zyrë, OJF-të mund të ndihmojnë komunitetet, të cilët jetojnë në zonat më të largëta ku aksesit tek institucionet shtetërore është edhe më i vështirë. Pra, me vendosjen e paraligjorëve në organizata në një zonë të caktuar, apo shpërndarjen e tyre sipas zonave të ndryshme gjeografike, do të rritet edhe numri i përfituesve në zonat e largëta, ku aksesit në institucionet shtetërore mbetet i vështirë. Ky lloj sistemi do të ndihmojë paraligjorin në ndërtimin e marrëdhënies së afërt me familjet përfituese të këtij shërbimi.

Lidhur me mënyrën e organizimit të punës së paralogjorit, është sugjeruar nga një i intervistuar, që punësimi i paralogjorit të jetë 4 orë pune në zyrë, e cila ndihmon për të kryer punët administrative dhe ndjekjen e rasteve, ndërkohë që do të ishte e rëndësishme që pjesa tjetër e ditës të kombinohej me punë në terren, me qëllim identifikimin e rasteve apo çështjeve që kanë nevojë për ofrimin e ndihmës juridike. Nëpërmjet këtij procesi, paralogjori mund të arrijë të fuqizojë edhe familjen që është duke i ofruar shërbimin ligjor, pasi dhe investimi i tyre do të ishte shume herë më efikas dhe i qëndrueshëm.

Përfundim: Lidhur me punësimin e paralogjorëve, të intervistuarit kanë pasur mendime të ndryshme. Një pjesë janë dakord që paralogjorët mund të punësohen pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pranë organizatave jofitimprurëse, si dhe pranë klinikave ligjore të themeluara pranë institucioneve të arsimit të lartë. Të tjerë të intervistuar konsiderojnë se, paralogjorët duhet të punësohen vetëm pranë OJF-ve. Gjithashtu, është vlerësuar nga një pjesë e të intervistuarve se, punësimi i paralogjorëve në institucione shtetërore do të ndihmojë qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve ligjore falas, ndërsa disa të tjerë nuk kanë qenë dakord për punësimin e tyre pranë institucioneve shtetërore.

9. Punësimi i paralogjorëve në zyra avokatie

Lidhur me punësimin e paralogjorëve në zyra avokatie me anë të punës *pro bono*, të intervistuarit kanë ndarë mendime të ndryshme. Sipas tyre, do të përbënte interes punësimi i paralogjorëve në zyra avokatie me anë të punës *pro bono*, por me qëllim që kjo t'i shërbejë ose trajnimit ose certifikimit të tyre, pra si një formë njohje kreditesh profesionale. Në një rast tjetër, me rëndësi shihet punësimi i tyre në zyra avokatie, por kjo në varësi të funksionit të fushës së veprimtarisë së zyrave të avokatisë. Nëse zyrat kanë kontakte të shpeshta me njerëzit, atëherë roli i paralogjorit është i nevojshëm dhe i rëndësishëm. Nëse zyrat e avokatisë nuk kanë kontakt të vazhdueshëm me klientë, sepse mund të bëjnë përfaqësimin e klientit me anë të një prokure, atëherë punën e paralogjorit e zëvendëson asistenti.

Ka dhe mendime të tjera sipas të cilave, paralogjorët në kontekstin shqiptar të zyrave të avokatisë nuk janë të përshtatshëm si profesion. Vlerësohet se profesion i përshtatshëm për t'u angazhuar pranë zyrave të avokatisë është një asistent ligjor, i cili fitohet pas studimeve universitare dyvjeçare, dhe jo një paralogjor. Argument tjetër është edhe fakti se paralogjori është një urë lidhëse midis problemeve ligjore të komunitetit dhe avokatëve, apo dhe institucioneve publike, që kanë mundësinë ta zgjidhin këtë problem. Një arsye tjetër është edhe që shërbimi i ofruar nga paralogjori nuk mund të kryhet *pro bono*, por një shërbim që duhet të paguhet.

Përfundim: Lidhur me punësimin e paralogjorëve në zyra avokatie me anë të punës *pro bono*, të intervistuarit kanë ndarë mendime të ndryshme, të cilët në disa raste e konsiderojnë të nevojshme dhe të rëndësishme punën e paralogjorit edhe në zyra avokatie, apo që ky punësim t'i shërbejë trajnimit ose certifikimit të tyre, pra si një formë njohje kreditesh profesionale. Disa të tjerë mendojnë se puna e paralogjorit është e tepërt, pasi funksionet e tij i ushtron asistent avokati.

10. Punësimi i paraligjorit në institucione shtetërore

Lidhur me punësimin e paraligjorit në institucione shtetërore, në përgjigje të pyetjeve të pyetësorit, të intervistuarit kanë argumentuar arsyet se pse paraligjorët duhet të punojnë në institucione shtetërore, si (a) domosdoshmëria e kontaktit të institucioneve shtetërore me njerëzit për të kuptuar nevojat e tyre, (b) të cilat më pas duhet të kthehen në politika për rritjen e aksesit për të gjitha kategoritë. Një paraligjore e intervistuar, e cila i përket komunitetit egjiptian, është shprehur se, paraligjori duhet të përfshihet në struktura shtetërore, për t'i dhënë një status të posaçëm këtij profesioni. Sipas saj, nëse një paraligjor punon brenda një strukture të posaçme shtetërore, qasja ndaj tij do të jetë e ndryshme nga qasja që i bëhet një personi që thjesht prezantohet si aktivist.

Por ka pasur edhe mendime ndryshe, sipas të cilëve punësimi i paraligjorëve nuk konsiderohet i përshtatshëm në struktura/institucione shtetërore, për shkak se paraligjori ka funksion në krijimin e sinergjive dhe bashkëpunimit me aktorët institucionalë, por kurrsesi nuk mund të garantojë llogaridhënien dhe transparencën nëse është i përfshirë në këtë mekanizëm. Gjithashtu, një paraligjor i punësuar në institucione shtetërore, nuk mund të jetë në mbështetje të anëtarëve që ka marrë përsipër të ndihmojë, pasi dikush që punësohet në institucione shtetërore nuk mund të kundërshtojë institucionin për shkak të konfliktit të interesit. Ndërsa, një organizatë tjetër vlerëson se, paraligjorët nuk mund të punojnë në institucione shtetërore, por mund të punojnë në bashkëpunim me këto institucione për gjetjen e zgjidhjes më të arsyeshme dhe optimale për situatën konkrete.

Në çdo rast, sa i përket punësimit të paraligjorëve në struktura/institucione shtetërore, paraligjorët duhet të jenë persona të pavarur dhe të pandikuar politikisht, kjo për arsye për të shmangur konfliktet e interesit në ushtrimin e detyrës së tyre.

Lidhur me fushat e punësimit të paraligjorëve në institucione shtetërore, të intervistuarit kanë sugjeruar se, paraligjori mund të përfshihet në ofrimin e shërbimeve sociale si, strehimi, punësimi, shëndetësia, zyrat e punës, formimi profesional etj. Është sugjeruar punësimi i paraligjorëve edhe në fushën ligjore.

Lidhur me pyetjen se pranë cilit autoritet shtetëror mund të punësohen paraligjorët, të intervistuarit kanë sugjeruar një sërë institucionesh shtetërore për punësimin e paraligjorëve si, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike; njësitë administrative dhe bashkitë (të cilat organizatat i kanë vlerësuar si punësimin më të mirë dhe që mund të zbatojnë më lehtë një program paraligjorësh), ku punonjës të veçantë mund të trajnohen e të kryejnë detyrat e paraligjorit, i cili do të orientojë qytetarët për të gjetur zgjidhje të problemeve të tyre; punësimi në qendrat e shërbimit shëndetësor; institucionet e qeverisjes lokale (në drejtoritë e varësisë ku kontakti me publikun është më i madh dhe nevoja për ndërgjegjësim si dhe ndihmë konkrete për zgjidhjen e problemeve është më e lartë); Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes Sociale; Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Lidhur me trajnimin e paralogjorëve që punojnë në institucione shtetërore, të intervistuarit kanë sugjeruar që trajnimi i paralogjorëve është i nevojshëm, por duhet të jetë specifik për secilin sektor në të cilin ata angazhohen. Trajnimi duhet të zhvillohet nga qendra të specializuara pranë universiteteve, apo OJF-ve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë. Nga një prej të intervistuarve nuk vlerësohet efektive, që paralogjorët e angazhuar në shtet të trajnohen nga struktura shtetërore, dhe ata që angazhohen në privat, të trajnohen nga struktura private.

Lidhur me funksionet që mund të ketë një paralogjor në institucionet shtetërore, është sugjeruar përfshirja e tij në rolin e specialistit dhe ndërmjetësuesit të komunitetit me institucionin dhe si lehtësues i shërbimeve në varësi të institucionit ku ata do të ofrojnë shërbim.

Përfundim: *Disa të intervistuar janë dakordësuar se paralogjorët duhet të punojnë në institucione shtetërore, pasi kontakti i drejtpërdrejtë do të ndihmojë që nevojat e komuniteteve të adresohen në institucionet përgjegjëse, e më tej në nivel politikash për përmirësimin e aksesit të tyre në drejtësi. Përfshirja e paralogjorit në institucione shtetërore do të formalizojë rolin dhe statusin e tij të posaçëm. Një mendim ndryshe lidhur me punësimin e tyre është se, paralogjorët nuk mund të punojnë në institucione shtetërore, për shkak të konfliktit të interesit që mund të kenë, por mund të punojnë në bashkëpunim me këto institucione për gjetjen e zgjidhjes më të arsyeshme dhe optimale për situatën konkrete.*

11. Përfshirja e paralogjorëve në komunitet si punonjës të OJF-ve, fushat e angazhimit dhe llojet e komuniteteve

Disa të intervistuar sikurse u sqarua edhe më sipër, e shohin paralogjorin dhe rolin e tij të lidhur ngushtësisht me punën në komunitet. Një ndër dallimet kryesore midis ndihmës avokatit, apo asistentit ligjor dhe paralogjorit është pikërisht pozicionimi i tij pranë komunitetit. Puna parësore e paralogjorit duhet të jetë përfshirja në komunitet dhe marrëdhënia e ngushtë me të, për të kuptuar nevojat dhe specifikat që ka komuniteti. Përfshirja e paralogjorit në komunitete është shumë e rëndësishme, pasi forcon komunitetin dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë. Gjithashtu, puna e paralogjorit është e lidhur me zhvillimin e aktivizmit komunitar, pasi shpesh herë çështjet strategjike kanë nevojë edhe për mënyra të tjera të ligjshme të trajtimit të tyre, krahas asaj ligjore, si për shembull protesta, konsultime, apo forma të tjera të advokimit dhe aktivizmit. Angazhimi dhe përfshirja e paralogjorit në punë komunitare dhe aktivitete që i shërbejnë dhe fuqizojnë komunitetin do të ndikonte në rritjen e performancës dhe produktivitetit të punës së tij. Paralogjori duhet të shërbejë si një aktivist i thjeshtë dhe njëkohësisht të ndërthur detyrat e tij me punën komunitare sipas fushës së veprimtarisë së organizatës. Nga të intervistuarit vlerësohet punësimi i paralogjorit në organizata jofitimprurëse me fokuse të ndryshme veprimtarie.

Lidhur me komunitetet me të cilat mund të përfshihet një paralogjor dhe pyetjes nëse një paralogjor mund të punojë edhe me komunitete të tjera, të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në ligjin

për ndihmën e garantuar nga shteti (nenet 11 dhe 12 të ligjit), të intervistuarit janë shprehur se, paralogjorët mund të punojnë me komunitete të ndryshme dhe me çdo grup të marginalizuar sa kohë që këto grupe/komunitete kanë nevojë për ndihmë si, për shembull personat HIV/AIDS, komunitetet minoritare, qytetarët në zona rurale, qytetarët që ndodhen në kushtet e kufizimit të lirisë etj. dhe me çdokënd që ka nevojë për këshillime të ndryshme. Pra, paralogjori mund të punojë me të gjitha kategoritë e parashikuara në nenin 11 të ligjit nr.111/2017, si edhe me kategori të tjera/ të veçanta, si për shembull kategoritë e parashikuara në ligjin për punësimin. Në tërësi aksesit i qytetarëve tek shërbimet e paralogjorit duhet të jetë shumë më i thjeshtë dhe të mos ketë kritere formale, krahasuar me kushtet e përfitimit të ndihmës ligjore sipas kushteve të ligjit 111/2017.

Lidhur me faktin nëse paralogjori mund të jetë pjesë e vetë komuniteteve, të tilla si romët dhe egjiptianët etj., të intervistuarit janë shprehur se, paralogjori mund të përzgjidhet anëtar i vetë komuniteteve, pasi njih problematikat dhe natyrën e tyre; njih kontekstin social, ekonomik, shoqëror etj; si pjesë e komunitetit mbron me çdo kusht çështjen për ta përcjellë kauzën si duhet; komunikon me lehtësi me komunitetin. Si pjesë e komunitetit egjiptian, një paralogjore është shprehur në favor të përfshirjes së anëtarëve të komunitetit, duke qenë se profesioni i paralogjorit të jep mundësinë që të kesh qasje tek institucionet, të jep mundësinë të trajnohesh, të ndihmohesh jo vetëm komunitetin tënd, por edhe personat që kanë nevojë për ndihmë juridike. Duke qenë pjesë e komunitetit dhe njëkohësisht paralogjor, ky profesionist është më i përgjegjshëm për të adresuar problemet e komunitetit te institucionet. Megjithatë, edhe paralogjorët jashtë komunitetit paraqesin rëndësi punësimi, pasi mund të vlerësojnë realitetin më nga afër nga një këndvështrim tjetër. Në këtë mënyrë, forcohet marrëdhënia e komunitetit me pjesën tjetër të shoqërisë, sepse minoriteti e ka më të vështirë të përshtatet duke qenë se përballet shpesh herë edhe me paragjykimet. Kombinimi i punësimit të paralogjorëve pjesëtarë ose jo të komunitetit, do të ndikojë në forcimin e kësaj marrëdhënie.

Lidhur me faktin nëse anëtarët e komuniteteve të marginalizuara mund të kenë interes për t'u bërë paralogjorë, elementë të ndryshëm ndikues të sugjeruar kanë qenë ofrimi i një trajnimi profesional; bursat e ndryshme; kryerja e praktikave pranë ofruesve të ndihmës juridike parësore; ndjekja e studimeve nga paralogjorët e komuniteteve të marginalizuara; pagesa; dieta; një kontratë shërbimi jo me orar pune fiks, që do ju mundësonte edhe angazhimin në punë apo veprimtari të tjera; zhvillimi i praktikave sipas kurrikulave mësimore.

Përfundim: Duke qenë se të intervistuarit e shohin punën e paralogjorit të lidhur ngushtë me komunitetin, kanë vlerësuar se ata mund të punësohen pranë OJF-ve në shërbim të grupeve të ndryshme të marginalizuara, si ato të parashikuara në ligjin nr. 111/2017, dhe jo vetëm. Paralogjorët e intervistuar vlerësojnë se, ata mund të punësohen në OJF, që punojnë me grupet vulnerabël pjesë e të cilëve janë edhe ata vetë, si komunitetet rom e egjiptian, por nuk përjashtohet edhe punësimi i paralogjorëve, që nuk janë pjesë e komuniteteve të marginalizuara.

12. Financimi i paralogjorëve

Lidhur me financimin e paralogjorëve, të intervistuarit janë përgjigjur se kjo mund të realizohet me të gjitha mundësitë e parashtruara në pyetësor, nëpërmjet një alokimi të veçantë në buxhetin e shtetit, apo forma të tjera nëpërmjet granteve/fondeve të OJF-ve dhe klinikave të ligjit etj. Forma më e preferuar e sugjeruar është ajo nëpërmjet alokimit të një zëri të veçantë në buxhetin e shtetit për paralogjorët që ofrojnë ndihmë juridike parësore. Kjo formë financimi i jep më shumë garanci dhe mbrojtje profesionit të paralogjorit dhe e bën më të qëndrueshëm si profesion. Nëse financimi realizohet vetëm në kuadër të donatorëve, funksionimi i paralogjorit rrezikohet, pasi mund të ndodhë që mos të ketë më donatorë, ose OJF-të mos të kenë mundësi financimi. Megjithatë, mbështetja e donatorëve nuk përjashtohet, me qëllim që financimi nga ana e shtetit të mbështetet më tej edhe me burime alternative financimi. Mbështetja e donatorëve mund të ndihmojë për të zhvilluar kapacitetin e paralogjorëve në sajë të dinamikave dhe zhvillimeve që mund të pësojë roli i paralogjorëve në të ardhmen e afërt. Gjithashtu, në rastet e OJF-ve është sugjeruar që, paralogjorët të trajtohen financiarisht me qëllim krijimin e qëndrueshmërisë deri në formalizimin e këtij profesioni. Të intervistuar të tjerë edhe pse ishin në favor të financimit nga shteti, mbeteshin skeptikë lidhur me mundësinë e funksionimit të një skeme të tillë. Gjithashtu, një shqetësim u ngrit edhe për mënyrën e funksionimit të kësaj skeme, më konkretisht, nëse do të ekzistonte një fond i veçantë që do t'i shpërndahej OJF-ve, apo do të kishte mënyra të tjera funksionimi.

Përfundim: Lidhur me financimin e paralogjorëve, të intervistuarit janë dakordësuar se mund të realizohet me të gjitha mundësitë e parashtruara në pyetësor, konkretisht, nëpërmjet një alokimi të veçantë në buxhetin e shtetit, nëpërmjet granteve/fondeve të OJF-ve dhe klinikave të ligjit etj., duke sugjeruar si më të përshtatshme formën e financimit që realizohet nëpërmjet alokimit të një zëri të veçantë në buxhetin e shtetit pasi sjell më shumë garanci e mbrojtje dhe e bën më të qëndrueshëm profesionin e paralogjorit.

13. Kriteret për të ushtruar funksionin e paralogjorit

Lidhur me kriteret për të ushtruar profesionin e paralogjorit nga ana e të intervistuarve janë parashtruar opsione të ndryshme, të tilla si:

1. të mos kenë arsim universitar juridik, shoqëruar me trajnim të posaçëm;
2. studime universitare një ose dyvjeçare;
3. persona që nuk kanë arsim universitar;
4. një person i pajisur me diplomë bachelor në drejtësi;
5. çdo person që ka përfunduar studime në drejtësi, nëse pranon ta ushtrojë si profesion;

Nga intervista e një paralogjoreje është sugjeruar ndjekja e një shkolle për një periudhë njëvjeçare, ose për një kohëzgjatje tjetër, si dhe specializimi i paralogjorit në disa fusha, dhe jo në një fushë specifike. Konkretisht, sipas saj është me rëndësi që paralogjorët të ndjekin një shkollë me specializim të përgjithshëm ose të posaçëm. Për shembull, nëse do të mundësohet pasja e një sistemi shkolle trevjeçar, në vitin e parë të mund të studiohen lëndë të përgjithshme dhe vitin e

dytë dhe të tretë lëndë më specifike, ose të mundësohet praktika në ofrimin e shërbimeve në komunitet. Në rastin e specializimit: për shembull, një paralogjor i përgjithshëm duhet të studiojë lëndë të përgjithshme, ku të përfshihen si lëndë studimi të gjitha fushat si puna sociale, puna në komunitet etj. Ndërsa, nëse paralogjori zgjedh të jetë një paralogjor komunitar, fokusi i studimit që nga viti i parë deri në vitin e tretë duhet të jetë paralogjori komunitar. Ky lloj studimi është sugjeruar të jetë në formën e një shkolle, por për ndjekjen e saj jo domosdoshmërisht personiduhet të ketë përfunduar studimet bachelor, por të përcaktohen kushte të tjera.

Në përgjithësi, të intervistuarit kanë vlerësuar rëndësinë e përfundimit të studimeve universitare për të ushtruar funksionet e paralogjorit, pasi pasja e njohurive juridike apo sociale ndihmon efektivisht komunitetin. Megjithatë, ka pasur mendime se, një diplomë universitare nuk është e domosdoshme, pasi edhe një trajnim i posaçëm/kualifikim profesional/specializim ndihmon në aftësimin e paralogjorit për informimin e komunitetit në mënyrë efektive si dhe për adresimin e problematikave të komunitetit në institucionet përgjegjëse. Një i intervistuar ka shtuar se, një kurs ose specializim një ose dyvjeçar është i mjaftueshëm për mos të kufizuar personat e tjerë, që nuk kanë përfunduar arsimin e lartë në ushtrimin e këtij profesioni. Gjithashtu, ndjekja e një kursi një ose dyvjeçar, mundëson marrjen e informacionit bazë për paralogjorin, dhe më pas me ndjekjen e kurseve të tjera paralogjori mund të specializohet në fusha të ndryshme. Nga eksperiencia e këtij të intervistuari ka rezultuar se, ka pasur aktivistë dhe bashkëpunëtorë që nuk kanë përfunduar arsimin e lartë, por pavarësisht kësaj, kanë pasur vullnetin e duhur për të ndjekur dhe çuar përpara çështje të rëndësishme.

Lidhur me kriteret për përzgjedhjen e paralogjorëve janë sugjeruar si vijon: eksperiencia profesionale e paralogjorit; puna dhe eksperiencia e tij e hershme në komunitet dhe eksperiencat e mëparshme; cilësia e ofrimit të shërbimeve të ndryshme profesionale; cilësitë personale dhe aftësia për analizë objektive dhe gjithëpërfshirëse; reflektimi i një qasjeje bashkëpunuese dhe advokuese me institucionet shtetërore. Në këtë kuadër, një i intervistuar ka konsideruar të përzgjidhen paraprakisht persona, të cilët plotësojnë disa kriteret paraprake dhe më pas personi të përzgjidhet nëpërmjet votimit të banorëve të zonës ku do të shërbejë. Një tjetër i intervistuar është shprehur se, përzgjedhja mund të kalojë nëpërmjet një procesi me disa faza, më konkretisht: Faza e parë ajo e identifikimit të personave që janë të ndjeshëm ndaj problemeve të komunitetit dhe kanë vullnet për të ndryshuar situatën e komunitetit ku ai/ajo jeton. Faza e dytë, ajo e trajnimit në fusha të caktuara. Faza e tretë, nëpërmjet këtij procesi lind natyrshëm lidhësi me bazë komunitare.

Përfundim: *Në përgjithësi, të intervistuarit kanë vlerësuar rëndësinë e përfundimit të studimeve universitare për të ushtruar funksionet e paralogjorit, pasi pasja e njohurive juridike apo sociale ndihmon efektivisht komunitetin. Megjithatë, ka pasur mendime se, një diplomë universitare nuk është e domosdoshme, por edhe një trajnim i posaçëm/kualifikim profesional/specializim është i mjaftueshëm për të ndihmuar në aftësimin e duhur të paralogjorit për ushtrimin e detyrave të tij.*

14. Trajnimet fillestare dhe të vazhdueshme të paralogjorëve si dhe përmbajtja e kurrikulave

Lidhur me trajnimet, të intervistuarit kanë sugjeruar që të zhvillohen trajnime fillestare dhe vazhduese si për çdo profesion tjetër, si dhe një cikël trajnimesh në formën e kualifikimeve profesionale. Trajnimet/kurset fillestare vlerësohen shumë të domosdoshme pasi puna e paraligjorit është po aq e rëndësishme sa e një avokati në realizimin e detyrave kryesore të ngarkuara. Gjithashtu, paraligjorët duhet të trajnohen në vazhdimësi dhe në mënyrë periodike. Në përfundim të trajnimit, apo programit të formimit/kualifikimit, personat duhet të pajisen me certifikatën përkatëse që provon njohuritë e fituara. Certifikimi në formën e një provimi standard shtetëror ka pasur raste që është parë si i tepërt.

Forma më e përshtatshme e trajnimit, krahas trajnimit teorik, është praktika në ofrimin e shërbimeve në komunitet, pasi kjo metodologji do të sillte rezultate konkrete dhe afatgjata.

Lidhur me kurrikulat, nga ana e të intervistuarve, u sugjerua si vijon: zbatimi i kurrikulave të përdorura në programin bachelor, por duke përfshirë në mënyrë specifike edhe ato lidhur me funksionet e paraligjorit të tilla si, të drejtat, detyrat/përgjegjësitë, organizimi i punës, marrëdhënia me komunitetin dhe institucionin etj.; rregullat etike që duhet të karakterizojnë profesionin e paraligjorit; kurrikula të përshtatura midis formimit juridik dhe atij social.

Kurrikula specifike të sugjeruara për punën e paraligjorëve kanë qenë: komunikimi, lidhshipi, mënyra e përzgjedhjes së problemeve, mënyra e menaxhimit të rasteve, përcaktimi i rasteve të zakonshme dhe strategjike etj; njohuri bazë për sistemin ligjor dhe procedural; njohuri bazike mbi ndërmjetësimin apo zgjidhjen me pajtim të konflikteve dhe aftësia bashkëpunuese me autoritetet lokale apo organe shtetërore në interes të përfituesve vulnerabël; trajtimi i nevojshëm psikologjik i paraligjorit.

Sipas një paraligjori të intervistuar, specializimi i paraligjorëve do të ishte i preferueshëm. Ai mund të emërtohet si paraligjor komunitar, i cili është i specializuar për t'u marrë me komunitetet dhe për fuqizimin e tyre, ose në rastet kur trajton çështje të grupeve të ndryshme vulnerabël, paraligjori të specializohet në trajtimin e specializuar të problematikave, që hasin këta qytetarë të margjinalizuar.

Lidhur me institucionet që mund të kryejnë trajnimet, të intervistuarit kanë dhënë mendime të ndryshme si: Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL); në mungesë të një programi për paraligjorët tek IAL, kualifikimet mund të bëhen edhe nga institucionet shtetërore për trajnime specifike sipas fushës së kompetencës të secilit institucion; Ministria e Drejtësisë; organizata të specializuara; organizata jofitimprurëse, rrjet ekspertësh të njohur dhe me përvojë; stafe të posaçme të universiteteve, të cilët mund të autorizohen/akreditoohen edhe për lëshimin e certifikatave; lektorë të ndryshëm të shkencave sociale dhe të drejtësisë; por edhe nëpërmjet mënyrave të tjera nga OJF-të, nëpërmjet trajnimeve të brendshme të tyre. Gjithashtu, u sugjerua edhe ngritja e një institucioni si Dhoma Kombëtare e Paraligjorëve, e cila të ofrojë kurse/trajnime me anë të trajnerëve të kontraktuar prej saj.

Lidhur me organizimin e trajnimeve të paraligjorëve nga universitetet dhe interesin e tyre në krijimin e programeve të studimit, apo trajnimit fillestar dhe vazhdues të paraligjorëve, organizatat kanë mbajtur qëndrimin se, ekziston rreziku që mos të ketë mjaftueshëm kandidatë për ndjekjen e këtyre kurseve duke qenë se është një profesion i ri. Në këtë aspekt shihet si i domosdoshëm promovimi nga ana e shtetit si dhe garantimi i shtetit për ngritjen e strukturave përkatëse. Për vlerësimin e faktit nëse do të ketë mjaftueshëm kandidatë është rekomanduar kryerja e një studimi të tregut sipas metodologjive përkatëse. Përfaqësuesja e një prej klinikave të ligjit, ka sqaruar se, interesi i universiteteve, të cilat kanë në përbërjen e tyre klinika ligji, në përfshirjen e programeve paraligjore do të konsistonte vetëm në supervizimin, pasi formati i funksionimit të klinikave të ligjit ka në fokus sistemin e rotacionit ndërmjet studentëve të përfshirë. Është sugjeruar që këto trajnime duhet të financohen nga ana e buxhetit të shtetit, për shkak se vetë klinikat e ligjit vetë-financohen, ndërkohë që studentët kandidatë për paraligjorë në mungesë të një pune konkrete nuk do të kenë aftësinë e nevojshme paguese për të përballuar kosto të tilla, shtesë ndaj atyre që paguajnë për arsimimin e tyre. Buxheti nëpërmjet të cilit mund të akordohet duhet të parashikohet në atë të Ministrisë së Drejtësisë dhe të akordohet nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Të intervistuarit konsiderojnë se për çdo program studimi, pavarësisht kohëzgjatjes së tij, universitetet kanë detyrimin që të pajisin studentin me diplomën apo certifikatën përkatëse, sipas llojit të programit të studimit.

Të intervistuarit konsiderojnë se, në përfundim të kursit, paraligjorit duhet t'i akordohet një certifikatë përkatëse për të provuar se fiton titullin paraligjor. Lidhur me institucionet që mund të lëshojnë certifikatat, organizatat janë të mendimit se, mund të lëshohen nga secili institucion që do të kryejë trajnimin, por që janë të akredituar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, apo institucione të tjera kompetente. Të tjerë janë shprehur se, këto certifikata/diploma mund të lëshohen nga Ministria e Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë ose Ministria e Shëndetësisë. Kjo formë certifikimi duhet të njihet nga shteti, dhe të shërbejë si provë për kualifikimin e paraligjorit dhe punësimin e tij.

Sa i përket mënyrës së shpërblimit të profesionit të paraligjorit, një organizatë është shprehur se, krahas pagesës bazë të paraligjorit, duhet të reflektohet dhe një mënyrë tjetër pagese e këtij profesioni, e parashikuar në orë specifike konsulte, në raport me vështirësitë e rasteve të referuara.

Përfundim: *Lidhur me trajnimet, të intervistuarit kanë sugjeruar që të zhvillohen trajnime fillestare dhe vazhduese si për çdo profesion tjetër, apo dhe një cikël trajnimesh në formën e kualifikimeve profesionale. Në përfundim të trajnimit, apo programit të formimit/kualifikimit, personat duhet të pajisen me certifikatën përkatëse që provon njohuritë e fituara, e cila mund të lëshohet nga institucione përgjegjëse të akredituara. Forma më e përshtatshme e trajnimit, krahas trajnimit teorik, është kryerja e punës në praktikë, duke sjellë rezultate konkrete dhe afatgjata. Gjithashtu, janë sugjeruar edhe kurrikulat e përgjithshme dhe specifike për aftësimin e paraligjorëve në ushtrimin e detyrave të tyre, të cilat mund të ofrohen nga institucione të arsimit të lartë, klinika ligji, OJF, etj.*

Pjesa III

VLERËSIMI I EKZISTENCËS SË KUSHTEVE PËR PËRFSHIRJEN E PARALIGJORIT NË LISTËN KOMBËTARE TË PROFESIONEVE

A. Përmbajtja e LKP duke analizuar listën e profesioneve që kanë ngjashmëri me paraligjorin

Në vitin 2017 shteti shqiptar miratoi Listën e re Kombëtare të Profesioneve (LKP), me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, i rishikuar¹⁰¹, e cila zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare.

LKP zbatohet nga agjencitë statistikore, ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Instituti i Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore janë parashikuar nga ligjvënësi si institucione që kryejnë përditësimin e informacionit statistikor zyrtar që nga momenti i hyrjes në fuqi të LKP-së.

Bazuar në VKM-në nr. 514/2017 janë përcaktuar të gjithë profesionet që lidhen me të gjitha punësimet e mundshme ligjore në vendin tonë, duke i kategorizuar në grupe të mëdha, ku secili nga këto grupe ka nëngrupet e veta të profesioneve si dhe grupet e vogla.

Për efekt të studimit ne do të analizojmë grupet e mëdha, nëngrupet dhe grupet e vogla, që lidhen me profesione të ngjashme me profesionin e paraligjorit.

Grupi i madh “Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)” me kod profesioni 2. nëngrupet e tij të mëdha dhe grupet e vogla

Më konkretisht, në listën e grupeve të profesioneve grupi i madh është parashikuar edhe **grupi i madh “Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)”, me kod profesioni 2.**

Sipas VKM-së objekt studimi, grupi i madh “Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)” do të konsiderohen ata specialistë që *zgjerojnë bagazhin ekzistues të njohurive, aplikojnë koncepte dhe teoritë shkencore apo artistike, japin mësim për to në mënyrë sistematike ose angazhohen në ndonjë nga kombinimet e këtyre tri aktiviteteve. Shumica e profesioneve në këtë grup kryesor kërkojnë shkathësitë e nivelit të katërt të kompetencës sipas niveleve të LKP.*

Funksionet kryesore të këtij grupi të madh janë:

- a) Realizojnë analiza dhe hulumtime, dhe zhvillojnë koncepte, teori dhe metoda operative;

¹⁰¹[file:///C:/Users/user/Downloads/VKM%20Nr.%20514%20dat%C3%AB%2020.9.2017%20_P%C3%ABr%20miratimin%20e%20list%C3%ABs%20komb%C3%ABtare%20t%C3%AB%20profesioneve%20\(lkp\)%20t%C3%AB%20rishikuar_.pdf](file:///C:/Users/user/Downloads/VKM%20Nr.%20514%20dat%C3%AB%2020.9.2017%20_P%C3%ABr%20miratimin%20e%20list%C3%ABs%20komb%C3%ABtare%20t%C3%AB%20profesioneve%20(lkp)%20t%C3%AB%20rishikuar_.pdf)

- b) Këshillojnë aktorë të ndryshëm, duke përdorur njohuritë ekzistuese, që lidhen me shkencat fizike, matematike, inxhinierike dhe teknologjinë, si dhe me shkencat e jetës duke përfshirë shërbimet mjekësore dhe shëndetësore, shkencat shoqërore dhe humane;
- c) Realizojnë mësimdhënien e teorisë dhe praktikës të një ose më shumë disiplinave në nivele të ndryshme të arsimimit;
- d) Realizojnë mësimdhënien dhe edukimin e personave me aftësi të kufizuara;
- e) Ofrojnë shërbime të ndryshme ligjore, shoqërore dhe të biznesit;
- f) Krijojnë dhe performojnë vepra të artit;
- g) Ofrojnë shërbime shpirtërore;
- h) Përgatisin dokumente dhe raporte shkencore;
- i) Mbikëqyrin të tjerët.

Në grupin e madh “Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)” parashikohen këto nëngrupe të mëdha:

- 21 Specialistë të shkencave dhe inxhinierisë
- 22 Specialistë të shëndetësisë
- 23 Specialistë të mësimdhënies
- 24 Specialistë të administrimit dhe biznesit
- 25 Specialistë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit
- 26 Specialistë në fushën ligjore, shoqërore dhe kulturore**

Për efekt të këtij studimi ne do të marrim në analizë vetëm **nëngrupin e madh me kod profesioni 26, të emërtuar “Specialistë në fushën ligjore, shoqërore dhe kulturore”.**

Këta specialistë kryejnë hulumtime apo kërkime, zhvillojnë e përmirësojnë konceptet, teoritë dhe metodat operacionale ose aplikojnë njohuritë në lidhje me zbatimin e ligjit. Gjithashtu, grumbullojnë informacion për aspekte të ndryshme në fushën ligjore, shoqërore dhe kulturore si: psikologji, mirëqenie sociale, politikë, ekonomi, histori, fe, gjuhësi, letërsi, arte, muzikë, sociologji, shkenca të tjera sociale, si dhe për artet zbavitëse dhe argëtuese. Ata mund të punësohen në institucione të ndryshme që ofrojnë shërbime në fushën ligjore, shoqërore dhe kulturore apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore të “specialistëve në fushën ligjore, shoqërore dhe kulturore” lidhur me fushën ligjore, janë si më poshtë:

- a) Kryejnë hetime, kërkime të ndryshme mbi problemet ligjore;
- b) Hartojnë ligje dhe rregullore për fusha të ndryshme;
- c) Këshillojnë të tjerët për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në institucione publike dhe private;
- d) Kryejnë shërbime të ndryshme avokatie;

- e) Këshillojnë klientët mbi rastet e ndryshme ligjore ose i përfaqësojnë në një gjykatë;
- f) Kryesojnë zbatimin e ligjit gjatë procedurave gjyqësore në gjykata të shkallëve të ndryshme;
- g) Kryejnë shërbime të ndryshme noterie; si dhe punë të ngjashme me funksionin e specialistit në fushën ligjore, etj.

Me qëllim ushtrimin e këtij profesioni kërkohet përfundimi i arsimit të lartë në fushat respektive të punësimit.

VKM liston në mënyrë specifike edhe funksionet kryesore të specialistëve në fushën shoqërore dhe kulturore, të cilat nuk janë objekt i këtij studimi.

Gjithashtu, sikurse u sqarua më sipër, grupi i madh i profesioneve klasifikohet në nëngrupe të mëdha profesionale ku secili nëngrup i madh klasifikohet në grupe të vogla. Kështu, **nëngrupi i madh “Specialistë në fushën ligjore, shoqërore dhe kulturore” përbehet nga grupe të vogla si më poshtë vijon:**

261 Specialistë në fushën ligjore

262 Arkivistë, librarë, bibliotekistë dhe kuratorë

263 Specialistë të fushës shoqërore dhe fetare

264 Autorë, gazetarë dhe gjuhëtarë

265 Artistë krijues dhe performues

Për efekt të këtij studimi do të merren në analizë vetëm dy nga grupet e vogla, që klasifikohen në këtë nëngrup të madh që janë **“Specialistë në fushën ligjore” me kod profesioni 261 dhe “Specialistë të fushës shoqërore dhe fetare” me kod profesioni 263.**

Në listën/grupin e vogël **“Specialistë në fushën ligjore” me kod profesioni 261** janë parashikuar profesionet që lidhen me ofrimin e shërbimeve ligjore, ku janë përshkruar funksionet kryesore, kërkesat për punësim, informacion shtesë, personat që klasifikohen në këtë grup të tillë si juristë, gjyqtarë, dhe specialistë të tjerë ligjorë, shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në LKP, shembuj të profesioneve/punësimeve të ngjashme që klasifikohen në nivele të ndryshme të kompetencës në LKP.

Më konkretisht, specialistë në fushën ligjore konsiderohen personat që kryejnë kërkime mbi problemet ligjore, japin këshilla ligjore klientëve në një shumëllojshmëri të subjekteve, hartojnë dokumente ligjore, përfaqësojnë dhe mbrojnë klientët para gjykatave të niveleve të ndryshme apo bordeve administrative në rastet e shkeljeve civile apo penale. Këta persona interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e procedurat ligjore në fuqi dhe marrin vendime në lidhje me pranueshmërinë e provave dhe fakteve të paraqitura në gjykatë, duke studiuar problemet ligjore dhe duke argumentuar vendimet e marra, si dhe këshillojnë përmirësime, modifikime, hartime dhe përgatitje të kuadrit ligjor ekzistues. Ata/ato mund të punësohen në institucione publike apo private të

sistemit të drejtësisë të niveleve të ndryshme, në institucione të tjera që aplikojnë shërbime ligjore apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore të specialistëve të fushës ligjore janë:

- a) Studiojnë parimet ligjore, statutet dhe vendimet e mëparshme gjyqësore që lidhen me raste të veçanta;
- b) Mbledhin prova për të formuluar një mbrojtje apo për të filluar veprime ligjore;
- c) Mbrojnë rastet e klientëve përpara gjykatave të niveleve të ndryshme dhe bordeve administrative;
- d) Negociojnë në emër të individit apo organizatës në çështjet që përfshijnë konteste ligjore;
- e) Japin këshilla ligjore klientëve, bizneseve apo institucioneve të tjera;
- f) Interpretojnë dhe zbatojnë legjislacionin në fuqi dhe procedurat përkatëse dhe marrin vendime në lidhje me pranueshmërinë e provave;
- g) Vlerësojnë, duke marrë parasysh provat në gjykime dhe vendosin për shkeljet ligjore, pafajësinë apo për shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit apo të pandehurit;
- h) Drejtojnë gjyqet dhe seancat gjyqësore;
- i) Shpallin gjykimin dhe marrin vendime në gjykata;
- j) Kryejnë hartimin e dokumenteve ligjore të tilla si kontratat, testamente, autorizime të përgjithshme apo të posaçme, transaksionet e pasurive etj.;
- k) Këshillojnë në përmirësimin, hartimin dhe përgatitjen e rregulloreve të legjislacionit ekzistues;
- l) Kryejnë verifikimin e nënshkrimeve, dokumenteve si dhe kopjeve të dokumenteve;
- m) Përgatisin artikuj, raporte shkencorë dhe materiale të tjera statistikore;
- n) Komunikojnë me profesionalizëm me eprorë, kolegë dhe të tjerë;
- o) Respektojnë politikat e brendshme dhe procedurat e hartuara nga organizata;
- p) Zbatojnë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit;
- q) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Me qëllim që këta specialistë të punësohen zakonisht kërkohet përfundimi i një diplome universitare.

Profesionet që klasifikohen në këtë grup profesionesh, në Listën Kombëtare të Profesioneve janë: Juristë, Gjyqtarë, Specialistë të tjerë ligjorë.

Në lidhje me **grupin-njësi (profesionin) “Juristë” me kod profesioni 2611**, VKM parashikon se juristi/ja jep këshilla ligjore klientëve në një shumëllojshmëri të subjekteve, harton dokumente ligjore, përfaqëson dhe mbron klientët para gjykatave të niveleve të ndryshme apo bordeve administrative në raste ose sjelljen shkeljeve penale apo i udhëzon ata. Ai/ajo këshillon në përmirësimin, modifikimin, hartimin dhe përgatitjen e rregulloreve të legjislacionit ekzistues. Ai/ajo mund të punësohet në institucione publike apo private të drejtësisë të niveleve të ndryshme, në institucione të tjera që aplikojnë shërbime ligjore apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore të juristit janë si më poshtë:

- a) Dhënien e këshillave juridike klientëve në një shumëllojshmëri të subjekteve dhe ndërmarrja e biznesit;
- b) Studiojnë parimet ligjore, statutet dhe vendimet e mëparshme gjyqësore që lidhen me raste të veçanta;
- c) Mbledhin prova për të formuluar një mbrojtje apo për të filluar veprime ligjore, me mjete të tilla si intervistimin e klientëve dhe dëshmitarëve për të konstatuar faktet e një çështjeje;
- d) Vlerësojnë faktet e mbledhura dhe të gjetura dhe zhvillon strategji dhe argumente në përgatitje për prezantimin e rasteve;
- e) Mbrojnë rastet e klientëve përpara gjykatave të niveleve të ndryshme dhe bordeve administrative;
- f) Udhëzojnë klientët mbi vetë deklarin në gjykatat të niveleve të ndryshme të drejtësisë;
- g) Veprojnë si avokat i popullit në emër të shtetit;
- h) Negociojnë në çështjet që përfshijnë konteste ligjore;
- i) Këshillojnë në përmirësimin, hartimin dhe përgatitjen e rregulloreve të legjislacionit ekzistues;
- j) Kryejnë hartimin e dokumenteve ligjore të tilla si kontratat, transaksionet e pasurive etj.;
- k) Kryejnë plotësimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, në formatin fizik dhe elektronik;
- l) Komunikojnë me profesionalizëm me eprorë, kolegë dhe të tjerë;
- m) Mbikëqyrin punën e personelit mbështetës;
- n) Zbatojnë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit;
- o) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;

Kriteret e nevojshme për punësimin e kësaj kategorie profesioni janë këto:

- a. Kërkohe të ketë diplomë universitare juridik.
- b. Të jetë shtetas shqiptar jo më pak se 25 vjeç.
- c. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- d. Të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës.
- e. Për avokat duhet të ketë kaluar provimin e shtetit.

Informacion shtesë për këtë grup-njësi profesioni “Jurist” parashikohet si më poshtë:

- a. Një individ mund të hyjë në profesion si asistent. Pas ushtrimit të detyrës për një afat jo më të shkurtër se 5 vjet në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, prokurori mund të emërohet në njërin nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit. Pas ushtrimit të detyrës për një afat jo më të shkurtër se 10 vjet në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë ose jo më të shkurtër se 5 vjet në prokuroritë pranë gjykatave të apelit, prokurori mund të emërohet në strukturën e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
- b. Specialistët në këtë fushë duhet të kenë një diplomë universitare në drejtësi.
- c. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrim për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

d. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: avokat, avokat populli, jurist, jurist për administratë publike, prokuror etj.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve: Avokat, Avokat populli, Jurist, Jurist për administratë publike, Prokuror, Prokuror i përgjithshëm, Avokat shteti, Këshilltar juridik, Jurist për shoqëritë tregtare.

Në këtë grup profesioneve ashtu sikurse e sqaruam më sipër përfshihet edhe grup-njësi (profesioni) “Gjyqtar”, të cilën nuk po e marrim në analizë pasi ky profesion nuk mund të lidhet me kompetencat dhe funksionet e një paraligjori.

Në lidhje me **grupin-njësi (profesioni) “Specialistë të tjerë ligjorë”, me kod profesioni 2619**, VKM parashikon se, “Specialistë të tjerë ligjorë” kryen veprime të nevojshme për të siguruar burimet e provës dhe për të grumbulluar gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit apo veprime procedurale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Ai/ajo përpilon dokumente testamenti dhe proces-verbal të çeljes së testamentit, kryen përpilimin dhe vërtetimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme për shitblerjen dhe transaksionet e tjera pronësore, përpilimin dhe vërtetimin e akteve të ndryshme përmes të cilëve krijohen dhe zhvillohen bizneset dhe puna, verifikimin e nënshkrimeve, dokumenteve si dhe kopjeve të dokumenteve, autorizime të ndryshme apo dokumente të tjera ligjore të përcaktuar me ligj. Specialist/ja ligjor këshillon në hartimin e dokumenteve ligjorë; Ky grup përfshin specialistët e tjerë ligjorë që nuk klasifikohen diku tjetër në nëngrupin specialistë në fushën ligjore me kod profesioni 261. Specialist/ja ligjor mund të punësohet në institucione publike apo private të drejtësisë të niveleve të ndryshme, në institucione të tjera që aplikojnë shërbime ligjore apo të vetëpunësohet.

Informacion shtesë:

a. Një individ mund të hyjë në profesion si asistent. Pas ushtrimit të detyrës për një afat jo më të shkurtër se 5 vjet në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, prokurori mund të emërohet në njërin nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit. Pas ushtrimit të detyrës për një afat jo më të shkurtër se 10 vjet në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë ose jo më të shkurtër se 5 vjet në prokuroritë pranë gjykatave të apelit, prokurori mund të emërohet në strukturën e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

b. Specialistët në këtë fushë duhet të kenë një diplomë universitare në drejtësi.

c. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrim për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

d. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: avokat, avokat populli, jurist, jurist për administratë publike, prokuror etj.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

2611.01 Avokat

2611.02 Avokat populli

- 2611.03 Jurist
- 2611.04 Jurist për administratë publike
- 2611.05 Prokuror
- 2611.06 Prokuror i përgjithshëm
- 2611.07 Avokat shteti
- 2611.08 Këshilltar juridik
- 2611.09 Jurist për shoqëritë tregtare

Sa më sipër, vërejmë se profesioni i avokatit në bazë të LKP shihet si fushë specializimi ose si shembull punësimi.

Gjithashtu, do të analizojmë edhe **grupin e vogël “Specialistë të fushës shoqërore dhe fetare”, me kod profesioni 263**, sepse konsiderojmë se disa nga detyrat apo funksionet e të punësuarve në këtë grup janë të lidhura drejtpërsëdrejti me funksionin e një paraligjori, i cili mund të punojë në institucione, organizata apo dhe të ofrojë shërbime në ndihmë të komunitetit.

Specialistët e fushës shoqërore dhe fetare bëjnë studime, zhvillojnë ose përmirësojnë koncepte, teori dhe metoda operacionale ose aplikojnë njohuri që lidhen me filozofinë, politikën, ekonominë, sociologjinë, antropologjinë, historinë, filologjinë, gjuhët, psikologjinë dhe shkenca të tjera sociale, ose sigurojnë shërbime sociale që të plotësojnë nevojat e individëve dhe familjeve në një komunitet.

Funksionet që kryejnë specialistët e fushës shoqërore dhe fetare janë si më poshtë:

- a) Formulojnë dhe aplikojnë zgjidhje për çështje ekonomike, politike apo sociale të së sotmes dhe të së ardhmes;
- b) Kërkojnë dhe analizojnë ngjarje dhe aktivitete të shkuara dhe gjejnë origjinën dhe evoluimin e racës njerëzore;
- c) Studiojnë origjinën dhe zhvillimin e gjuhëve ose përkthimin dhe përshtatjen e tyre;
- d) Studiojnë proceset mendore dhe të sjelljes së individit dhe grupeve;
- e) Ofrojnë shërbime sociale;
- f) Përgatitin artikuj dhe raporte akademikë;
- g) Mbikëqyrin punonjës të tjerë.

Me qëllim ushtrimin e këtij profesioni personat duhet të kenë arsimin e lartë. Kualifikimet e mëtejshme pasuniversitare përbëjnë avantazh për punësim dhe zhvillim në karrierë.

Profesionet që klasifikohen në grupin e profesionit “Specialistë të fushës shoqërore dhe fetare”, në Listën Kombëtare të Profesioneve janë:

- 2631 Ekonomistë
- 2632 Sociologë, antropologë dhe specialistë të tjerë të kësaj fushe
- 2633 Filozofë, historianë, specialistë të shkencave politike

2634 Psikologë

2635 Specialistë të këshillimit dhe të punës sociale

2636 Specialistë të fesë

Për efekt të këtij studimi do të analizojmë **grupin-njësi (profesioni), “Specialistë të këshillimit dhe të punës sociale” me kod profesioni 2635.**

Specialistët e këshillimit dhe të punës sociale ofrojnë këshillim dhe udhëzim për individët, familjet, grupet, komunitetet dhe organizatat ndaj vështirësive sociale dhe personale. Ata i asistojnë klientët të zhvillojnë aftësi dhe aksesojnë burime, si dhe mbështesin shërbime që duhen për të reaguar ndaj çështjeve që vijnë si shkak i papunësisë, varfërisë, paaftësisë, varësisë, sjelljes kriminale dhe delinkuente, problemeve martesore dhe të tjera.

Funksionet e Specialistëve të këshillimit dhe të punës sociale janë:

- a) Intervistojnë klientët individualisht, familjarisht ose në grup për të vlerësuar situatën e tyre dhe problemet dhe për të përcaktuar llojin e shërbimeve për të cilat kanë nevojë;
- b) Analizojnë situatën e klientëve dhe paraqesin qasje alternative për të zgjidhur problemet;
- c) Hartojnë të dhëna për raste ose raporte për gjyq dhe procedura të tjera ligjore;
- d) Ofrojnë këshillim, terapi dhe shërbime ndërmjetësimi dhe sesione të lehtësimit të grupeve për të asistuar klientët për të zhvilluar aftësi dhe mprehtësi për t’u përballur dhe për të zgjidhur problemet e tyre sociale dhe personale;
- e) Planifikojnë dhe zbatojnë programet e asistencës për klientë që përfshijnë ndërhyrje në krizë dhe referon te agjencitë që sigurojnë asistencë financiare, ndihmë ligjore, strehim, trajtim mjekësor dhe shërbime të tjera;
- f) Hetojnë raste abuzimi ose neglizhimi dhe ndërmarrin veprime për të mbrojtur fëmijët dhe të tjerët nga persona të rrezikshëm;
- g) Punojnë me shkelësit e ligjit gjatë dhe pas dënimit, i ndihmojnë ata të integrohen në komunitet dhe për të ndryshuar qasjen dhe sjelljet për të reduktuar shkelje të tjera;
- h) Këshillojnë drejtuesit e burgut dhe të bordeve për lirimin me kusht, nëse dhe në cilat kushte duhet një shkelës ligji të burgoset, të lirohet nga burgu apo të ketë metoda të tjera korrektimi;
- i) Sillen si avokat për një grup klientësh në komunitet dhe të llojë për zgjidhje ndaj problemeve që ndikojnë ata;
- j) Zhvillojnë programe parandalimi dhe ndërhyrjeje për të plotësuar nevojat e komunitetit;
- k) Mbajnë kontakte me agjencitë e tjera të shërbimeve sociale, institucionet e edukimit dhe ofruesit e shërbimit për mirëqenien shëndetësore për të shkëmbyer informacion në lidhje me situatën e përgjithshme të klientit dhe progresin e tij;
- l) Realizojnë detyra të ngjashme.

Kërkesa për punësim është pasja e arsimit të lartë. Megjithatë, kualifikimet e mëtjshme pasuniversitare përbëjnë avantazh për punësim dhe zhvillim në karrierë.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion “Specialistë të këshillimit dhe të punës sociale” që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve janë:

- 2635.01 Përgjegjës sektori të shërbimeve të punësimit
- 2635.02 Përgjegjës sektori në administratë/fusha sociale
- 2635.03 Punonjës social
- 2635.04 Punonjës social në ambiente pune
- 2635.05 Punonjës social në arsim
- 2635.06 Punonjës social në burg
- 2635.07 Punonjës social për azilet
- 2635.08 Punonjës social për fëmijët
- 2635.09 Punonjës social për persona me aftësi të kufizuar
- 2635.10 Punonjës social për planifikimin familjar
- 2635.11 Specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve
- 2635.12 Specialist për mbrojtjen e të drejtave të grave
- 2635.13 Këshillues për përdorues të drogës
- 2635.14 Këshillues për humbjen e të afërmit
- 2635.15 Këshillues për fëmijët dhe të rinjtë
- 2635.16 Këshillues familjeje
- 2635.17 Këshillues martese
- 2635.18 Këshillues për personat e liruar me kusht
- 2635.19 Këshillues për personat në kohë prove

Grupi i madh “Teknikë dhe specialistë në zbatim” me kod profesioni 3. nëngrupet dhe grupet e vogla

Një kategori tjetër profesioni, pjesë e një grupi tjetër të madh është: **“Teknikë dhe specialistë në zbatim” me kod profesioni 3.** Ky grup i madh ka si karakteristika të përgjithshme kryerjen e detyrave teknike dhe detyrave të ngjashme të lidhura me kërkimet dhe aplikimet e koncepteve dhe metodave operacionale shkencore apo artistike, dhe rregulloret e qeverisë ose biznesit. Shumica e profesioneve në këtë grup kryesor kërkojnë aftësi të nivelit të tretë sipas niveleve të kompetencës të LKP. Ata ndërmarrin dhe kryejnë punë teknike të lidhura me hulumtimin dhe aplikimin e koncepteve dhe metodave operative në fushat e shkencave fizike duke përfshirë inxhinierinë dhe teknologjinë, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, shkencat e jetës si dhe profesione të mjekësisë, të shkencave shoqërore dhe humane.

Në varësi të detyrave të veçanta dhe shkallës së përgjegjësisë në ekzekutimin e tyre, profesionet e klasifikuara në këtë grup mund t’u kërkojë arsim i lartë i nivelit bachelor, arsim i mesëm apo kualifikime profesionale në varësi të fushës profesionale dhe specifikave të organizimit të punës në to.

Funksionet kryesore të këtij grupi të madh janë:

- a) Ndërmarrin dhe kryejnë punë teknike të lidhura me hulumtimin dhe aplikimin e koncepteve dhe metodave operative në fushat e shkencave fizike duke përfshirë inxhinierinë dhe teknologjinë, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, shkencat e jetës duke përfshirë profesione të mjekësisë, të shkencave shoqërore dhe humane.
- b) Kryejnë shërbime të ndryshme teknike që kanë të bëjnë me tregtinë, financën, administratën, duke përfshirë administrimin e një numri të ligjeve dhe rregullave të qeverisë, si dhe të punës sociale;
- c) Sigurojnë organizimin dhe kryerjen e aktiviteteve argëtuese, sportive dhe artistike;
- d) Kryejnë përmbushjen e disa detyrave fetare;
- e) Teknikët dhe specialistët në zbatim mund të marrin udhëzime nga zyrtarë më të lartë të qeverisë ose manaxherët profesionistë;
- f) Mbikëqyrin të tjerët.

Nëngrupet e mëdha kryesore që klasifikohen në grupin e madh “Teknikë dhe specialistë në zbatim” janë si vijon:

31 Bashkëpunëtorë profesionistë në inxhinieri dhe shkencë

32 Asistentë të specializuar të shëndetësisë

33 Asistentë në administrim dhe biznes

34 Specialistë ligjor, shoqëror, kulturor, të rendit dhe të tjera të ngjashme

35 Teknikë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)

Për efekt të këtij studimi do të analizojmë **nëngrupin e madh “Specialistë ligjor, shoqëror, kulturor dhe të tjera të ngjashme” me kod profesioni 34**. Specialistët ligjor, shoqëror, kulturor, të rendit dhe të tjera të ngjashme, kryejnë detyrat teknike që lidhen me aplikimin e njohurive të fushave përkatëse në praktikë që kanë të bëjnë me shërbimet ligjore, ruajtjen e rendit, punët sociale, veprimtaritë kulturore, arredimin e ambienteve të brendshme, me sportet dhe fenë. Ata mund të pranojnë udhëzime nga zyrtarët e niveleve më të lartë, menaxherët apo profesionistët. Ata mund të punësohen në kompani shërbimesh të ndryshme, apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore të nëngrupit “Specialistë ligjor, shoqëror, kulturor, të rendit dhe të tjera të ngjashme”, që mund të ngjasojnë me funksionet e paraligjorit janë:

- a) Ofrimi i shërbimeve teknike apo praktike dhe mbështetja e funksioneve në proceset ligjore, gjyqësore, hetimore, etj. që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit;
- b) Kontrollimi dhe inspektimi i veprimtarive të ndryshme për të siguruar zbatimin e ligjit dhe normave të paracaktuara;
- c) Ofrimi i shërbimeve të kujdestarisë dhe përkujdesjes sociale në institucione të ndryshme;
- d) Ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes sociale për personat me aftësi të kufizuar;
- e) Përgatitja dhe drejtimi i programeve sociale dhe komunitare, aktiviteteve kulturore, programeve rekreative, duke kombinuar aftësitë krijuese dhe teknike në një larmi artistike e kulturore;

- f) Pranimi dhe marrja e udhëzimeve nga zyrtarët e lartë, menaxherët apo profesionistët;
- g) Realizimi i detyrave të ngjashme;
- h) Mbikëqyrja e punëtorëve të tjerë;

Në lidhje me punësimin për këtë profesion zakonisht kërkohet përfundimi i studimeve bachelor ose një shkolle profesionale në këtë fushë.

Grupet e vogla që klasifikohen në këtë nëngrup të madh janë si në vijim:

341 Specialistë ligjor, të punës sociale dhe të fesë

342 Punonjës në sporte dhe palestra

343 Specialistë të artit, kulturës dhe kulinarisë

Për efekt të këtij studimi do të analizojmë **grupin e vogël “Specialistë ligjorë, të punës sociale dhe të fesë”, kodi i profesionit: 341**. Specialistët ligjorë, të punës sociale dhe të fesë ofrojnë shërbime teknike dhe praktike, duke përdorur njohuri të specializuara për veprimtarinë e organizatës, ofrojnë shërbime mbështetjeje organizative, komunikimi dhe dokumentacioni në proceset ligjore dhe hetimore, në programe të përkrahjes sociale dhe aktivitete fetare të komunitetit. Ata kryejnë këshillime profesionale për fushat përkatëse dhe përgatisin dokumente e raporte të ndryshme për aktivitetin e kryer. Ata mund të punësohen në institucione /organizata, të niveleve të ndryshme, të shërbimeve ligjore, të përkrahjes sociale, institucione fetare apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore të këtij profesioni “Specialistë ligjorë, të punës sociale dhe të fesë” janë:

- a) Përgatisin dokumentacione të procedurave gjyqësore dhe ligjore, deklarata e kërkesa, garanci, fletëthirrjet dhe urdhëresat e tjera të gjykatës;
- b) Kryejnë marrjen dhe analizimin e provave juridike sipas procedurave të paracaktuara;
- c) Hetojnë faktet dhe prova apo vendime të tjera ligjore;
- d) Ekzaminojnë dokumentacione të tilla si hipotekat, garancitë, gjykimet, kontratat dhe harta për të verifikuar përshkrimet ligjore të pronave dhe pronësisë;
- e) Këshillojnë klientët për çështje juridike;
- f) Përgatisin dhe përpunojnë dokumente ligjore dhe materiale të tjera;
- g) Ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për individët që kërkojnë të përfitojnë përkrahje sociale;
- h) Kryejnë marrjen dhe analizimin e dokumenteve për individët që kërkojnë të përfitojnë përkrahje sociale;
- i) Asistojnë dhe këshillojnë individët për procedurat dhe përgatitjen e dokumenteve për përfitimin e përkrahjes sociale;
- j) Administrojnë dhe zbatojnë programe të përkrahjes sociale dhe shërbimeve komunitare;
- m) Regjistrojnë dhe hedhin të dhënat, për të bërë statistika, draft raporte dhe materiale të tjera;
- n) Komunikojnë me profesionalizëm me klientët në njësinë e shërbimit;
- o) Mbikëqyrin punën e punëtorëve mbështetës dhe personelit tjetër të zyrës;

p) Respektojnë politikat e brendshme dhe procedurat e hartuara nga organizata;

Në lidhje me kërkesat për punësim për këtë profesion zakonisht kërkohet përfundimi i një diplome bachelor.

Profesionet që klasifikohen në këtë grup profesione “Specialistët ligjorë, të punës sociale dhe të fesë”, në Listën Kombëtare të Profesioneve janë:

3411 Specialistë ligjorë dhe profesione që lidhen me to

3412 Asistentë, specialistë të punës sociale

3413 Asistentë, specialistë të fesë

Një grup tjetër njësi (profesioni) është edhe “Specialistë ligjorë dhe profesione që lidhen me to” me kod profesioni 3411. Specialisti/ja ligjor/e dhe profesione që lidhen me to kryen funksione mbështetëse në gjykata apo në zyra të tjera ligjore, siguron shërbimet që lidhen me çështje të tilla ligjore si kontrata të sigurimit, transferimi i pronës, dhënia e kredive dhe transaksione të tjera financiare ose kryen hetime për klientët. Ai/ajo heton faktet dhe prova apo vendime të tjera ligjore, hulumton dhe grumbullon prova përkatëse, për përgatitjen e rasteve gjyqësore, këshillon klientët për çështje juridike, kryen detyra të tjera procedurale, administrative dhe koordinuese në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi, si dhe përgatit, përpunon, ruan dokumentet e përgatitura apo të grumbulluara, regjistrat dhe regjistrime të nevojshme nëpërmjet programeve të duhura kompjuterike ose manuale. Ai/ajo mund të punësohet në gjykata të niveleve të ndryshme, prokurori, në institucionin e avokatit të popullit, në studio avokatie, institucione të tjera të drejtësisë, institucione të tjera apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore të Specialistëve ligjorë dhe profesioneve që lidhen me to, janë si më poshtë:

- a) Kryejnë dokumentimin e procedurave gjyqësore dhe ligjore;
- b) Përgatisin deklaratat e kërkesave, thirrjeve, garancive, fletëthirrjet dhe urdhëresat e tjera të gjykatës;
- c) Mbajnë rendin dhe qetësinë në gjykatë dhe dhomat e dëgjimit;
- d) Përgatisin dokumente ligjore, duke përfshirë ese/përmbledhje të shkurtra për gjykim, deklaratat, ankesat, testamentet dhe kontratat, përmbledhje për revista e gazeta, drafte ligjore, dokumente që përcaktojnë kushtet e kredive ose të sigurimit;
- e) Hetojnë fakte dhe prova apo vendime të tjera ligjore;
- f) Hulumtojnë dhe grumbullojnë prova përkatëse, vendime dhe dokumente të tjera për përgatitjen e rasteve gjyqësore;
- g) Këshillojnë klientët për çështje juridike;
- h) Ekzaminojnë dokumentacione të tilla si hipotekat, garancitë, gjykimet, kontratat dhe harta për të verifikuar përshkrimet ligjore të pronave dhe pronësisë;
- i) Përgatisin dokumente që lidhen me transferimin e pasurive të paluajtshme, rezervat apo çështje të tjera që kërkojnë regjistrim formal;

- j) Hetojnë raste të mundshme të vjedhjes së mallrave, parave ose informacion nga qendrat e biznesit dhe të rasteve të tjera të mundshme të sjelljes së paligjshme nga klientët ose të punësuarit;
- k) Hetojnë institucionet apo rrethanat dhe sjelljen e personave në emër të klientëve;
- l) Kryejnë detyra procedurale dhe koordinuese në përputhje me legjislacionin duke respektuar varësinë hierarkike;
- m) Përgatisin dhe përpunojnë statistika, dokumente ligjore dhe materiale të tjera;
- n) Kryejnë mbajtjen dhe ruajtjen e dosjeve apo dokumenteve të tjera deri në momentin e arkivimit të tyre;
- o) Mbajnë regjistrat dhe regjistrime të nevojshme nëpërmjet programeve të duhura kompjuterike ose në mënyrë manuale;
- p) Bashkëpunojnë me autoritetet tatimore për çështjet e taksave dhe tarifave gjyqësore;
- q) Mbajnë shënime lidhur me planifikimin dhe organizimin e takimeve, oraret e takimeve në dispozicion;
- r) Pranojnë dhe u përcjellin mesazhe personave të duhur;
- s) Kryejnë çdo detyrë tjetër të përcaktuar në legjislacionin në fuqi;
- t) Raportojnë te eprorët për veprimtarinë e kryer;
- u) Mbikëqyrin punën e punëtorëve mbështetës në zyrë;
- v) Zbatojnë kodin e etikës profesionale;
- ë) Zbatojnë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit;
- x) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Në lidhje me kërkesat për punësim për këtë profesion kërkohet zakonisht të ketë diplomë universitare.

Informacion shtesë në lidhje me profesionin “Specialistë ligjorë dhe profesione që lidhen me to” përfshin si më poshtë:

- a. Një individ mund të hyjë në profesion si asistent (praktikant). Me eksperiencë dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin e specialistit ligjor. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një specialist ligjor apo profesionist që lidhen me to, mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivele të ndryshme ligjore (avokat, noter, gjyqtar). Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e juristit.
- b. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: asistent avokat, asistent ligjor, asistent logjistik, asistent sigurimi, nëpunës gjykate, përmbarues, detektiv privat.

Shembuj të punësimeve të përfshira në profesionin “Specialistë ligjorë dhe profesione që lidhen me to”, që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 3411.01 Asistent i avokatit
- 3411.02 Asistent i komisionerit
- 3411.03 Asistent ligjor
- 3411.04 Asistent ligjor banke
- 3411.05 Asistent ligjor projekti
- 3411.06 Asistent logjistik
- 3411.07 Asistent sigurimi
- 3411.08 Asistent sigurimi/politikash
- 3411.09 Nëpunës gjykatë
- 3411.10 Nëpunës i aktit të tjetërsimit
- 3411.11 Nëpunës ligjor
- 3411.12 Nëpunës ligjor sigurimi
- 3411.13 Nëpunës që shqyrton vërtetësinë e një testamenti
- 3411.14 Përmbarues
- 3411.15 Detektiv privat
- 3411.16 Nëpunës hipoteke

Në LKP parashikohet në mënyrë të posaçme edhe **grupi-njësi (profesioni) “Asistentë, specialistë të punës sociale”**, me kod profesioni **3412**, të cilët u ofrojnë udhëzime klientëve për çështje sociale, punë administrative duke zbatuar programe të asistencës sociale dhe shërbimeve ndaj komunitetit. Ata asistojnë dhe këshillojnë klientët për të identifikuar qasjet e tyre në burimet e komunitetit për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë ndihmën ligjore, mjekësore, financiare, strehim, punësim, transport, ndihmë me lëvizje, kujdesi ditor dhe shërbime të tjera. Ai mund të punësohet në institucione apo kompani shërbimesh sociale dhe shëndetësore ose të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore të profesionit “Asistentë, specialistë të punës sociale”, janë:

- a) Mbledhin informacionin përkatës për nevojat e klientëve dhe vlerësojnë aftësitë e tyre përkatëse, mangësitë apo anët e forta;
- b) Ndhmojnë personat me aftësi të kufizuara apo të moshuar për të marrë shërbimet dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre në jetën e përditshme;
- c) Ndhmojnë klientët për të identifikuar mundësitë dhe zhvilluar planet e veprimit, duke i siguruar mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme;
- d) Ndhmojnë klientët për të identifikuar qasjet e tyre në burimet e komunitetit për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë ndihmën ligjore, mjekësore, financiare, strehimin, punësimin, transportin, ndihmë me lëvizje, kujdesin ditor dhe shërbime të tjera;
- e) Këshillojnë klientët që jetojnë në shtëpitë apo institucione të grupuara (shtëpitë për fëmijë, të moshuar etj.) dhe i mbikëqyrin ata duke i ndihmuar në realizimin e aktivitetit të tyre të përditshëm;
- f) Ndhmojnë dhe këshillojnë klientët në qendra sociale të rehabilitimit;
- g) Marrin pjesë në përzgjedhjen dhe pranimin e klientëve në programet përkatëse sociale;

- h) Sigurojnë ndërhyrjen në kriza emergjente dhe shërbimet e strehimit;
- i) Kryejnë aktivitete profesionale të kujdesit shëndetësor sipas kushteve apo nevojave shëndetësore;
- j) Kryejnë përkujdesje sociale dhe ndihmë për personat me aftësi të kufizuara sipas rastit të tyre;
- k) Kryejnë aktivitete profesionale për rehabilitimin e personave të dalë nga burgu;
- l) Ndihmojnë në vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve dhe programeve me monitorime dhe raportime mbi progresin e klientëve;
- m) Mbajnë kontakt me agjencitë e tjera të shërbimeve sociale, shkollave dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor të përfshirë me klientët për të siguruar informacion rreth gjendjes së përgjithshme të klientit dhe përparimin e tij;
- n) Komunikojnë dhe koordinojnë punën me kolegët për shërbime në kohë dhe me cilësi të klientit;
- o) Përpilojnë regjistrimet e rastit dhe bëjnë raportimet e duhura në institucionet përkatëse;
- p) Punojnë për parandalimin e veprimeve të padëshirueshme duke organizuar aktivitetet shoqërore, rekreative dhe edukative në klube të rinjve, qendra të komunitetit dhe organizatat e tjera;
- q) Këshillojnë dhe ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në programe dhe trajtime të përshtatshme për të përmirësuar aftësitë e tyre që të lehtësojnë jetesën në shoqëri;
- r) Planifikojnë, organizojnë apo ofrojnë shërbime ndihme në shtëpi;
- s) Zbatojnë rregulloret e njësisë së shërbimit dhe urdhrat e ditës.
- t) Realizojnë detyra të ngjashme;
- u) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;
- v) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Në lidhje me kërkesat për punësim për profesionin “Asistentë, specialistë të punës sociale”, zakonisht kërkohet përfundimi i studimeve bachelor ose i një shkolle profesionale në këtë fushë;

- b. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion.
- c. Të ketë një eksperiencë pune paraprake në këtë fushë
- e. Të ketë aftësi komunikuese;

Informacion shtesë në lidhje me profesionin “Asistentë, specialistë të punës sociale”, parashikohet si më poshtë:

- a. Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës, asistentë. Me eksperiencë dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin specialistë të punës sociale. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një asistent, specialist i punës sociale mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivelin e menaxherit të shërbimeve sociale.

- b. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: kujdestar në qendrën e përkujdesit social, kujdestar në qendrën sociale të rehabilitimit, kujdestar social (edukator), punonjësi i përkujdesit social për personat me aftësi të kufizuara, punonjës social sektori i shëndetësisë etj.
- c. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrim për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 3412.01 Kujdestar në qendrën e përkujdesit social
- 3412.02 Kujdestar në qendrën sociale të rehabilitimit
- 3412.03 Kujdestar social (edukator)
- 3412.04 Kujdestar (krye edukator) shkolle
- 3412.05 Nëpunës mbikëqyrës (për persona të liruar nga burgu me kusht)
- 3412.06 Nëpunës në fushat social-administrative
- 3412.07 Punonjës i përkujdesit social për personat me aftësi të kufizuara
- 3412.08 Punonjës i përkujdesit social për personat me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe të folur
- 3412.09 Punonjës i përkujdesit social për shëndetin mendor
- 3412.10 Punonjës social
- 3412.11 Punonjës social (përkujdesje shoqërore ndihmë ekonomike)
- 3412.12 Punonjës social administrator për planifikim familjar
- 3412.13 Punonjës social i administratës së burgut
- 3412.14 Punonjës social në shkollë
- 3412.15 Punonjës social për rehabilitim të personave të dalë nga burgu
- 3412.16 Punonjës social përkujdesje familjesh
- 3412.17 Punonjës social përkujdesje fëmijësh
- 3412.18 Punonjës social sektori i psikiatrisë
- 3412.19 Punonjës social sektori i shëndetësisë
- 3412.20 Punonjës social shërbim në shtëpi
- 3412.21 Punonjës për zhvillimin e komunitetit
- 3412.22 Punonjës shërbimi i komunitetit
- 3412.23 Punonjës për zgjidhje konfliktesh
- 3412.24 Instruktor i aftësimit për jetën
- 3412.25 Punonjës mbështetjeje për shërbime sociale
- 3412.26 Punonjës i qendrave të strehimit të grave
- 3412.27 Punonjës rinie

Sa më sipër, vërejmë se, shembujt e punësimit për këtë profesion përfshijnë, ndër të tjera, kujdestar në qendrën e kujdesit social/rehabilitimit, punonjës i përkujdesit social për persona me aftësi të kufizuara, për fëmijët etj., punonjës për zhvillimin e komunitetit me kod profesioni 3412.21,

punonjës shërbimi i komunitetit me kod profesioni 3412.22, punonjës për zgjidhje konfliktesh me kod profesioni 3412.23 etj.

B. Analiza e LKP krahasuar me analizën e shteteve objekt studimi dhe eksperiencën shqiptare

Referuar listës së mësipërme kombëtare të profesioneve të parashikuar në VKM-në 514/2017 vëmë re se, paraligjori nuk është parashikuar si profesion i veçantë, edhe pse në Shqipëri disa organizata kanë një praktikë të konsoliduar disavjeçare në ushtrimin e këtij profesioni. Në fakt, pavarësisht se nuk ka një profesion të tillë, sipas intervistave të realizuara në pjesën e dytë të këtij studimi, na ka rezultuar se në Shqipëri ka eksperiencë të paformalizuara dhe individë që kryejnë funksionin e paraligjorit. Paraligjorët janë të punësuar pranë organizatave dhe ushtrojnë funksionet e tyre në bashkëpunim me klinikat e ligjit. Prandaj, duke qenë se paraligjori nuk është parashikuar si profesion i veçantë në LKP, me anë të analizës sonë në këtë pjesë të studimit, së pari do të evidentojmë karakteristikat që ka paraligjori në vendet e tjera, objekt studimi, dhe së dyti, karakteristikat që ka ai në praktikën shqiptare. Këto dy elementë do të na shërbejnë për të arritur në një konkluzion nëse paraligjori është i ngjashëm me ndonjë profesion tjetër të parashikuar në LKP.

Lidhur me karakteristikat që ka paraligjori në vendet e tjera, objekt studimi, vërejmë se të gjitha legjislativet e tyre pavarësisht nëse e kanë formalizuar paraligjorin si profesion apo jo, kanë të përbashkët qëllimin e këtij profesioni, detyrat, përgjegjësitë e tij, ndërsa diferenca ndërmjet tyre qëndron vetëm në shkollimin, punësimin dhe aspekte që lidhen me rritjen e kapaciteteve të këtyre profesionistëve. Konkretisht, në Sierra Leone, Moldavi, Ukrainë, Filipine paraligjorët nuk shërbejnë si ndihmës avokatë, ata punojnë me klientët për të gjetur zgjidhje konkrete për padrejtësitë, shpesh në nivelin e komunitetit, ose të administratës dhe bëjnë një punë të rëndësishme në rritjen e qasjes në drejtësi, veçanërisht në komunitetet e largëta. Paraligjorët përbëjnë një urë lidhëse ndërmjet ligjit, institucioneve dhe qytetarëve duke i qasur këta të fundit në drejtësi. Paraligjorët edhe pse në disa shtete janë pjesë e sistemit të ndihmës juridike falas, punën e tyre e ushtrojnë në terren pranë qytetarëve e komuniteteve me qëllim identifikimin e çështjeve dhe adresimin e tyre te institucionet përgjegjëse.

Në Moldavi paraligjorë mund të jetë kushdo me studime juridike jo të plota, ose studime të përfunduara të arsimit të lartë, i cili nuk ushtron profesionin e avokatit të kualifikuar, dhe pas një trajnimit të posaçëm kualifikohet për të ofruar ndihmë ligjore parësore për anëtarët e komunitetit, nga buxheti i alokuar për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Në Afrikën e Jugut paraligjorë zakonisht janë ata individë që nuk kanë një diplomë në drejtësi, por kanë aftësi dhe njohuri të ligjit që i lejojnë ata të ofrojnë një formë të ndihmës juridike dhe asistencës për individët në nevojë, në veçanti anëtarët e një komuniteti ku ata bëjnë pjesë, dhe zakonisht nën mbikëqyrjen e një praktikuesi ligjor.

Në shtetet e tjera objekt studimi, edhe pse paraligjori është i paformalizuuar sërish detyrat dhe rëndësia e këtij profesioni është e njëjtë si në shtetet që e kanë tashmë këtë profesion si pjesë të skemës së ndihmës juridike.

Të përbashkëtat e këtij profesioni për të gjitha shtetet qëndrojnë në rëndësinë e tij për të rritur aksesin e komunitetit në shërbime ligjore falas, lidhja e ngushtë dhe identifikimi i nevojave të komunitetit si dhe adresimi i çështjeve që shqetësojnë komunitetin të ofruesit e shërbimeve ligjore falas apo në institucionet përgjegjëse. Paraligjorët kanë lindur si profesion për të lehtësuar aksesin e komuniteteve më të largëta në ndihmë ligjore falas duke pasur lidhje të ngushtë me to si dhe për të mundësuar qasjen e këtyre komuniteteve në sistemin e drejtësisë. Ky element i përbashkët shënjon dhe rëndësinë e këtij profesioni, i cili nuk mund të krahasohet me asnjë profesion tjetër.

Lidhur me karakteristikat që ka paraligjori në praktikën shqiptare, do të marrim në konsideratë praktikën e organizatave shqiptare dhe paraligjorëve në Shqipëri për të kuptuar se cili është roli i këtij profesioni dhe nëse ka ngjashmëri me profesione të ngjashme.

Nga intervistimi i organizatave dhe paraligjorëve, paraligjori në Shqipëri konceptohet në mënyra të ndryshme: si një person që ofron ndihmë juridike, kryesisht parësore, si ndërmjetës ndërmjet qytetarit, komunitetit dhe avokatit/juristit që asiston dhe ndihmon punën e mëtejshme të avokatit/juristit, si personi që ndërlikon punën në komunitet dhe e sjell rastin të avokati, i cili jep zgjidhjen e duhur ligjore. Paraligjori, gjithashtu është një profesionist, i cili ndikon në fuqizimin e komuniteteve.

Nga përgjigjet e dhëna nga të intervistuarit, vërejmë se, paraligjori është një profesion i ngjashëm për nga funksionet me asistent avokatin me veçantinë e vetme se puna e paraligjorit është e lidhur ngushtësisht me komunitetin dhe nevojat e tij dhe ky i fundit i adreson problematikat të paraligjori. Asistent avokati në LKP parashikohet si shërbull punësimi në grupin-njësi (profesioni) “specialistë ligjorë dhe profesione që lidhen me to” dhe diferenca e tij me paraligjorin qëndron në faktin se paraligjori identifikon rastin në komunitet për shkak se puna e tij është pranë komunitetit dhe e adreson rastin për zgjidhje pranë një profesionisti ligjor. Asistent avokati ka detyra që lidhen me ndihmën që i ofron avokatit, duke u përfshirë edhe në hartimin e akteve apo edhe ofrimin e asistencës gjatë procesit gjyqësor në gjykatë etj., të cilat nga analiza e mësipërme nuk lidhen me funksionet e paraligjorit.

Sipas të intervistuarve rezulton se roli dhe detyrat e paraligjorëve konsistojnë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, pasja e një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me komunitetin, edukimin ligjor dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve në nevojë për të drejtat e tyre. Konstatohet se detyrat e paraligjorëve janë shumë të ngjashme me ato të punonjësve me trajnim të posaçëm, të cilët janë të punësuar pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Ndryshe nga këta profesionistë, paraligjorët kanë një lidhje më të ngushtë me komunitetet kryesisht vulnerabël për të cilët ofrojnë jo vetëm shërbime të ndihmës juridike parësore, por edhe informacione për të drejtat.

Lidhur me ofrimin e ndihmës juridike parësore nga paraligjorët, të intervistuarit kanë mbajtur qëndrimin, se e veçanta e këtij profesioni, parë ngushtë edhe me rolin e paraligjorit, ndryshe nga ofrues të tjerë të ndihmës juridike parësore, është marrëdhënia e ngushtë me komunitetin dhe roli i tij si ndërmjetës ndërmjet komunitetit dhe avokatit, komunitetit dhe institucionit shtetëror etj. Pra, vërejmë se, punonjësi me trajnim të posaçëm ofron shërbime të ndihmës juridike parësore në ambientet e QSHNJP në dallim nga paraligjori, i cili ofron të njëjtat shërbime duke vajtur në komunitet apo në zonat më të largëta.

Në bazë të intervistave ka rezultuar se, profesioni i ushtruar nga disa paraligjorë nuk është i formalizuar. Kryesisht përfshirja e tyre në projekte apo angazhimi si paraligjorë është krejtësisht rastësor, duke u përzgjedhur bazuar në rezultatet e mira në universitet, apo të rinj që kanë pasur dëshirë të advokojnë dhe janë përfshirë në veprimtarinë e organizatës, si dhe të rinj që kanë pasur angazhime të mëparshme në komunitet.

Sa më sipër, paraligjorët thuajse në të gjitha shtetet e marra në analizë, sikurse në Shqipëri, punojnë në komunitet në zonat rurale me grupe të marginalizuara si gratë e dhunuara, komuniteti rom etj. dhe ofrojnë kryesisht ndihmë juridike parësore në formën e konsultimeve dhe këshillave juridike. Gjithashtu, në shumë prej vendeve objekt studimi është evidentuar roli i paraligjorit në rritjen e aksesit të publikut në ato qytete/fshatra të vogla, të cilat nuk janë lehtësisht të aksesueshme. Dobia e veprimtarive të këshilltarëve të komunitetit është se ata janë të parët që identifikojnë çështje ligjore që shqetësojnë banorët e komunitetit dhe sa më shumë të këshillojnë komunitetin, aq më shumë komuniteti dhe problemet e tij do të dëgjojnë.

Paraligjorët nuk janë avokatë dhe jo të gjithë kanë një diplomë në drejtësi, por ata kanë disa nga cilësitë e mëposhtme: njohuri themelore të ligjit dhe sistemit juridik; janë anëtarë të komunitetit, ose pjesë e organizatave me bazë komunitare; kanë aftësi dhe njohuri themelore/bazike për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ndërmjetësim, negociim etj.); janë në gjendje të përcjellin ide dhe informacion në komunitet duke përdorur metoda interaktive; mund të kenë një marrëdhënie pune me autoritetet lokale dhe ofruesit e shërbimeve; kanë aftësi për të organizuar një komunitet (për të rritur kapacitetet e komunitetit) që të rritet aftësia e komuniteteve për të zgjidhur problemet komunitare sistematike në të ardhmen.

Duke iu kthyer përmbajtjes së LKP, dhe duke pasur parasysh funksionet e paraligjorit në vendet objekt studimi dhe eksperiencën shqiptare, profesionet e LKP të cilat do të marrim në analizë për të kuptuar nëse janë të ngjashëm me profesionin e paraligjorit, janë profesionet si vijon: jurist me kod profesioni 2611; specialistë të tjerë ligjorë me kod profesioni 2619; specialistë të këshillimit dhe të punës sociale, me kod profesioni 2635; specialistë ligjorë dhe profesione që lidhen me to, me kod profesioni 3411; asistentë, specialistë të punës sociale, me kod profesioni 3412; përkatësisht profesione që janë pjesë të grupeve të vogla “specialistë në fushën ligjore” me kod profesioni 261, “specialistë të fushës shoqërore dhe fetare” me kod profesioni 263 dhe “specialistë ligjorë, të punës sociale dhe të fesë”, me kod profesioni 341 (pjesë të nëngrupeve të mëdha

“specialistë në fushën ligjore, shoqërore dhe kulturore” me kod profesioni 26 dhe “specialistë ligjorë, shoqëror, kulturor, të rendit dhe të tjera të ngjashme”, me kod profesioni 34).

Vërejmë se në LKP nuk ka asnjë profesion të parashikuar, i cili të ketë detyrë primare punën me komunitetin dhe nevojat e tij, pavarësisht disa detyrave të ngjashme që mund të kenë profesione të caktuara pjesë të kësaj liste. Profesionet e analizuara si pjesë e LKP edhe pse në pamje të parë kanë ngjashmëri në disa nga funksionet e paraligjorit, kanë diferencë në ushtrimin e funksioneve, detyrave, shkollimin, punësimin etj.

Më konkretisht, në ndryshim nga paraligjorët, të gjithë shembujt e punësimeve të profesioneve të analizuara më sipër, të cilat kanë ngjashmëri për nga funksionet me paraligjorin, kryesisht punësohen pranë institucioneve shtetërore por edhe në privat. Sa i përket shërbimeve sociale apo ligjore që profesionet e analizuara më sipër kryejnë si punonjës të institucioneve shtetërore, të ngjashme për nga funksionet me paraligjorin, ofrohen në kuadër të detyrave të ngarkuara si pjesë e institucionit, pra kryejnë detyrat në përputhje me kompetencat e institucionit, që jo gjithmonë përfshin shërbime sipas nevojave të qytetarëve apo komunitetit. Gjithashtu, konstatojmë se, këta profesionistë jo domosdoshmërisht ofrojnë ndihmë juridike, kjo e fundit detyrë e paraligjorit. Edhe në rastet që ofrohet ndihmë juridike nga ana e këtyre profesionistëve, punonjës të institucioneve, është individ i cili qaset në institucionet shtetërore përkatëse dhe në asnjë rast punonjësit e institucionit nuk shkojnë të identifikojnë rastet apo të ofrojnë shërbim ligjor pranë komunitetit. Për më tepër, edhe nëse do të ndalemi tek punësimi i tyre, ka një diferencë thelbësore pasi punonjësit e institucioneve nëpërmjet kualifikimeve të mëtejshme mund të ushtrojnë funksione të tjera duke kaluar në nivele të tjera profesioni (specialistë, përgjegjës, drejtorë etj.). Rritja profesionale e këtyre profesionistëve diferencon këto profesione nga paraligjori, i cili përpos kualifikimeve dhe trajnimeve që mund të marrë, punon gjithmonë dhe vetëm për komunitetin dhe nuk i ndryshojnë përgjegjësitë e ushtruara.

Ka rezultuar i njëjti konstatim edhe për profesionet e tjera të marra në analizë, si jurist; specialistë ligjorë, shoqëror, kulturor, të rendit dhe të tjera të ngjashme; specialistë ligjorë, të punës sociale dhe të fesë; apo dhe avokat, të cilët përpos të përbashkëtave, kanë një ndryshim themelor në ushtrimin e funksioneve të tyre, të punësimit etj.

Sa i përket profesioneve specifike, pëer shembull, grupi-njësi (profesioni) “Specialistë të këshillimit dhe të punës sociale” me kod profesioni 2635, këta specialistë intervistojnë klientët individualisht, familjarisht, ose në grup për të vlerësuar situatën e tyre dhe problemet si dhe për të përcaktuar llojin e shërbimeve për të cilat kanë nevojë, sillen si avokat për një grup klientësh në komunitet dhe llojnë për zgjidhje ndaj problemeve të tyre etj. Këta profesionistë mund të punësohen si përgjegjës sektori në institucione, specialistë, këshillues etj. Shembujt e punësimeve të këtij profesioni janë, ndër të tjera, si punonjës social në burg, për azilet, për fëmijët, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të grave, për personat me aftësi të kufizuar etj. Nëse e

vlerësojmë në tërësi këtë grup njësi profesioni, përveç disa detyrave të ngjashme me paralogjorin, nuk ka asnjë funksion tjetër të përbashkët.

Së fundi, do të analizojmë profesionin “asistentë, specialistë të punës sociale” me kod profesioni 3412, i cili ka më shumë karakteristika të përbashkëta me profesionin e paralogjorit. Prandaj, në vijim do të analizojmë këtë profesion për të kuptuar nëse mund të konsiderohet si paralogjor dhe nëse për këtë në LKP është i nevojshëm ndryshimi i terminologjisë, apo është rasti për të parashikuar parashikuar një profesion tërësisht të ri, i cili mund të listohet pas këtij grupi - njësi (profesioni).

Bazuar në analizën e mësipërme në pjesën e parë të këtij kapitulli, ky profesion, me kod profesioni 3412 ka si funksion të tij ofrimin e udhëzimeve klientëve për çështje sociale, kryerjen e punëve administrative duke zbatuar programe të asistencës sociale dhe shërbimeve ndaj komunitetit. Këta profesionistë asistojnë dhe këshillojnë klientët për të identifikuar qasjet e tyre në burimet e komunitetit për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë ndihmën ligjore, mjekësore, financiare, strehim, punësim, transport, kujdesi ditor dhe shërbime të tjera. Ata mund të punësohen në institucione, apo kompani shërbimesh sociale dhe shëndetësore, ose të vetëpunësohen. Mundësitë e punësimit për këtë profesion janë që të hyjë në profesion si ndihmës, asistentë. Me eksperiencë dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin specialistë i punës sociale. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një asistent, specialist i punës sociale mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivelin e menaxherit të shërbimeve sociale. Këta profesionistë punësohen si kujdestar në qendrën e përkujdesit social, kujdestar në qendrën sociale të rehabilitimit, kujdestar social (edukator), punonjës i përkujdesit social për personat me aftësi të kufizuar, punonjës social në sektorin e shëndetësisë etj.

Vihet re se edhe ky profesion i ngjashëm për nga detyra me paralogjorin, ka diferencë të madhe me atë çka është paralogjori. Nëse grupi-njësi profesioni “asistentë, specialistë të punës sociale”, punësohet në institucione apo kompani shërbimesh sociale dhe shëndetësore ose vetëpunësohet, paralogjori mund të punësohet edhe në institucione shtetërore si pjesë e ndihmës juridike, pasi puna e tij është pranë komunitetit. Pra, identifikimi i rasteve në dhe pranë komunitetit, e diferencon këtë profesion me paralogjorin. Një dallim tjetër qëndron në faktin se, funksionet e paralogjorit ushtrohen në shërbim të qytetarëve dhe komunitetit me qëllim rritjen e aksesit të tyre në sistemin e drejtësisë, ndërsa grupi-njësi profesioni “asistentë, specialistë të punës sociale” parashikon punësimin në qendrat e kujdesit social si kujdestar apo punonjës social.

Përfundim: *Përsa u paraqit dhe argumentua edhe më lart, bazuar në të gjithë elementet e marrë në analizë nga legjislacionet e shteteve objekt studimi, por edhe nga praktika shqiptare e paralogjorëve, në LKP nuk rezulton asnjë profesion që të ketë emërtimin paralogjor, dhe përpos ngjashmërive në ushtrimin e disa prej detyrave, asnjë prej profesioneve të parashikuara në LKP*

nuk përputhet plotësisht me profesionin e paraligjorit, apo të jetë i njëjtë për nga funksionet, punësimi, shkollimi me paraligjorin.

Me qëllim që analiza të jetë e plotë në këtë pjesë të studimit do të ndalemi edhe në legjislacionin shqiptar duke analizuar rrishtë dhe ndryshimet e tij pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese të reformës në drejtësi të vitit 2016, si më poshtë.

C. Analiza e legjislacionit shqiptar lidhur me aksesin në drejtësi ¹⁰²

Sikurse u përmend më sipër pjesë e kësaj analize është edhe legjislacioni shqiptar përkatës. Duke qenë se paraligjori dhe funksionet e tij kanë për qëllim që të mundësojnë forma të ndryshme të aksesit në drejtësi për qytetarët atëherë do të analizohet legjislacioni, i cili e garanton këtë të drejtë.

Neni 42 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë vendos bazat për garantimin e një procesi të rregullt ligjor. Sipas këtij neni, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Nocioni i “procesit të rregullt ligjor” përfshin disa komponentë si: aksesin në drejtësi, të qenit të pranishëm në procesin gjyqësor, barazia në mjete dhe e drejta për t’u vënë në dijeni për faktet e argumentet e palës kundërshtare dhe anasjelltas dhe e drejta për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme etj. Të gjithë këta komponentë përbëjnë garancitë e nevojshme për të garantuar funksionimin e parimeve bazë të shtetit të së drejtës.

Një formë specifike e të drejtës për një proces të rregullt ligjor është edhe e drejta për akses në drejtësi. Aksesin në drejtësi është garancia kushtetuese që i mundëson individëve mbrojtjen e të drejtave të shkelura. Shtetet janë të detyruara të garantojnë të drejtën e çdo individi për t’iu drejtuar gjykatës apo organeve të tjera të administratës publike.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka interpretuar gjerësisht çështjen e aksesit në drejtësi, duke argumentuar se është me rëndësi themelore për funksionimin e demokracisë dhe shtetit ligjor: *“Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës”*.

Mbrojtja e këtyre të drejtave nëpërmjet aksesit në institucionet e së drejtës, përbën një nga parimet themelore kushtetuese dhe konventore, parim të cilit i është dhënë një rëndësi e veçantë që në krijimet e institucioneve të para të së drejtës.

¹⁰² Një pjesë e informacionit është marrë nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Ministria e Drejtësisë

Një nga format më të rëndësishme të aksesit në drejtësi në funksion të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pjesë substanciale e nenit 6 të KEDNJ është aksesit në ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti. GJEDNJ në çështjen *Gnahore kundër Francës*, ka theksuar se për të shmangur arbitraritetin, shtetet duhet të garantojnë një mekanizëm që të krijojë një sistem të tillë ndihme juridike të garantuar nga shteti, që të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet,¹⁰³ e GJEDNJ. Ky qëndrim i GJEDNJ është në të njëjtën linjë edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (GJK), e cila e ka konsideruar ndihmën juridike të garantuar nga shteti si një pjesë themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. GJK ka theksuar se detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera.

Në këtë kuadër, në Republikën e Shqipërisë, Reforma në Drejtësi, e konsideruar si fryt i përpjekjeve të shumta për të krijuar bazën e një mentaliteti të ri në sistemin gjyqësor por jo vetëm, sollti një sërë ndryshimesh themelore legjislative duke i dhënë një rëndësi parësore garantimit të aksesit në drejtësi të qytetarëve përfshirë edhe shërbimin ligjor falas, reduktimit të kostove si dhe rritjes së cilësisë dhe performancës në dhënien e shërbimeve.

Shkurtimisht, në vijim do të parashtrohen disa nga risitë kryesore që passolli reforma në drejtësi në kuadër të aksesit në drejtësi për qytetarët, duke u përqendruar kryesisht në ndihmën juridike të garantuar nga shteti si një formë e posaçme e aksesit në drejtësi.

Ndryshimet kushtetuese që garantojnë aksesin në drejtësi

Thelbi i reformës në drejtësi në vendin tonë, kishte të bënte pikërisht me miratimin e ndryshimeve kushtetuese, ku nga 26 nene të Kushtetutës, që i përkasin sistemit të drejtësisë, reforma ndryshoi 21 prej tyre, dhe ndër të tjera u shkrinë tre institucione të përcaktuara në Kushtetutë dhe u parashikua krijimi i të paktën 12 institucione të reja (përmendim këtu Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë në funksion të garantimit të sistemit të pavarur dhe të paanshëm të drejtësisë).

Në kuadër të aksesit, ndryshimet kushtetuese dhe ligjore kanë sjellë një sërë risish, si në drejtim të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, të subjekteve që legjitimohen, kushteve dhe kriterëve, procedurave dhe afateve ligjore për t'u respektuar dhe plotësuar, me qëllim të një aksesit më të madh, qasjeje sa më cilësore të subjekteve kërkues ndaj gjykimit kushtetues, dhe për më shumë efektivitet të vetë Gjykatës Kushtetuese, si mjet ankimi kombëtar.

Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi, shteti shqiptar mori masa për të ndryshuar mekanizmin, mjetet ligjore dhe ligjin që garantonte ofrimin e ndihmës juridike. Qëllimi kryesor i

¹⁰³Disa nga standartet kryesore të përcaktuara nga GJEDNJ konsistojnë kryesisht në: “Gëzimin e garancive të nenit 6 në mënyrë të vërtetë dhe efektive dhe jo iluzive (*Staroszczyk kundër Polonisë* 22 Mars 20017, nr. 8932/05; *Airey kundër Irlandës*, 9 Tetor 1979, nr. 6289/73)”

këtyre ndryshimeve ishte krijimi i një sistemi efektiv të ndihmës juridike të ofruar nga shteti, i cili do të garantojë aksesin në institucionet administrative dhe gjyqësore me fokus të veçantë individët pa të ardhura të mjaftueshme, grupet e marginalizuara, grupet në nevojë etj. Kështu për të garantuar aksesin e individëve në nevojë apo grupeve të marginalizuara u ndërmorën hapa konkrete për të reformuar të gjithë sistemin e vjetër që garantonte ndihmën juridike.

Konkretisht, në vitin 2017, si pjesë e paketës ligjore të Reformës në Drejtësi, u miratua ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili shfuqizoi ligjin e mëparshëm duke ofruar një qasje të re ndaj aksesit të grupeve vulnerabël. Sipas Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, miratimi i ligjit të ri ishte i mirëpritur, ashtu si dhe përkushtimi i autoriteteve për ta bërë ndihmën juridike falas të qëndrueshme specifikisht për grupet që janë të dobëta ekonomikisht për të cilët duhet të ketë vëmendje të shtuar të autoriteteve për t’i garantuar akses efektiv në drejtësi. Ligji i ri, përcjell një shtrirje më të plotë nga pikëpamja normative duke e zgjeruar rrethin e subjekteve dhe objektit të ndihmës juridike falas.

Vështrim historik i kuadrit ligjor mbi ndihmën juridike

Në legjislacionin shqiptar, për herë të parë, ligjvënësi ka miratuar një *lex specialis* për ndihmën juridike në vitin 2008, specifikisht me anë të ligjit nr. 10039, datë 12.2008, “Për ndihmën juridike”. Me miratimin e ligjit për ndihmën juridike, sistemi i ndihmës juridike pritej të ndryshonte në mënyrë rrënjësore pasi ky ligj parashikonte përgjegjësi konkrete të agjencive shtetërore dhe atyre publike në zbatimin e standardeve të avancuara të ndihmës juridike. Ligji nr. 10039/2008, parashikonte kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti për personat pa mjete të mjaftueshme për të paguar shërbimin e dhënies së ndihmës juridike. Organi kompetent për dhënien e ndihmës juridike në bazë të kërkesës së subjektit përfitues¹⁰⁴ ishte Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike (KSHNJ), organ kolegjal shtetëror i përbërë nga 5 anëtarë, me një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme vetëm një herë.

Ndihma juridike klasifikohet në ndihmë juridike parësore dhe dytësore, ndërsa subjektet përfitues ishin personat në pamundësi financiare, të miturit si dhe personat që përfitonin nga mbrojtja sociale. Ndihma juridike parësore dhe dytësore jepej nga personat që ushtronin profesionin e avokatit sipas një liste të përcaktuar nga KSHNJ, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë ku KSHNJ, në funksion të zbatimit të politikës shtetërore për ndihmën juridike merrte vendime të detyrueshme për zbatim nga avokatët, monitoronte cilësinë e shërbimit të dhënë, madje ishte edhe një ndër subjektet iniciues të procedimit disiplinor sipas ligjit nr. 9109 datë 17.07.2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Një dispozitë e rëndësishme e këtij ligji, ishte dhe bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse, të specializuara në fushën e dhënies së ndihmës juridike, të cilat lidhnin kontrata bashkëpunimi me KSHNJ me qëllim dhënien e ndihmës juridike për subjektet përfitues.

¹⁰⁴Shih nenin 16 të ligjit nr.10039/2008.

Ofrimi ose jo i ndihmës juridike falas ishte në diskrecion të kryetarit të KSHNJ, ku referuar nenit 15 të ligjit, vendimi jepej duke pasur parasysh: 1) vlerën relative të ankesës apo pasurisë së përfshirë; 2) bazueshmërinë në ligj të argumenteve ligjore dhe pretendimeve, të cilat paraqiten në emër të kërkuarit apo përfituesit; 3) mundësinë e suksesit të ankesës apo të mbrojtjes; 4) kompleksitetin e çështjes; 5) aftësinë e kërkuarit apo të përfituesit, që të vetëpërfaqësohet. Ndaj vendimit të kryetarit mund të bëhej ankim në KSHNJ brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij, ndërsa kundër vendimit të refuzimit të dhënies së ndihmës juridike mund të bëhej ankim në gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Nga një analizë e dispozitave të këtij ligji konstatohet se procedura e parashikuar ishte relativisht e vakët duke lënë vend për vakum ligjor arsye të cilat, së bashku me zvarritjet dhe periudhën e gjatë nga hyrja në fuqi deri në zbatimin e ligjit sollën në mos funksionimin *de facto* të këtij ligji dhe rrjedhimisht cënimin e aksesit në drejtësi të personave në nevojë. Komisioni Evropian në Progres-Raportin për Shqipërinë, për vitin 2012,¹⁰⁵ ka shqyrtuar në detaje ecuritë mbi të drejtën për akses në gjykatë dhe progresin që solli zbatimi i këtij ligji, duke theksuar se: *“Pak përparim është bërë në lidhje me aksesin në drejtësi. Zbatimi i ligjit “Për ndihmë juridike falas” ka qenë i ngadaltë për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm dhe mungesës së koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Gjithashtu, nuk zbatohen me efektivitet as aktet nënligjore për rekrutimin e avokatëve të ndihmës juridike falas dhe as procedurat për kërkimin e ndihmës juridike falas. KSHNJ ka trajtuar disa çështje, por ndërgjegjësimi për ligjin dhe shërbimet e Komisionit mbeten të pamjaftueshme, përfshi edhe rangun e nëpunësve shtetërorë që merren me kategoritë e cënueshme. Aksesin në drejtësi për kategoritë e cënueshme nuk është i garantuar, kryesisht për shkak të tarifave të larta të administrimit gjyqësor”.*

Në vitin 2017, në kuadër të këtyre përpjekjeve për të përmirësuar sistemin e ndihmës juridike dhe për ta bërë një mjet efektiv për qytetarët, u miratua edhe ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, i cili ka për qëllim krijimin e një sistemi për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë individët në sistemin e drejtësisë, si dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efikase dhe efektive. Në bazë të këtij ligji ndihma juridike falas ofrohet si për ndihmën juridike parësore ashtu edhe për atë dytësore. Përsa i përket ofrimit të ndihmës juridike parësore, ligjvënësi ka parashikuar mjete ligjore jo-shteruese në formën e dhënies së informacioneve në tërësi për sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, akteve normative në fuqi, si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor.

Gjithashtu, ndihmë juridike parësore në kuptim të ligjit konsiderohet edhe dhënia e këshillimit, dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore, përfaqësimi përpara organeve administrative ose procedurave për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

¹⁰⁵ http://www.parlament.al/Files/Integrimi/2012_progress_report_en_23392_1.pdf fq. 17-18

Ligji parashikon se ndihmë juridike parësore do të jepet edhe nëpërmjet dhënies së këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, si dhe dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike, që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Ligjvënësi ka parashikuar një spektër të gjerë dhe jo shterues për sa i përket ofrimit të ndihmës juridike parësore ku përveç dhënies së këshillimeve, informacionit të përgjithshëm mbi sistemin ligjor, mjeteve ligjore mbrojtëse, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nëpërmjet ndërmjetësimit apo formave të tjera alternative, ka garantuar dhe ofrimin e shërbimit ligjor për mosmarrëveshje që lidhen me veprimtarinë e institucioneve administrative, aktet e tyre etj. Ky ligj në mënyrë të posaçme, nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike parësore ka garantuar akses para institucioneve administrative në të tre elementët e shërbimit ligjor falas duke parashikuar këshillim ligjor, përgatitje aktesh dhe përfaqësim pranë tyre.

Ligji i ri i ndihmës juridike të garantuar nga shteti ashtu sikurse u përmend më sipër, ndryshoi mekanizmin e mëparshëm që ofronte ndihmë ligjore falas, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, duke krijuar Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Kjo drejtori, e cila është në varësi të Ministrisë së Drejtësisë administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

Në bazë të ligjit ndihma juridike parësore ofrohet pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Në kuptim të ligjit kjo qendër është njësi e specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Organi kompetent i qeverisjes qendrore që miraton krijimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore është Ministria e Drejtësisë. Kjo procedurë realizohet pasi Ministria të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, organ ky i krijuar në zbatim të Reformës në Drejtësi dhe ndryshimeve kushtetuese.

Për sa sқaruam më sipër, ndihma juridike parësore do të ofrohet pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore nga punonjës që do të marrin trajnim të posaçëm, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe nga klinikat ligjore të themeluara pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Aktualisht, janë hapur dhe funksionojnë 6 Qendra të Shërbimit të ndihmës juridike parësore, nën administrimin e DNJF në qytetet Tiranë, Lushnje, Durrës, Fier, Lezhë dhe Pogradec, ndërkohë që Ministria e Drejtësisë është duke hapur qendra të tjera në qytete të ndryshme. Brenda vitit 2020, Ministria e Drejtësisë do të vijojë me hapjen e qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike

parësore, konkretisht në Gjirokastrë dhe 3 qendra të tjera (qytetet /qarku është duke u identifikuar dhe vlerësuar), duke e çuar numrin total të qendrave të administruara në 10 qendra¹⁰⁶.

Në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë të punësuar “punonjës me trajnim të posaçëm”, ku sipas kritereve të rekrutimit të përcaktuara nga DNJF është punonjësi i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimi të posaçëm, i cili ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Eksperienca për t’u punësuar në këto njësi shërbimi të ndihmës juridike kërkohet jo më pak se 1 vit eksperiencë në punë si jurist ose avokat¹⁰⁷.

Një nga risitë thelbësore të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në kuadër të aksesit në drejtësi është përcaktimi i organizatave jofitimprurëse të autorizuara si ofruese të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Aktualisht janë autorizuar 12 organizata jofitimprurëse, të cilat krahas qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Klinikave të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, përmes eksperiencës së tyre shumëvjeçare sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas tek qytetarët në qytetet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Beratit etj.

Gjithashtu, një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe Klinikat e Ligjit, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, DNJF bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuara. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Gjatë pandemisë të Covid-19 u prezantuan për herë të parë shërbimet online, ku Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundur për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes platformës *juristionline.al*. Gjithashtu, në funksion të garantimit të shërbimit ligjor falas dhe informimit të qytetarëve Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me OSFA ka vendosur në dispozicion një numër të gjelbër falas për të gjithë qytetarët, për t’iu ardhur në ndihmë sidomos edhe referuar situatës së pandemisë.

¹⁰⁶ Informacion i marrë nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

¹⁰⁷ Informacion i marrë nga faqja e internetit DNJF: <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/vende-vakante/>

Përfundim: Nga vështrimi i legjislacionit të reformuar të aksesit në drejtësi konstatojmë se, paraligjori nuk është parashikuar si profesion jo vetëm në LKP, por as në akte të tjera ligjore.

D. Raporte monitoruese për sistemin aktual të ndihmës juridike si dhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike

Më sipër u sqaruan arsyet se pse asnjë nga profesionet pjesë e LKP-së nuk mund të konsiderohet apo emërtohet si paraligjor. Megjithatë, për të arritur në një përfundim lidhur me rëndësinë e këtij profesioni, nevojën për të pasur si profesion, në këtë pjesë të studimit do të analizohen raporte monitoruese për sistemin aktual të ndihmës juridike si dhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike. Kjo pjesë e studimit me të dhëna konkrete do të shërbejë edhe për të dhënë sugjerime dhe konkluzione të bazuara në të dhëna cilësore dhe sasiore.

Referuar studimit të realizuar në vitin 2019 nga Instituti Liberal Shqiptar për nevojat ligjore në Shqipëri¹⁰⁸ ka rezultuar se, në periudhën janar 2016 dhe qershor 2019 një në dy shqiptarë (52.3%) kanë hasur të paktën një herë një problem, për të cilin u është dashur të kenë një mjet ligjor. Pra, më shumë se gjysma e të intervistuarve kanë pasur nevoja ligjore apo kanë kërkuar akses në një mjet ligjor për të zgjidhur problematikat e tyre. Kjo e dhënë tregon nevojat e qytetarëve shqiptarë për ndihmë juridike pavarësisht ekzistencës së shërbimeve ligjore falas nëpërmjet skemës së ndihmës juridike shtetërore. Nga studimi ka rezultuar se qytetarët e intervistuar kanë besim të ulët në sistemin e drejtësisë. Më konkretisht, rreth 64% e të gjithë të anketuarve nuk besojnë në sistemin e drejtësisë, pasi konsiderojnë se sistemi është i paanshëm, dhe vetëm 6% prej tyre besojnë se është i drejtë. Në shumicën e rasteve, 71% e të gjithë të anketuarve, bien dakord që sistemi aktual favorizon të fuqishmit dhe të pasurit. Më shumë se gjysma e të anketuarve (53%) nuk kanë dijeni për të drejtën e tyre për ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Informacioni për ndihmën juridike që nuk ofrohet nga shteti pothuajse mungon, pasi vetëm një në dhjetë të anketuar është në dijeni që ka organizata jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike për personat në nevojë.

Në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2018,¹⁰⁹ evidentohet se, edhe pse ligji i ri për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, e ka zgjeruar rrethin e kategorive përfituese, dhe ka zhvilluar konceptin e ndihmës parësore dhe ndihmës dytësore, gjithsesi skema e ndihmës ligjore falas, akoma ka nevojë të zhvillojë një mekanizëm funksional të arritshëm, si dhe akses në shërbime. Pjesa më e madhe e çështjeve, ku përfshihen grupet vulnerabël mbulohen akoma nga shoqëria civile me mbështetje donatorësh.

Në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2019, evidentohet se: *“Gratë nga grupe të disavantazhuara dhe të marginalizuara, të tilla si gratë rome dhe egjiptiane, shpesh nuk kanë dijeni për të drejtat e tyre dhe mënyrës së qasjes në shërbime, përfshirë strehëzat. Zbatimi efektiv i sistemit të ndihmës juridike falas dhe promovimi i ndërjegjësimit dhe fuqizimit ligjor do të jenë thelbësore për të siguruar qasjen e grave në drejtësi...Ka ende raporte që tregojnë për pengesat e*

¹⁰⁸ <file:///C:/Users/user/Downloads/Legal%20Needs%20Full%20Report%E2%80%94Draft.pdf>

¹⁰⁹ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>, fq. 30

*hasura në qasjen në drejtësi dhe mungesë të aksesit në ndihmë juridike për grupet në nevojë, përfshirë romët, egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat me vështirësi ekonomike. Shumica dërrmuese e rasteve që përfshijnë grupe në nevojë trajtohen ende nga grupe të shoqërisë civile me mbështetjen e donatorëve”.*¹¹⁰

Në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2020, evidentohet se, është i nevojshëm zbatimi efektiv i sistemit të ndihmës juridike falas dhe vlerësohet se, promovimi i ndërjegjësimit dhe fuqizimit ligjor janë thelbësore për të siguruar qasjen e grave në drejtësi.¹¹¹

Në vijimësi do të paraqesim të dhënat nga disa raporte monitorimi që Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka realizuar për ligjin e ri të ndihmës juridike lidhur me garantimin e aksesit të qytetarëve në ndihmën juridike falas.

Më konkretisht, sipas një raporti studimor për aksesin në drejtësi të grupeve vulnerabël, “Aksesi në drejtësi për kategorinë me të ardhura të pakta ose të pamjaftueshme, bazuar në ligjin nr.111/2017 për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,¹¹² rezulton se, afërsisht gjysma e të intervistuarve kanë dijeni të përgjithshme lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti, por në terma konkrete nuk janë në gjendje ta përcaktojnë se ku konsiston ajo.

Ashtu, sikurse u përmend më sipër, përpos një skeme të re të ndihmës juridike funksionale dhe në shërbim të qytetarëve, ende shumë individë nuk arrijnë dot të marrin shërbime, pasi ata nuk jetojnë në qytetet ku janë ngritur qendrat e ndihmës juridike parësore, ata nuk janë pjesë e vendbanimeve ku organizatat e shoqërisë civile janë autorizuar për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore si dhe nuk ndodhen në qytete ku janë ngritur tashmë klinikat e ligjit (Durrës, Tiranë, Shkodër, Vlorë etj.). Kjo passjellë mungesë të aksesit të qytetarëve në shërbim ligjor falas nga njëra anë dhe nga ana tjetër nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas janë të shumta.

Referuar një raporti tjetër të ndërmjetëm të monitorimit “Mbi ngritjen dhe funksionimin e aktorëve përgjegjës të ofrimit të ndihmës juridike parësore” të KShH-së,¹¹³ për periudhën janar-maj 2020, të shtrirë në qytetet Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Elbasan, rezulton se për shkak të vonesave të funksionimit të skemës së ndihmës juridike parësore, një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve juridike parësore falas kanë luajtur OJF-të, KL-të si dhe është vënë re një angazhim nga studentët dhe paraligjorët për t’u përfshirë në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Sipas një studimi mbi aksesin në drejtësi në Shqipëri të PNUD,¹¹⁴ nevojat për drejtësi janë të mëdha dhe ato mbeten përgjithësisht të paplotësuara. Në bazë të këtij studimi, për të cilin u

¹¹⁰ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>, fq. 28 dhe 30

¹¹¹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf, fq. 34

¹¹² https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH_Shkurt-2018.pdf?fbclid=IwAR2oZBPFJIRfSg3ShejIbIc40JNWpVscHtPYGrJGrSDwe1MrPx1L_WrSLoM, faqe 7

¹¹³ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/07/Mbi-ngritjen-dhe-funksionimin-e-aktor%C3%ABve-p%C3%ABrgjegj%C3%ABs-t%C3%AB-ofrimit-t%C3%AB-ndihm%C3%ABs-juridike-par%C3%ABsore.pdf?fbclid=IwAR25L64tZHm83gTW5y_HviUVjbN2UvUtAMhjfInYm56phTetzEnV9kTqSkk, faqet 5 dhe 10

¹¹⁴ file:///C:/Users/user/Downloads/FINAL_DRAFT_SURVEY_SQ.pdf, faqe 7,8

intervistuan 1758 individë, është arritur në përfundimin se, pothuajse gjysma e popullatës ka pasur probleme ligjore gjatë pesë viteve të fundit dhe se, në pjesën më të madhe, këto probleme kanë mbetur të pazgjidhura për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit ligjor të shoqërisë dhe performancës së ulët të institucioneve në sektorin e drejtësisë. Kjo është sidomos e vërtetë për anëtarët e grupeve të pafavorizuara, si të varfërit, personat me nivel të ulët arsimor, romët, anëtarët e komunitetit LGBTI, viktimat e dhunës në familje, e të tjerë.

Rezultatet e studimit nxjerrin në pah kërkesën e madhe për akses në drejtësi nga individët në Shqipëri. Nisur nga fakti që pothuajse gjysma e popullatës kanë pasur nevoja lidhur me drejtësinë këto pesë vitet e fundit, ekziston nevoja për një sistem drejtësie të drejtë e të paanshëm që t'u përgjigjet këtyre nevojave. Individët kanë nivel mjaft të ulët njohurie për të drejtat e tyre: më se një e katërta e personave të anketuar nuk ishin në gjendje të përmendnin emrin e asnjë prej të drejtave dhe lirive kushtetuese. Niveli i ulët i njohjes dhe njohurive ligjore është më i theksuar në radhët e popullatës romë, personat me nivel arsimor të ulët, dhe nivel të ardhurash më të ulta. Pothuajse tri të katërtat e popullatës besojnë se sistemi shqiptar i drejtësisë nuk i mbron të drejtat e tyre. Këta tre faktorë mungesa e njohurive për ligjin, qëndrimet e dyshimta ndaj drejtësisë, dhe mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë paraqesin një pamje të brishtë të aksesit në drejtësi në Shqipëri.

Sipas të anketuarve, performanca në nivelin e duhur e institucioneve të sektorit të drejtësisë është ndoshta pengesa kryesore ndaj aksesit në drejtësi në Shqipëri. Disa grupe të pafavorizuara e kanë edhe më të vështirë të kenë akses në drejtësi dhe t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë të drejtë. Në këto grupe përfshihen romët, personat me të ardhura të ulta, ata me nivel arsimor të ulët, anëtarët e komunitetit LGBTI, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, dhe fëmijët në institucione rezidenciale.

E. Konstatime dhe sugjerime për institucionalizimin e profesionit të paraligjorit

Në këtë pjesë të studimit do të arrijmë në konkluzione nëse profesioni i paraligjorit është i rëndësishëm në Shqipëri, nëse është e nevojshme që të parashikohet ky profesion i posaçëm dhe në Shqipëri, dhe çfarë sjell ky profesion në sistemin e ndihmës juridike apo sistemin e drejtësisë në tërësi, ndryshe nga profesione të tjera.

Nga të dhënat e studimeve të mësipërme lidhur me aksesin në drejtësi, rezultojnë se, nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike janë të mëdha. Grupet vulnerabël kanë më pak akses në sistemin e drejtësisë, si dhe evidentohet se, është e nevojshme që sistemi i drejtësisë t'i përgjigjet të gjitha këtyre nevojave. Gjithashtu, rezultojnë se ka një mungesë besimi në institucionet shqiptare dhe performanca e këtyre të fundit nuk është në nivelin e duhur dhe ndoshta kjo është pengesa madhore ndaj aksesit në Shqipëri.

Studimet e mësipërme përfshijnë një periudhë kohore 2016-2020 dhe tregojnë edhe përmirësimin e aksesit në drejtësi si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit të ri të ndihmës juridike falas. Gjithsesi, ky sistem aktual përpos gjithë arritjeve në garantimin e aksesit nëpërmjet ndihmës juridike falas ka nevojë që të ketë një parashikim të ri në listën e profesioneve si ai i paraligjorit, si një profesion që do të jetë më afër qytetarit duke mundësuar lidhjen e komunitetit në shërbimet e ndihmës juridike falas, sindihmë juridike parësore, dytësore etj.

Nga gjithë analiza e realizuar në kuadër të këtij studimi ka rezultuar se, shtetet që kanë të parashikuar këtë profesion kanë pasur përmirësim dhe rritje të aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Konkretisht, në Sierra Leone, ku sistemi i ndihmës juridike falas është i ngjashëm me sistemin tonë, paraligjori është institucionalizuar si profesion. Në këtë shtet paraligjorët bëjnë një punë të rëndësishme në rritjen e qasjes në drejtësi, veçanërisht në komunitetet e largëta si dhe punojnë me klientët për të gjetur zgjidhje konkrete për padrejtësitë, shpesh në nivelin e komunitetit ose administratës. Pas luftës civile, qeveria e Sierra Leone, organizata ndërkombëtare dhe organizata të shoqërisë civile përqaftuan përdorimin e paraligjorëve me bazë komunitare si një mënyrë për të çuar përpara drejtësinë. Në Afrikën e Jugut paraligjorët si ofruer të ndihmës juridike shpesh janë qasja e parë për njerëzit që kërkojnë ndihmë juridike (në çështjet civile ose penale), dhe që ofrojnë këshilla të përgjithshme juridike për çështjet e paraqitura për ndihmë juridike. Aktualisht, në Afrikën e Jugut ka mbi 2000 personel juridik, i cili përfshin avokatë, kandidatë për avokatë dhe paraligjorët. Në Moldavi paraligjorët luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe tre qëllime kryesore: edukimin e komuniteteve për të drejtat e tyre dhe mjetet për të kërkuar të drejtat e tyre; ofrimi i këshillave themelore juridike; dhe lehtësimi i përfshirjes së anëtarëve të komunitetit në proceset e vendimmarrjes dhe aktivitetet me interes të komunitetit.

Referuar informacionit të mësipërm konsiderojmë dhe sugjerojmë se:

Duke u mbështetur në eksperiencën e shteteve të mësipërme si dhe në eksperiencën shqiptare kemi evidentuar se paraligjori është një koncept i ri në realitetin shqiptar dhe si i tillë jo të gjithë qytetarët apo profesionistët të ndryshëm të sistemit të drejtësisë janë të njohur me këtë profesion. Nga eksperiencia e organizatave këto të fundit na kanë sqaruar se paraligjori luan një rol kyç dhe thelbësor për mirëfunksionimin e sistemit të ndihmës juridike.

Rëndësia dhe roli i paraligjorit konsiston në faktin se ata janë shumë afër komunitetit dhe kanë mundësi që të njihen me problemet e komunitetit dhe t'i adresojnë ato në institucionet përgjegjëse apo në ofruerit e ndihmës juridike parësore apo dytësore (avokat, jurist) me qëllim zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Paraligjorët si profesionistët më të afërt të komunitetit kanë mundësi të adresojnë problemet e tyre dhe të jenë një zë për qytetarët para institucioneve shtetërore. Duke qenë se paraligjorët kanë njohuri ligjore, llojnë për të drejtët e qytetarëve me qëllim zgjidhjen përfundimtare të tyre. Paraligjorët mund të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat, rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, rritjen e aksesit të banorëve në komunitetet më të largëta dhe grupeve vulnerabël, reduktimin e kostove gjyqësore, duke kontribuar në

qeverisjen e mire dhe në një afat më të gjatë në uljen e varfërisë në komunitetet rurale si rezultat i angazhimit aktiv të komuniteteve në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të tyre.¹¹⁵

Nëse do të krahasojmë praktikën e paralogjorëve në Shqipëri dhe rolin që aktivistët kanë në krahasim me paralogjorët, ka një diferencë shumë të madhe midis këtyre profesionistëve, pasi aktivistët identifikimin e rastit e referojnë tek OJF-të dhe nuk kanë më dijeni për mënyrën sesi zgjidhet rasti. Ndërsa, paralogjorët pasi identifikojnë rastin, i japin qytetarit këshillat paraprake të nevojshme që lidhen me çështjen, procedurat që duhen ndjekur, dokumentacionin e nevojshëm dhe e referojnë rastin në klinikat e ligjit apo OJF-të dhe ndjekin edhe zgjidhjen përfundimtare të saj. Paralogjorët kanë kontakte dhe marrëdhënie të ngushtë me komunitetin dhe ata ndjekin të gjithë çështjen që prej identifikimit e deri në zgjidhjen e saj. Nuk është paralogjori që zgjidh përfundimisht çështjen, por duke qenë se është në kontakt të vazhdueshëm me qytetarin, kjo ndikon edhe në rritjen e llogaridhënies së tij ndaj qytetarit. Paralogjorët e intervistuar na kanë sqaruar se, kontaktet e vazhdueshme i bëjnë ata që të kërkojnë informacion te juristi, avokati apo klinika e ligjit ku e kanë referuar rastin. Paralogjori nuk luan vetëm rolin e ndërmjetësit ndërmjet komunitetit dhe profesionistit (jurist, avokat, institucion etj.), por roli i tij është i rëndësishëm për shkak se duke ndjekur çështjet në të gjitha fazat, mundëson zgjidhjen finale të saj. Duke qenë se puna e paralogjorit është e lidhur ngushtësisht me komunitetin, kjo i mundëson atyre të takojnë njerëz dhe të identifikojnë rastet konkrete, apo rastet strategjike që i përkasin apo çënojnë komunitetin e gjerë. Për shembull, disa raste që janë identifikuar nga paralogjorët janë legalizimi i banesave në Selitë ku u gjet një zgjidhje për të gjithë komunitetin që kishte të njëjtin problem në atë zonë. Gjithashtu, të dhëna të tjera të sjella si shembull nga praktika e të intervistuarve, mund të jenë një ndërhyrje që mund të bëjë paralogjori në rastin e ndërtimit të një hidrocentrali në një zonë të caktuar. Në këtë rast paralogjori mund të ndihmojë drejtpërdrejtë qytetarët që të ndërmarrin veprime konkrete ligjore, për të cilat ata nuk kanë dijeni, me qëllim parandalimin e ndërtimit të tij. Më konkretisht, qytetarët, të cilët nuk kanë njohuri ligjore mund të organizojnë protesta, por pavarësisht kësaj, institucionet shtetërore shpesh ndodh që të vijojnë me procedurat ligjore të cilat mund të shkelin të drejtat e tyre. Paralogjori, i cili nëpërmjet njohurive ligjore që ka, duke identifikuar këtë problematikë që prek një komunitet të gjerë, mund të parandalojë ndërtimin e hidrocentralit.

Duke qenë se paralogjorët ndjekin rastin edhe kur ai trajtohet nga juristi apo avokati, ata kanë mundësinë që të aftësohen më tej për të ofruar këto shërbime nëpërmjet njohurive që fitojnë nga juristi apo avokati. Organizatat e intervistuarra na kanë informuar se, kjo praktikë pune ka shërbyer që paralogjorët të rrisin kapacitetet e tyre.

Ofruesit e ndihmës juridike parësore punojnë në zyrë dhe ata ofrojnë shërbime për çdo qytetar që qasen në këto zyra. Komunitetet vulnerabël dhe qytetarë të ndryshëm nuk kanë informacion apo akses në këto shërbime apo nuk kanë informacion për të drejtat e tyre. Paralogjori është

¹¹⁵ Këto konkluzione janë bazuar në punën kërkimore objekt të këtij studimi të kryer nga ekspertet, të dhëna që evidentohen edhe në kapitujt pararendës të këtij studimi.

profesionisti, i cili duke qenë më afër këtyre kategorive, ka mundësinë më të mirë që të informojë qytetarët/komunitetin dhe të identifikojë rastet dhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike parësore, dhe nëse është rasti duke referuar çështjet pranë ofruesve të shërbimeve juridike dhe/ose pranë institucioneve shtetërore. Edhe nga studimet sikurse u pasqyrua edhe më sipër, rezulton se, ka mungesë aksesit të grupeve vulnerabël në drejtësi.

Gjithashtu, organizatat që kanë punësuar paraligjorë na kanë sqaruar se, ata njohin target-grupet, komunitetin, mentalitetin e tyre, nivelin gjuhësor, dhe mund t'i këshillojnë më mirë sesa një jurist apo avokat, të cilët përdorin terminologji ligjore duke e bërë më të vështirë kuptueshmërinë sidomos për komunitetet më vulnerabël.

Është evidentuar gjithashtu nga eksperiencia me paraligjorët se, ata që kanë pasur një formim juridik bachelor ofrojnë një shërbim ligjor më cilësor duke lehtësuar edhe punën e klinikës së ligjit, OJF, apo avokatit të cilit i është referuar rasti. Këta paraligjorë kanë qenë më efektivë duke orientuar qytetarin për dokumentacionin që nevojitet për të vënë në lëvizje një institucion administrativ apo gjyqësor, apo duke adresuar rastin te institucioni përgjegjës. Paraligjorët luajnë një rol të rëndësishëm duke ndihmuar dhe lehtësuar punën e ofruesve të ndihmës juridike parësore apo dhe dytësore. Një e dhënë e tillë ka rezultuar edhe në eksperiencën e shteteve që e kanë të formalizuar këtë profesion.

Përzgjedhja rastësore e deritanishme e paraligjorëve nuk ofron qëndrueshmëri për këtë profesion dhe nuk i jep paraligjorëve një status të caktuar në profilin shoqëror dhe atë ligjor. Përzgjedhja e paraligjorëve duhet të jetë e mirë-përcaktuar me kritere të qarta pasi puna e tyre do të jetë e lidhur drejtpërdrejtë me shërbimet që do i ofrohen komunitetit, kategorive vulnerabël etj.

Paraligjorët mund të luajnë një rol të rëndësishëm edhe përse i përket edukimit ligjor apo ndërgjegjësimit të komuniteteve.

Duke qenë se ky profesion nuk ka rregullim ligjor në Shqipëri është vënë re se, nuk ka interes sidomos nga studentët me rezultate të larta që të angazhohen dhe të ushtrojnë detyrat e paraligjorit. Për rëndësinë që ka në sistemin e ndihmës juridike dhe në rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë sugjerohet nga të intervistuarit që ky profesion të institucionalizohet dhe të parashikohen detyrat konkrete të paraligjorit, punësimi i tij si dhe pagesat. Paraligjorët është vënë re se janë më të motivuar për të punuar pranë komuniteteve, ndryshe nga studentët apo profesionistë të tjerë.

Paraligjorët mundësojnë që aksesit i qytetarëve të rritet edhe në zonat më të largëta dhe të bëhen zëri i tyre në sistemin e drejtësisë. Një konstatim i tillë rezultoi edhe nga analiza e shteteve që kanë paraligjorin pjesë të sistemit të ndihmës juridike apo të sistemit të drejtësisë.

Lidhur me nevojën për të pasur një profesion të posaçëm si paraligjori në Shqipëri, nga analiza na ka rezultuar se, ky profesion nuk ka mbivendosje me asnjë profesion tjetër (asistent avokat, avokat

etj.) pasi të gjitha profesionet aktuale ofrojnë shërbime ligjore për qytetarët, por nuk janë afër qytetarëve, ashtu sikurse është paraligjori. Identifikimi i rasteve në komunitet, njohja e komuniteteve i bën paraligjorët më të suksesshëm për të garantuar aksesin e qytetarëve në drejtësi. Gjithashtu, ndryshe nga profesionistë të tjerë si asistent avokati etj., paraligjori nuk lidhet me këto profesione përsa i përket formimit profesional, por edhe përsa i përket detyrave që ka.

Pasja e një profesioni të posaçëm do të ndihmojë dhe në qëndrueshmërinë e paraligjorit pasi asistent avokati punon në mënyrë të ndërmjetme përrreth një vit dhe më tej thëllon studimet e tij për t'u bërë avokat dhe nuk ka interes të bëhet paraligjor duke punuar në komunitet. Gjithashtu, edhe të gjitha profesionet e tjera të ngjashme me paraligjorin nuk kanë interes që të punojnë për një kohë të gjatë si paraligjor, pasi në LKP është parashikuar mundësia e rritjes së tyre profesionale nga asistentë deri në avokatë etj. Paraligjori si profesion i institucionalizuar do të jap mundësinë e qëndrueshmërisë së këtij profesioni dhe interesin e paraligjorit për t'u aftësuar.

Profesioni i paraligjorit tashmë ekziston në praktikë si profesion, me funksione të ndryshme nga profesionistë të tjerë të parashikuar në LKP.

Nga analiza e shteteve kemi evidentuar se shtete të tjera që e kanë të parashikuar profesionin e paraligjorit, ka mundësuar që të plotësojnë boshllëqe që ka pasur sistemi i ndihmës juridike (Moldavia).

Paraligjori nëpërmjet informacionit ligjor që i jep komuniteteve të caktuara ndikon dhe në zvogëlimin e problemeve sociale, që mund të ketë anëtarët e një komuniteti, të cilat mund të zgjidhen me një këshillë ligjore.

Përfundimisht, konstatojmë se, koncepti i paraligjorit nuk ekziston as në legjislacion, në literaturë apo doktrinë ligjore. Në dy grupet e mëdha të marra në shqyrtim “Specialistë me arsim të lartë” dhe “Teknikë dhe specialistë në zbatim”, ashtu edhe nëngrupet dhe grupet e vogla, asnjë nga këto kategori profesionale që përmendëm nuk është specifike me funksionin e paraligjorit. Analiza e profesioneve u fokusua jo vetëm në grupet dhe nëngrupet që lidhen me profesione ligjore, por edhe profesione sociale. Profesionet ligjore dhe konkretisht nëngrupet “specialistë në fushën ligjore” si dhe grupet e vogla të tyre, ngjasojnë më tepër me profesionin e avokatit, juristit, gjyqtarit etj. Ndërsa, përsa i përket grupeve dhe nëngrupeve që lidhen me specialistë të fushës shoqërore apo sociale, ngjasojnë me detyrat e një psikologu apo punonjësi social.

Nga gjithë analiza e mësipërme, të dhënat cilësore dhe sasiore të parashtruara më sipër, argumentat e dhëna për rëndësinë që ka paraligjori, vlerësojmë/sugjerojmë që në LKP duhet të parashikohet një profesion i ri i emërtuar “Paraligjor”. Ky profesion i veçantë mund të integrohet edhe në një grup-njësi profesioni të posaçëm, i cili mund të emërtohet “paraligjor”, dhëmund të përfshihet në fushën ligjore ose sociale, me veprimtari të lidhur ngushtësisht me komunitetin. Profesionin i

paraligjorit mund të vendoset pas profesionit me kod profesioni 3412, ose në mënyrë alternative, mund të parashikohet si shembull punësimi profesioni me kod profesioni gjashtëshifror.

PJESA IV

INSTITUCIONALIZIMI I PARALIGJORIT NË SHQIPËRI

A. Rregullimi i paraligjorit në Shqipëri dhe komunitetet me të cilat mund të punojë në praktikë

Referuar studimeve të ndryshme të mësipërme të përfshira në këtë studim ka rezultuar se, sistemi i ndihmës juridike në Shqipëri nuk arrin të mbulojë plotësisht nevojat ligjore që kanë qytetarët për ndihmë juridike, sidomos të grupeve që janë më të margjinalizuara dhe komuniteteve të largëta. Duke analizuar edhe legjislacionin më të hershëm të ndihmës juridike falas, ka rezultuar se sistemi i ndihmës juridike nuk ka qenë efektiv dhe i arritshëm për të gjithë qytetarët. Përpos ndryshimeve të fundit që ka pësuar legjislacioni ai nuk mbulon plotësisht nevojat për ndihmë ligjore të komuniteteve të ndryshme. Sikurse rezulton edhe nga eksperiencia e shteteve objekt studimi dhe eksperiencia shqiptare me paraligjorë, përfshirja e paraligjorëve në ofrimin e ndihmës juridike ndikon në fuqizimin ligjor të individëve, komuniteteve në nevojë, të cilët për shkak të situatës së tyre financiare nuk mund të kenë akses në sistemin e drejtësisë.

Bazuar në analizën e legjislacioneve të vendeve objekt studimi, si dhe në eksperiencën shqiptare, konstatojmë se, përpos zhvillimeve të ndryshme politike, sociale, kulturore apo sistemeve të ndryshme të ndihmës juridike, paraligjori emërtohet si profesion me terminologji të ndryshme si, paraligjorë, paraligjorë me bazë komunitare/i bazuar në komunitet, këshilltarë publikë etj. Pavarësisht emërtimeve të tyre, paraligjorët në të gjitha shtetet e analizuar më sipër, si dhe referuar eksperiencës së organizatave shqiptare, kryejnë funksione të ngjashme, apo dhe të njëjta duke i shërbyer komuniteteve për qasjen e tyre në shërbime ligjore falas pranë ofruesve të shërbimeve ligjore, apo institucioneve shtetërore. Paraligjorët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në identifikimin e rasteve në komunitetet më të largëta dhe kanë adresuar çështjet e tyre deri në zgjidhjen përfundimtare pranë institucioneve përgjegjëse.

Më konkretisht, paraligjorët i dedikohen fuqizimit ligjor të komuniteteve me të cilët punojnë duke ndihmuar njerëzit të kuptojnë ligjin dhe të përdorin mjetet ligjore të tij. Këta profesionistë punojnë me qytetarët/individët duke kërkuar zgjidhje konkrete për rastet e padrejtësive, shpesh në nivelin e komunitetit, ose administratës.

Referuar punës së paraligjorëve në vendet objekt studimi, këta profesionistë janë përfshirë në komunitet duke punuar kryesisht në zona rurale (Ukrainë, Filipine) dhe me komunitete të margjinalizuara (si Filipine). Gjithashtu, në Ukrainë të ashtuquajturit këshilltarë publikë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore tek ato qytete/fshatra, të cilat nuk kanë qenë lehtësisht të aksesueshme. Nga analiza e mësipërme ka rezultuar se, përfshirja e paraligjorit në punën me komunitetet, ka përmirësuar situatën e tyre në fusha të ndryshme të jetës si, rasti i reformës agrare në Filipine ku paraligjorët këshillonin

komunitetin dhe kjo solli impakt pozitiv tek çështjet e tokës. Rast i ngjashëm ka qenë edhe Sierra Leone, ku paraligjorët kanë pasur një impakt të madh atje si në rastin e parandalimit të punësimit të fëmijëve në miniera, parandalimin e rasteve të korrupsionit, përdhunimit nga forcat e policisë, riintegrimin e individëve të liruar nga burgu, etj. Në rastin e Maqedonisë, paraligjorët romë kanë ndihmuar komunitetin rom me probleme të ndryshme, kryesisht lidhur me të drejtat e tyre shëndetësore. Në të gjitha vendet objekt studimi, këta profesionistë trajnohen si përsa i përket legjislacionit ashtu edhe politikave sociale duke u aftësuar në zgjidhjen në praktikë të çështjeve bazike të komunitetit e duke përdorur mjete dhe strategji për zgjidhjen tyre të tilla si, ndërmjetësimi, organizimi në komunitet, dhe advokimi.

Për t'i ardhur në ndihmë kërkimit lidhur me komunitetet me të cilat paraligjorët mund të punojnë, kemi evidentuar se, në Indonezi dhe Kenia,¹¹⁶ ku përdorimi i drogës është jashtëzakonisht i lartë, nëpërmjet projekteve të organizatave janë vendosur paraligjorë të këtyre komuniteteve për të ndihmuar përdoruesit e drogës që të lirohen nga burgu. Në Kenia dhe Uganda, gjithashtu, paraligjorët ndihmojnë njerëzit e sëmurë që të gëzojnë të drejtat e tyre ligjore. Shoqata e Strehëzave dhe Kujdesit Paliativ në Kenia ndihmon pacientët me probleme që lidhen me pronën, trashëgiminë dhe testamentet, mbrojtjen nga dhuna në familje etj. Një organizatë tjetër keniane, Qendra e Ndhmës Ligjore të Eldoret, funksionon “si një qendër ndalese për trajtimin mjekësor të individëve dhe ofrimin e këshillave ligjore”.¹¹⁷ Rrjeti Uganda për Ligjin, Etikën dhe HIV/AIDS (UGANET) vendos paraligjorët e tij në biçikleta, gjë që u mundëson paraligjorëve që me anë të shërbimeve të tyre të mbulojnë territore në distanca të largëta. Duke veshur xhaketa të veçanta për të identifikuar veten e tyre, paraligjorët ofrojnë ndihmë juridike personave HIV/AIDS, të cilët shpesh ngacmohen dhe dëbohen nga pronat e tyre.¹¹⁸

Qëllimi i të gjithë projekteve të mësipërme në këto vende është që t'i shërbejë personave që kanë nevojë duke sjellë paraligjorët aty ku janë njerëzit. Kjo nuk ka të bëjë me “gjetjen e zgjidhjeve të gatshme, por për të punuar me komunitetet për të identifikuar mënyrat se si ata mund të përdorin ligjin dhe për të punuar për komunitetet”.

Përsa më sipër, sikurse u përmend edhe në pjesët e tjera të studimit, profesioni i paraligjorit duhet të institucionalizohet në Shqipëri për të gjithë rëndësinë që ka ky profesion në rritjen e aksesit në sistemin e drejtësisë në komunitetet më të largëta dhe të grupeve vulnerabël. Në këtë kuadër, referuar edhe studimeve të mësipërme, grupet e marginalizuara kanë më pak akses në ndihmë juridike, konsiderojmë se përfshirja e paraligjorit pranë këtyre komuniteteve është e rëndësishme edhe në Shqipëri me qëllim përmirësimin e të drejtave dhe jetesës së këtyre komuniteteve.

Në Shqipëri, OJF-të, të cilat mund të jenë qendra, shoqata dhe fondacione, kryejnë kryesisht veprimtari në fusha të caktuara si ligjore, sociale, mjedisore etj. Puna e tyre kryesisht është e lidhur

¹¹⁶ Këto shtete nuk ishin objekt studimi, megjithatë për efekt të këtij studimi, për t'i dhënë përgjigje pyetjes lidhur me komunitetet me të cilat mund të angazhohet paraligjori, kemi kryer kërkime të tjera që i përgjigjen kësaj kërkesë.

¹¹⁷ <https://reliefweb.int/report/world/when-fear-being-criminalized-locks-out-healthcare>

¹¹⁸ <https://www.opensocietyfoundations.org/voices/justice-wheels>

ngushtësisht me shërbimin ndaj një komuniteti të caktuar. Nga gjithë eksperiencia thuhet se 30-vjeçare e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, një pjesë e tyre e kanë të përfshirë paraligjorin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të përditshme. OSFA ka pasur disa iniciativa nëpërmjet projekteve të financuara prej saj për të përfshirë profesionin e paraligjorit si pjesë të stafeve të organizatave, duke i ngarkuar edhe me një sërë detyrash që lidhen me funksionin e këtij profesioni. Nga intervistat e realizuara me organizata dhe paraligjorë ka rezultuar se, ky profesion deri diku është i formalizuar në organizatat që e kanë të përfshirë këtë profesionist si pjesë të stafeve të tyre. OJF-të kanë përcaktuar detyra të mirëpërcaktuara, kanë rritur kapacitetet e paraligjorëve në vazhdimësi, por edhe kanë përcaktuar mënyrën e rekrutimit dhe trajtimit financiar të tyre. Ashtu sikurse u përmend në analizën e këtij studimi, disa nga funksionet e paraligjorëve lidhen edhe me edukimin ligjor të komuniteteve apo ndërgjegjësimin e tyre mbi të drejtat, detyrimet, ushtrimin e tyre etj. Disa nga format më të zakonshme të përfshirjes së paraligjorit në shërbim të komuniteteve në Shqipëri janë fushatat e edukimit ligjor apo ndërmjetësimit që OJF-të organizojnë me komunitete të ndryshme të marginalizuara si komuniteti rom, egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, gratë, viktimat me bazë gjinore etj. Gjithashtu, një sërë organizatash ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore duke përfshirë në këto shërbime paraligjorë apo edhe studentë të fakulteteve të drejtësisë, të cilët nuk janë ende të diplomuar në drejtësi, por që kanë marrë trajnime për të ofruar këto shërbime ose për t'u angazhuar në aktivitete ndërgjegjësimi në rrugë (*street law activities*). *Megjithatë*, pavarësisht eksperiencës në praktikë të paraligjorëve si pjesë të organizatave dhe punës së tyre në terren, paraligjori nuk është i parashikuar si profesion në legjislativonin tonë, në këtë mënyrë duke mos u njohur roli i tij nga aktorë të ndryshëm, përveçse nga organizatat.

Përsa më sipër, në rastin e institucionalizimit të profesionit të paraligjorit, konsiderojmë se, paraligjorët në Shqipëri mund të vazhdojnë të përfshihen në veprimtarinë e këtyre organizatave me qëllim që të japin kontributin e tyre në ndihmë të komunitetit.

Lidhur me komunitetet me të cilat paraligjorët mund të punojnë, evidentojmë se, ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti ka parashikuar subjekte të posaçme, të cilët njëkohësisht mund të bëjnë pjesë edhe në komunitete të caktuara si komuniteti rom dhe egjiptian, me anë të të cilave organizatat e shoqërisë civile punojnë duke ofruar shërbime të ndryshme.

Gjithashtu, ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti parashikon kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, si viktimat e dhunës në familje, viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, kategori të caktuar të miturish, persona me aftësi të kufizuara, persona me probleme të shëndetit mendor, personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale (neni 11 i ligjit); persona të diskriminuar, dhe personat me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme (neni 12 i ligjit).

Duke qenë se komunitetet pjesë e skemës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti, marrin shërbime të specializuara nga organizatat, sugjerojmë që këto shërbime të vazhdojnë të ofrohen,

por me qasje tjetër duke parashikuar edhe paralogjorin në këto komunitete dhe forcimin e vetë anëtarëve të këtyre komuniteteve për të advokuar për të drejtat e tyre.

Duke qenë se ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti i ka të përcaktuar në mënyrë eksplicite qytetarët që janë përfitues të ndihmës juridike në varësi të formës së ndihmës juridike të kërkuar, vlerësojmë se është e rëndësishme që paralogjorët të angazhohen jo vetëm në komunitete të përcaktuara në ligj, por edhe komunitete të tjera, që nuk janë të përfshirë në legjislacionin aktual në fuqi. Përfshirja e paralogjorëve në ofrimin e ndihmës juridike për këto komunitete do të përmirësonte jo vetëm situatat individuale dhe të familjeve të tyre, por edhe të shoqërisë dhe komunitetit ku ata jetojnë.

Gjithashtu, komuniteti rom dhe egjiptian janë përfitues të një sërë shërbimesh në ligje të caktuara, por sugjerohet që edhe ky komunitet të ketë paralogjorë që të angazhohen me të gjitha problematikat që ata kanë. Një zgjidhje që do të ndihmonte këtë komunitet është angazhimi i vetë anëtarëve të komunitetit (sugjeruar nga organizatat dhe paralogjorët e intervistuar), me anë të trajnimit dhe aftësimin të tyre me qëllim që ata të marrin rolin e paralogjorit në komunitetin e tyre. Kjo qasje do të shërbejë që të arrihen rezultate konkrete pasi anëtarët e këtij komuniteti duke njohur më mirë problematikat, mentalitetin, edukimin, zhvillimin e tyre do të ndër marrin masa të cilat janë konkrete dhe do të prodhojnë rezultate pozitive për këtë komunitet.

Komunitete të tjera të marginalizuara janë edhe anëtarët e komunitetit LGTBQI, të cilët gëzojnë mbrojtje nga një sërë ligjesh, por duke i lidhur ngushtësisht të drejtat e tyre më çështje të diskriminimit. Mendojmë që edhe kjo është një kategori, e cila ka nevojë që të forcojë kapacitetet e veta duke pasur paralogjorë anëtarë të këtij komuniteti, por edhe paralogjorë, të cilët nuk janë pjesë e këtij komuniteti.

Komunitete të tjera me të cilat paralogjorët mund të punojnë mund të jetë edhe komuniteti i personave që kanë varësi nga lëndët narkotike, të cilët sjellin një sërë pasojash në shoqëri dhe në komunitetin ku ata jetojnë.

Gjithashtu, konsiderojmë se, paralogjorët mund të punojnë edhe me individë që vuajnë sëmundje të shëndetit mendor, apo që kanë sëmundje seksualisht të transmetueshme si HIV/AIDS. Në Shqipëri ka disa organizata, por edhe institucione shtetërore, të cilat ofrojnë shërbime për këto kategori qytetarësh, por kjo nuk është e mjaftueshme kështu që specializimi i një grupi paralogjorësh, të cilët do t'i shërbejnë këtyre komuniteteve do të ndikojë në përmirësimin e jetesës së tyre. Për më tepër, përfshirja e paralogjorëve në këtë komunitet do të shërbejë për fuqizimin e tyre duke ndikuar ndër të tjera edhe në përmirësimin e politikave shtetërore ndaj këtij komuniteti.

Në përfundim, konsiderojmë që paralogjorët të ofrojnë shërbimet e tyre, jo vetëm për kategoritë e personave të parashikuar në ligjin për ndihmën juridike, por edhe për komunitete të tjera si, personat HIV/AIDS, përdoruesit e drogës, komunitetet rom, egjiptian, LGTBQI, personat me aftësi të kufizuara, gratë etj.

B. Kompetencat e paraligjorëve

Nga eksperiencia e organizatave shqiptare me paraligjorë, rezulton se, roli i paraligjorëve konsiston në ofrimin e ndihmës juridike parësore, në edukimin ligjor, apo ndërgjegjësimin e komuniteteve në nevojë për të drejtat e tyre. Ndryshe nga profesione të tjera, paraligjorët kanë një lidhje më të ngushtë me komunitetet kryesisht vulnerabël për të cilët ofrojnë jo vetëm shërbime të ndihmës juridike parësore, por edhe informimin e tyre për të drejtat. Më konkretisht, disa prej detyrave konkrete të paraligjorëve janë, informimi i qytetarit për çështje të rëndësishme ligjore, edukimi ligjor i komunitetit, organizimi i takimeve periodike me komunitetin, identifikimi i rasteve në komunitet, identifikimi i rasteve strategjike, ofrimi i ndihmës juridike parësore për familjet në nevojë, këshillim ligjor, mbledhje informacioni për trajtimin e rastit, hartimi i shkresave të ndryshme, asistimi i avokatit, asistenca e komunitetit për rritjen e aksesit në shërbime sociale e ligjore.

Një rol i ngjashëm i paraligjorit rezulton edhe në vendet objekt studimi si në shtetet ku ky profesion është i institucionalizuar ashtu edhe në shtetet ku paraligjori është punësuar me anë të projekteve të OJF-ve të ndryshme.

Në pjesën II të studimit “Paraligjori në Shqipëri (eksperiencia e organizatave jofitimprurëse dhe paraligjorëve)”, organizatat e intervistuar na kanë dhënë një sërë sugjerimesh lidhur me funksionet që duhet të ketë një paraligjor në rast të institucionalizimit të tij në Shqipëri, duke i parë detyrat e paraligjorit të lidhura ngushtësisht me ofruesin e ndihmës juridike parësore, edukimin e qytetarëve për të drejtat e tyre, marrëdhëniet e drejtpërdrejta me komunitetin.

Bazuar në sugjerimet e OJF-ve të intervistuar, praktikën e paformalizuar të paraligjorit në Shqipëri dhe eksperiencën e vendeve objekt studimi me paraligjorin, rekomandojmë që roli dhe funksionet e paraligjorit të jenë të ngjashme me disa prej funksioneve që paraligjori ka pasur deri tani në praktikë. Gjithashtu, vlerësojmë se, roli dhe detyrat e paraligjorit të konsistojë në fushën ligjore dhe atë sociale. Konkretisht, disa prej funksioneve dhe detyrave të paraligjorit që sugjerohen me anë të këtij studimi janë si vijon:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor i komunitetit;
2. Fuqizimi ligjor i komunitetit;
3. Organizatori komunitar, i cili transferon njohuri ligjore tek komuniteti dhe që bashkë me to advokojnë për të zgjidhur problemet;
4. Komunikimi me qytetarët dhe organizatat për të garantuar akses në shërbime ligjore dhe sociale.
5. Identifikimi i rasteve strategjike që prekin një komunitet;
6. Identifikimi i rasteve në komunitet dhe ofrimi i shërbimeve ligjore të nevojshme;
7. Këshillimi ligjor bazik për zgjidhjen e problemit nëpërmjet dhënies së informacioneve lidhur me legjisllacionin në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në ligj;

8. Orientimi i duhur i qytetarëve për rrugët ligjore që duhet të ndjekin për zgjidhjen e problemit apo mosmarrëveshjes; ofrimi i asistencës së drejtpërdrejtë; shpjegimi me fjalë të thjeshta i procedurës administrative apo ligjore;
9. Hartimi dhe përpilimi i dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore, hartim i shkresave të ndryshme kur rasti nuk paraqet komplikime juridike ose përfshin procedura standarde; Hartimi i shkresave për të mbrojtur çështje të ndryshme administrative lidhur me ofrimin e ndihmës juridike parësore, në raste të thjeshta ligjore, apo për procedura standarde; hartimi i ankesave kundrejt institucioneve shtetërore dhe të pavarura. Informimi i qytetarëve për mbledhjen e dokumenteve të nevojshme;
10. Shoqërimi përpara institucioneve shtetërore, lehtësimi i komunikimit të anëtarëve të zonës ku jeton me institucionet shtetërore dhe, për raste të veçanta përfaqësimi përpara këtyre institucioneve;
11. Referimi i rastit pranë ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore dhe institucioneve përgjegjëse për zgjidhjen e tyre, kur është nevoja për ndihmë më të specializuar;
12. Ofrimi i asistencës për ofruesit e ndihmës juridike parësore dhe dytësore me qëllim lehtësimin e punës së tyre.
13. Identifikimi nëse një çështje duhet ndjekur edhe gjyqësisht, referimi i saj tek avokati; asistenca për avokatin në identifikimin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm; përpilimi i dokumenteve paraprakë për të asistuar avokatin; bashkëpunimi reciprok në grup me avokatin/këshilltarin ligjor.

Lidhur me rolin dhe funksionet e paraligjorit, sugjerojmë që paraligjori duhet të përfshihet në ofrimin e ndihmës juridike parësore nëpërmjet ofrimit të informacionit dhe këshillimit ligjor si dhe duke mbajtur marrëdhënie të drejtpërdrejtë e të ngushtë me komunitetin.

C. Mënyra e punësimit të paraligjorëve

Nga analiza e shteteve objekt studimi është evidentuar se paraligjorët janë të punësuar pranë institucioneve shtetërore (rasti në Sierra Leone ku paraligjorët ofrojnë edukim të përgjithshëm ligjor për të paraburgosurit e vendosur në burgje, apo dhe rasti i Filipineve), pjesë të sistemit të ndihmës juridike (Moldavi), organizatave jofitimprurëse (në të gjitha vendet objekt studimi), zyrave të avokatisë (rasti i Filipineve). Ndërsa, në Shqipëri paraligjorët janë të punësuar vetëm pranë organizatave dhe klinikave të ligjit.

Sugjerojmë që mundësitë e punësimit të paraligjorëve, në rast të institucionalizimit të tij si profesion në Shqipëri, të jenë si më poshtë vijon:

Paraligjori si pjesë e skemës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti

Këtë mënyrë përfshirje të paraligjorit si profesion të posaçëm në LKP, e kemi përmendur edhe në pjesën e mësipërme të studimit ku paraligjorët mund të punësohen në zyrat e ndihmës juridike parësore pranë qendrave të ngritura për këtë qëllim në kuadër të zbatimit të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Gjithashtu, paraligjorët mund të punojnë në klinikat e ligjit dhe pranë OJF-ve të financuara nga Ministria e Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore. Për më tepër, sugjerojmë që ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore të koordinojnë dhe bashkërendojnë punën me qëllim që mos të ketë mbivendosje dhe të gjithë qytetarët në nevojë apo komunitetet e marginalizuara të jenë përfitues të këtyre shërbimeve.

Paraligjorë që punësohen pranë OJF-ve, që punojnë me komunitetet e marginalizuara

Bazuar në eksperiencën e vendeve të tilla si Afrika e Jugut dhe Filipinet, skemat/modelet e paraligjorëve përfshijnë një qasje me bazë komunitare. Një model i tillë bazohet në rritjen e aksesit në drejtësi nëpërmjet fuqizimit ligjor të komunitetit dhe përfshirjes së komunitetit në zgjidhjen e problemeve ligjore dhe vendos theksin tek aftësia unike e grupeve të shoqërisë civile për të kuptuar nevojat e tyre.¹¹⁹

Gjithashtu, bazuar edhe në eksperiencën e vendeve të tjera objekt studimi si dhe eksperiencën e organizatave shqiptare, roli i paraligjorit është parë gjithmonë ngushtë me fuqizimin e komunitetit. Në Shqipëri pjesë e skemës juridike parësore janë vetëm 12 OJF-të,¹²⁰ që janë të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë. Pavarësisht kësaj, aktualisht në Shqipëri ka një numër të konsiderueshëm organizatash të tjera, ofruese të shërbimeve ligjore e sociale dhe që punojnë për komunitetet, por që nuk bëjnë pjesë në 12 OJF-të e autorizuara nga Ministri i Drejtësisë. Referuar kësaj situate, si dhe rolin e paraligjorit me komunitetet, vlerësojmë të rëndësishme që OJF-të ofruese të shërbimeve ligjore dhe sociale të punësojnë paraligjorë me qëllim ofrimin e shërbimeve ligjore falas pranë komuniteteve më të marginalizuara.

Paraligjori si punonjës i institucioneve shtetërore

Ky model paraligjori ka për qëllim që të përdoren kapacitetet dhe burimet njerëzore, financiare e materiale që kanë institucionet shtetërore me qëllim që t'i shërbejë komuniteteve apo adresojë problematikat e komuniteteve të caktuara. Në shtetet objekt studimi, për shembull, Filipine ka zbatuar disa projekte pilot, të cilët kanë rezultuar të suksesshëm përsa i përket garantimit të të drejtave të të akuzuarve të ndodhur në sistemet penitenciare. Në këtë shtet oficerët e policisë gjyqësore kanë shërbyer si paraligjorë në kuadër të këtyre projekteve dhe kanë ndjekur kurse të posaçme trajnimi për të këshilluar dhe ndihmuar të burgosurit apo të akuzuarit, të cilët kanë qenë të izoluar pranë sistemeve penitenciare. Ata kanë luajtur rolin e paraligjorëve dhe në përfundim të

¹¹⁹ <https://www.justiceinitiative.org/uploads/6001868b-f85d-4883-8da7-bdf2ebc93a4c/OSJI-Paralegal-Manual-US-11-05-2014.pdf>

¹²⁰ <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/2020/09/14/regjistri-i-organizatave-jofitimpruresse-qe-ofrojne-ndihme-juridike-paresore/>

projektit ka rezultuar se me përfshirjen e tyre në këto projekte të akuzuarit kanë fituar njohuri më të gjera mbi ligjin dhe të drejtat e tyre.

Duke pasur parasysh sa më sipër, konsiderojmë se, punonjësit shtetërorë të institucioneve shtetërore mund të ushtrojnë funksione dhe detyra të paraligjorit në institucione të tilla si, institute rehabilituese të të miturve, qendra ku janë të strehuar persona të dhunuar me bazë gjinore etj. Kjo është një mundësi alternative punësimi i paraligjorëve, e cila do të varet edhe nga nevojat që ka shteti dhe komunitetet për ndihmë juridike falas.

Gjithashtu, duke pasur parasysh programe të zbatuara nga vende të ndryshme, të cilat kanë rezultuar pozitive, punonjësit e institucioneve shtetërore, mund të përfshihen në ditë apo orë të caktuara dhe të bëjnë punën e paraligjorit (Afrika e Jugut, Filipine). Këto lloj programesh nuk kanë nevojë për financime shtesë, pasi punonjësit e institucioneve lokale apo qendrore do të vazhdojnë të kryejnë të njëjtat detyra, do të jenë pjesë e strukturës së institucioneve, por në ditë të caktuara mund të kryejnë edhe rolin e paraligjorit për komunitete të ndryshme, për shembull, oficerët e policisë gjyqësore.¹²¹ Këta paraligjorë mund të plotësojnë nevojat që kanë qytetarët shqiptarë për ndihmë juridike falas.

Nga eksperiencat e mësipërme të shteteve, përfshirja e institucioneve shtetërore në këtë model paraligjori do të ndihmojë komunitetet që ne përmendëm, si edhe komunitete të tjera që të fuqizohen ligjërisht dhe të advokojnë për të drejtat e tyre. Ky lloj modeli apo programi nuk ka nevojë për kosto të mëdha shtesë financiare dhe është i qëndrueshëm. Këto lloj programesh mund të fillojnë të zbatohen si projekte pilot të financuara nga donatorë të ndryshëm ose edhe vetë shteti mund të ketë kapacitete financiare dhe ekspertizë për t'i ngritur dhe administruar vetë.

Paraligjori si punonjës i zyrave të avokatisë

Sikurse u përmend edhe më sipër, model tjetër alternativ që mund të zbatohet për profesionin e paraligjorit është punësimi në një zyrë avokatie private ku paraligjori të kryejë punë komunitare për komunitetet që nuk përfshihen në ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Ligji për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë parashikon ofrimin e shërbimeve të avokatisë “pro bono” si kredit në përmbushjen e detyrimit për trajnimin vazhdues.

Këto zyra avokatie nëpërmjet orëve *probono* duke përdorur paraligjorët mund të ofrojnë shërbime ligjore falas për individë në nevojë apo komunitete të caktuara, të cilët nuk përfitojnë nga skema e ndihmës juridike të garantuar nga shteti apo nga ligje të tjera të posaçme.

Përfundim: *Nga analiza e shteteve objekt studimi dhe analiza e paraligjorit në Shqipëri kemi evidentuar se paraligjorët, të cilët nuk njihen nga shteti dhe që nuk janë të formalizuar si profesion, hasin një sërë problematikash, duke përfshirë këtu vështirësi edhe në ushtrimin e detyrave të tyre*

¹²¹ Shih më sipër analizën e paraligjorit dhe praktikën përkatëse në Filipine ku oficerët e policisë gjyqësore kanë luajtur rolin e paraligjorit në institucionet penitenciare të vendit

funkcionale. Vlerësojmë se është e rëndësishme që profesioni i paraligjorit të njihet si profesion i posaçëm dhe të përfshihet në skemat e sugjeruara më sipër.

D. Financimi i paraligjorëve

Nga analiza e vendeve objekt studimi, si dhe një kërkim i detajuar që i kemi bërë sistemeve të ndryshme të paraligjorëve në vende të tjera të Evropës, Afrikës e Azisë, vlerësohet se, financimi i paraligjorëve mund të parashikohet me mënyra të ndryshme, duke i përfshirë si pjesë të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me financim nga pushteti qendror edhe lokal, si dhe nga donatorë të ndryshëm. Sugjerimet lidhur me financimin e paraligjorëve në këtë pjesë të studimit janë bërë duke pasur parasysh edhe alternativat e dhëna më sipër lidhur me punësimin e tyre në institucione/organe të ndryshme.

Me qëllim pasjen e një programi të vazhdueshëm e të qëndrueshëm për financimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, si dhe paraligjorin si pjesë e integruar e sistemit të ndihmës juridike konsiderojmë se, ky financim mund të realizohet nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet alokimit të fondeve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike të garantuar nga shteti. Në bazë të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, kjo Drejtori ka kompetencën për menaxhimin e fondeve buxhetore të alokuara nga Ministria e Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike.

Duke pasur parasysh sistemin aktual të ofrimit të ndihmës juridike parësore ku në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë të punësuar dy punonjës me trajnim të posaçëm, një alternativë e mundshme mund të jetë përfshirja e profesionit të paraligjorit në këtë skemë, edhe për efekt të fondeve. Më konkretisht, një zgjidhje praktike në këtë aspekt do të ishte punësimi në këto zyra i një punonjësi me trajnim të posaçëm dhe një paraligjori, me qëllim që buxheti i shtetit jo vetëm mos të preket, por njëkohësisht sistemi të mbetet efektiv. Në rastin e zbatimit të një skeme të tillë detyrat e paraligjorit duhet të jenë të ndryshme nga ato të punonjësit me trajnim të posaçëm. Paraligjori do të mundësojë rritjen e aksesit të qytetarëve në shërbimet e ndihmës juridike parësore. Kjo është një alternativë që sugjerohet duke pasur parasysh edhe shtete si Moldavia, ku paraligjori punësohet si pjesë e ndihmës juridike parësore dhe paguhet nga buxheti i shtetit në bazë të orëve të punës që ai kryen në komunitet. Kjo mënyrë financimi duket e përshtatshme edhe për shtetin shqiptar duke mbajtur në konsideratë nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas.

Në Shqipëri janë ngritur klinikat e ligjit pranë universiteteve shtetërore por edhe private, të cilat bazuar në ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, janë ofrues të ndihmës juridike parësore. Funkcionimi i këtyre klinikave është bërë i mundur nëpërmjet donatorëve të ndryshëm, ku një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Në lidhje me vijimësinë e financimit të tyre, konsiderojmë që në të ardhmen këto klinika të kenë kapacitete dhe organizimin e duhur të brendshëm, me qëllim që të kenë akses në fondet e donatorëve të ndryshëm. Një mënyrë tjetër për financimin e klinikave është edhe përfshirja e tyre si pjesë e

financimeve nga universiteti pranë të cilit funksionojnë, me qëllim që në të ardhmen të punësohen paraligjorë. Paraligjorët do të mundësojnë identifikimin e rasteve nga komuniteti dhe do t'i drejtojnë për zgjidhje pranë klinikave të ligjit.

Në vendin tonë, për garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike, një rol të rëndësishëm e kanë ruajtur edhe OJF ndërkombëtare e vendase. Kështu, donatorë si, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Civil Rights Defenders (CRD), Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), UNWomen etj. Këto organizata nëpërmjet këtyre fondeve kanë mundësuar ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike, të cilën shteti shqiptar nuk ka pasur fonde t'ua garantojë qytetarëve pa të ardhura e pa mjete financiare të mjaftueshme. Në këto kushte, duke pasur parasysh rolin, specializimin, kapacitetet që OJF-të kanë për të punuar me komunitete të caktuara, apo grupe të caktuara vulnerabël, konsiderojmë se një model tjetër financimi për paraligjorët duhet të vijojë nëpërmjet ofrimit të granteve/fondeve nga donatorët. Organizatat mund të trajnojnë anëtarë të komuniteteve me të cilat ata punojnë, të cilët do të marrin rolin dhe funksionin e paraligjorit. Një problematikë që mund të haset në zbatimin e këtyre programeve është paqëndrueshmëria e tyre për shkak të fondeve, të cilat jepen në periudha të caktuara dhe me një vazhdimësi të kufizuar. Për të mundësuar qëndrueshmërinë e këtij profesioni mundësia më e mirë është financimi i tij nga buxheti i shtetit.

Gjithashtu, duke pasur parasysh programe të zbatuara nga vende të ndryshme, të cilat kanë rezultuar pozitive, punonjësit e institucioneve shtetërore, mund të përfshihen në ditë apo orë të caktuara dhe të bëjnë punën e paraligjorit (Afrika e Jugut, Filipine). Këto lloj programesh nuk kanë nevojë për financime shtesë, pasi punonjësit e institucioneve lokale apo qendrore do të vazhdojnë të kryejnë të njëjtat detyra, do të jenë pjesë e strukturës së institucioneve, por në ditë të caktuara mund të kryejnë edhe rolin e paraligjorit për komunitete të ndryshme, për shembull, oficerët e policisë gjyqësore.¹²² Këta paraligjorë mund të plotësojnë nevojat që kanë qytetarët shqiptarë për ndihmë juridike falas.

Në analizën ligjore që i kemi bërë legjislacionit shqiptar kemi rekomanduar që paraligjori mund të përfshihet edhe në zyrat e avokatëve privatë. Zyrat e avokatisë duke përfshirë paraligjorët në punën e tyre, mund të ofrojnë shërbime ligjore falas për individë në nevojë, apo komunitete të caktuara, të cilët nuk përfitojnë nga skema e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Në lidhje me financimin e këtyre zyrave, paraligjorët mund të paguhen nga buxheti që ka çdo zyrë avokatie. Zyrat e avokatisë private nuk sugjerojmë që të kenë akses në fonde shtetërore, apo në thirrjet për aplikime të donatorëve të ndryshëm, por sugjerojmë që përfshirja e paraligjorëve të jetë pjesë e vetë-financimit të tyre të brendshëm. Sugjerimi i mësipërm është një alternativë e mundshme punësimi dhe financimi, si dhe një mënyrë në zbatim të parashikimit ligjor për punët *probono* të avokatëve, ku nëpërmjet identifikimit të rasteve nga paraligjorët, ata do të kenë mundësi të

¹²² Shih më sipër analizën e paraligjorit dhe praktikën përkatëse në Filipine ku oficerët e policisë gjyqësore kanë luajtur rolin e paraligjorit në institucionet penitenciare të vendit.

asistojnë qytetarët falas. Paraligjori mund të paguhet me orë pune, por njëkohësisht duke asistuar avokatin, mund të aftësohet edhe vetë për ofrim të shërbimeve më të specializuara.

E. Trajnimet fillestare e të vazhdueshme

Nga analiza e mësipërme kemi evidentuar se, paraligjorët në shtete të ndryshme, por edhe në Shqipëri ndjekin trajnim fillestar dhe rritje të vazhdueshme të kapaciteteve (trajnim vazhdueshëm). Meqënëse në këtë studim është sugjeruar formalizimi i këtij profesioni, do të ndalemi edhe në aspektin e shkollimit dhe trajnimeve të këtij profesioni.

Kemi evidentuar se në disa shtete paraligjorët kanë përfunduar studimet bachelor për drejtësi apo studime të tjera të fushave sociale (Moldavi), por ka edhe shtete ku paraligjorët nuk kanë përfunduar programet e ciklit të parë apo të dytë të studimeve (Sierra Leone).

Nga intervistimi i organizatave në Shqipëri kemi informuar se, paraligjorët që kanë një diplomë bachelor janë më efektiv në punën e tyre, pasi ofrojnë ndihmë juridike paraprake më të plotë që lidhet me dokumentacionin e procedurat, duke ofruar jo vetëm ndihmë juridike parësore por edhe duke lehtësuar punën e ofruesve të ndihmës juridike parësore apo edhe dytësore.

Lidhur me trajnimin e paraligjorëve në Sierra Leone trajnimet realizohen nga OJF të ndryshme, nga Instituti i Trajnimit Gjyqësor dhe Ligjor ose në një institucion tjetër të miratuar nga Bordi (neni 30 i ligjit paragrafi 2 i ligjit për ndihmën juridike të Sierra Leone). Çdo paraligjor duhet gjithashtu të akreditohet në Bordin e Ndihmës Juridike.

Në Filipine, universitetet kryesisht private parashikojnë një program të trajnimit të paraligjorëve. Për të qenë një paraligjor në Filipine duhet të përfundohen studimet bachelor në shkencat sociale, ose në ligj. Programi i Trajnimit Paraligjor, kryesisht në universitete është krijuar për t'u dhënë pjesëmarrësve të saj njohuri themelore dhe praktike për konceptet ligjore thelbësore që i përkasin qeverisë; sistemit gjyqësor; procedurave civile, penale dhe kuazi-gjyqësore; juridiksionit tënjësive të qeverisjes vendore; standardet etike të gjyqtarëve, avokatëve dhe nëpunësve civilë; dhe rregullat, rregulloret dhe procedurat e agjencive të ndryshme administrative. Në fund të programit, pjesëmarrësit pritet të kenë zhvilluar aftësitë e mëposhtme: të identifikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë fushat e konflikteve të zakonshme në punën si paraligjorë; dhe për të përpunuar transaksione të zakonshme juridike me gjykatat gjyqësore dhe agjencitë qeveritare. Kurset për t'u bërë paraligjorë janë të ndryshme dhe variojnë nga njëri universitet në tjetrin. Universitete të caktuara kërkojnë nga pjesëmarrësit në këto trajnime që të ndjekin njëzet e gjashtë (26) seanca tre-orëshe, që mbulon një periudhë prej tre muajsh. Programi është hapi i parë në një shkallë të programeve të specializuara të trajnimit për zhvillimin e profesionit paraligjorë në Filipine.

Sa më sipër, duke pasur parasysh eksperiencën e vendeve objekt studimi, konsiderojmë se programet e trajnimit, duhet të jenë fillestare e të vazhdueshme.

Në lidhje me trajnimin fillestar, sugjerojmë se mund të ofrohet dhe të realizohet nga sistemi i ndihmës juridike falas. Aktualisht, ky sistem ofron trajnime për ofruesit e ndihmës juridike parësore dhe është duke hartuar kurrikula të posaçme trajnimi. Kurrikulat për paraligjorët duhet të përfshijnë njohuri bazë mbi sistemin juridik në përgjithësi dhe fusha specifike të ligjit. Kurrikulat sugjerohet të hartohen nga akademikë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile ofrues të shërbimeve ligjore si dhe përfaqësues nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, si dhe nga ekspertë të së drejtës. Gjithashtu, paraligjorët sugjerohet të trajnohen nga staf akademik, të cilët kanë edhe eksperiencë praktike të zbatimit të legjislacionit, avokatë të organizatave të shoqërisë civile dhe praktikantë, ofrues të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, apo praktikantë ofrues shërbimesh në komunitete.

Gjithashtu, programe të tilla duhet të përfshijnë edhe aftësim praktik të tyre ku sugjerohet angazhimi pranë klinikave të ligjit pjesë e universiteteve, qendrave të ndihmës juridike parësore dhe organizatave të licencuara për ofrimin e shërbimeve ligjore parësore falas.

Trajnimi fillestar sugjerohet të jetë në formën e një kursi të përcaktuar në bazë të orëve të dedikuara për paraligjorin. Kohëzgjatja e këtij kursi/trajnimi mund të variojë nga gjashtë muaj deri në një vit, ose me një kohëzgjatje më të gjatë. Gjatë kryerjes së trajnimit fillestar, paraligjorët duhet të supervizohen nga profesionistë të ligjit si avokatë dhe të kryejnë orë praktike pranë klinikave, organizatave të shoqërisë civile, apo edhe zyrave të shërbimeve të ndihmës juridike parësore. Praktikimi i pjesës teorike është shumë i rëndësishëm dhe sugjerohet që alternimi i praktikës me teorinë të jetë në kohëzgjatje të njëjta (për shembull, 3 orë teori dhe tre ore praktikë në zyrat e mësipërme).

Këto programe duhet të kenë kurrikula të mirëpërcaktuara, që lidhen me të drejtat e qytetarëve, procedurat e nevojshme që duhen ndjekur në gjykatë apo institucione të ndryshme, funksionimin e sistemit ligjor, fusha të ndryshme të së drejtës si ajo familjare, civile, penale, administrative, ndërmjetësim, advokim, por edhe metoda sesi intervistohen klientët, analiza e provave, këshillimi ligjor, përgatitje kërkesash etj. Gjithashtu, paraligjorët duhet të marrin njohuri për të drejtat e komuniteteve të marginalizuara si viktimat e dhunës, trafikimit, komunitetit rom, egjiptian, fëmijët që kanë vepruar në kundërshtim me ligjin etj. Në kurrikulat e paraligjorëve mund të përfshihen edhe raste studimore, simulimet dhe luajtja e roleve. Rastet studimore dhe simulimet mund të ndihmojnë gjithashtu në përcjelljen e shembujve të përsëritjes së situatave me të cilët paraligjorët mund të ndeshen në punën e tyre. Këto metodika kanë për qëllim aftësimin praktik të paraligjorëve, për shembull luajtja e roleve për të zhvilluar aftësitë e paraligjorëve për të intervistuar dhe marrë deklaratat. Në këto raste paraligjorëve u kërkohet të luajnë rolin e tyre, ose dhe të klientit.

Një formë trajnimi apo praktimi i njohurive të marra mund të jetë përfshirja e paraligjorëve në aktivitete të informimit në rrugë (*street law activities*), fushatat ndërgjegjësuese, fushata të edukimit ligjor etj.

Në përfundim të këtyre programeve, sugjerojmë që paraligjorët të pajisen me certifikatë, që do të vërtetojë ndjekjen e këtyre kurseve/trajnimeve dhe aftësimin e paraligjorëve për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore si dhe të mundësojnë për pasojë punësimin e tyre me komunitete të marginalizuara.

Së fundi, sugjerojmë që paraligjorët të kryejnë trajnime të vazhdueshme, që do të ofrohen nga OJF, donatorë të ndryshëm (rasti i Sierra Leone), por edhe institucione shtetërore apo vetë universitete publike e private.

KONKLUSIONE DHE SUGJERIME

- 1- Rekomandojmë që në listën e profesioneve të parashikohet edhe një grup njësi i ri profesioni i posaçëm që do të emërtohet “paraligjor”, i cili mund të përfshihet në fushën ligjore ose sociale, me veprimtari të lidhur ngushtësisht me komunitetin. Ky profesion sugjerojmë të parashikohet në LKP si pjesë e grupit të vogël të profesioneve me kod profesioni 341 “Specialistë ligjor, të punës sociale dhe të fesë”, pas grupit-njësi profesioni me kod profesioni 3412 “Asistentë, specialistë të punës sociale”, ose në mënyrë alternative, mund të parashikohet si shembull punësimi profesioni.
- 2- Paraligjorët mund të ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e ndihmës juridike parësore, OJF dhe klinikat e ligjit.
- 3- Paraligjorët mund të punësohen në qendrat e ndihmës juridike parësore, klinikat e ligjit, zyra avokatie, institucione shtetërore, OJF të autorizuara si ofrues të ndihmës juridike parësore dhe OJF që punojnë me komunitete të ndryshme, por që nuk janë pjesë e skemës së ndihmës juridike.
- 4- Financimi i paraligjorëve mund të kryhet nëpërmjet alokimit të fondeve nga pushteti qendror edhe lokal si dhe nga donatorë të ndryshëm.
- 5- Programet e trajnimit të paraligjorëve konsiderojmë se, duhet të jenë fillestare e të vazhdueshme, të ofruara dhe të certifikuara nga institucione të akredituara. Trajnimi fillestar sugjerojmë që të ofrohet dhe të realizohet nga sistemi i ndihmës juridike falas. Trajnimi i vazhdueshëm sugjerojmë që të ofrohet nga OJF, donatorë të ndryshëm, por edhe institucione shtetërore apo vetë universitete publike e private.

ANEKS 1

PYETËSOR PËR PARALIGJORIN NË SHQIPËRI DHE MUNDËSINË E INSTITUCIONALIZIMIT TË TIJ

A. PYETJE TË PËRGJITHME PËR PARALIGJORIN

- 1- Cila është organizata që ju drejtoni dhe çfarë shërbimesh ofron organizata?
- 2- A e keni përfshirë paraligjorin në projektet tuaja?
- 3- Sipas mendimit tuaj, çfarë është paraligjori? Ju lutem, sipas mendimit dhe eksperiencës tuaj, jepni një përkufizim të përgjithshëm në lidhje me paraligjorin.
- 4- Cili ka qenë roli i paraligjorëve në projektet që organizata ka pasur?
Çfarë shërbimesh/detyrash/funksioni kanë kryer paraligjorët (në fushën ligjore, sociale etj., paraligjorë në punë komunitare)?
Si janë përzgjedhur paraligjorët për kryerjen e shërbimeve/detyrave në fjalë?
A kanë qenë paraligjorët të trajnuar për kryerjen e shërbimeve? Kush i ka trajnuar për kryerjen e shërbimeve?
A ka/ka pasur persona të tjerë në organizatë që kryejnë të njëjtat detyra/shërbime si ai i një paraligjori?
- 5- Nga studimi i kryer deri më tani rezulton se paraligjori nuk është parashikuar si profesion i veçantë në Listën Kombëtare të Profesioneve dhe as në akte të tjera ligjore. Duke pasur parasysh punën dhe eksperiencën e organizatës tuaj, sipas mendimit tuaj, a konsideroni se është e nevojshme që të parashikohet dhe të njihet në legjislacionin paraligjori si një profesion i veçantë? Lutemi listoni arsyet?

B. PYETJE LIDHUR ME MUNDËSINË E INSTITUCIONALIZIMIT TË PARALIGJORËVE

- 6- Duke pasur parasysh eksperiencën e organizatës që ju drejtoni, dhe nëse konsiderojmë se profesioni i paraligjorit institucionalizohet, sipas mendimit tuaj çfarë është; si duhet të jetë/të parashikohet paraligjori në kontekstin shqiptar?
Cilat mund të jenë funksionet/roli/detyrat që mund të ketë një paraligjor – në fushën ligjore, sociale apo fusha të tjera?
A mundet të përfshihet paraligjori në ofrimin e shërbimit ligjor parësor? Në punë me komunitet (*community-based paralegal*)? Etj.
(Pyetjet në pikën 6 të pyetësorit janë të lidhura edhe me pyetjet e mëposhtme të ngritura në pikat 7 dhe 8).

7- Ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti parashikon se ndihma juridike parësore do të ofrohet pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore nga punonjës që do të marrin trajnim të posaçëm, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe nga klinikat ligjore të themeluara pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Sipas mendimit tuaj, ku mund të punësohen paraligjorët (ku mund të ofrojnë më mirë punën/shërbimin e tyre paraligjorët) - pranë organizatave jofitimprurëse, klinikave ligjore, apo pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, apo në të gjitha opsionet e mësipërme?

A konsideroni të përshtatshme edhe punësimin e paraligjorëve në zyra avokatie me anë të punës pro bono?

A konsideroni të përshtatshme punësimin e paraligjorëve në struktura/institucione shtetërore?

Në të gjitha mundësitë e mësipërme të punësimit, sipas mendimit tuaj si konsideroni se duhet të punësohen paraligjorët?

Në të gjitha mundësitë e mësipërme të punësimit, çfarë funksioni/roli duhet të ketë paraligjori?

8- Nisur nga eksperiencia e organizatës që ju drejtoni, duke pasur parasysh kontekstin shqiptar dhe nevojat e grupeve të marginalizuara, a konsideroni të përshtatshëm punësimin e paraligjorit në organizata jofitimprurëse [të cilat ofrojnë shërbime ligjore apo dhe shërbime në fusha të tjera si sociale apo mjedisore], duke u përfshirë në punë komunitare që t'i shërbejnë një grupi vulnerabël të caktuar sipas fushës së veprimtarisë së organizatës, pra duke u përfshirë edhe në aktivitete të tjera që i shërbejnë komunitetit dhe që fuqizojnë komunitetin?

Me cilat komunitete konsideroni se mund të punojë një paraligjor?

A konsideroni se një paraligjor mund të punojë edhe me komunitete të tjera, të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në Ligjin për Ndihmën e Garantuar nga Shteti (nenet 11 dhe 12 të ligjit)?

Si konsideroni se mund të tërhiqen anëtarët e komuniteteve të marginalizuara për t'u bërë paraligjorë? Për shembull, a mund të jetë një formë e tillë i tërheqjes së tyre nëpërmjet ofrimit të trajnimeve falas apo trajnimeve falas dhe bursave, apo dhe forma të tjera?

9- Nëse paraligjorët punojnë në institucione shtetërore, në çfarë fushash dhe çfarë funksioni/roli mund të përfshihen paraligjorët?

A do të kenë nevojë për trajnime shtesë këta paraligjorë nëse punojnë pranë institucioneve shtetërore? Cili institucion/organ shtetëror do të zbatojë këtë model/program paraligjorësh në institucionet shtetërore?

- 10- A konsideroni se duhet të institucionalizohen dy profesione të ndara: (a) profesioni i paralogjorit, dhe (b) profesioni i një paralogjori të posaçëm – paralogjori që punon në komunitet (*community-based paralegal*)?
Apo konsideroni se është i mjaftueshëm institucionalizimi i një profesioni të vetëm - paralogjorit duke parashikuar si detyrë të tij edhe ofrimin e shërbimeve në komunitetet e margjinalizuara etj.?
- 11- Në bazë të eksperiencës tuaj si konsideroni se do të ishte më e përshtatshme financimi i paralogjorëve: nëpërmjet një alokimi të veçantë në buxhetin e shtetit (nëse paralogjorët do të kenë si funksion të tyre kryesor ofrimin e ndihmës ligjore parësore), apo forma të tjera (grante/fonde të OJF-ve e klinikave të ligjit etj.)?
- 12- Sipas eksperiencës dhe mendimit tuaj, cilat duhet të jenë kriteret për të ushtruar profesionin e paralogjorit?
A është e domosdoshme pasja e një diplome bachelor në fushën ligjore/sociale etj.? A është i nevojshëm trajnimi i posaçëm?
Çfarë kurrikulash janë të nevojshme për trajnimet/kurset fillestare dhe të vazhdueshme të paralogjorëve?
A duhet të jenë këto trajnime/kurse në formën e kualifikimeve profesionale (*vocational training*) apo si diplomë universitare? Çfarë forme konsideroni se është më e përshtatshme dhe më fizibël në Shqipëri?
A duhet bërë një certifikim i paralogjorëve nga institucionet kompetente shtetërore në mënyrë ligjore?
A duhet bërë trajnimi nga institucionet shtetërore apo nëpërmjet mënyrave të tjera – organizata jofitimprurëse etj.?
A konsideroni se për ushtrimin e profesionit të paralogjorit dhe për t’u bërë paralogjor duhet patjetër një diplomë universitare apo është i mjaftueshëm edhe vetëm një kualifikim profesional me anë të një kursi (*vocational course*)?
Sipas mendimit tuaj, cili do të jetë interesi i universiteteve në ngritjen e këtyre programeve? Për shembull, a do të kenë universitetet mjaftueshëm kandidatë që do të paguajnë për këto kurse/trajnime apo këta persona do të financohen nga shteti? Nëse pranohet si formë financimi nga shteti, nëpërmjet kujt sistemi/buxheti?
A konsideroni se universiteti që do të ofrojë këto kurse duhet të japë një diplomë/certifikatë në fund të kursit si një provë se personi në fjalë fiton titullin paralogjor?
Kush do të organizojë kurset/trajnimet?
Cilat institucione do të lëshojnë certifikatat/diplomat?

ANEKS NR. 2

Dinamika e numrit të çështjeve të ndjekura nga avokatët dhe paraligjorët e TLAS gjatë vitit 2019 dhe gjatë gjithë vitit:

TLAS														
Përmbledhje e shërbimit të çështjeve për vitin 2019	2019													
Çështje të ndjekura nga	Status	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj	Në 21 vite
Avokatët	Të hapura	118	158	188	221	246	272	301	304	337	368	387	403	10193
	Të mbyllura	10	22	45	67	94	124	152	157	192	227	262	299	10089
	Aktive	108	136	143	154	152	148	149	147	145	141	125	104	104
Paraligjorët	Të hapura	323	463	554	632	756	873	964	970	1077	1190	1298	1336	15760
	Të mbyllura	50	107	185	245	365	491	603	732	898	1000	1078	1161	15585
	Aktive	273	356	369	387	391	382	361	228	179	190	220	175	175
Të kombinuara	Të hapura	441	621	742	853	1002	1145	1265	1274	1414	1558	1685	1739	25953
	Të mbyllura	60	129	230	312	485	615	755	889	1090	1227	1340	1460	25696
	Aktive	381	492	512	542	517	530	510	385	324	331	348	279	279

TLAS_LLOJET E ÇËSHTJEVE_2019

Llojet e çështjeve	Paraligjorë	Avokatë	Totali
Regjistrimi i lindjes së fëmijëve	457	73	530
Regjistrime të tjera civile	167	32	199
Zgjidhje martesë	243	90	333
E drejta familjare	108	187	295
Strehimi/Mirëqenia	159	0	159
Mbështetje psikologjike	3	7	10

Të tjera	199	14	213
Totali: 2019	1336	403	1739

TLAS_TARGET-GRUPET_2019

Target-Grupet	Paraligjorë	Avokatë	Totali
Fëmijët	457	73	530
Kryefamiljaret	277	118	395
Persona me aftësi të kufizuara	17	1	18
Të papunët	287	138	425
Personat e moshuar pa të ardhura financiare	45	2	47
Pensionistët	61	3	64
Familje të tjera të varfra	192	68	260
Totali:2019	1336	403	1739

ANEKS NR. 3

TË DHËNA TË PARAQITURA NGA TLAS

Themelimi i një programi paraligjor


Konceptimi i programit paraligjor

- Qëllimi;
- Shtrirja gjeografike;
- Baza institucionale;
- Biblioteke e programit me materiale, manuale, materiale trajnuese; Kodet përkatëse të procedurave, Legjislacioni i mbrojtjes sociale, etj.;
- Vendosja e procedurave administrative;
- Sistem i menaxhimit të rasteve ;
- Sistem i mbajtjes së dosjeve;
- Procedura financiare;



Buxhetimi: Pagat, ekspertizat, shpenzimet operacionale, pajisjet, publikimet, shpenzimet e udhëtimit, kostot e trajnimeve etj;

Sigurimi i resurseve:

- Donatorë;
- Ndihmë nga shteti, biznesi privat etj;
- Plane dhe strategji për ngritjen e fondeve;



ANEKS NR. 4
STRUKTURA TLAS (Anglisht dhe Shqip)



BIBLIOGRAFIA

LIGJE

- 1- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- 2- Ligj nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- 3- Ligji Nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”
- 4- Ligj nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” datë 22.5.2015
- 5- VKM nr. 514/2018 “Për listën e profesioneve”
- 6- Ligji mbi Ndhimën Juridike Falas i Maqedonisë (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 161/2009, 185/2011 dhe 27/2014)
- 7- Ligj nr. N 3460-VI, datë 2 qershor 2011 “Ligji i Ukrainës mbi ndihmën juridike falas”
- 8- Ligj i Moldavisë për ndihmën juridike të garantuar nga shteti
- 9- Ligji mbi Ndhimën Juridike Falas i Filipineve
- 10- Ligji mbi Ndhimën Juridike Falas i Afrikës së Jugut
- 11- Ligji mbi Ndhimën Juridike Falas i Sierra Leone

RAPORTE

- 1- Raporti mbi Zbatimin e Ligjit të Maqedonisë mbi Ndhimën Juridike Falas në vitet 2016-2017, Botim i Fondacionit Shoqëria e Hapur Maqedoni dhe Bashkimit Evropian
- 2- Raporte të Fondacionit Shoqëria e Hapur në vendet objekt studimi për paralogjin
- 3- Raport i ndërmjetëm monitorimi “Mbi ngritjen dhe funksionimin e aktorëve përgjegjës të ofrimit të ndihmës juridike parësore”, Komitetit Shqiptar i Helsinkit, Maj 2020.
- 4- Studim mbi aksesin në drejtësi, Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri, 2017
- 5- Raport “Monitorimi i zbatimit të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, në kuadër të ofrimit të ndihmës juridike parësore”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, Nëntor 2019
- 6- Raport Studimor “Për aksesin në drejtësi të grupeve vulnerabël” [Aksesi në drejtësi për kategorinë me të ardhura të pakta ose të pamjaftueshme, bazuar në Ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti”], Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Shkurt 2019
- 7- Legal Needs in Albania, Insights from a nationwide survey, Instituti Liberal Shqiptar, Tiranë, 2019
- 8- Progres-raportet e Komisionit Evropiane për Shqipërinë 2018-2020

FAQE INTERNETI

www.ligjet.org

www.qbz.gov.al

<https://www.eurailus.eu/index.php/en/>

https://www.undp.org/content/dam/ukraine/docs/seichasen_4708604_eng_international_study_legal_aid_systems.pdf

<https://www.undp.org/content/dam/ukraine/docs/DG/12.%20UNDP-IRF%20manual-%20centres%20legal%20consultations%20eng.pdf>

<https://spp.ceu.edu/sites/spp.ceu.hu/files/attachment/basicpage/2536/legalempowermentleadershipparticipants handbook2017.pdf>

https://www.oa.edu.ua/en/student/en_studorganizations/probono_en

<https://pinchukfund.org/en/projects/13/>

<https://www.justiceinitiative.org/uploads/ce76d68b-747d-4743-a594-4cd18d1759cb/improving-pretrial-justice-20120416.pdf>

<https://www.kmu.gov.ua/en/reformi/verhovenstvo-prava-ta-borotba-z-korupciyeyu/zabezpechennya-rivnogo-dostupu-do-pravosuddya-ta-pravovoyi-dopomogi>

<https://www.lw.com/admin/Upload/Documents/Global%20Pro%20Bono%20Survey/pro-bono-in-ukraine.pdf>

<https://o.canada.com/opinion/columnists/ian-mulgrew-ukraine-turns-to-b-c-for-legal-aid/wcm/900c0be1-b4d6-441c-a84a-82c6fbc8c020>

<https://www.coe.int/en/web/national-implementation/interviews/andriy-vyshnevsky-2016-ukrainian-legal-aid-system>

<https://www.opensocietyfoundations.org/uploads/575ab024-f0c1-4114-9a71-fc3b420593bd/community-legal-ukraine-20160920.pdf>

<https://www.justiceinitiative.org/uploads/1ad25cfb-f315-45cb-9d0a-fe0c5d3e1af2/fact-sheet-justice-implementation-partnerships-20130319.pdf>

<https://www.justiceinitiative.org/voices/access-justice-advances-ukraine>

<https://www.youtube.com/watch?v=1nLjcZcJsc>

<https://www.undp.org/content/dam/ukraine/docs/DG/12.%20UNDP-IRF%20manual-%20centres%20legal%20consultations%20eng.pdf>

<https://osgf.ge/en/where-an-open-society-scholarship-can-take-you/>

<https://legalaid.gov.ua/ua/holovna/178-hruden-2017/2159-pershi-hromadski-radnyky-v-ukraini-proishly-navchannia>

<https://legalaid.gov.ua/ua/component/content/article/146-news/novyny/traven-2017/2029-v-ukraini-hotuiut-treneriv-merezhi-paraiurystiv-pershyi-navchalnyi-treninh-proishov-na-chernihivshchyni>

<https://legalaid.gov.ua/ua/holovna/2113-v-ukraini-vpershe-rozpochato-navchannia-hromadskykh-radnykiv>

https://www.irf.ua/novyny/komanda_yaka_zminit_spriynyattya_prava_v_kievi_obgovorili_instytut_gromadskikh_radnykiv/

<http://www.vin.gov.ua/neës/ostanni-novyny/17583-na-vinnychchyni-aktyvno-rozvyvaietsia-institut-hromadskykh-radnykiv>

https://www.irf.ua/novyny/vidkrita_diskusiya_trendi_v_gromadakh_dosvid_gromadskikh_radnykiv/

<http://fosm.org.mk/CMS/Files/Documents/Monitoring-report-2017-eng1.pdf>

<https://www.coe.int/en/web/cdcj/support-to-legal-aid-reforms-in-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia>

[https://z-p4-cdn.fbsbx.com/v/t59.2708-21/50233093_2515034091871896_804101805767131136_n.pdf/fYROM_Law-on-Free-Legal-Aid_2009_en.pdf?nc_cat=106&nc_ht=z-p4-cdn.fbsbx.com&oh=ea0fb3a97779182eac37ea899475fddb&oe=5C4E302C&dl=1file:///C:/Users/user/AppData/Local/Packages/Microsoft.MicrosoftEdge_8wekyb3d8bbwe/Temp/State/Downloads/Pravo_Eng%20\(1\).pdf](https://z-p4-cdn.fbsbx.com/v/t59.2708-21/50233093_2515034091871896_804101805767131136_n.pdf/fYROM_Law-on-Free-Legal-Aid_2009_en.pdf?nc_cat=106&nc_ht=z-p4-cdn.fbsbx.com&oh=ea0fb3a97779182eac37ea899475fddb&oe=5C4E302C&dl=1file:///C:/Users/user/AppData/Local/Packages/Microsoft.MicrosoftEdge_8wekyb3d8bbwe/Temp/State/Downloads/Pravo_Eng%20(1).pdf)

<https://acjr.org.za/resource-centre/formalising-the-role-of-paralegals-in-africa-a-review-of-legislative-and-policy-developments>

<https://www.coe.int/en/web/national-implementation/interviews/andriy-vyshnevsky-2016-ukrainian-legal-aid-system>

<https://www.lawyer-moldova.com/2012/10/law-on-state-guaranteed-legal-aid.html?m=1>

<https://www.rechtsanwaelte.at/en/support-and-services/services/arrest-hotline/>

<http://www.cnajgs.md/en/structure/page/nlac>

http://www.rvr.org/binaries/content/assets/rvrorg/informatie-over-de-raad/legalaid-brochure_online--2015.pdf

http://ec.europa.eu/civiljustice/legal_aid/legal_aid_por_en.htmfile:///C:/Users/user/Downloads/Legal%20Needs%20Full%20Report%E2%80%94Draft.pdf

https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH_Shkurt-2018.pdf?fbclid=IwAR189w-hT9Q7CSJhC_BScb_IKZRj53xLwa1UzAS6F_gUaac1c9ZCEk29KE

https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/12/Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim--Komiteti-Shqiptar-i-Helsinki.pdf?fbclid=IwAR01icImjhy1kUa8nsK-VY6S6j--hh8YO35-Lat FAIf7diZr_ofEe_n2Xo

https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/07/Mbi-ngritjen-dhe-funksionimin-e-aktor%C3%ABve-p%C3%ABrgjegj%C3%ABs-t%C3%AB-ofrimit-t%C3%AB-ndihm%C3%ABs-juridike-par%C3%ABsore.pdf?fbclid=IwAR1YtbTaZzXXqDUDBggv6QLIVvlpVvraBkjSZ0Z5sH_MbrhPQP_lu-9jT0

<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/12/Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim--Komiteti-Shqiptar-i->

[Helsinki.pdf?fbclid=IwAR3INChZ64nmYQ39wsVN7XtdRRvSpFd8ILJDQ-jlBIGro-Yek5nJJy4WSpQ](https://www.justiceinitiative.org/uploads/f65afb31-a77c-4a06-ab08-b4277d404f52/between-law-and-society-20100310.pdf)

<https://www.justiceinitiative.org/uploads/f65afb31-a77c-4a06-ab08-b4277d404f52/between-law-and-society-20100310.pdf>

<https://advocaidsl.org/access-to-justice/>

<https://www.opensocietyfoundations.org/uploads/a9195295-e66e-4108-a8ef-a82db21f47ba/community-legal-sierraleone-20160920.pdf>

<https://namati.org/wp-content/uploads/2019/03/Sierra-Leone-Community-Paralegal-Research-Brief-Final.pdf>

<https://www.justiceinitiative.org/uploads/6001868b-f85d-4883-8da7-bdf2ebc93a4c/OSJI-Paralegal-Manual-US-11-05-2014.pdf?fbclid=IwAR1G4INPAQU31BkQj2-uG7è fyMvea2emKclKRJJC9nRWZIV5pm2Gxr37KE>

<http://www.accesstojustice.africa/countries/sierra-leone/>

<http://www.sierra-leone.org/Laws/2012-06.pdf>

<https://www.justiceinitiative.org/voices/new-legal-aid-law-sierra-leone-embraces-role-paralegals>

<https://namati.org/wp-content/uploads/2012/09/Final-Timap-Manual-June-2012.pdf>

<https://namati.org/wp-content/uploads/2014/10/Daniel-A-STORY-FROM-THE-FIELD-final.pdf>

<http://www.accesstojustice.africa/countries/sierra-leone/>

https://acjr.org.za/resource-centre/formalising-the-role-of-paralegals-in-africa-a-review-of-legislative-and-policy-developments?fbclid=IwAR3RRgN3ds6TLg2eq3QRsmT7ohTMS98 ItRjWXEKB37e8r ILzEC_YcXXIk

http://www.internationallegalaidgroup.org/images/miscdocs/LEGAL_AID_BOARD_COUNTRY_REPORT_2016_Final.pdf

<https://thecalabashnewspaper.com/sierra-leone-news-legal-aid-board-staff-benefit-from-undp-funded-capacity-building-training/>

https://namati.org/resources/community-paralegals-recognition-and-financing/?fbclid=IwAR0pCwsr9J-zOPH3atQO8kGbdw2gV04dXg_LobRWEfz588V8aE9c5AGzJWc

https://namati.org/wp-content/uploads/2016/01/sierra_leone_robb-jackson.pdf

<https://namati.org/wp-content/uploads/2012/01/rep-2007-access-africa-and-beyond-en1.pdf>

<https://namati.org/resources/guidance-note-paralegal-intervention-in-defending-community-rights-in-land-acquisition-cases/>

<https://namati.org/wp-content/uploads/2012/09/Leitner-handbook-justice-peace-commission.pdf>

<http://sierraexpressmedia.com/?p=80285>

<https://www.undp.org/content/dam/undp/library/Democratic%20Governance/Legal%20Aid%20Service%20Provision%20-%20A%20Guide%20on%20Programming%20in%20Africa.pdf>

<http://www.osiwa.org/>

<https://www.refworld.org/pdfid/46725d142.pdf>

<https://matsne.gov.ge/en/document/download/21604/11/en/pdf>
<https://www.osce.org/odihr/36297?download=true>
<http://georgiatoday.ge/news/10975/Free-Legal-Aid-Now-Available-by-Phone-for-Georgian-Citizens?fbclid=IwAR1-i6isY3XwByqhfl0oMWQQqOH38Rx08H0rLVGZw5NQceexk5DzQhphkec>
https://www.undp.org/content/dam/georgia/docs/publications/DG/UNDP_GE_DG_Early%20Access%20to%20Legal%20Aid%20Eng.pdf
https://eeas.europa.eu/delegations/georgia/36552/legal-aid-service-parliament-and-eu-mark-150000th-free-legal-consultation-legal-aid-service_en
<https://rm.coe.int/georgia-barriers-remedies-and-good-practices/168075fd52?fbclid=IwAR0HhAPhy4WuYsc5v5Kw8H0OS-akGTLQcixoeS4J-2GtDLgYRQpuRIyuFsY>
https://www.undp.org/content/dam/ukraine/docs/seichasen_4708604_eng-international_study-legal_aid_systems.pdf
<https://rm.coe.int/georgia-barriers-remedies-and-good-practices/168075fd52>